



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE
DHE SHKENCAVE HUMANE



III - 2019



NATYRA DHE KULTURA

III - 2019

NATYRA DHE KULTURA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI
"FAN S. NOLI", KORÇË
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE
SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE

**“ARRITJE DHE SFIDA NË FUSHËN E STUDIMEVE
SOCIOLOGJIKE NË SHQIPËRI: PROF. DR. ZYHDI
DERVISHI, PROTAGONIST DHE MODEL I NJË
STUDIUESI TË SUKSESSHËM”**



**UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE
SHKENCAVE HUMANE**

NATYRA DHE KULTURA 3

(BOTIM I VEÇANTË)

AKTET E KONFERENCËS SHKENCORE
KOMBËTARE “ARRITJE DHE SFIDA NË FUSHËN E
STUDIMEVE SOCIOLOGJIKE NË SHQIPËRI: PROF.
DR. ZYHDI DERVISHI, PROTAGONIST DHE MODEL
I NJË STUDIUESI TË SUKSESSHËM”

Botim i veçantë i buletinit shkencor të Universitetit “Fan S.
Noli)

REDAKSIA PËR BOTIM:

Prof. dr. ALI JASHARI
Prof. dr. GJERGJI PENDAVINJI
Prof. dr. LORENC EKONOMI
Prof. dr. GJERGJ SINANI
Dr. MAGDALINI VAMPA
Dr. EDA STASA
Dr. ARTO ADILI
Dr. RAFAIL PRODANI
Dr. ARBEN GJATA
Dr. MARIA DOJÇE

PËRGATITI PËR BOTIM:

EFTIONA BYLYKBASHI

SHTËPIA BOTUESE:

ISSN: 2078-7111

Korçë, 2020

NATYRA DHE KULTURA 3



TABELA E PËRMBAJTJES

FJALA PËRSHËNDETËSE.....	10
Prof. dr. Sabri LAÇI.....	10
NJË JETË PËR ARSIMIN, EDUKIMIN E KULTURËN SHQIPTARE (FJALË PËRSHËNDETËSE).....	16
Prof. as. dr. Arsim Sinani	16
PROF. DR. ZYHDI DERVISHI – LENTE INTELEKTUALE BASHKËKOHORE NË SOCIOLOGJINË SHQIPTARE (REFERATI KRYESOR)	18
Prof. dr. Altin SHEGANI.....	18
(REFERATE).....	24
Prof. dr. Gjergji Pendavinji.....	24
ARRITJET METODOLOGJIKE TË KËRKIMIT NË SHKENCAT SOCIALE (Referuar veprimtarisë kërkimore të prof. dr. Zyhdi Dervishit).....	24
PËRMASAT SOCIALE TË NJOHJES SHKENCORE NË VEPRËN “SOCIOLOGJI SHKENCE 1” TË PROF. ZYHDI DERVISHIT	41
IRENA NIKAJ	41
PROFILE TË DUKURIVE FAMILJARE NË SHOQËRINË SHQIPTARE NË STUDIMET E PROF. DR. ZYHDI DERVISHIT	62
Dr. Blerina Hamzallari.....	62
(KUMTESA).....	92
PABARAZITË GJINORE NË KËNDVËSHTRIMIN SOCIOLOGJIK TË ZYHDI DERVISHIT	92
Dr. Merita Poni	92

MJESHTËRIA E ANALIZËS SOCIOLOGJIKE NË TEKSTIN MONOGRAFI “VËSHTRIME TË KRYQËZUARA NË DET” OSE “SOCIOLOGJI KULTURE 1”	102
Dr. Brunilda ZENELAGA	102
KOMUNIKMI SIMBOLIK: E PADUKSHMJA SOCIOLOGJIKE NË STUDIMET E ZYHDI DERVISHITDr. Eriseld KALEMAJ	115
ZYHDI DERVISHI DHE STUDIMI SOCIOLOGJIK I KONFLIKTEVE NË SHOQËRINË SHQIPTARE.....	126
Dr. Darina Çoni (Kacollja)	126
DIVERSITETI NËNKULTUROR: KËNDVËSHTRIME KONCEPTUALE MBI KULTURËN SHQIPTARE NË STUDIMET SOCIOLOGJIKE TË ZYHDI DERVISHIT	133
Dr. Denisa Titili	133
Dr. Maria Dojçe	133
RILEVIMI I PROFILEVE THELBËSORE TË HARMONISË NDËRFETARE TË SHQIPËTARËVE NË STUDIMET E SOCIOLOGUT ZYHDI DERVISHI	142
Doktorante BLERINA MUSTAFALLARI (KËRÇUKU)	142
PERCEPTIMI DHE PRIRJA NDAJ VULLNETARIZMIT TE QYTETARËT E KOSOVËS DHE VIZIONE TEORIKE TË SOCIOLOGUT ZYHDI DERVISHI	153
Doktorante ARBENITA SYLEJMANI- NIMANI.....	153
TRADITA E MIRËBËRËSISË KORÇARE DHE REFLEKSIONE MBI VULLNETARIZMIN NË STUDIMET E SOCIOLOGUT ZYHDI DERVISHI	165

Msc Jorida TOLLKUÇI.....	165
INTEGRIMI SHOQËROR I EMIGRANTËVE SHQIPTAR NË TERRITORE TË NDRYSHME SHOQËRORE (KRAHASIM, RASTI I ITALISË DHE I TURQISË EDHE NËPËRMJET STUDIMEVE TË SOCIOLOGUT ZYHDI DERVISHI).....	175
Msc. Eneida Binaj.....	175
PARAGJYKIMET KRYESORE QË PENGOJNË PËRPARIMIN E VAJZAVE DHE GRAVE NË KARRIEREN POLITIKE E PROFESIONALE, NË SKANERIN E STUDIMEVE TË SOCIOLOGUT ZYHDI DERVISHI.....	183
Amarda Likaj	183
MOTIVE SHOQËRORE NË POEZINË E ZYHDI DERVISHIT	191
Sadik Bejko.....	191
SHQETËSIME PËR PROBLEME SHQIPTARE DHE TË PËRBOTSHME NË POEZINË E ZYHDI DERVISHIT Sazan Goliku.....	200
PERCEPTIMI DHE FORMA ‘KENNING’ NË KRIJIMTARINË E ZYHDI DERVISHIT Prof. dr. Fatmir Terziu.....	210

FJALA PËRSHËNDETËSE

Prof. dr. Sabri LAÇI

Dekan i fakultetit Filologjik

Universiteti i Tiranës

I nderuar Rektor i Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, Prof. dr. Ali JASHARI,

I nderuar Dekan i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, Prof. dr. Gjergji PENDAVINJI,

I nderuar Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, Prof. dr. Edmond RAPTI,

Të dashur studentë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Prej disa vitesh, Universiteti “Fan S. Noli” organizon tubime shkencore dhe promovuese, sa interesante e gjithëpërfshirëse, aq edhe me vlera akademike dhe profesionale. Kjo evidenton qartë rolin e Korçës si njëri prej poleve më të rëndësishme kulturore, shkencore dhe universitare të Shqipërisë, si dhe vizionin e autoriteteve dhe organeve drejtuese të universitetit për identifikimin dhe vlerësimin e kontributeve shkencore të pedagogëve,

departamenteve dhe fakulteteve të universiteteve të mbarë hapësirës shqiptare.

Përzgjedhja e Prof. dr. Zyhdi Dervishit, njëri prej sociologëve më të spikatur të ditëve të sotme, si figurë qendrore e tubimit të sotëm, është, pa asnjë dyshim, gjetje origjinale dhe meritë e veçantë e Rektorit të Universitetit “Fan S. Noli”, Prof. dr. Ali Jashari, e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane, Prof. Dr. Gjergji Pendavinji, e pedagogëve të departamentit të Shkencave Sociale të atij fakulteti.

Universiteti i Tiranës dhe të gjitha universitetet e tjera në hapësirën shqiptare në Ballkanin Perëndimor jo vetëm duhet ta kenë zili Universitetin e Korçës, por duhet ta falënderojnë e ta shohin atë si model shumë të mirë të punës shkencore kreative, si shembull bashkëpunimi ndëruniversitar dhe promovimi për personalitetet e shquara të botës akademike shqiptare.

Të nderuar pjesëmarrës,

Ndjehem i privilegjuar që ndodhem para jush për t’ju përshëndetur dhe për të folur, qoftë edhe fare shkurt, për Prof. dr. Zyhdi Dervishin. Kur mu propozua që të përshëndesja këtë konferencë shkencore, në qendër të të cilës është një personalitet i botës universitare shqiptare, përjetova një ndjesi të veçantë: diçka që bashkon dëshirën për të paraqitur një profil sa më të plotë e objektiv për Prof. dr. Dervishin, me përgjegjësinë për ta shprehur atë thjeshtë dhe qartë për audiencën dhe lexuesin. Në fakt, nuk janë të pakta rastet kur kam folur e shkruar për kolegë dhe studiues. Zaten, në profesionin tonë, kjo është krejtësisht e zakonshme. Por të flasësh dhe shkruash për Zyhdi Dervishin nuk është aspak e lehtë: një profesor i shkëlqyeshëm; një

studiues skrupuloz; një drejtues shkencor i palodhur, i duruar, inkurajues dhe shumë i kujdesshëm; një bashkëbisedues i vëmendshëm, bindës dhe mirëkuptues; një akademik me kulturë të thellë dhe shumëdimensionale; një humanist i vërtetë, shok besnik dhe mik i çmuar.

Së pari, dëshiroj t'ju bëj me dije se profesorin e kam njohur para rreth dyzet vjetësh, kur sapo kisha filluar studimet në Universitetin e Tiranës. Ju siguroj se, që prej asaj kohe, e kam parë atë jo vetëm si një koleg e mik, por edhe si një model të shkëlqyer të profesorit dhe studiuesit, gjithmonë në kërkim të së resë, të së vërtetës, të së bukurës, të së veçantës, të së rëndësishmes.

Së dyti, para kolanës së veprave të tij të shumta dhe voluminoze (në dijeninë tonë, Prof. dr. Dervishi është më prodhimtari ndër profesorët e gjeneratës së tij) jam ndjerë vazhdimisht i mahnitur: diversiteti i temave sociale dhe kulturore të trajtuara prej tij është i jashtëzakonshëm; falët janë të zgjedhura dhe frazat të qarta e të rrjedhshme; forma e paraqitjes dhe stili i të shkruarit janë krejt origjinale; përmbajtja dhe struktura e punimeve janë logjike dhe korrekte; temat, çështjet, nënçështjet dhe gjithçka tjetër janë në koherencë të plotë; titujt, ballinat, ilustrimet janë gjetje që spikasin, plot domethënie dhe në funksion të çështjeve të trajtuara; referencat janë kurdoherë të qarta dhe korrekte, deri në perfeksion; burimet e shfrytëzuara janë të panumërta e të shumëllojshme, aq sa të befasojnë.

Natyrshëm, kujt do i lind pyetja: ku e ka gjetur kohën ky njeri për t'i lexuar tërë ato libra, revista e artikuj; për t'i konsultuar tërë ato materiale arkivore; për t'i bërë tërë ato intervista; për t'i realizuar tërë ato emisione televizive e radiofonike; për të takuar tërë ata njerëz, brenda dhe jashtë shtetit; për t'i shkruar ato mijëra faqe

Dhe përgjigja është vetëm një: prof. Zyhdi Dervishi është një studiues i pazakontë, vullneti i tij është i jashtëzakonshëm; krijimtaria e tij është e pashtershme, sepse ai është një njeri që beson tek e vërteta, që i do njerëzit pa asnjë paragjykim, që e do punën, shkencën, universitetin, një njeri me kurajë qytetare të pashoqe, jo konformist dhe që e do me shpirt vendin dhe kombin e tij, një njeri i prirë dhe i vendosur për të bërë sa më shumë punë dhe vepra të mira e të dobishme.

Sigurisht që vlerat e një studiuesi maten me krijimtarinë shkencore që realizon, në pikëpamje të cilësisë dhe sasisë. Unë kam pasur fatin t'i përcjell hap pas hapi dhe me shumë vëmendje të gjitha botimet e Prof. dr. Dervishit, madje, për ndonjë prej tyre kam qenë edhe recensent. Jam i sigurt se kushdo që i ka lexuar veprat e tij, bashkohet me mua në vlerësimin se çdo libër i Prof. dr. Zyhdi Dervishit është jo vetëm një dritare për të parë dimensionin social dhe kulturor të botës shqiptare në evolucion, në gjendjen e sotme dhe në perspektivë, por edhe për të depërtuar në brendësi të komuniteteve, kategorive sociale dhe të shoqërisë në tërësi, për të kuptuar deri në detaje dukuritë dhe proceset, konfliktet dhe pajtueshmëritë, tradicionalen dhe modernen, trashëgiminë dhe risitë, që shfaqen e përjetohen në mënyra të ndryshme, në rrethanat e transformimeve herë graduale e herë të vullshme të shoqërisë shqiptare, sidomos që nga koha e shpalljes së Pavarësisë, në nëntor 1912. Përmes leximit të shkrimeve të Prof. dr. Dervishit, evolucioni i shoqërisë shqiptare shfaqet si në një ekran gjigand, ku mund të vërehet jo vetëm gjithë spektri i zhvillimeve në nivel makro, por edhe imtësitë, në kuptimin e historive të jetës së personave, familjeve dhe të kategorive sociale të veçanta. Qasja e tij ndaj çështjeve socialkulturore është e gjerë dhe e thellë, kurdoherë origjinale dhe vizionare.

Së treti, dimensionimi human i Zyhdi Dervishit është mbresëlënës. Kushdo që, ashtu si unë, ka pasur rastin t'i drejtohet atij për një këshillë, ndihmë, sqarim a mbështetje, besoj se ka gjetur gatishmërinë e plotë e të pakushtëzuar të Prof. dr. Dervishit për të ofruar gjithçka që ka qenë në dorën e tij, me shumë thjeshtësi e dashamirësi, me objektivitet e saktësi, madje duke të trajtuar si të barabartë e në një frymë shumë miqësore. Efekti i sugjerimeve të tij është gjithmonë i dukshëm, përmirësues dhe inkurajues.

Shumicën e librave Prof. dr. Dervishi i ka botuar me shpenzimet e tij dhe qindra kopje të tyre i ka dhuruar për bibliotekat, universitetet dhe shkollat e nivelit parauniversitar, për kolegët dhe studentët, për kërkuesit shkencor dhe lexuesit e të gjitha kategorive. Jam i sigurt se kjo sjellje e prof. Dervishit frymëzohet nga bindja e tij se të shkruash e të botosh është e pamjaftueshme. Për të, rëndësi ka që librat të jenë në dorë të lexuesve, për t'u bërë të dobishëm në punën dhe jetën e gjithsecilit. Një shkencëtar si Zyhdi Dervishi nuk ka dhe nuk mund të ketë kurrë në plan të parë fitimin, interesin material, por ka mbi gjithçka zbulimin e së vërtetës dhe përhapjen e dijes kudo dhe kurdoherë.

Një pjesë të madhe të kohës së tij shumë të çmuar, Prof. dr. Dervishi ia ka kushtuar në vazhdimësi drejtimin shkencorë të studentëve, redaktimit të artikujve dhe përgatitjes për botim të revistave shkencore, përgatitjes së opionencave, artikujve për mediat, realizimit të bisedave me nxënës, studentë e grupe të tjera lexuesish, pjesëmarrjes në emisione televizive e radiofonike, përgatitjes dhe paraqitjes së kumtesave dhe referateve në tubime shkencore të të gjitha niveleve, vizitave në terren dhe komunikimit drejtpërdrejt me individë nga më të ndryshmit, grupe sociale etj. Çdo punë

që bën Prof. dr. Dervishi është e rëndësishme dhe e vlefshme, por në këtë rast dëshirojmë të evidentojmë faktin që shumica dërmuese e tyre janë vullnetare.

Të nderuar pjesëmarrës,

Sa më sipër, besojmë se nxjerrë në pah disa nga atributet e Prof. dr. Dervishit, por ju siguroj se çfarë kemi shkruar është fare pak për të prezantuar në mënyrë të plotë këtë personalitet të shquar të shkencës dhe botës universitare shqiptare, këtë humanist të spikatur të ditëve të sotme. Personalisht ndjehem krenar, më shumë se kurrë, për kolegun dhe mikun tim dhe tuajin, Prof. dr. Zyhdi Dervishi, prandaj dëshiroj t’ju falënderoj ngrohtësisht për mundësinë që me dhatë për të folur para jush, si dhe t’i uroj Profesorit suksese të mëtejshme.

Faleminderit për vëmendjen!

Suksese konferencës!

NJË JETË PËR ARSIMIN, EDUKIMIN E KULTURËN
SHQIPTARE (FJALË PËRSHËNDETËSE)

Prof. as. dr. Arsim Sinani

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti Filozofik

Departamenti i Antropologjisë

Drejtor i Institutit për studime sociale e humanistike

Më ka bërë shumë përshtypje perceptimi i problematikave që i ka shtjelluar me shumë kujdes profesori i nderuar Zyhdi Dervishi në kontinuitet të veprimtarisë së tij. E kam thënë dhe po e përsëris në këtë shkrim timin, për te dhe për veprën dhe punën e tij, se në shoqërinë shqiptare vlerësimet vijnë pas vdekjes. Mirë do të ishte që te rasti i profesor Zyhdi Dervishi kjo mos të ndodhte, pasi ai është një intelektual dhe një studjues mjaft i rëndësishëm dhe kontributi i tij për kulturën, arsimin dhe shoqërinë shqiptare është shumë i madh.

E kam ndjekur me vëmendje një kohë të gjatë dhe më ka bërë shumë përshtypje qetësia e profesor Zyhdi Dervishi, edhe sot nuk e kuptoj këtë qetësi se si ka mundur një njeri, intelektual, në këtë kaos që ka kaluar shoqëria shqiptare të jetë kaq i qetë dhe të vazhdojë të punojë pavarësisht nga këto sfida.

Në të vërtetë shoqëria shqiptare në kontinuitet ka një konflikt, i cili për arsye të ndryshme shpesh di edhe të shpërthejë në pakuptimin e saj. Këtu, mendoj se duhet shikuar puna e profesorit sepse ai është imponuar me

qetësinë e tij, jo pse ka bërë mijëra faqe të cilat do u mbeten gjeneratave që vijnë, por për rezistencën e tij që të vazhdojë punën intelektuale në vitet e një tranzicioni i cili nuk po merr fund. Të jesh intelektual në shoqërinë shqiptare është mjaft e vështirë, ka plot sfida, dhe si i tillë kjo qetësi e studiuesit Zyhdi Dervishi, flet shumë se kah duhet të lëvizim ne si shoqëri.

Modeli që na ofron në librat e tij është një thirrje e vazhdueshme për kaosin e shoqërisë shqiptare, për këtë mënyrë të keqe që po ua lëmë pas brevaze duke pasur mundësi që të marrim modelin e profesorit dhe të brezit të tij, që kanë kaluar mjaft sfida por që kanë arritur të vazhdojnë punën e tyre dhe të na motivojnë, që mbi të gjitha shoqëria shqiptare ka nevojë për njerëz racionalë, për njerëz të cilët e dijnë se çfarë kërkojnë dhe kah duhet ta lëvizin vendin tonë, Shqipërinë.

Them se mbeten në mendimin tim të parë se professor Zyhdi Dervishi mbetet një monument i rëndësishëm i kulturës dhe shkencës shqiptare, sepse vepra e tij mbetet gjëja më e shtrenjtë që ai si korife na e lë të shtruar për të vazhduar më tutje. Pasi ka një tendencë në shoqërinë shqiptare se gjithcka fillon me mua dhe përfundon poashtu me individin. Këtë mesazh e kemi brenda punës së tij, që na thërret që të vazhdojmë atë që e kemi gjetur dhe të kërkojmë më tutje, rrënjët tona dhe të mirën e të vlefshmen si vlerë të shoqërisë shqiptare.

PROF. DR. ZYHDI DERVISHI – LENTE
INTELEKTUALE BASHKËKOHORE NË
SOCIOLOGJINË SHQIPTARE (REFERATI KRYESOR)

Prof. dr. Altin SHEGANI
Fakulteti Juridik
Universiteti i Tiranës

Të nderuar autoritete drejtuese të Universitetit “Fan S. Noli”
të Korçës,

Të nderuar profesorë, të nderuar studentë, të nderuar
pjesëmarrës në konferencë

Personalisht ndjehem i privilegjuar të jem mes jush (është
hera e parë që ndodhem në një auditor të Universitetit të
Korçës) dhe i surprizuar pozitivisht në fakt, sepse më në fund
në mënyrë shumë bujare dhe emancipuese na dëshmuat ne
pedagogëve të Universitetit të Tiranës, se si duhet t'i
nderojmë e respektojmë universitarët. Është formati më
domethënës, mënyra që ju keni përzgjedhur që nëpërmjet një
Konference Shkencore Kombëtare, të nderoni ata që kanë
kontribuar për dijen. Njeriu i dijes për konvencion nderohet
me dije. E kuptueshme kjo në rastin e formatit intelektual të
çdo profesori që lidhet në mënyrë shpirtërore me
universitetin edhe për faktin se shkalla e emancipimit të një
shoqërie të caktuar, në një farë mënyre, dëshmohet edhe nga
qasja e saj ndaj universitetit. Nuk ka dhuratë më të çmuar
sesa të shkruash për njerëzit e mençur të vendit tënd. Që prej
kohës që jam pjesë e stafit të Universitetit të Tiranës, kam
përjetuar me kënaqësi faktin që, Universiteti ndjehej i
nderuar të kishte në gjirin e tij Prof. Zyhdi Dervishin. Ftesat
e përhershme që kam marrë nga Departamenti i Sociologjisë
për pjesëmarrje në evenimente shkencore, kanë qenë një
dhuratë e çmuar për mua. Natyrisht përveç faktit se kam
patur nderin të jem një ndër lexuesit e botimeve të profesorit,
kam njohur profesorin me moral të kristaltë universitar, që
ka gjeneruar me një dashuri të veçantë dije, aq të dobishme

për studentët tanë dhe jo vetëm. Shkencat sociale në Shqipëri, e njohin me plot të drejtë, si një nga “etërit themelues” të sociologjisë në Shqipëri.

Pa dashur t’i jap aktivitetit të sotëm sensin e garës ndërmjet institucioneve, mendoj se do të kishte qenë kuptimplotë që këtij aktiviteti në Korçë, t’i kishte paraprirë Universiteti i Tiranës, shtëpia e dijes ku profesori aktualisht jeton dhe kontribuon profesionalisht. Kjo për të mos harruar format e përkujdesjes dhe dashurisë për universitarët, të cilët kanë transmetuar dijen me shumë bujari, por jo gjithmonë janë vlerësuar për këtë gjë. Kjo vlen edhe për personazhe të tjerë të lidhur ngushtë me dijen universitare. Gjithsesi, vlerësuar në total, përsëri gjen kuptim që nderohet një universitar model brenda gjeografisë universitare të vendit tonë. Të përshkruash, vlerësosh dhe analizosh personalitetin e Prof. Dr. Dervishit, është sa e thjeshtë dhe e vështirë. E thjeshtë, sepse dëshmohet individ model i qytetarisë, model i intelektualit lider në kërkimin dhe produktin shkencor; E vështirë, sepse fuqia e fjalëve të mia nuk është shteruese.

Modest në zgjedhjen që ka bërë për të treguar shkëlqimin e tij intelektual, Prof. Dr. Zyhdi Dervishi është nder ato figura universitare që i bën nder Universitetit, i jep dinjitet atij dhe është vlerë e shtuar për çdo auditor. Pjesë e emocionit të përbashkët universitar, ka ditur të paraqesë një profil të njeriut të përkushtuar pas dijes dhe universitetit në veçanti. Pjesa më e rëndësishme e forcës së personalitetit të tij intelektual, është ajo kushtuar dijes universitare, forcë e cila ka gjeneruar dashuri e kurajë për të mbjellë farën e mirë të së drejtës dhe humanes mbi të cilat mbështetet rendi moral i gjërave në shoqëri. Është pikërisht ajo që duhet të bëjë çdo intelektual e universitar sot dhe nesër për Shqipërinë tonë. Rrugëtimi akademik i profesor Zyhdi Dervishit, është mbresëlënë, nga pikëpamja e kohës së maturimit të ideve të tij në funksion të dijes universitare dhe nga pikëpamja e shëndetit dhe higjienës morale të produktit shkencor. Një lloj prirje rebele, e njeriut që nuk i dorëzohet vështirësive, që e

karakterizon profesorin në qasjen e tij ndaj kujdesit për të prodhuar dije sociologjike me të cilat ka një raport simbiotik, ka bërë që ne të kemi botime të spikatura për auditorin universitar dhe jo vetëm. Në këtë mënyrë ka mundur të ndërtojë shëmbëlltyrën e sjelljes intelektuale që funksionon më së miri ndaj elementeve të rendit moral. Pikërisht këtë rend moral ofron edhe demokracia, e cila si sistem politik dhe si formë e shfaqjes së filozofisë së lirisë, në kodin e saj gjenetik të funksionimit, nuk bën dot pa qasjen sociologjike që i paraprin logjikës dhe optikës së ligjit. Prof. Dr. Zyhdi Dervishi, është thirrur si ekspert nga organizmat kombëtare e ndërkombëtare, pikërisht për kontributin dhe eksperiencën e veçantë në fushën e shkencave sociale në përgjithësi dhe sociologjisë në veçanti.

Me fillimin e proceseve demokratizuese, që në vitin 1991, profesor Zyhdi Dervishi është angazhuar tërësisht në hartimin e programeve dhe teksteve mësimore për lëndët e sociologjisë që do të integroheshin si pjesë e formatit të edukimit, në shkollat e mesme dhe të larta në Shqipëri. Prej vitit 1995 deri në vitin 2018 ka hartuar 4 tekste sociologjike për shkollat e mesme, të cilët kanë zëvendësuar njëri-tjetrin. Në formatin e edukimit sociologjik në shkollat e mesme përmes këtyre teksteve, janë parashtruar koncepte dhe teori kryesore sociologjike bashkëkohore të cilat janë plotësuar duke u harmonizuar me analiza sociologjike origjinale të dukurive të zhvillimit të shoqërisë e veçanërisht të kulturës shqiptare. Këto njohuri sociologjike, sipas përlllogaritjeve, janë transmetuar në vite, tek rreth 750 000 nxënës të shkollave të mesme në Shqipëri. Profesori ka shkruar disa tekste dhe punime monografike në fusha të ndryshme të sociologjisë. Veçanërisht në studimet monografike janë trajtuar probleme të rëndësishme të zhvillimit të shoqërisë, të kulturës shqiptare. Punimet monografike janë bazuar në studimet e drejtpërdrejta të profesorit, në mjedise nga më të ndryshmet ku punojnë dhe jetojnë shqiptarët, në burime arkivore e statistikore të shumëllojshme, në shfrytëzimin e

një literature të pasur. Tekstet mësimore të tij, janë përdorur dhe përdoren si literaturë nga studentë të disa degëve në Universitetin e Tiranës, në Universitetin Mjekësor të Tiranës, në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Elbasan, në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, në Degën Shqipe të Mësuesisë në Universitetin e Podgoricës, Mali i Zi, etj. Libri monografik “*Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik*” demonstroi një analizë komplekse sociologjike, juridike dhe psikologjike të përfshirjes së vajzave dhe grave shqiptare në luftë dhe specifikisht në jetën politike. Krahasimi me realitetet e disa shoqërive të tjera më të urbanizuara, ofrojnë një tablo të detajuar të mendësive të shoqërisë shqiptare që pengon përparimin e vajzave dhe grave në karrierën politike. Monografia “*Vullnetarizmi-ind shumëfunksional i shoqërisë*”, shtjellon një qasje analitike teorike origjinale, sipas të cilës shoqëria nuk mund të funksionojë pa frymën altruiste të veprimtarive të ndryshme vullnetare. Në këtë punim, mbizotëron ideja se veprimtaria shkencore, ka profil altruist më të spikatur sepse arritjet shkencore i shërbejnë të gjithëve. Ky libër është botuar edhe i përkthyer në gjuhën angleze, në Berlin të Gjermanisë.

Libri “*Lente të ndërveprimit simbolik*” përfaqëson një përpjekje të suksesshme për të shpjeguar dukuritë, prirjet e zhvillimit dhe funksionimit të shoqërisë nëpërmjet dritës së simboleve kulturore. Në rrjedhën e historisë, shqiptarët kanë zhvilluar një fond shumë të pasur simbolesh kulturore origjinale, që të zbusnin efektet negative të fjalëve të rënda, fyese e deri mohuese. Funksionimi i shoqërisë tradicionale shqiptare, nuk do të mund të shpjegohej pa deshifruar kuptimet e simboleve kulturore me përdorim krahor, rajonal, mbarëkombëtar. Në radhët e kësaj monografie argumentohet se mjaft të vërteta, mund të zbulohen duke evidentuar kontradiktat ndërmjet mesazheve që përcillen me dokumente të ndryshme, nga njëra anë dhe mesazheve që përcillen nëpërmjet komunikimit simbolik nga ana tjetër.

Risi është edhe ofrimi i mekanizmit metodologjik simbolik për të kuptuar më në thellësi, dukuritë shoqërore.

Trendi i botimeve të këtij njeriu na dëshmon interesin e lartë shkencor dhe ndjesinë e veçantë për të ndërtuar “*lente*” sociologjike, nëpërmjet të cilave vëzhgohet ndërveprimi i raporteve sociale. Këto dhe gjithë botimet e përmendura më sipër, janë shprehje e lirisë për dijen, pasionit për ta krijuar dhe për ta interpretuar atë, jo vetëm në simbolet e saj. Ky produkt domethënës sociologjik, dëshmon një kontribut të spikatur, emancipues për sociologjinë dhe antropologjinë. Aktiviteti i profesorit është një burim krenarie për të gjithë ne sepse, falë këtij njeriu, pedagogu e studiuesi të spikatur dhe tepër domethënës në kontributin e tij profesional, shkencat sociologjike shqiptare kanë një bibliografi të tërë në dispozicion, gurë themeli për zhvillimet e ardhshme në fushën e shkencave sociale shqiptare. Kjo është një dhuratë domethënëse që i shërben shumë bibliotekës së brezave të sotëm dhe të ardhshëm, duke i orientuar në kërkimin e rrënjëve të shoqërisë shqiptare, në ecejaket historike kulturore të saj.

Duke e njohur si pedagog e studiues që nuk ka bërë kurrë kompromis me rutinën, rehatllëkun, besoj shumë se do të kemi përpara botime të tjera të formatit të konsoliduar sociologjik dhe jo vetëm nga profesori. Mbase do të kemi ndonjë botim edhe si kontribut ndaj premisave sociologjike në procesin e ligjërjes. Kur them këtë kam parasysh dobishmërinë e konkluzioneve sociologjike si ekskluzive në procesin e ligjërjes. Dimensionin kulturor dhe i mendimit të një shoqërie, në kuadrin e procesit të juridizimit të saj, si në çdo shoqëri tjetër, është shumë i ndjeshëm për ligjërjen. Ligjërja, duhet të mbajë parasysh këtë format pothuajse të munguar në ditët që jetojmë.

Në çdo gjë që do të shtoja veçse do ta bëja më të gjatë fjalën time, por jo më të bukur, të paktën aq sa meriton të njihet dhe të nderohet kontributi i këtij njeriu në terrenin e shkencave sociale shqiptare, kështu që për këtë arsye, po e

mbyll këtu duke falënderuar Universitetin e Korçës “Fan S. Noli”, edhe një herë, për gjetjen dhe leksionin shume origjinal që na dhanë sot, duke nderuar një pedagog dhe studiues të Universitetit të Tiranës.

(REFERATE)**Prof. dr. Gjergji Pendavinji****ARRITJET METODOLOGJIKE TË KËRKIMIT NË SHKENCAT SOCIALE (Referuar veprimtarisë kërkimore të prof. dr. Zyhdi Dervishit)****Abstrakt**

Shkencat sociale dhe humane kanë në vetvete një problematikë të gjerë metodologjike, e cila ka qënë dhe është në vëmendje të studiuesve duke përpunuar mjaft koncepte, teori e teknika efikase për njohjen e dukurive të fushës sociale. Çështjet metodologjike janë vënë në funksion të zgjerimit të njohurive, duke e bërë sa më efektive njohjen e dukurive komplekse të shoqërisë njerëzore. Kështu edhe shoqëria shqiptare është zhvilluar përmes proceseve të ndërlikuara sociale, historike e kulturore, njohja e thelluar e të cilave ka vënë para provës së vërtetë studimet sociale në shoqërinë shqiptare. Në këtë përpjekje shkencore, veçanërisht pas vitit 1990, ne shohim një punë serioze studimore duke përruar një varg studimesh të reja të fenomeneve sociale dhe humane, si dhe projekte kërkimi në këto fusha. Një vend të nderuar, të padiskutuar dhe të merituar ka studiuesi dhe kolegu ynë Zyhdi Dervishi, profesor, doktor pranë Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës si dhe profesor i ftuar i Universitetit të Korçës. Puna e tij e gjithanshme dhe arritjet shkencore të veprave të tij janë vënë në vëmendjen dhe fokusin e analizës së kësaj konference shkencore pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane të këtij Universiteti. Në këtë referat

do të dëshiroja të trajtoja disa nga arritjet e këtij studiuesi në fushën metodologjike si dhe evidentimin e ndikimeve që ato kanë patur në studimin e dukurive sociale të shoqërisë shqiptare të shtrira edhe mbi një platformë ndërdisiplinare si etnologjia, antropologjia, kulturologjia etj. Interesi dhe pritshmëritë e kësaj konference do të jenë mjaft të rëndësishëm dhe dobipurës për ecurinë e studimeve sociale në Shqipëri.

1.Hyrje

Në se i referohemi situatës së trashëguar në veprimtarinë shkencore pas vitit 1990 në vendin tonë, konstatohej një prapambetje e theksuar konceptuale për sa i përket ecurisë së shkencave sociale dhe humane. Parimet metodologjike të drejtimit dominoheshin nga dogmatizmi dhe koncepte të prapambetura e të ideologjizuara që këshillonin marksizëm-leninizmin si e vetmja “metodologji shkencore”, e detyrueshme për kërkimet në këto fusha. Nga ana tjetër, konstatohej një vakum teorik e metodologjik në përdorimin e koncepteve e parimeve të përpunuara të metodës shkencore në kërkime. Kjo sillte jo pak vështirësi në këtë proces ku duhej punuar me shumë përgjegjësi e kompetencë profesionale. Shkencat sociale e humane në këtë etapë kishin hyrë në një proces të rëndësishëm dhe kishin marrë një hov të madh në studimin e shoqërisë, të veprimtarive humane në tërësi. Ndërsa situata në vendin tonë ishte shumë larg këtyre zhvillimeve. Lypsej një kapërcim i guximshëm dhe i përshpejtuar për ta futur dhe orientuar punën shkencore në drejtimin e duhur. Kjo situatë i angazhoi dhe i vuri para sprovës së madhe studiuesit e rinj që kishin vuajtur pasojat e dogmatizmit, por që ndjenin dhe kuptonin më mirë nevojën e ndryshimit. Në këtë përpjekje shohim një grup të ri

studiuesish, të fakultetit përkatës të Universitetit të Tiranës, ndër të cilët edhe studiuesi Zyhdi Dervishi.

Në aspektin e metodës ky studiues ka meritën se ka trajtuar në gjërësi e thellësi në një numër shkrimesh dhe punimesh monografike çështje bazike të metodave të kërkimit sociologjik, duke u ndalur në shpjegimin teorik të tyre. Por ajo që ka më tepër rëndësi është përpunimi i tyre në përputhje me veçoritë e kulturës shqiptare, një arritje kjo shumë e rëndësishme në këtë fushë kërkimi.

2. Puna koceptuale dhe përpunime teorike

Pas vitit 1992 edhe në Republikën e Shqipërisë filluan përpjekjet e para për ndryshimet e domosdoshme e të shumëpritura të kurikulës, të programeve në fushën e shkencave sociale. Riorganizimi i Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës çeli një fushë të re pune e përpjekjesh serioze për studime dhe kërkime shkencore. U përgatitën programet e para të punës në fushën e sociologjisë ku flitej mbi konceptin dhe tipin e njohurive të saj, objektin e studimit dhe metodën, kushtet historike dhe premiset shkencore që favorizuan lindjen e shkencës së re të studimit të shoqërisë, teoritë sociologjike, devijanca sociale, kultura, familja, feja, urbanizimi etj. Veç tyre rëndësi iu kushtua edhe metodave të kërkimit sociologjik. Këto përbënin ndryshimet e para që u evidentuan dhe që zunë vend në kurrikulën e re universitare dhe programet e reja të shkencave sociale pas vitit 1992. Në punën e cila u thellua me tej po përpunoheshin dhe njohuritë mbi tipologjitë e kërkimit social dhe fazat e tij si faza përgatitore, mbledhja e të dhënave, analiza e të dhënave, përfundimet. Po kështu u pasqyruan edhe tema metodologjike me rëndësi për studimin

e dukurive sociale si: hipoteza, kampionimi, vëzhgimi, intervista dhe pyetëtori, historitë e jetës etj.

Në këtë lëvizje të gjërë akademike e shkencore Dr. Zyhdi Dervishi ka punuar me pasion e përkushtim, duke përgatitur leksione, tekste e monografi në këtë fushë. Fillimet e këtij procesi i gjejmë në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, i cili u bë lider i këtyre transformimeve. Ndaj, botimet e para akademike janë realizuar nga Zyhdi Dervishi si “Njohuri mbi shoqërinë 1”, (botuar në vitin 1995 si tekst për shkollat e mesme) . Më tej kemi Sociologjia 2, botuar në vitin 2000 edhe ky destinuar për shkollat e mesme. Më pas, në rrjedhën e viteve Zyhdi Dervishi ka botuar tekste për nxënësit e shkollave të mesme dhe tekste monografi për studentët që kanë studiuar e studiojnë lëndë sociologjike. Ndër ta, vend të veçantë zënë botimet “Sociologjia” (1999), “Sociologji kulture 1” (1999), “Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva” (2000), “Adoleshentët, bashkëjetesë me demonët e konflikteve” (2001), “Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global” (2002, bashkëautorë me Prof. Dr. Artan Fuga), “Flirte me plagët” (2003), “Vullnetarizmi – ind shumëfunksional i shoqërisë” (2004, më vitin 2014 ky punim monografik është botuar në gjuhën angleze në Berlin), “Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik” (2011), “Lentë të ndërveprimit simbolik” (2016), “Sociologji shkence 1”, (2019) etj.

3. Refleksione kritike mbi metodat e kërkimit

Sociologjia si disiplinë shkencore është relativisht e re dhe u themelua nga pozitivizmi me Ogyst Kontin, Emil Dyrhejmin etj, si një shkencë pozitive që studion me saktësi dukuritë sociale. Neopozitivistët u munduan të tregonin një sërë vështirësish në kuadrin e përdorimit të metodave

shkencore dhe sidomos ato të karakterit epistemik që lidhen me objektin e studimit që janë aktet njerëzore dhe vetë subjektet humane si të tillë. Po një nga vështirësitë e para është pikërisht se qëniet humane, në dallim nga sendet, nuk janë transparente, se ato nuk “japin” kollaj privatësinë e tyre, brendësinë e tyre. Fakti që qëniet humane janë të ndërgjegjshme pikërisht kjo e bën komplekse e të vështirë njohjen. Por Prof. Dr. Zyhdi Dervishi e zhvillon këtë tezë duke theksuar se “mostransparenca” e qënieve humane lidhet edhe me faktorë historiko-kulturore dhe ekonomikë. Argumenti i tij brilant shpaloset me disa tipare dhe veçori të tilla të popullit shqiptar i cili është tepër diskret përpara transparencës, si rrjedhojë e faktorëve ekonomikë dhe socialkulturore. Argumenti lidhet me “tëhuajëzimin” si një veçori psikokulturore e shqiptarëve. Mendoj se ky argument është çelës shpjegues dhe ka një rëndësi të madhe për studimin e dukurive sociale në terrenin e shoqërisë shqiptare.

Në studimet sociale, kërkuesit duhet të jenë të informuar dhe të vejtëdëshëm mbi veçoritë e kërkimit në shkencat sociale e në këtë kuadër mbi vështirësitë që ndërfiten në këtë fushë dhe që lidhen me subjektet njerëzore. Por këtyre vështirësive u shtohen dhe disa pengesa suplementare që paraqet shoqëria shqiptare, si pjesë e kontekstit socialkulturore ballkanas. Këtë problematikë e shpalos qysh në vitin 1998 Zyhdi Dervishi në artikullin “Veçori të anketimit për dukuri demografike në realitetin shqiptar”, botuar në revista “Demografia” nr.1.

Në këtë artikull parashtrahet një historik i përmbledhur i evoluimit të metodës së anketimit, mjaft elemente të cilës janë aplikuar nga Artur Jungu që në vitin 1760 për studimin e problemeve të ndryshme të popullsisë në disa nga zonat më të industrializuara të Anglisë. Në vijim analizohen përparësitë kryesore të metodës së anketimit në studimin e

dukurive shoqërore. Theksohen dy prirje të kundërta: nga njëra anë, ajo e formulimit të anketave me pyetje standarde, të cilat shpesh shërbejnë për analiza krahasimore të gjendjes së dukurive të ndryshme ekonomike, kulturore, psikologjike, shoqërore etj., të shoqërive të ndryshme; nga ana tjetër, përgatitja e anketave mjaft të specifikuara për shoqëri, madje edhe për grupime sociale, profesionale, fetare, me një numër të kufizuar anëtarësh.

Në vitet e regjimit socialist totalitar (1945-1990) metoda konkrete sociologjike e anketimit shpërfillej në një masë të konsiderueshme, anatomohej e karakterizuar si “metodë borgjeze empirike”, e cila trajtohej e nënrenditur në krahasim me metodologjinë teorike të përpunuar nga materializmi dialektik dhe historik. Krahas këtyre konstatimeve, sociologu Zyhdi Dervishi ka studiuar me kujdes mangësitë më problematike të zbatimit të metodës së anketimit nga studiuesit shqiptarë pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1990. Ndër të tjera, ai ka argumentuar se përgjatë viteve 1945-1990 në shoqërinë shqiptare të anketuarit nuk kishin hapësirë të shprehnin lirshëm opinionet e tyre, si rrjedhojë e trysnisë politike: “... neni 55 i Kodit Penal të RPS të Shqipërisë që parashikonte dënimin me heqje lirie nga 3 deri 10 vjet për të gjithë ata që shprehnin mendime të kundërta, madje të ndryshme nga ata të përcaktuar si vijë zyrtare për çdo çështje politike, sociale, ekonomike, kulturore, artistike etj., e kufizonte shumë sferën reale të aplikimit praktik të metodës së anketimit. Nën trysninë e këtij neni, shumica e njerëzve ngurrnin të shprehnin opinionet e tyre jo vetëm për çështjet kryesore politike, ekonomike e sociale që shqetësonin shoqërinë shqiptare, por edhe për probleme të tjera që konsideroheshin më larg interesave themelore të rendit e pushtetmbajtësve dhe që kishin të bënin me aspekte anësore të traditave

kulturore, artistike, etj. Vetëkuptohet që këta njerëz do të ishin edhe më ngurrues për të shprehur mendimet e tyre reale në “dëshmi” të shkruara, qoftë edhe në trajtë anonime, sikurse janë anketat. Përgjithësisht përgjigjedhënës ishin pothuajse krejtësisht të kufizuar në shprehjen e opinionëve të tyre reale. Ata ishin të imponuar ose të vetimponuar të shprehnin “me entuziazëm” konformitetin e tyre të plotë me orientimet zyrtare kryesore ose edhe me veprimtarinë praktike të përditshme të strukturave partiako-shtetërore” (Po aty: 45).

Një atmosferë e tillë rëndohej më shumë edhe prej reagimit të drejtuesve, të cilët kishin frikë nga shprehja e opinionëve të masave të gjera të punëtorëve ose të kooperativistëve. Sociologu Zyhdi Dervishi e analizon në mënyrë të detajuar edhe një realitet të tillë. Ai argumenton: “Përgjithësisht, kuadrot drejtuese të strukturave partiako-shtetërore, madje edhe të organizatave të masave, të nisur nga slogani se në shoqërinë shqiptare po krijohej “njeriu i ri”, me “mendësi të unifikuar”, e shpërfillnin metodën e anketimit, si një teknikë që synon të qëmtojë e të përgjithësojë opinione të një bashkësie të caktuar individësh, të cilët përfaqësojnë, si të thuash, kategori të caktuara sociale. Kur studiuesit vinin për të anketuar punonjës në kooperativa bujqësore ose në ndërmarrje industriale, kuadrot drejtuese kryesore të tyre përpiqeshin t’i bindnin se anketimi në njësinë e tyre nuk do të kishte vlerë, pasi sipas tyre “nga opinionet e punëtorëve nuk mund të pritët ndonjë gjë e madhe”, se informacionet e mendimet e kuadrove mund të ezauronin plotësisht opinionet e “pakultivuar” të punëtorëve dhe kooperativistëve etj... Shumica e drejtuesve të njësive ekonomike ose të institucioneve të ndryshme kishin fobi nga anketimi i vartësve të tyre pasi mendonin se problemet që mund të ngriheshin përmes anketimit mund të shërbenin si

pretekst për t'i ulur në përgjegjësi ose edhe për masa të tjera ndëshkimore më të rënda. Ndaj ndodhte shpesh që drejtuesit e njërive të ndryshme përpiqeshin të zvarrisnin ose të bllokonin anketimin (Po aty: 44-45).

Sociologu Zyhdi Dervishi ka analizuar disa tipe anketash që kanë përgatitur dhe realizuar në terren disa institute kërkimore-shkencore në Republikën e Shqipërisë, veçanërisht përgjatë viteve 1970-1990. Ai ka vënë në dukje edhe mangësitë kryesore në formulimin e anketave.

Së pari, në shumicën e anketave nuk viheshin raporte optimale ndërmjet pyetjeve të strukturave dhe atyre të pastrukturuara. Përgjithësisht në anketa bëheshin shumë pyetje të pastrukturuara, të formuluar në mënyrë të përgjithshme, të cilat nuk i orientonin si duhet përgjigjet e të anketuarve.

Së dyti, pyetjet e pastrukturuara nuk formuloheshin sipas kritereve shkencore, nuk kërkonin përgjigje për një çështje, por shpesh për dy ose tri çështje njëkohësisht.

Së treti, kishte kuptime të thjeshtësuara për pyetjet e strukturuar. Shpesh ato nuk ofronin alternativa të nuancuara të përgjigjeve, por vetëm alternativat “po” dhe “jo”, pra kërkonin përgjigje bardhë e zi. Shpesh alternativat e përgjigjeve të pyetjeve të strukturuar nuk kishin koherencë logjike me njëra-tjetrën, madje as edhe me pyetjen.

Së katërti, edhe kampionet e të anketuarve nuk përzgjidheshin sipas kritereve shkencore, madje shpesh ata ishin të zbalancuar (Po aty: 45-47).

Duke filluar veçanërisht që nga viti 1992 e në vijim edhe në shoqërinë shqiptare organizma studimore ndërkombëtare dhe studiues shqiptarë filluan të aplikojnë gjerësisht

metodën e anketimit për studimin e dukurive të ndryshme. Sociologu Zyhdi Dervishi ka analizuar me kujdes edhe veçoritë e mangësitë kryesore të realizimit të anketuarve ndër shqiptarët edhe këto vite. Pas një shqyrtimi të intensishëm ai kritikon prirjet dilentanteske në konceptimin dhe realizimin e anketave, mendësitë dhe praktikat që e mbivlerësojnë ose e vulgarizojnë anketën dhe procesin e anketimit etj. Pas një analizë të tillë sociologu Zyhdi Dervishi identifikon veçoritë kryesore të realizimit të anketimit në shoqërinë shqiptare, pjesa më e madhe e të cilave përcaktohen nga shkalla e lartë e tjetërsimit të vetëdijes së shqiptarëve, jo vetëm në rrafshin politike e intim, por edhe në atë shoqëror, artistik etj. Për këtë problematikë sociologu Zyhdi Dervishi ka argumentuar: “Nën trysninë e sfidave të shumëllojshme si luftërat rrënimtare, varfëria e skajshme, politikat çkombëtarizuese të shteteve të mëdhenj sidomos në momente e udhëkryqe të rrezikshme të historisë etj., përgjithësisht popujt ballkanikë kanë formim psikokulturor tejet kompleks që përshkohet nga një masë e konsiderueshme tëhuajësimi. I tillë është edhe populli shqiptar. Si pjesë përbërëse dhe shprehje e këtij tëhuajësimi, shqiptarët përgjithësisht i karakterizon prirja për të mos e shprehur veten, për të mos u prononcuar për shqetësimet ekonomike, politike, shpirtërore, sidomos kur këta kanë profil individual më të theksuar. ... shkalla e tëhuajësimit të shqiptarëve pas Luftës së Dytë Botërore është rritur në mënyrë të konsiderueshme nën trysninë e shumanshme të sistemit totalitar gjatë periudhës së sistemit socialist. Gjithashtu, edhe gjatë viteve të fundit masa e tëhuajësimit përgjithësisht është shtuar edhe si rrjedhojë e thellimit të shpërpjesëtimeve në statuset pasurore, ekonomike, arsimore, të përforcimit të prirjeve individualiste në mënyrën e jetesës, ose po të shpreheshim

me një karakterizim sociologjik më përgjithësues e atomizimit edhe të shoqërisë shqiptare. Në kushte të tilla ku shumica e njerëzve janë më të prirur të “mbyllen në vetvete”, ku nën trysinë “tëhuajësuese” të ndjenjës së turpër apo të dyzimit për shkaqe e motive të ndryshme, pothuajse në çdo moment të jetës së tyre ndryshe mendojnë, ndryshe flasin e ndryshe veprojnë përgjithësisht vështirësohet shumë zbulimi i opinionëve të vërteta të tyre edhe përmes metodës së anketimit (Po aty: 49-50).

Duke u bazuar edhe në përvojën e përparuar të anketimit në vende të tjera, sociologu Zyhdi Dervishi ka argumentuar se për të sfumuar masën e tjetërsimit është e nevojshme që në anketa të ndryshme, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me çështje politike dhe intime, të formulohen cikle pyetjesh, të cilat të zbulojnë opinionet reale të përgjigjedhënësve, duke zbuluar kontradikta në mendimet e tyre. Ai e ilustron një argumentim të tillë me disa shembuj konkretë nga fusha e politikës, e veprimtarisë së gazetarëve, e marrëdhënieve intime etj. Përvoja e pasur metodologjike e sociologut Zyhdi Dervishi në konceptimin dhe realizimin e anketave me cikle pyetjesh të tilla, të formuluar me nivel të lartë profesionaliteti është mjaft e vlefshme, jo vetëm për studentët e sociologjisë, të gazetarisë dhe përgjithësisht të shkencave shoqërore, por edhe për studiuesit e rinj të këtyre fushave. Një përvojë të tillë ai ua ofron me bujari doktorantëve të fushës së sociologjisë, të cilët i këshillon si drejtues ose i këshillon shoqërisht.

4. Studime aplikative komplekse në terren

Një ndër drejtimet e punës kërkimore të Zyhdi Dervishit kanë qënë studimet aplikative në terren të publikuara në

vepra monografike ose artikuj të shumtë të botuar në revista shkencore që publikohen në hapsirat shqiptare në Ballkan dhe në vende të tjera të Perëndimit dhe të Lindjes. Sociologu Zyhdi Dervishi ka studiuar me vëmendje dukuri shoqërore e kulturore jo vetëm ndër shqiptarët që banojnë në trojet e tyre në Ballkan, por edhe të atyre që kanë emigruar ose janë pjesë e diasporës shqiptare në vendet e tjera. Tekstet, artikujt shkencorë dhe sidomos punimet monografike të shkruara nga ky autor bazohen në studime të shumanshme, të vazhdueshme të arritjeve të përparuara të mendimit sociologjik të afirmuar përbotërisht, në studimet shumëvjeçare të fondeve të ndryshme të dokumenteve që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar dhe në arkivat e tjera të institucioneve të shoqërisë shqiptare, në studimin e hollësishëm të krijimtarisë folklorike të shqiptarëve, në vëzhgimet sociologjike të shumëllojshme të dukurive të ndryshme në pothuajse të gjitha mjediset e shoqërisë shqiptare, në anketimet e shumta për çështje të ndryshme të realizuara pothuajse në të gjitha qytetet dhe krahinat e Shqipërisë, në intervistat dhe bisedat e lira të realizuara me shqiptarë të të gjithë statuseve, në organizimin e fokus-grupeve të shumtë, etj.

Sociologu Dervishi në situata të caktuara ka realizuar edhe eksperimente sociologjike të cilët ai me modesti i konsideron si minieksperimente. Të dhënat e shumëllojshme të grumbulluara me metoda të tilla në studimet e shumta, veçanërisht në punimet monografike, janë të harmonizuara në mënyrë të natyrshme dhe krijojnë tablo komplekse të gjera e të mirëdetajuara të zhvillimeve në shoqërinë shqiptare, jo rrallë të krahasuara me tablotë analoge të disa shoqërive të tjera, kryesisht të perëndimit. Krjimtaria sociologjike e Zyhdi Dervishit ofron fonde të pasura faktesh

të shumëllojshme me vlera sociologjike, historike për shoqërinë shqiptare.

5. Sociologji e kulturës dhe metodat antropologjike

Një nga drejtimet më të rëndësishme të punës kërkimore të sociologut Zyhdi Dervishi është sociologjia e cultures, në të cilën ai ka përpunuar një sërë konceptesh dhe idesh që zhvillojnë përmbajtjen e kësaj fushe të gjërë njohurish sociologjike. Në një botim të strukturuar dhe të organizuar me mjaft interes dhe vlera studimore si “Sociologji Kulture 1”, viti i botimit 1999 autori shpalos problematikën në tërësi të rolit dhe funksioneve të kulturës në jetën sociale, por ndalet veçanërisht në kulturën shqiptare si objekt i synuar kërkimi me mjaft detaje e procese studimore.

Libri “Sociologji kulture 1” përfaqëson risi edhe nga ana metodologjike. Synimi kryesor i këtij libri është të pasqyrojë vlerat kryesore të kulturës shqiptare përmes krahasimit me analoget e tyre të kulturës italiane., si një nga kulturat perëndimore me të cilën kultura shqiptare ka komunikuar më dendur. Analizat krahasimore të kulturave sociologët përgjithësisht i realizojnë duke qëndruar 5 deri 7 vjet në mjediset e kulturës tjetër, me të cilët krahasojnë kulturën vetjake. Pamundësinë për të qëndruar për një kohë të gjatë në mjediset e kulturës italiane (ku ka qëndruar rreth 1 vit), sociologu Dervishi e ka kompensuar duke përgjithësuar mendimet, emocionet e përjetimet e një mase të madhe të emigrantëve shqiptarë që prej vitesh punojnë dhe jetojnë në hapsirat e shoqërisë italiane. Këtë zgjidhje metodologjike të sociologut Dervishi, studiues të vendeve të tjera e kanë konsideruar si risi.

Ndërsa në botimin e vitit 2014 “Nëpër degëzimet e kulturës shqiptare” kemi një platformë më të thelluar edhe tepër interesante funksionet dhe ndikimet që kanë proceset dhe dukuritë kulturore në Shqipëri. Po kështu duhet theksuar vëmendja e studiuesit tek vlerat dhe simbolet kulturore, rregullat dhe kodet e zbulimit të kuptimshmërisë së tyre, duke i argumentuar ato me mjaft aspekte të kulturës shqiptare. Tërheqja pas fushës së ndërveprimit simbolik dhe shpjegimi se si ka funksionuar bota simbolike kulturore në jetën e shqiptarëve është një arritje me shumë interes. Kjo arritje trajtohet gjërësisht tek vepra “Lente të ndërveprimit simbolik” (botuar për herë të parë ë vitin 2008 dhe ribotuar e plotësuar në vitin 2016). Ky botim është përdoruar dhe inkluduar në programet e mjaft lëndëve akademike të programeve universitare. Në një kuadër reflektues mbi këto punime të Prof. Dr. Zyhdi Dervishit evidentojmë qartësisht disa piketa të forta mbështetëse të argumentave siç janë pikësëpari se kultura dallohet si një sistem njohurish i përdorur nga njerzit për të interpretuar përvojën dhe për të gjeneruar sjelljet dhe pikësedyti se mund të penetrohet në sistemet e njohjeve kulturore duke zbuluar dhe duke analizuar shprehjet gjuhësore që antarët e një grupi kulturor përdorin gjatë bashkëveprimeve të tyre sociale. Autori qartëson efikasitetin e përdorimit të metodës etnografike në studimin e fenomeneve kulturore. Kështu nisur nga trajtimi i tij si një ndër format e kërkimeve cilësore autori na qartëson synimin e kërkuesit në se ai kërkon të dijë atë çfarë kanë ndërmend të bëjnë njerëzit, duhet bashkëvepruar ngushtë me ta për një periudhë të gjatë kohe. Në të njëjtën linjë ne shohim se studimi mbi qëniet humane është kompleks sepse dhe keto të fundit janë më komplekse se sendet natyrore. Qëniet humane nuk janë transparente sidomos kur nuk janë pjesëtarë të shoqërive të afërta. Nga ana tjetër, “izolimi në

komunitet” i studiuesit krijon një ndjesi vetmije dhe më tej një shkrirje me kulturën e komunitetit që ai studion.

Metoda etnografike mundëson vrojtimin e ngjarjeve unikale e të pazakonta. Kjo përbën një nga përparësitë e kësaj metode. Ne shohim se si kjo metodë mund të ç’kodojë e të zbulojë kuptimin e ngjarjeve rastësore. Ndër avantazhet e saj duhet përmendur edhe kapaciteti i saj përshkrues i fenomeneve dhe krahasimet ndërkulturore. Në punimet e Prof.Dr. Zyhdi Dervishit shohim edhe një reflektim mbi përdorimin e metodave në terren për të tërhequr vëmendjen e studiuesve të rinj, të angazhuar në këtë fushë. Ato kanë të bëjnë me një problematikë sa metodologjike aq dhe epistemologjike.

Kështu nëse i referohemi “Vëzhgimit pjesëmarrës” ai ka risqet e veta për sa i takon anësisë së studiuesit për ta paraqitur komunitetin në studim mbi bazën e influencës të së tashmes si një “komunitet i ngrirë” ose i “izoluar”. Por, studiuesit ndonjëherë, rëmbehen nga romantika e tyre në vlerësime traditash apo ngjarjesh. Megjithatë ky tip vëzhgimi futet thellë në kompleksitetin dhe hollësitë e jetës sociale të një komuniteti. Nga ana tjetër, studimi etnografik duhet të mbështetet në një platformë ndërdisiplinare në aspektin e metodës, veçanërisht kur hasen çështje të interpretimit historik, përgjithësime etj.

Punimi monografik “Sociologji Kulture 1” është bazuar jo vetëm në të dhënat e anketimit të emigrantëve shqiptarë që pas vitit 1990 punonin e jetonin në rajonin italian të Sienës, intervistat e bisedat e lira me to, por edhe në vëzhgimet pjesëmarrëse. Vëzhgime të tilla, madje edhe miqësimi me emigrantët nuk e kanë cënuar objektivitetin e përfundimeve të parashtruara në këtë studim, të cilat i kanë rezistuar kohës.

Këto reflektime mbi çështje të metodës studimore të fenomeneve sociokulturore rrjedhin nga përdorimi me frytshmëri e me profesionalizëm që studiuesi Zyhdi Dervishi i bën kërkimit etnografik në kuadrin e kërkimit cilësor i cili mbështetet tek përshkrimi i dukurisë nëpërmjet kapjes së specifikave sinjifikante brenda kuadrit të thelbit morfologjik që karakterizon këto dukuri.

6. Çështje epistemologjike

Një vëmendje të veçantë sociologu Zyhdi Dervishi u kushton çështjeve epistemologjike në veprat e botuara vitet e fundit. Le të përmendim: “Fillime vizionare në kohë të traumatizuar” (Sociologji shkence 1), botuar në vitin 2019. Në të analizohen disa aspekte shumë të rëndësishme të sociologjisë së shkencës, duke filluar nga përcaktimi i objektit të saj: “Disiplinë që studion funksionet komplekse të përparimit të njohurive shkencore në zhvillimet e gjithanshme, ndikimet e rethanave komplekse shoqërore si dhe veçoritë e komunikimit, të bashkëpunimit midis shkencëtarëve”(f.17).

Autori shtron një problematikë të gjerë referuar proceseve historike të përparimit të njohurive shkencore por ajo që është më e dukshme dhe e analizuar në thellësi është përpjekja për të zhvilluar njohjen dhe inovimin shkencor në Shqipëri. Kjo është një përpjekje serioze për të evidentuar ecurinë historike dhe kontributin e mendimtarëve shqiptarë në shkencë. Autori veç të tjerash, thekson: “Populli shqiptar ka përjetuar edhe pasojat e rënda, traumatike të përpjekjeve të shumanshme, deri edhe me luftë të armatosur të shteteve fqinje shoviniste për aneksimin e tokave shqiptare, për dëbimin e shqiptarëve nga tokat e tyre të trashëguara brez

pas brezi. Rrjedhojat kryesore të politikave të tilla kundërshtuese janë tkurja e vazhdueshme e hapësirës ku banojnë shqiptarët në Ballkan dhe detyrimi i shqiptarëve për të mos jetuar të bashkuar, por të shpërndarë në 5 shtete. Brenda fatit tragjik, edhe themelet e veprimtarisë kërkimore-shkencore të institucionalizuar, shqiptarët i hodhën në kohë të traumatizuar të luftërave të mëdha të përbotshme të shekullit të 20-të. Përpjekja e parë për krijimin e një bërthame organizimi kërkimor-shkencor u mishërua në ngritjen e “Komisia Letrare Shqipe”, e cila ka funksionuar afro 19 muaj (1 shtator 1916-22 maj 1918) (Parathënie, f. 21-22) Në këtë libër shtjellohen edhe analiza në rrafsh historik të problemeve sociale e psikologjike të zhvillimit të mendimit shkencor në vende të tjera dhe në hapësirën shqiptare. Për shembull, me përparësi, me dokumente arkivore të shumtë, analizohet veprimtaria kërkimore-shkencore e Institutit të Studimeve Shqiptare që ka funksionuar në Shqipëri në vitet e Luftës së Dytë Botërore (prill 1940-nëntor 1944). Përzgjedhja e fakteve e interpretimi i tyre me profesionalizëm kanë tingëllime të forta aktuale edhe për zhvillimin e shkencave në shoqërinë shqiptare të ditëve tona. Trajtime të tilla gjenden edhe në mjaft libra të tjerë të shkruara nga Zyhdi Dervishi. Shembulli i punës së palodhur, plot pasion e profesionalizëm i studiuesit Zyhdi Dervishi, veprimtaria e tij e gjerë kërkimore janë tepër domethënëse dhe me shumë interes studimor në mbështetje të ecurisë së studimeve sociale në vendin tonë.

Korçë, më 31 maj 2019

Literatura kryesore:

- Dervishi, Zyhdi: Fillimiet vizionare në kohë të traumatizuar (Sociologji shkence 1), Tiranë 2019.

- Dervishi, Zyhdi: “Veçori të anketimit për dukuri demografike në realitetin shqiptar”, revista “Demografia” 1998, nr.1.
- Dervishi, Zyhdi: Lente të ndërveprimit simbolik, Tiranë 2016.
- Dervishi, Zyhdi: Flirte me plagë, Tiranë 2003
- Fuga, Artan; Dervishi, Zyhdi: Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global, Tiranë 2002
- Dervishi, Zyhdi: Gratë në turbulencat e mendësive dhe realitetit politik, Tiranë 2011
- Dervishi, Zyhdi: Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektivave, Tiranë 2000
- Dervishi, Zyhdi: Adoleshentët bashkëjetesë me demonët e konflikteve, Tiranë 2001
- Dervishi, Zyhdi: Sociologjia 1, Tiranë 1999
- Dervishi, Zyhdi: Sociologji kulture 1, Tiranë 1999

**PËRMASAT SOCIALE TË NJOHJES SHKENCORE NË
VEPRËN “SOCIOLOGJI SHKENCE 1” TË PROF. ZYHDI
DERVISHIT**

IRENA NIKAJ

Departamenti i Edukimit

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

renanikaj@gmail.com

Në këtë punimi trajtojmë përmasat sociale të njohjes shkencore në veprën e prof. Z. Dervishi “Fillime vizionare në kohë të traumatizuar”-Sociologji shkence 1, në kuadër të parimeve të përgjithshme të sociologjisë së shkencës, vlerave dhe shkollave të saj të lidhura me realitetin e zhvillimit të mendimit, kërkimit shkencor nga kërkuesit dhe studiuesit shqiptarë.

Të hulumtosh për thelbin social të shkencës do të thotë që mendimi dhe shkenca përmes forcës dhe aftësisë krijuese, qënies dhe pamjeve empirike a modeluese të shfaqjeve të saj të dëftojnë parreshtur se mjedisi dhe hapësira sociale është ndërtuar nga kultura njerëzore, e shfaqur rregullisht tek strukturat sociale dhe rolet sociale, të së kalurës, të sotme dhe si mundësi për të dimensionuar të ardhmen, pamjet dhe format, gjuhën dhe konstruktet sociale të botës/botërave.

Institucionet e mirëfillta shkencore janë produkt i fillimeve të kohëve moderne në Evropë, ndërsa në Shqipëri një institucion i tillë shfaqet në vite të vështira për vendin(1940),

pikërisht atëherë kur Evropa dhe bota ishin në luftë me forcat e së keqes, fashiste dhe naziste.

Arritjet dhe përmasat e veprës shkencore që shkenca shqiptare e kësaj periudhe krijoi, dhe jo vetëm, janë arritje të vërteta shkencore, por ka nevojë të konsiderohen qartë edhe themel i vlerave shkencore shqiptare e të zenë vendin që meritojnë në historinë e shkencës shqiptare dhe të jenë themel dinjitoz në rrugën e zhvillimit të saj edhe më intensiv në ditët tona.

Koncepte kryesore: *njohje shkencore, revolucion shkencor, sociologji e shkencës, dijetarë shqiptarë, Instituti i Studimeve Shqiptare*

Përvoja historike provon se popujt që vlerësojnë më shumë dritën e dijes

se hijet e politikës kanë më shumë mundësi të përparojnë në shumëçka,

të vetëemancipohen pandërprerë

(Zyhdi Dervishi)

Hyrje

Përmasat sociale të njohurive shkencore rrokin efektet e kërkimit shkencor mbi jetën njerëzore dhe marrëdhëniet shoqërore, ashtu si edhe aspektet sociale të vetë hulumtimit. Brenda hapësirës së përmasave sociale janë disa faktorë që na mundësojnë studimin dhe njohjen e fenomenit/eve. Këta faktorë përfshijnë shfaqjen e lëvizjeve sociale të tilla si mbrojtja e natyrës, çështjet gjinore e të përfshirjes së grave,

kritikën ndaj shkencës së zakonshme; shqetësimet rreth efekteve sociale të përhapjes dhe zbatimit të teknologjive të reja shkencore; pyetjet epistemologjike të vëna në pah nga shkenca; prirje zhvillimi të reja në historinë e shkencës, qasjet antinormative në sociologjinë e shkencës, etj.

Në studimet e fushës së sociologjisë së shkencës pranohet tashmë se hetimi shkencor në të vërtetë bëhet në mjediset shoqërore edhe kur paraqitet si epistemologji standarde që trajton probleme të shkencës. *Së dyti*, në këto studime shfaqet socialiteti si një aspekt themelor i dijes dhe studimet i kanë këto cilësi edhe kur kanë trajtuar çështje standarde të epistemologjisë, pa shfaqur drejtpërdrejt perspektivën shoqërore. *Së treti*, në kuadër të sociologjisë së shkencës janë bërë publikë shqetësimet për çështje të tilla si besimi dhe përgjegjshmëria që shfaqet tek punimet me disa autorë, ndarjet e punës hulumtuese/njohëse, besueshmëria në vlerësimin a rishikimin e punës së kolegëve, sfidat e shkencës së financuar nga burime private, si dhe shqetësimet konstante që rrjedhin nga roli i kërkimit shkencor në shoqëri.

1.Shkenca-një arritje madhështore e njeriut

Në fillim të punimit, në parathënie, paraqiten shtysat që kanë shërbyer si mbështetje për një punim të tillë pioner në këtë fushë në hapësirën shqiptare; përshkruhet objekti, themeluesit dhe jepet përkufizimi për shkencën, pra: Shkenca është një formë kryesore e dijeve që zhvillohet nëpërmjet metodave të kërkimeve sistematike, ndërsa teknologjia mund të konsiderohet si një dije praktike ose instrument që ndihmon për zbatimin në praktikë të parimeve shkencore[Dervishi, Z., 2019:18(Thio, A.,1989:478)]. Ky përkufizim trajtohet i lidhur me zhvillimet moderne shoqërore dhe shqiptare, duke vënë në dukje transformimin që jetoi çdo përmasë shoqërore nga zhvillimet e vullshme

shkencore dhe teknologjike, zhvillime që kanë krijuar edhe probleme për shkak të ndikimit të tyre në jetën e njerëzve dhe sigurinë e ripërtëritjes së burimeve natyrore të planetit. Në tokën shqiptare, pas Luftës II Botërore, shkenca e zhvilluar me shumë përpjekje dhe përkorje nuk pati vazhdimësi, sepse sistemi politik pas 1945 i ndaloi veprat shkencore të paraluftës, i dënoi me harresë dhe injorim të plotë.

Në pjesën e dytë të punimit paraqiten arsyet dhe metodologjia mbi të cilat është mbështetur Sociologji shkence 1: Dijet, parimet, vlerat e shumanshme të sociologjisë së shkencës, të përpunuara nga shkollat sociologjike më të shquara të botës, dhe më tej, në këtë tekst –monografi parashtrahet simbioza shkencë-teknologji në lidhje organike me realitetin e zhvillimit të mendimit, të kërkimit shkencor nga dijetarët shqiptarë në rrjedhën e kohës dhe në mënyrë të veçantë me veprimtarinë kërkimore të strukturës së parë shkencore me fizionomi të plotë në hapësirën shqiptare në Ballkan, që është themeluar në prill 1940 dhe ka funksionuar deri në nëntor 1944 (Dervishi, Z., 2019:20).

Simbioza shkencë-teknologji zë fill që nga format elementare të mendimit, hamëndjet gjeniale në kushtet e mungesës së përpunimit të ligjësive shkencore. Zhvillimet më rrezëllitëse sociologjia e shkencës i ka në periudhën moderne. Në kapërcyell nga Mesjeta në erën moderne ndodh një ndryshim domethënës: zbulimet shkencore dhe teknologjike krijojnë kushtet që shkenca dhe teknologjia të integrohen dhe së bashku të ndryshojnë në mënyrë të thellë jetën e njerëzve, të menduarit e tyre. Shoqëritë moderne ja mbërritën që shkencën dhe teknologjinë ta bëjnë bazë të përparimit dhe zhvillimit të tyre, e kjo i transformoi këto

shoqëri në lokomotiva të ecjes përpara të shoqërisë njerëzore, ashtu si “shkencën e vogël e transformuan në “shkencë të madhe” dhe nga puna e vetmuar kërkimore u kalua në punë në grup, në ekipe kërkimore dhe institute kërkimi.

Njihen tashmë në historinë e sociologjisë së shkencës 4 shtrirje kohore me karakteristika të dallueshme dhe mendimtarë të spikatur, që janë:

1. Periudha nga Aristoteli tek John S. Mill: koha e zhvillimit të parimit të verifikimit me bazë pikëpamjet e trajtimet e Aristotelit, filozofit dhe mendimtarit klasik më të njohur të antikitetit.
2. Periudha hipotetike-deduktive ku një rol parësor ka vepra e Karl Poperit dhe parimi i tij i falsifikimit
3. Periudha e tretë shfaqet si metametodologjia dhe fundi i metodës, në të cilën zë vend qendror puna e Thomas Kuhn dhe teoria e tij e paradigmës dhe revolucioneve shkencore.
4. Periudha e katërt është koha shumë komplekse dhe me kontradikta pas Th. Kuhn, e frymëzuar prej veprës së tij.


Kjo shtrirje kohore dhe etapat e zhvillimit na ndihmojnë për të kuptuar shtyllat mbi të cilat është mbështetur vepra “Sociologji shkence 1”.

2.Përtej neopozitivizmit

Ishte Karl R. Popper, që në përpjekje për të ndërtuar një qasje jo(neo)pozitiviste për të shpjeguar transformimet e thella shkencore që kishin ndodhur, shpesh, trajtoi në veprat e tij rëndësinë e kritikës për zhvillimin e njohurive shkencore. Në veprën “E gjithë jeta është zgjidhje problemesh”, Popper(1994) trajton dy konceptet e kritikës që mund të

përshkruhen si kuptime logjike dhe praktike të falsifikimit. Paraqitja logjike e falsifikimit është vetëm struktura e një argumenti *modus tollens*, në të cilin një hipotezë shfaqet e falsifikuar nga demonstrimi sesa prej pasojave të saj logjike të rreme. Falsifikimi është një nocion kritikash, por është edhe një çështje e marrëdhënieve formale midis deklaratave apo pohimeve. Paraqitja praktike e falsifikimit i referohet përpjekjeve të Poperit dhe shkencëtarëve të tjerë për të demonstruar pamjaftueshmëritë apo paplotërinë e teorive të njeri-tjetrit përmes shfaqjeve të mangësive vëzhgimore/empirike ose mospërputhjeve konceptuale, pra pohime singulare apo pohime bazike që përshkruajnë ngjarje. Ky kontekst dhe kjo përmbajtje janë pjesë përbërëse e aktivitetit shoqëror.

Fig.1 Paraqitje krahasuese e parimeve të metodës shkencore sipas Émile Durkheim dhe Karl Popper



Për Popper, në ndryshim prej Durkheimit, metodologjia e shkencës (deduktive-nomologjike) është falsifikuese në të dyja aspektet e saj: logjike dhe praktike, dhe shkenca

përparon përmes demonstrimit duke falsifikuar përshtatshmërinë/vërtetësinë e teorive dhe hipotezave. Parimi i falsifikimit logjik i Popperit është pjesë e një përpjekje për të përkufizuar shkencën e vërtetë duke e dalluar nga pseudoshkenca dhe kritika e tij ka një rol të rëndësishëm në disa qasje aktuale në epistemologjinë sociale. Duke kundërshtuar (neo) pozitivistët, Popper u orvat të rehabilitonte metafizikën, atë metafizikë që ishte e aftë të shndërrohej në program të hulumtimit shkencor dhe në këtë pikë pikëpamja e Popperit vlerësohet sidomos kur ai e konsideronte hulumtimin shkencor të suksesshëm edhe në rastin kur sillte përgënjeshttrimin e një teorie shkencore; përcaktimi i kufizimeve të një teorie është po aq shkencor sa verifikimi i saj. Popper zgjidhi vështirësinë (neo) pozitiviste përmes revolucioneve shkencore, por nuk arriti të argumentonte gjendjet shkencore nga një revolucion në tjetrin. Pikëpamja e Popperit, në mënyrë të ngjashme me (neo) pozitivizmin, shpjegoi nga pikëpamja procedurale procesin shkencor si veprimtari racionale e shkencëtarëve, pra formatimi i kërkimit, qëllimet, si të realizohej kërkimi, si të bëhej verifikimi dhe rishikimi i kërkimit, si të realizohej procesi i zëvendësimit të teorive të vjetra me të reja.

Për Popper-in funksioni i kritikës është të eliminojë teoritë e rreme sesa t'i përmirësojë ato (Popper 1972). Nisur nga shembujt që dha Popper mund të kuptojmë sesi arsyeton; Popper mendon se teoritë e Sigmund Frojdit dhe Alfred Adlerit nuk janë teori shkencore, ndërsa teoria e Anjshtajnit është e tillë, sepse teoria e Anjshtajnit është ndërtuar mbi bazën e arsytimit dhe metodës shkencore, duke sjellë kështu mundësinë për përfundime krejt të ndryshme nga teoria e Isak Njutonit. Teoria e relativitetit e Anjshtajnit u verifikua pjesërisht e vërtetë përmes eksperimentit të Arthur S. Eddington, në 1919, pra e jetoi atë proces që përcaktonte

Poperi, ndërsa teoritë psikoanalitike u shfaqën të pafalsifikueshme, nuk u provuan si të tilla. Pra, sipas Poperit, të qëniet e këtyre teorive mjaft të qëndrueshme në argumentat e tyre, përbën dobësi për to dhe pamundësi për t'u kritikuar.

Fig.2 Modelimi social si praktikë kërkimi ndërdisiplinore



Fig. 3 Grafikë që ilustron kuptimin e K. Poperit për falsifikimin



Dija, shkencë, për Poperin, janë objektive, nga njëra anë sepse shfaqen si objektivisht të vërteta dhe nga ana tjetër dija, shkencë kanë status ontologjik, të pavarur nga subjekti që ka aftësi njohëse. Poperi paraqiti në teorinë e tij tre botë: e para, bota fizike, e dyta, bota e mendjes, dhe e treta, bota e organizuar e dijes, shkencës që shfaqen në forma të shumëllojshme, pra, bota e tretë mund të shfaqet në formën e produkteve të botës së dytë dhe materialeve të botës së parë. Kjo pikëpamje e Poperit e afërt shumë me teorinë e dualizmit trup-mendje ka pasur edhe me shumë kritika. Gjithsesi, pavarësisht arritjeve dhe provokimit që solli në shkencë, Poperi përmes parimit të falsifikimit nuk arriti të shpjegonte zhvillimin e shkencës, krizën dhe përmbysjet-revolucionet shkencore, sepse në fakt një teori e re është më lehtë e përgënjeshtreshme sesa e vjetra.

3. Revolucionet shkencore

Një vend të veçantë në zhvillimin e sociologjisë së shkencës ka vepra e Thomas Kuhn, “Struktura e revolucioneve shkencore”, botuar në 1962. Th. Kuhn, në ndryshim me


pikëpamjet e Poperit, sidomos me parimin e falsitetit, ndërtoi konceptin e ndryshimit të paradigmës, koncept që u përhap bashkë me përhapjen e teorisë së tij. Pikëpamja qëndrore e Th. Kuhn ishte që përparimi shkencor nuk shfaqet në një trajektore drejtvizore, por në cikle ndryshimi paradigmatiche apo revolucione periodike. Shkencën në modelin që përpunoi, Kuhn, e sheh në tre gjendje: parashkencë, shkenca normale dhe në krizë-revolucion (këtu kuptohet edhe kritika ndaj parimit të falsitetit të Poperit), e cila na paraqitet si gjendje paaftësie për të provuar paradigmën, por kjo gjendje nuk e rrëzon paradigmën, sepse paaftësia e vërtetimit mund të jetë e lidhur me gabime në kërkim.

Ndikimi i veprës së Th. Kuhn është vlerësuar në Sociologji shkence 1, ndërsa veçohet nga autori përkufizimi i paradigmës që mendojmë se ka natyrën e *modus tollens dhe modus ponens*: [...]paradigma në çdo fushë të shkencës është një model konceptual, teori me shkallë të lartë përgjithësimi që i ndihmon shkencëtarët për përcaktimin e problemeve që lipsen studiuar në dinamikën e zhvillimit të mendimit shkencor, është një aparat teorik që orienton zgjidhjen e problemeve dhe interpretimin e arritjeve të kërkimit (Dervishi, Z: f.47).

Cikli i paraqitur nga Kuhn është një cikël progresi. Me të Kuhn sfidoi konceptimin e shkencës, që e shihte atë si një përparim të vazhdueshëm të akumulimit të ideve të reja. Në një seri të rishikimeve të përparimeve të mëdha shkencore të së kaluarës, Kuhn tregoi se ky këndvështrim ishte i gabuar. Shkenca nxitet më shumë nga shpërthimet e rastësishme revolucionare të njohurive të reja, nga revolucioni i shkaktuar nga zbulimi i mënyrave të reja të mendimit shumë të fuqishme që ai i quajti paradigma të reja.

Në figurën 4, kemi paraqitur në plan ciklin e zbulimeve shkencore dhe shfaqjen e paradigmës që ne mendojmë se tregon jo vetëm sesi përparon shkenca, por aty mund të ndërtohet në çdo segment kohor dhe konceptual nga njëra fazë në tjetrën edhe ndryshimi shoqëror, edhe për shembull, revolucionin e Rilindjes Evropiane, modelin keynesian të ekonomisë, diskutimin paspozitivist në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe zhvillimet shkencore në sociologjinë pasmeritoniane të shkencës, teoria e zgjedhjes, etj; vendosja në kohë e ngjarjeve shkencore ndërton shkollat teorike, vendosja në radhë e koncepteve krijon rrathë, ndërsa rrathët racionalë në hapësirën me dimensione krijojnë sistemet. Kuhn nuk harroi të sugjeronte se kriteret që ai ka përcaktuar nuk përfaqësojnë rregullin për të zgjedhur, por shfaqen si vlera që ndikojnë aftësinë për të zgjedhur.

Fig.4 Cikli i zbulimeve shkencore tek Thomas Kuhn mbi bazën e veprës “Struktura e revolucioneve shkencore”



Mendojmë se në trajtimet që inkuadrohen në veprën Sociologji e shkencës 1, modeli i përpunuar nga Kuhn i ka shërbyer autorit për të treguar sesi ndryshuan shoqërinë e kohës revolucionet shkencore në të kaluarën, përmbysjet shkencore në studimin e materies, në fushën biomolekulare dhe bioteknologjike, në mendim etj. Këto argumenta vlejné për të provuar ciklin e paradigmës dhe revolucioneve shkencore, ashtu si kanë përcaktuar përmasat e ndryshimit të shoqërisë së sotme, shoqërisë së dijes, revolucionin e katërt industrial dhe paralajmërojnë edhe përmasat e të ardhmes së nesërme, mjaft të afërt, të një shoqërie të transformuar në karakteristikat thelbësore të qënies si dhe natyrën kulturore, sociale dhe ekonomike të funksionimit të saj.

4. Strukturimi i njohurive shkencore dhe zhvillimi i shkencës shqiptare

Vëmendja ndaj dimensioneve shoqërore të njohurive shkencore dhe potencialit që kanë për të ushqyer zhvillimin e njerëzve dhe shoqërive pluraliste në veprën Sociologji shkence 1 na shfaqet me trajtimin e fillimeve të shkencës në Evropë dhe rolin e shkencëtarëve shqiptarë në vende të tjera, kryesisht evropiane, përcaktuar kjo nga zhvillimi i këtyre shoqërive si qendra kulturore dhe marrëdhëniet që krijuan me të ashtuquajturat periferi kulturore. Paraqitja e figurave shkencore dhe humaniste dëshmon kontributin e jashtëzakonshëm të tyre në ndriçimin kulturor dhe përparimin e jashtëzakonshëm të shoqërive kryesore evropiane, por edhe në zhvillimin ekonomik, shkencor dhe politik të Perandorisë Osmane me personalitete si Gjon Gazuli, Mikel Maruli, Nikollë-Leonic Tomeu, Marin Barleci-Barleti, Marin Beçikemi, Mihal Artioti, Veziri i madh-Lutfi Pasha, Koçi Beu nga Korça, Mimar Sinani, Karl Gega, Hasan Tahsini, Elena Gjika-Dora d'Istria, Sami

Frashëri, Refat Frashëri, Shtjefën Gjeçovi, Bilal Golemi. Përmes përshkrimit të profilit të tyre shkencor dhe kulturor ndërtohet kohezioni midis gjeneratave të shkencëtarëve shqiptarë, që dëftojnë sesi nga veprimtari individuale shkencore deri në fund të shekullit XIX, në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX shfaqet një përpjekje madhështore organizimi për shkencën shqiptare si Komsia letrare shqipe në Shkodër në vjeshtë të 1916.

Mendimi humanist shqiptar (XV-XX)

Ky mendim lindi dhe u shfaq në kohën kur sipas studiuesve shqiptarë “Shkenca nuk kishte atdhe, por shkencëtari ka atdhe” (Dervishi 2019), ndërsa në hapësirën shqiptare nuk kishte universitete dhe institute kërkimore shkencore.

Vend të nderuar në kulturën shkencore ndërkombëtare kishin **Gjon Gazuli**, doktor në shkencat e lira, pedagog në Universitetin e Padovës, që u orvat të arsyetonte paradigmen gjeocentrike të Ptolemeut, por edhe të hartonte një traktat për astronominë dhe përmes vrojtimeve të sillte argumenta në të mirë të idesë heliocentrike.

Mikel Maruli, që njihet si luftëtar, poet, filozof dhe mendimtar i shquar në fushën e pedagogjisë, aq sa mendohet se vepra e tij në fushën e pedagogjisë ka qenë pararendëse e Rilindjes Evropiane.

Nikollë-Leonic Tomeu u formua si dijetar dhe intelektual në shkollën aristoteliane të Demetrio Kalkondila në Firence. Tomeu ishte filozof, përfaqësuesi kryesor i rrymës aristoteliane në Universitetin e Padova-s, si njohësi më i mirë i Mësuesit të parë-Filozof në atë kohë.

Marin Barleci-Barleti ishte humanist dhe historian i njohur i kohës. Tre veprat e shkruara në gjuhën latine: De obsidione

Scodrensi-Rrethimi i Shkodrës, Compendium vitarum pontificum et imperatorum-Shkurtore e jetës së papëve dhe perandorëve, Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis, impressum Romae janë dëshmitë më të spikatura të luftës së shqiptarëve kundër Perandorisë Osmane në shekullin e 15-të dhe nivelit të zhvillimit të kulturës shqiptare si pjesë e amfiteatrit kulturor evropian.

Marin Beçikemi është pjesëtar aktiv i Rilindjes evropaine, humanist, historian dhe orator shumë i zoti. Kultura e gjerë historike, letrare dhe filozofike e lejoi të kryente detyra shumë të rëndësishme si rektor i Shkollës Letrare të Raguzës, diplomat dhe mësues i parë i shkollës shqipe në Venedik për emigrantët shqiptare.

Mihal Artioti njihet me disa emra: Mihal Trivoli, Massimo d'Arta l'Aghiorita, Massimo il Greco, Maximus dhe Maksim Greku. U njoh në Evropë si zotërues shumë i mirë i latinishtes, greqishtes, italishtes dhe frëngjishtes. Artioti luajti rol të rëndësishëm në përhapjes e frymës dhe ideve iluministe të Rilindjes Evropiane në Rusi e shekullit XVI, mjaft e prapambetur dhe mes pabarazive të thella shoqërore.

Veziri i madh-**Lutfi Pasha** ishte nga Vlora dhe për dy vjet ishte Veir i madh i Perandorisë Osmane, më pas iu përkushtua studimeve dhe shkroi rreth 12 vepra, mes të cilave pëmden Asaf-name: Libri vezirëve dhe Historia e Perandorisë Osmane. Këto vepra kanë shërbyer si burime të besueshme historike për të njohur sistemin ekonomik, politik dhe administrativ të Perandorisë Osmane gjatë sundimit të Sulltan Selimit dhe Sulejmanit të madhërishtëm.

Koçi Beu nga Korça konsiderohet teoricieni dhe kritiku më i mirë i sistemit politik dhe administrativ otoman në shekullin e 17-të. Ai është krahasuar me Monteskienë për

shkak tv natyrës kritike dhe reformatore të raporteve që ka hartuar për sulltanët.

Mimar Sinani ka qënë arkitekti i famshëm i Perandorisë Osmane me origjinë nga Tepelena, i cili pasi luftoi në rradhët e jeniçerëve në fushatat e ushtrisë osmane në Moldavi, ku spikati edhe talenti projektues i tij. Ndërtoi vepra inxhinierike, hidroteknike, xhami, të cilat janë vlerësuar nga arkitektë të shquar si monumente dhe arritje madhështore, gati jashtëtokësore.

Karl Gega, projektuesi i tunelit të Zemingur, ishte një inxhinier ndërtimi shqiptar, shumë i aftë në projektimin dhe ndërtimin e veprave teknike me shumë rëndësi në Italinë e Veriut. Përvoja që kishte krijuar i dha mundësi të zgjidhte teknikisht problemet shumë të vështira projektuese që u shfaqën realizimit të hekurudhës së Zemingut. Realizimi i projektit të Zemingut solli edhe koncepte të reja shkencore dhe teknike si *koncepti i gjatësisë virtuale të hekurudhës, koeficienti i virtualitetit*.

Hasan Tahsini ishte rektori i parë i Universitetit të Stambollit, njohës shumë i mirë i shumë gjuhëve të huaja, të Lindjes dhe Perëndimit, i shumë shkencave si fizika, gjeologjia, paleontologjia, kozmografia, historia, gjuhësia, psikopatologjia, pedagogjia. Vlerësime për të ka pasur mjaft dhe për rolin ndriçues në fushën e shkencës e quajtnë edhe Lomonosovi i Turqisë.

Elena Gjika-Dora d'Istria ka qënë shkrimtare dhe studiuese rumune me origjinë shqiptare. Ka pasur rol të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të grave, por edhe në realizimin e shumë studimeve për historinë dhe trashëgiminë kulturore të popullit shqiptar.

Sami Frashëri, më eruditi i familjes së Frashërllinjve, shfaq talentin e vet në shumë fusha të dijes si në gjuhësi, gjeografi, histori, krijimtari artistike, përkthime, botime shkollore në disiplina të shkencave natyrore dhe shoqërore. Sami Frashëri me përkushtimin e thellë intelektual dhe atdhetar, mendojmë se është pikërisht mendimtari i parë shqiptar me rolin e Volterit apo Didëroit në hapësirat e Lindjes, ndriçuesi, iluministi i madh shqiptar i fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX.

Prof. Dr. Refat Frashëri, mjek, mikrobiolog në Institutin Bakteriologjik të Stambollit, me merita të veçanta në prodhimin e vaksinës kundër lisë, tërbimit, pas një pune të gjatë në Universitetin e Stambollit, në vitet 20 të shekullit XX kthehet në Shqipëri. Edhe në Shqipëri, pavarësisht vështirësive dhe mungesave, profesor Frashëri u përpoq me modesti të shpërndante dituri në mes bashkëkombasve të vet.

Shtefën Gjeçovi, jetoi si albanolog dhe vdiq si martir. Merita e tij në fushën e albanologjisë lidhet me mbledhjen e pasurisë folklorike, traditave, zakoneve, normave tradicionale shqiptare. Gjeçovi jetoi si frat dhe e pagoi me jetën e vet punën për të mbrojtur visaret e kombit, kulturën tradicionale shqiptare.

Dr. Bilal Golemi, shkencëtar shumë i njohur shqiptar në Evropë dhe më gjerë, ishte nga Kurveleshi dhe që në moshë të vogël emigroi në Turqi. Punoi si mjek veteriner dhe me pas si mikrobiolog. U specializua në Gjermani dhe Francë, ku u njoh dhe bashkëpunoi me mikrobiologë shumë të shquar të kohës. U kthye në atdhe për t'i shërbyer me përkushtim atdheut me aftësi profesionale dhe shkencore, por me çdo gjë që mundej. Me shumë përpjekje organizoi shërbimin veterinar, themeloi revistën e përmuajshme "Bujqësia", organizoi kurse për infermierë veterinerë, hartoi

ligjin mbi shërbimin veterinar, krijoi Laboratorin Bakterologjik Veterinar, i pari në Ballkan. Me shumë vetmohim, Dr. Golemi kreu studime me shumë vlerë për zoonozat, sëmundjet që kalojnë nga kafshët tek njerëzit si plasja, bruçeloza, talasemia, tuberkulozi, ethet “Q”. Për të përcaktuar modelin që përfaqësonte Dr Golemi autori citon akademikun Bajram Preza, i cili e ka vlerësuar Dr. Bilal Golemin si pionerin, heroin e heshtur, njeriun e sakrificës, që i kushtoi gjithçka shkencës(Dervishi, 2019:111).

Institucionalizimi i shkencës shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XX

1. Komësija letrare shqipe në Shkodër shfaqet nga 1 shtatori 1916 deri në 22 maj 1918, si një strukturë e vogël studimore dhe arsimore, e financuar dhe e kontrolluar nga autoritetet austro-hungareze. Anëtarër e parë të saj ishin Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Dom Ndre Mjeda, Atë Ambroz Marlaskaj, të cilët autori i cilëson anëtarë me cilësi të epërme në shumëçka, të pasuar nga pjesëmarrës dhe të ftuar si Rakjo Nahtigal, Maksimilian Lamperc, Dr. Gjergj Pekmezi, Hilë Mosi, Hafiz Ali Korça, Luigj Naraçi, Imzot Vinçenc Prenushi, Sali Nivica, Josif Haxhimima.

Qëllim të parë Komsia përcaktoi lëvrimin dhe krijimin e gjuhës letrare shqipe, duke u ngritur mbi dialektet dhe përmes përpunimit të ortografsë së shqipes së shkruar. Për mendimin tonë, kjo orvatje i jep jetë përpjekjeve për të ndërtuar kohezionin kulturor të shqiptarëve përmes njëjtësisimit të rregullave të shqipes së shkruar dhe krijimit të gjuhës letrare shqipe, një shërbim madhështor ky ndaj kombit dhe të ardhmes së shqiptarëve. Për këtë arsye, autori ka shumë të drejtë kur vlerëson se në aspektet metodologjike, në vizonin teorik dhe largëpamësinë me frymë atdhetare që tregoi Komsia Letrare, qëndron shumë

më lart sesa diskutimet e orvatjet e mëvonshme lokaliste, krahinore që kanë pasur objekt sulmi gjuhën letrare shqipe dhe misionin përbashkues kombëtar, kulturor e iluminist të saj.

2. Instituti Kombëtar Zooteknik në Xhafzotaj është produkt i stabilizimit të shoqërisë shqiptare gjatë viteve 1925-1939. Ai u krijua në vitin 1925 si strukturë publike me sipërfaqe toke nën juridiksionin e vet dhe synim të realizonte veprimtari kërkimore në fushën e studimit, përzgjedhjes dhe shtimit të kafshëve dhe shpendëve. Nisur nga programi i veprimtarive dhe vizioni mendohej të ishte një institut kërkimor-shkencor, por mungesa e specialistëve nuk i lejoi institutit të realizonte qëllimet që kishte në program.

3. Instituti Mbretnor i Studimeve shqiptare u përgatit nga Kuvendi i parë i Studimeve Shqiptare, të cilin morën pjesë studiues shqiptarë dhe të huaj të fushës së albanologjisë. Ai e fillon jetën e vet në paraditen e 9 prillit 1940, ndërsa Këshilli i Institutit mbajti mbledhjen e parë më 13 prill 1940. Autori ka studiuar me shumë kujdes dokumentacionin e mbajtur dhe përmes tij ka arritur në përfundimin se Instituti përfaqësonte një strukturë të mirëfilltë kërkimore dhe shkencore të hapur për studiues të fushave të gjuhësisë, historisë, kulturologjisë dhe shkencave teknike. Sipas autorit profili shkencor i studiuesve që themeluan Institutin e parë të Studimeve Shqiptare ishte i nivelit të lartë duke filluar nga ata shqiptarë si Dhimitër Berati, Eqeren Çabej, Atë Gjergj Fishta, Karl Gurakuqi, At Anton Harapi, Prof. Kolë Kamsi, Dr. Vangjel Koça, Ernest Koliqi, Mustafa Kruja, Prof. Mati Logoreci, Atë Bernardin Palaj, Prof. Lasgush Poradeci, Prof. Ilo Mitkë Qafzezi, Prof. Namik Resuli, Dom Lazër Shantoja, Dr. Eqerem bej Volra, Prof. Aleksandër Xhuvani, Prof. Ndue Paluca, ndërsa studiuesit italianë që bënë pjesë në

institut ishin Prof. Antonio Baldaçi, Mateo Bartoli, Prof. Serxhio Betini, Atë Nilo Borxhia, Atë Fulvio Kordinjano, Prof. Françesko Erkole, Prof. Anxhelo Leoti, Dr. Nikola Lo Ruso Atoma, Prof. Xhenario maria Monti, Domeniko Mustili, Prof. Paolo Emilio Pavolini, Prof. Gaetano Petrota, Dr. Zef Skiro (i Riu), Karlo Taljavini, At Zef Valentini.

Prof. Dervishi ka vërejtur se në hierarkinë e strukturave shtetore kryetari i Institutit të Studimeve Shqiptare vinte pas mëkëmbësit të mbretit dhe kryeministrit, pra, një vlerësim të cilin nuk e ka pasur më vonë asnjë titullar institucioni kërkimor dhe shkencor në Shqipëri deri në ditët tona, madje autori nënvizon: Asnjëherë në shtetin shqiptar të pas vitit 1944 statusi i kryetarit të ndonjë instituti studimesh, moralisht, zyrtarisht dhe ekonomikisht nuk është trajtuar si i barabartë ose më i privilegjuar se ai ministrit dhe statusi i një punonjësi shkencor i çdo instituti në këta aspekte nuk është trajtuar si i barabartë me atë të deputetëve (Dervishi, 2019).

Instituti i Studimeve Shqiptare, struktura, organizimi dhe funksionimi i tij jo vetëm që frymëzuan respekt në Shqipërinë e asaj kohe, por edhe shërbyen si modele referimi për punë të kualifikuara ku ekspertizën e kishte Instituti, si për shembull në përkthime, në përgatitjen e librave shkollorë, enciklopedive, fjalorëve apo botimeve tematike.

Merita më e spikatur dhe e padyshimtë e Institutit, sipas Prof. Dervishit, është para së gjithash, funksionimi i tij mbi bazën e idealeve dhe parimeve shkencore moderne, pra, universalizmi, komunaliteti, paintersshmëria dhe skepticizmi i organizuar. Këto parime dhe ideale sendërtojnë rëndësinë e studimit të këtij fenomeni në shkencën shqiptare, përgatitësit të themeleve të Akademisë Shqiptare të Shkencave dhe natyrisht modelin që duhet ndjekur.

Përfundime

Sociologjia e shkencës është një fushë studimi me rëndësi të posaçme në shoqërinë e sotme të dijes. Kjo fushë studimi ka ardhur koha të zhvillohet me më shumë vëmendje edhe në Shqipëri dhe në rrethet akademike e shkencore shqiptare, sepse të kuptuarit shkencor i botës është domosdoshmëri në rritje e shoqërive të sotme. Shoqëritë që kanë të zhvilluar në nivel të lartë shkencën dhe teknologjinë janë edhe shoqëritë më të përparuara të kohës së sotme.

Studimi i dimensioneve sociale të shkencës është intensifikuar në dhjetëvjeçarët pas 1970. Kontradiktat shoqërore që janë shfaqur rreth shkencave dhe teknologjive shkencore si dhe zhvillimet brenda natyralizmit filozofik dhe epistemologjisë shoqërore janë kombinuar tashmë për të nxitur përparimin e të menduarit në këtë fushë. Dijetarët në mjaft disiplina të ngjashme vazhdojnë të hulumtojnë marrëdhëniet e panumërta shoqërore brenda komuniteteve shkencore dhe midis tyre si dhe kontekstin e tyre social, ekonomik dhe institucional.

Monografia “Fillime vizionare në kohë të traumatizuar- Sociologji shkence 1” u shfaq në mjedisin e sotëm shqiptar, plot konflikte, edhe në shkencë, si në të gjitha pjesët përbërëse të sistemit shoqëror shqiptar. Misioni i saj i parë është të dëshmojë se shkenca shqiptare ka ndjekur një rrugëtim, i cili ka pasur edhe arritje të spikatura, edhe maja. Në mënyrë të sigurtë autori e përcakton vendin e monografisë në bibliotekën e shkencës si një analizë e zbulimeve, dukurive sociale të zhvillimit të shkencave, mendimet dhe modelet e sjelljes së shkencëtarëve shqiptarë, margaritarë me vlera të shumëfishta për të orientuar nga pikëpamja metodologjike dhe etike zhvillimin e mendimit shkencor të sotëm. Nuk është vetëm zbulimi shkencor, por

edhe modelet e fisme të komunikimit ato që i japin kohezion dhe energji mjaft të nevojshme botës akademike dhe shkencore, por edhe shoqërisë në përgjithësi.

Shkenca moderne dëshmohet përmes shembujve të shumtë se përfaqëson një model të vetëqeverisjes demokratike dhe një veprimtari që kërkon dhe lehtëson praktikat demokratike në kontekstin shoqëror. Për më tepër, duke pasur parasysh se efektet e kërkimit shkencor janë potencialisht globale, ndërsa vendimet demokratike janë në të mirë të zhvillimeve kombëtare, vendimet kombëtare do të kenë efekt edhe përtej popullsisë të përfaqësuar nga vendimmarrësit e një vendi të vetëm.

Kjo orvatje serioze e prof. Z. Dervishit për të sjellë një punim të tillë, pra, trajtimin voluminoz të rrugës që ka kaluar institucionalizimi i shkencës shqiptare në ciklet e saj përfaqëson modelin që kishim nevojë ta shqyrtonim dhe një analizë të gjerë e të thellë me shumë vlera në fushën e sociologjisë së shkencës, punë që ka nevojë për vlerësimin e duhur; por ajo edhe fton e hap rrugën për studime të tjera në këtë fushë që ta pasojnë.

Literatura kryesore

Dervishi, Z.2019. Fillime vizionare në kohë të traumatizuar-Sociologji shkence 1. Emal, Tiranë

Kuhn, Th.1997. Struktura e revolucioneve shkencore. Dukagjini & CEU Press, Tiranë-Pejë

Nikaj, I.2014. Albanian social and philosophical thinking of the '30-Neo-Albanianism. AuthorHouse, Bloomington, IN 47403.

Poper, K.R. 2000. Vepra të zgjedhura, përgatitur nga David Miller në 1983. Shtëpia e Librit & Afërdita, Tiranë.

Popper, K.R. 1972. Objective Knowledge. Oxford University Press, UK.

PROFILE TË DUKURIVE FAMILJARE NË SHOQËRINË SHQIPTARE NË STUDIMET E PROF. DR. ZYHDI DERVISHIT

Dr. Blerina Hamzallari

Departamenti i Sociologjisë

Fakulteti i Shkencave Sociale

Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Ky artikull mëton të identifikojë ndihmesat e studimeve të publikuara nga Prof. Dr. Zyhdi Dervishi në fushën e Sociologjisë së Familjes. Ndër objektivat kryesorë të këtij hulumtimi ndërtekstual janë: 1- Të identifikohen disa nga dukuritë kryesore familjare të trajtuara në studimet e sociologut Dervishi; 2- Të analizohet objektiviteti i gjetjeve studimore në analizë diakronike; 3- Të argumentohet rreth ndihmesave të studiuesit në pasurimin e literaturës të studimeve sociologjike vendase mbi familjen si dhe ekspozimi ndaj burimeve alternative të literaturës vendase dhe të huaj.

Për nga vetë qëllimi dhe objektivat e këtij artikulli aspektet kryesore metodologjike orientohen nga analiza e teksteve të vetë studiuesit bashkëshoqëruar me analizë nga burime të tjera dytësore.

Në përfundim të kësaj kumtese studiuesit e disiplinës së Sociologjisë së Familjes, të disiplinave të shkencave të tjera sociale dhe humane, të interesuar rreth studimeve sociologjike do të mund të orientohen lehtësisht në studimet

e Profesor Dervishit mbi dukuri familjare si, prindërimi, konfliktet familjare, bashkëjetesa, veçanti të shoqërizimit dhe edukimit në familje, martesë, etj. Pas njohjes me kumtesën do të realizohet një panoramë më e plotë rreth shqyrtimeve sociologjike të thelluara të një studiuesi të sprovuar si sociologu Zyhdi Dervishi, sfidave të studiuesve të rinj dhe nevojës për studime serioze sociologjike, sidomos mbi familjen, të cilat të mund t'i rezistojnë kohës për nga objektiviteti i të dhënave, argumentit shkencor si dhe për nga rëndësia publike e çështjeve të trajtuara.

Koncepte kryesore: *familje, shoqërizim, bashkëjetesë, martesë, prindërim, etj.*

Hyrje

Studiuesi George Ritzer, i njohur si një nga kontribuesit në mbledhjen dhe transmetimin e mendimit sociologjik, ka shkruar: *“Është e vështirë të saktësohet fillimi i teorisë sociologjike, sepse njerëzit qysh në antikitet kanë reflektuar dhe kanë zhvilluar teori rreth jetës shoqërore, por asnjëri prej tyre nuk e konsideronte veten sociolog, vetëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë ne mund të gjejmë mendimtarë që mund të identifikohen si të tillë”* (1983:4). Pavarësisht gjyqimeve të tilla ndër studiuesit e sociologjisë është pranuar se origjina e sociologjisë mund të gjendet kryesisht në filozofinë, historinë dhe ekonominë politike të shekullit të tetëmbëdhjetë në veprat e Giambattista Vico, Montesquieu, Adam Smith, Sir Alex Ferguson, Jean-Jacques Rousseau (Swingewood, A.;1991:ix). Në këtë shekull u diskutua për tema sociologjike brenda një debati jo sociologjik bazuar kryesisht në mendimin e filozofëve si Aristoteli, Platoni,

Hobbes dhe Locke (Po aty, 7). Në evolucionin e mendimit, akumulimin e dijeve dhe shpërthimet revolucionare të zhvillimeve shoqërore të shekullit të XVIII dhe vitet e herhsmë të shekullit të XIX, kushtet e ndryshimit shoqëror ofronin mjaft tema sociologjike për trajtim, por shpesh ato integroheshin në trajtesat politike, ekonomike, fetare, filozofike dhe asnjëherë shoqëria dhe zhvillimet e saj nuk u panë si një objekt i dallueshëm studimi.

Sociologjia, teoria sociologjike në thelb përcaktohen:

“Zhvillimi i dijes sistematike mbi jetën sociale, mbi mënyrën se si është organizuar ajo, si ndryshon, si krijohet nga veprimi social, si ndikojnë konfliktet shoqërore në prishjen e rendit dhe se si rivendoset rregulli pas tyre...Teoria sociologjike është njëkohësisht një guidë në hulumtimin sociologjik si dhe një përpjekje për të vendosur rregull në gjetjet sociologjike, për zbulimin e ligjësive shoqërore.”
(Calhoun, C.; Gerteis, J.; Moody, J.; Pffaf, S. & Virk, I.; 2012:1)

Historia e mendimit sociologjik botëror nuk mund të jetë e thjeshtë dhe doemos ajo kalon nëpër disa faza zhvillimi dhe jo rrallë herë bëhet objekt i qasjeve kundërthënëse ndaj njëra-tjetrës. Pavarësisht dakortësisë së përgjithshme mbi fazat kyçe të zhvillimit të mendimit teorik sociologjik botëror, çdo shtet-komb ka historinë vetjake të zhvillimit të mendimit sociologjik. Edhe në shtetin shqiptar sociologjia është zhvilluar midis një historie dashurie dhe urrejtjeje, të dallgëzuar vullshëm nga qasjet pragmatike aftashkurtra dhe jovizionare të politkberësve. Një sintezë të këtij zhvillimi e ka realizuar studiuesi Zyhdi Dervishi, i cili identifikon disa tipare domethënëse në kurbën e zhvillimit të disa disiplinave sociologjike në shoqërinë shqiptare.

Në një projektskicë të mendimit sociologjik përgjatë 100 viteve të historisë së shtetit të pavarur shqiptar (1912-2012) studiuesi Dervishi faktonte se qysh në vitin 1897, Faik Konica themeloi revistën “Albania” (Shih: Dervishi, Z.; 2012:221). Që në kopertinën e numrit të parë theksohej se kjo revistë do të trajtonte me përparësi çështje të sociologjisë, krahas atyre të letërsisë, të gjuhësisë dhe të historisë. Të gjithë revistat e mëvonshme teorike e kulturologjike të themeluara në hapësirën shqiptare në Ballkan dhe nga shqiptarët e diasporës që nga fillimi i shekullit XX deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, si “Hylli i Dritës”, “Zani i Naltës”, “Illyria”, “Minerva”, “Përpyjekja shqiptare”, “Shkëndija” etj., krahas shumë problemeve të tjera, kanë trajtuar edhe çështje të profilit sociologjik. Në shumë shkrime të botuara në revista të tilla janë botuar artikuj e pjesë të zgjedhura të veprave të sociologëve më të shquar si Konti e Dyrhejmi, Veberi e Zimeli, Spenseri e Midi etj. Në vitet 1930 gazetari dhe intelektuali Branko Merxhani pohonte se: “Sociologjia është ndihmësja e parë e reformatorëve... është shkencë më e nevojshme për çdo reformë shoqërore” (Shih: Dervishi, Z.; 2012: 223,224). Pikë kthese dramatike për mendimin sociologjik do të shënonin vitet e para të pas 1950-ës. Ashpërsimi i luftës së klasave solli edhe “frikë” ndaj sociologjisë, një nga rrjedhojat e kësaj lufte ka qenë edhe nxjerrja jashtë qarkullimit zyrtar e mendimit sociologjik (Poaty: 226). Zhvillimet e proceseve demokratizuese të pas vitit 1990 krijuan sërish hapësirat për rivlerësimin e sociologjisë dhe studimeve sociologjike.

Nëse në vitet e mëpasshme studiues të apasionuar pas sociologjisë do të ndër marrin iniciativën e guximshme dhe sfiduese të shkrimit të historisë së mendimit sociologjik në Republikën e Shqipërisë, me siguri në radhën e parë të studiuesve profesionistë të pas vitit 1990 do të ishte emri dhe

veprat e Profesor Dervishit. Me vetëdijen e një njeriu idealist dhe humanist, me mundin e një studiuesi sistematik dhe profesionisti dinjitoz e të pakompromis, me ndjenja atdhedashurie dhe vetëdije të lartë kombëtare Profesor Dervishi është një model i suksesshëm i arritjeve në fushën e studimeve sociologjike. Me përvojën e tij si studiues profesionist me një sërë publikime origjinale dhe angazhimin si Profesor në Departamentin e Sociologjisë së Universitetit të Tiranës studiuesi dhe pedagogu Zyhdi Dervishi është model për të transmetuar ndër studiesit e shoqërisë kulturën e punës sistematike dhe ndër brezat e rinj të interesuar për sociologjinë, modelin e një rrugëtimi të suksesshëm të studimeve serioze sociologjike, të kapërcimit të sprovave dhe sfidave të panumërta, të cilat më shumë se sa tipar i studimeve sociologjike janë produkt i rrethanave të deritanishme të zhvillimeve shoqërore, politike, ekonomike e kulturore në Republikën e Shqipërisë. Kontributet e studiuesit Zyhdi Dervishi janë të larmishme, me ndërthurje nga profilizime dhe nënprofilizime të ndryshme të sociologjisë si: Sociologji kulture, Sociologji e konfliktit, Sociologji e familjes, Sociologji gjinore, Sociologji e artit, Sociologji e shkencës, Sociologji e fesë, Sociologji e vullnetarizmit, Sociologji e komunikimit simbolik, etj. Studimet e tij janë me interes jo vetëm për sociologët, por edhe për studiuesit e tjerë të shkencave shoqërore, historike, etj., ose edhe të apasionuarve dhe të interesuarve për studime sociologjike. Në këtë artikull vëmendja do të përqëndrohet në çështje dhe aspekte studimore të Profesor Dervishit, të cilat profilizojnë zhvillime të jetës familjare në shoqërinë shqiptare, veçanërisht pas vitit 1990.

Për realizimin e këtij artikulli jam ndeshur edhe me problematika, ndër të cilat më kryesoret kanë qënë:

E para, ka të bëjë me volumin dhe intensitetin e trajtimit të çështjeve të familjes në veprat e publikuara të një studiuesi të tillë të sprovuar.

E dyta, përcaktohet nga vetë objekti i kësaj kumtese, pasi çështjet e familjes në studime sociologjike janë vazhdimisht variabël kyç, çka ndikon që edhe në studimet e profesor Dervishit të jenë mjaft komplekse. Për këto arsye krijimi i gjithë tablosë së ndihmesës së tij në tema që i përkasin Sociologjisë së familjes i tejkalon përmasat e këtij punimi.

Familja dhe dukuri të jetës familjare në studimet e sociologut Zyhdi Dervishi

Familja si institucion shoqëror dhe si agjensi e rëndësishme e krijimit të kapitalit shoqëror, nuk mund të mos jetë në fokus të analizave sociologjike. Në këtë këndvështrim, e konsideruar si një agjenci kryesore e formësimit dhe e transmetimit të modeleve të sjelljeve dhe qëndrimeve, familja edhe në studimet e Profesor Dervishit është një nga strukturat shoqërore më të rëndësishme që analizohet me përparësi e në shumëanshmërinë e saj.

II.1. Funksione të familjes shqiptare përgjatë tranzicionit

Në prezantimin me studimet e sociologut Dervishi, çdo tip lexuesi i lidhur drejtpërdrejt me sociologjinë si shkencë ose edhe i kuriozuar ose i interesuar ndaj saj, dallon lehtësisht prirjen e studiuesit për të dalluar tipare të veçanta të shoqërisë shqiptare dhe të funksionimit të saj. Kushdo që e njeh zinxhirin e kontributeve të shkruara të Dervishit nuk do të harronte të nënvizonte se pavarësisht misionit të tij si sociolog, filli që ndërthur në mënyrë organike gjithë punën e tij është edhe vizioni idealist e argumentimet teorike për një shoqëri shqiptare më të mirë, si një detyrë qytetare edhe

profesionale e një njeriu të angazhuar dhe me optimizëm ndaj së ardhmes. Në këtë frymë është me rëndësi analiza që studiuesi ofron për disa nga tiparet e familjes në shoqërinë shqiptare në tranzicion, në përmbushjen e funksioneve të saj, por edhe në zbutjen e rrjedhojave të ndryshimeve anomike.

Në literaturën sociologjike teoricienët funksionalë kanë identifikuar disa funksione të kryesore universale të familjes: sigurimi i mbështetjes emocionale, mbështetja ekonomike, shoqërizimi, kontrolli i riprodhimit dhe seksualitetit, trashëgimia e statuseve (Hammond, R. J.; 2012: 4-6). Cilat janë disa nga veçoritë e përmbushjes së këtyre funksioneve në familjet shqiptare pas vitit 1990? Si ravijëzohet roli dhe rëndësia e përmbushjes së përgjegjësiave familjare në mbështetje të stabilitetit shoqëror në studimet e sociologut Dervishi?

II.1.1. Familja si strukturë e qëndrueshme ekonomike përballë dilemave të zhvillimit kapitalist

Në studimin monografik “Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva” (2001) edhe pse fokusohet me përparësi kah problematikave me profil kryesisht gjinor në shoqërinë shqiptare përgjatë viteve 1990, është mjaft interesant këndvështrimi i studiuesit Z. Dervishi ndaj rolit të familjes në përballimin e krizës së papunësisë kryesisht për gratë dhe vajzat. Riorientimi politik dhe ekonomik i shtetit shqiptar pas 1990 drejt zhvillimeve demokratike dhe ekonomisë së tregut reflektoi dukshëm mungesën e strategjive vizionare të reformave. Në këtë perspektivë të çorganizuar të ndryshimeve demokratike shumë vende pune u mbyllën.

Në kornizat e interpretimeve sociologjike rritja e treguesve të papunësisë ndërlihet me një reaksion zinxhir ndikimesh negative shoqërore si rritja e përjashtimit shoqëror, mungesë

integrimi etj. (Charles, N.; Davies, Ch. A. And Harris, Ch.; 2008:115,116). Në studimin monografik të sipërcituar gjithë refleksioni i sociologut organizohet rreth këtyre dukurive problematike të zhvillimeve të reja ekonomike, sidomos për gratë dhe vajzat. Paaftësia e ekonomisë së re për të mbajtur të angazhuar në punë forcat e afta për punë, solli zhvillime alternative në krijimin e formave private të organizimit të punës, të cilat lidheshin ngushtësisht me skemat e vetëpunësimit në ekonominë familjare. Sociologu e faktin statistikisht këtë dukuri duke ju referuar të dhënave të Istitutit të Statistikës në Republikën e Shqipërisë, sipas të cilit 78.4 për qind e forcave të afta për punë në vitin 1998 ishin të vetëpunësuar. Shkalla e të vetëpunësuarve ka qënë më e lartë ndër vajzat dhe gratë. Kjo prirje është shoqëruar me rrjedhoja problematike të shumanshme (Shih: Dervishi, Z.; 2001:21).

“Çpunësimi i grave jashtë ekonomisë shtëpiake, - ka argumentuar Dervishi- “ngujimi” i tyre në ekonominë private, përgjithësisht pronë e burrit ose e fisit të tij, pra gjithësesi humbja e pavarësisë ekonomike është ndoshta sfida më e rëndë që ka tronditur jetën dhe personalitetin e vajzave e të grave në shoqërinë shqiptare, është ndoshta sfida që gjeneron sfida të tjera për to në të tanishmen dhe për të ardhmen, jo shumë të afërt.”(2001:21)

Rreth 18 vite më pas ende në shoqërinë shqiptare studiuesit shoqërorë dhe politikat në interes të përmirësimit të mirëqënies sociale kanë si një nga temat më të ndjeshme për element bazë në zhvillimin e qëndrueshëm pjesëmarrjen e gruas në punë dhe në proceset vendimarrëse. Në retrospektivë dhe në analogji me qasjen e analizës së studiuesit Dervishi sot mund të themi se *çpunësimi i grave nga jashtë ekonomisë shtëpiake*, ka qënë me siguri një sfidë

në vetvete dhe që gjithashtu ka gjeneruar sfida të reja deri në ditët tona dhe për të ardhmen.

II.1.2. Familja si njësi kryesore e krijimit të kapitalit social

Në perspektivën e disiplinave të ndryshme shkencore jo vetëm sociologjike, por edhe të atyre psikologjike, demografike, antropologjike, historike, ekonomike, mjekësore, politike, etj. familja si institucion dhe marrëdhëniet e anëtarëve të saj me njëri-tjetrin dhe shoqërinë në përgjithësi mbartin rëndësinë kryesore në çdo analizë, argument, reflektim dhe proces reformues. Familja dhe marrëdhëniet e saj me struktura të tjera shoqërore janë në zemër të një procesi jetësor shumë të rëndësishëm shoqëror, sikundër është riprodhimi dhe krijimi i kapitalit social.

Në funksionin e parë, të riprodhimit të kapitalit social në konceptet ligjore dhe sociologjike, familja mbart atributet e të qenit mjedisi social më i sigurt i njohur dhe pranuar shoqërisht dhe ligjërisht për sjelljen në jetë të fëmijëve. Ky funksion shpreh prirjet shoqërore për të rregulluar proceset biologjike bazuar në norma kulturore dhe norma ligjore, të cilat diferencojnë ndër të tjera aspektet riprodhuese të njerëzve, ndryshe nga çdo specie tjetër biologjike.

Në funksionin e dytë, të krijimit të kapitalit social familja dhe anëtarët e saj vendosen përballë sfidës së proceseve shoqërizuese për të aftësuar dhe vetëdijësuar anëtarët e rinj të shoqërisë për mjedisin social në të cilin kanë lindur dhe do të veprojnë. Ky proces konsiderohet si një nga më sfiduesit, sepse nëpërmjet shoqërizimit anëtarët e rritur të familjes duhet të transmetojnë tek anëtarët e rinj modelet e pranueshme dhe të sukseshme për të qënë shoqërisht i

pranuar dhe i shpërblyer, dhe njëkohësisht për të përmirësuar kushtet e vetërealizimit dhe përparimit të të rinjve.

II.1.2.1. Funkzioni i kontrollit të marrëdhënieve seksuale

Analiza e familjes në shoqërinë shqiptare në përmbushjen e funksionit riprodhues në studimet e sociologut Dervishi prezantohet në këndvështrime të larmishme. Studiuesi parashtron kushtet dhe kriteret e përgjithshme që në shumicën e vendeve të botës, e veçanërisht vendeve më të urbanizuara qysh pas Luftës së Dytë Botërore kanë ndikuar në prirjet e lindshmërisë ndër të cilat më kryesoret janë: dëshirimi i prindërve për djem, fëmijët si aset ekonomik në funksionimin e ekonomisë familjare në shoqëritë rurale, kufizimi i lindshmërisë si faktor stabiliteti në shoqëritë bashkëkohore (Dervishi, Z.; 2003: 21-33). Kriete dhe kushte të ngjashme në periudha të ndryshme historike kanë shërbyer si faktorë të transformimit të rolit të familjes edhe në shoqërinë shqiptare.

Familja shqiptare, në rrjedhën e dinamikave sociohistorike, ka funksionuar duke u bazuar në norma kulturore dhe ligjore. Sociologu Dervishi analizon në mënyrë të detajuar tiparet e veçanta të familjes në realizimin e funksionit riprodhues dhe të kontrollit seksual të të rinjve në tri periudha të historisë së shoqërisë shqiptare: shoqërinë shqiptare tradicionale, shoqërinë shqiptare të periudhës së regjimit socialist totalitar dhe në shoqërinë shqiptare të pas vitit 1990.

Studiuesi Dervishi analizon me përparësi një sërë vlerash dhe normash kulturore, të

cilat kanë rregulluar edhe marrëdhëniet seksuale ndërmjet anëtarëve të shoqërisë tradicionale shqiptare. Ai argumenton se këto janë të pakta, shpesh të tërthorta dhe anemike. Studiuesi Dervishi thekson:

“Kultura shqiptare tradicionale karakterizohet nga një numër shumë i madh normash kulturore të detajuara, të cilat rregullonin të gjithë sistemin e marrëdhënieve, të komunikimeve të shumanshme të anëtarëve të saj. Por për problematikën e marrëdhënieve martesore dhe sidomos seksuale norma të tilla janë të pakta, më anemike, madje të shprehura në trajta më të tërthorta.” (2003:38)

Nëpërmjet argumenteve të përshkallëzuara sociologu Dervishi veçon disa tipare të qëndrueshme të familjes në rregullimin dhe kontrollin e marrëdhënieve seksuale që kanë të bëjnë me normat kulturore kanunore që vlerësojnë si përparësor nderin e vajzave dhe grave, të cilat përshkrohen nga intoleranca totale ndaj marrëdhënieve seksuale paramartesore dhe jashtëmartesore (Dervishi, Z.; 2003:40). Tagrin e babait dhe anëtarëve meshkuj të familjes për të vendosur mbi marrëdhëniet seksuale të të rinjve nëpërmjet lidhjeve të tyre në fejesë e martesë (Po aty:46). Martesa, bazuar në normat kulturore tradicionale konsiderohej si i vetmi institucion që legjitimon marrëdhëniet seksuale, si pjesë e detyrave martesore (Po aty: fq 53). Gjithashtu sociologu Dervishi analizon edhe tagrin e burrit mbi kontrollin ndaj gruas të tij në çështje të nderit, që i njihnin atij edhe të drejtën mbi jetën e gruas (Po aty:40). Në këtë kuadër ai ka analizuar edhe implikimet shoqërore në reagimet kolektive ndaj shkelësve të normave kulturore të nderit, por dhe në nxitjen e konflikteve shoqërore ndaj “kallëzuesve” për veprime të tilla kundërnormative (Po aty:42-45).

Opinionin e shoqërisë shqiptare tradicionale nuk i pranonte poligamitë. Por, burrat kishin të drejtë të martoheshin me një grua të dytë, e ndonjëherë edhe të tretë nëse gruaja e parë ose e dytë nuk lindte fëmijë dhe sidomos djem. Gruaja e parë, si

rregull, nuk divorcohej, ajo fitonte një status më të nderuar në familje të bashkëshortit. Këtë dukuri të marrëdhënieve martesore e familjare origjinale sociologu Dervishi e ka analizuar në shumë rrafshe sociologjike, etnologjike, etj. (Dervishi, Z. 2003: 51-52). Dervishi ka analizuar në rafsh sociologjik “mekanizmin” e formimit të grupit social të virgjinave, të vajzave që deklarorin se nuk do të martoheshin gjithë jetën. Këto ishin vajza të vetme ose një ndër vajzat pa vëlla, që i përkushtoheshin përkujdesjes për prindërit. Virgjina të tilla kanë qënë më të pakta, pasi shumica e këtij grupimi ishin vajza që kishin refuzuar të martoheshin me djalin, me të cilin i kishin fejuar pa lindur ose që në fëmijëri të hershme. Sipas normave kulturore kanunore refuzime të tilla i jepnin të drejtën burrave të familjes së djalit të refuzuar të vrisnin babain ose një nga vëllezërit e ish të fejuarës. Për të shpëtuar jetën e babait ose të vëllait virgjinat sakrifikonin jetën e tyre, i mohonin vetes të drejtën për të qënë nëna, që në shoqërinë tradicionale shqiptare konsiderohej si një nga detyrimet më të rëndësishme. Në këtë këndvështrim sociologu Dervishi dukurinë e virgjinave e karakterizon si shfaqje të altruizmit të skajshëm të vajzave në shoqërinë tradicionale shqiptare (Po aty, 55-56).

Pas Luftës së Dytë Botërore orientimi i shoqërisë shqiptare drejt organizimit politik

socialist totalitar dhe formave të reja të ekonomisë së centralizuar shtetërore, me pretendimet e krijimit të një rendi të ri, synuan shpëputjen nga tradita. Sociologu Z. Dervishi analizon edhe paradokset e kontrollit ndaj marrëdhënieve seksuale në këtë periudhë, të cilat përmbledhtasi do të shpreheshin në këto profile kryesore:

Së pari, strukturat patriarko-shtetërore shpreheshin zyrtarisht kundër normave kulturore kanunore. Megjithatë

në praktikën e masave të ndëshkimit për sjellje seksuale jokorrekte mbaheshin në konsideratë norma të tilla. Veçse në një regjim totalitar ndëshkime të tilla jepeshin nga struktura shtetërore ose të organizatave të masave dhe jo nga strukturat familjare ose farefisnore (Dervishi, Z.; 2003: 64)

Së dyti, në përpjekje për të forcuar qëndrimet etnocentrike shfaqjet e papranueshme dhe të gjykueshme në sjelljet seksuale nuk ishin në tagër vetëm të familjes, por nën hetimin e gjykimin e vazhdueshëm të përfaqësuesve partiako-shtetërorë, sepse këto sjellje i kundërviheshin ideologjisë socialiste, si sjellje që karakterizonin shoqëritë e kalbura perëndimore, të papranueshme për njeriun e ri në shoqërinë shqiptare (2003: 66).

Në këtë fazë të zhvillimeve sociokulturore në realizimin e funksioneve riprodhuese dhe të kontrollit seksual familja shqiptare u ndikua nga dëpërtimi i politikave shtetërore. Aspekte të kontrollit dhe ndikimit politik përcaktuan aspekte të rolit të familjes, pasi shumë parametra të zgjedhjes së partnerit si përkatësia intelektuale, e vendbanimit, përkatësia fetare, përkatësia klasore, moshë e martesës, ndalesa dhe lejesa në marrëdhëniet intime, numri i fëmijëve në familje, etj., ndikoheshin shumë prej strukturave partiako-shtetërore. Nëpërmjet bazimit në të dhëna nga dokumente të rëndësishme të kohës sociologu Dervishi argumenton se edhe aspektet e planifikimit familjar ishin të rregulluara politikisht, prej vullnetit shtetëror të shtimit të popullsisë, duke ndaluar me ligj ndërprerjen e vullnetshme të shtatëzanive, ndalimin e përdorimit të metodave kontraceptive, shpërblimet në formë të ndryshme në rastet e lindjes së shumë fëmijëve, etj. (2003: 177-199).

Jeta familjare, struktura e marrëdhënieve familjare pësuan ndryshime të ndjeshme në shoqërinë shqiptare të pas vitit

1990, duke reflektuar përmes problemeve të shfaqura dilemat dhe sfidat e zhvillimit të institucionit të familjes në shoqërinë bashkëkohore. E megjithatë, në studime ndërdisiplinore mbi familjen dhe përmbushjen e funksioneve prej saj, reflektohen elementët e kulturës tradicionale dhe ballafaqimi hera-herës jo pak problematik, me modelet e kulturës bashkëkohore me ndikime të larmishme multikulturore.

Ndryshimi në perceptime dhe qëndrime ndaj marrëdhënieve seksuale pas vitit 1990, sociologu Dervishi i ka analizuar në mënyrë më të detajuar në punimin monografik “Flirte me plagët” (2003:66-99). Në të ai ofron një tablo të gjerë të faktorëve dhe rrjedhëve të trazimeve në marrëdhëniet intime sipas këndvështrimit të vetë të rinjve në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të XX. Nëpërmjet analizës dhe interpretimit sociologjik të të dhënave empirike, studiuesi ia mbërrin të reflektojë disa nga rrjedhojat kryesore në botëkuptimin e të rinjve përgjatë proceseve të tilla të vullshme e kaotike problematike. Në një përmbledhje gjeneralizuese në këtë syth vihen re: 1- standartet e dyfishta të kuptimit mbi lirinë seksuale, domethënë ndryshe për djemtë dhe ndryshe për vajzat; 2- përjetimet e gjykimeve dhe kontrollit shoqëror ndaj numrit të partnerëve për vajzat, në trajtim ndryshe ndaj sjelljeve dhe kritereve të vlerësimit për djemtë; 3- kuptimi mbi marrëdhëniet seksuale paramartesore dhe jashtëmartesore në mënyrë të dyzuar: ndryshe për vajzat dhe ndryshe për djemtë. Në këto veçanti evidentohet trajtimi jo i barabartë sipas përkatësisë gjinore dhe mund të sintetizojmë se konservimi i traditës në funksionin familjar të riprodhimit dhe kontrollit seksual në dhjetëvjeçarin e parë të pas vitit 1990 shprehet më shumë ndaj vajzave se sa ndaj djemve, gjë që reflektohet edhe në format e planifikimit familjar të “rezistencës” për të përdorur mjete kontraceptive;

të stigmatizimit të vajzave që kërkojnë të mbrohen gjatë marrëdhënieve seksuale paramartesore; në prirjen e nxitjes së abortit përzgjedhës bazuar në përkatësinë gjinore të foshnjës (Dervishi, Z.; 2003:198-203).

II.1.2.2. Veçori të shoqërizimit të të rinjve në familjet shqiptare

Në studimet e Profesor Dervishit, roli shoqërizues i familjes dhe veçanërisht ndaj brezit të ri, është vazhdimisht në qëndër të reflektimeve dhe analizave sociologjike për vetë rëndësinë që ky funksion i familjes mbart në krijimin e kapitalit social dhe në trashëgiminë e aseteve njerëzore për të ardhmen shoqërore. Duke patur parasysh larmishmërinë e studimeve të autorit në fusha të ndryshme të disiplinave shkencore sociologjike është shumë e vështirë që në disa paragrafë të përmbledhësh në mënyrë përfaqësuese veçoritë e familjes shqiptare në përmbushjen e funksionit shoqërizues si kontribut në krijimin e kapitalit social.

Në përpjekje për rilevimin e drejtimeve kryesore të ndikimit të familjes në shoqërinë shqiptare në tranzicion për shoqërizimin e kapitalit human ndër studimet e sociologut Dervishi mund të veçojmë disa forma të orientimit të marrëdhënieve dhe shoqërizimit në familje:

Mbështetja e familjeve shqiptare për arsimimin e të rinjve dhe veçanërisht vajzave si mundësi për punësim, pavarësi ekonomike dhe dinjitet në familje e shoqëri (Dervishi, Z., 2001:13-20; Dervishi, Z., 2003:77-78). Dervishi përshkruan raste të prindërve shqiptarë, të cilët braktisin karrierën e tyre të suksesshme të mjekut, të avokatit, të noterit në Shqipëri dhe shkojnë në vende të tjera si emigrant, ku kryejnë punë të rëndomta, sfilitesë me pikësynimin fisnik për të arsimuar fëmijët e tyre në shkollat më cilësore.

Shprehja e profileve të shoqërizimit sipas përcaktimeve të roleve gjinore tradicionale

në profilet e punëve të parapëlqyera për vajzat dhe djemtë nga familjet e origjinës. Kryesisht vajzat dhe gratë nxiten të angazhohen në profile edukimi për karierrë profesionale sipas modeleve tradicionale të roleve gjinore dhe gjejnë pak ose aspak mbështetje për t'u angazhuar në sferat e larta të vendimarrjes, sidomos në politikë (Dervishi, Z., 2001: 94-100, 106-118).

Familja në shoqërinë shqiptare luan një rol përcaktues në statusin e të rinjve dhe të rejave, sidomos për sa u përket pozitive politike, ekonomike dhe trashëgimisë fetare (Dervishi, Z., 2001: 39, 112-118)

Familja në shoqërinë shqiptare kryen funksionin e rëndësishëm të transmetimit të rëndësisë së vlerës së martesës, familjes dhe të modeleve të jetës familjare. Në studimin monografik “Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva” (2001), sociologu Dervishi bazuar në të dhëna statistikore empirike analizon risitë sociokulturore në zhvillimin e lidhjeve martesore e familjare në rrjedhën e zhvillimeve demokratike të shoqërisë shqiptare. Nëpërmjet një analize në rafsh krahasimor historik e kulturor studiuesi arsyeton në lidhje me tiparet pluraliste të familjeve në shoqërinë shqiptare të fillimit të shekullit të XXI. Vend të rëndësishëm zë shqyrtimi i perceptimeve dhe qëndrimeve të prindërve dhe të rejave ndaj çështjes së raporteve ndërmjet bashkëjetesës dhe martesës. Profilet e bashkëjetesës nga vajzat e reja motivoheshin më së shumti nga dashuria mes të rinjve, por mbartnin tregues të lartë rreziku për vajzat e reja, të cilat mund të rrezikonin të binin në rrjetën e trafikimit ose në kurthin e biznesmenëve, të cilët i përdornin seksualisht nën premtimin për bashkëjetesë ose martesë (Dervishi, Z.;

2001:197-200). Përgjithësisht bashkëjetesa e të rinjve dhe veçanërisht e të rejave pranohet me vështirësi ose kundërshtohet prej prindërve të tyre. Në gjetjet e studimit theksohet se nënat, veçanërisht për vajzat e tyre parapëlqejnë fejesën e martesën sipas normave kulturore dhe ligjore. Në qëndrimet e nënave është e rëndësishme simbolika që mbart në vetvete martesa dhe krijimi i familjes sipas rregullave dhe nuk do të dëshironin që vajzat e tyre të bashkëjetonin. Shqetësimet e tyre përcaktohen nga trysnia e opinionit shoqëror dhe përgjegjësia e prindërve për të ardhmen e vajzave të tyre, sepse siç argumenton sociologu Dervishi *“bashkëjetesën në kushtet e Shqipërisë e konsiderojnë të papërshtatshme, sepse ajo rregjistrohet në kujtesën kolektive dhe përgojohet në ato përmasa sa që bëhet shqetësim, jo vetëm për familjet, por edhe për të afërmit e partnerëve”*(Dervishi, Z.; 2001: 209)

Duke u bazuar në perspektivën strukturo-funksionaliste të përpunuar nga Talcot Parsons mund të pohojmë se në studimet e sociologut Dervishi përvijohet prirja e familjes në konservimin dhe ruajtjen e strukturës shoqërore tradicionale shqiptare, nëpërmjet procesit të shoqërizimit, por edhe aspekte të përcaktimeve kulturore ndaj formës së marrëdhënieve familjare (Shih: Ritzer, G.; 1983: 195-198). Në tiparet e sipërrenditura të shoqërizimit, familja shqiptare reflekton rëndësinë e saj në riprodhimin e vlerave, besimeve dhe normave kulturore tradicionale të shoqërisë shqiptare si dhe funksionin e saj të natyrshëm në përbrendësimin e rregullimeve shoqërore me tipare patriarkale ndër anëtarët e rinj të shoqërisë. Në refleksion të këtij qëndrimi parsonsian të interesuarit ndaj proceseve reformuese dhe përshtatëse të dobishme për zhvillime progresiste në shoqërinë shqiptare në studimet e profesor Zyhdit do të gjejnë një sërë të dhënash empirike, të cilat identifikojnë aspektet funksionale

dhe disfunktionale të familjes përgjatë viteve të kalimit të shoqërisë shqiptare nga rendi socialist totalitar në proceset me qasje demokratizuese. Vendosija e studimeve sociologjike mbi familjen në fokus të proceseve reformuese, do të ndikonte në rritjen e efektivitetit të masave të ndryshme politike, kulturore, ekonomike e shoqërore.

II.2. Problematika dhe konflikte në jetën familjare

Familja, pothuajse përherë, shfaqet në studimet sociologjike si një nga dukuritë universale, brenda të cilës aktori social shfaq në mënyrë të njëkohshme veten dhe shoqërinë. Studimet e sociologut Z. Dervishi, ndër të tjera, mund të shihen edhe si një refleksion i kujdesshëm i mënyrës se si dukuritë e jetës familjare dhe proceseve brenda saj janë pasqyrim i më së paku tre faktorëve në marrëdhënie dialektike me njëri-tjetrin si:

Kushtet e reja të zhvillimeve në shoqërinë shqiptare, me tipare dalluese nxitjen dhe anominë e ndryshimit.

Përpjekjet, sfidat dhe arritjet e anëtarëve të shoqërisë shqiptare për t'u përshtatur me kushtet e reja të zhvillimeve.

Familjet shqiptare si faktorë drejtpeshues ndërmjet vlerave tradicionale dhe bashkëkohore, ndërmjet risive dhe aspekteve problematike të tyre.

Në përmbushje të refleksionit sociologjik për të kuptuar rrjedhojat kritike të ndërveprimit

kundërshtues të këtyre faktorëve në studime të ndryshme monografike të tij siç janë “Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva” (2001), “Flirte me plagët” (2003), “Bashkëjetesë me demonët e konflikteve” (2005), Dervishi trajton tema të rëndësishme të problemeve dhe konflikteve në jetën familjare të viteve të tranzicionit në shoqërinë

shqiptare. Tema të tilla janë të larmishme, të kundruara përmes një sërë lentesh që nxisin zhvillimin e analizave të pasura dhe të qëndrueshme.

Së pari, ndër format e reja të zhvillimeve në jetën familjare të shoqërisë shqiptare pas vitit 1990 studiuesi veçon prirjen në rritje të zgjidhjes së martesave. Në studimet sociologjike mbi divorcin studiuesit përgjithësisht ndërtojnë argumente në linja të ndryshme arsyetimi. Disa prej studiuesve e shohin prirjen në rritje të treguesve të divorcit si shprehje të konflikteve dhe kundërshtive në familje mes bashkëshortëve, ndërsa të tjerë studiues e shohin divorcin jo medoemos si shprehje të aspekteve disfunksionale të jetës familjare, por si prirje e nxitur dhe e zhvilluar nga larmia e modeleve të jetës intime në shoqëritë me elemente pluraliste, e cila vë në qëndër stilin individualist të jetesës. Sociologu Dervishi ka dhënë ndihmesë origjinale në parashtrimin e një sërë arsyetimeve rreth treguesve të zgjidhjes së martesave në shoqërinë shqiptare. Nëpërmjet një analize historike ai reflekton se *“dukuria e divorcimit ka qënë dhe vazhdon të jetë një nga problemet më shqetësuese të shoqërisë shqiptare si në mendësi, ashtu edhe në realitet”* (Dervishi, Z. 2001:141). Një refleksion i tillë përball dy faktorë të rëndësishëm në shqyrtimet e kohëpaskohëshme mbi divorcin në shoqërinë shqiptare. Nga njëra anë, qëndron norma kulturore tradicionale e martesës së përjetshme dhe të shenjtë, dhe nga ana tjetër, prirja e rritjes së treguesve të divorcit si një proces, i cili mbart rrjedhoja dhe sfida si për të divorcuarit, ashtu edhe për shoqërinë shqiptare në tërësi. Zgjedhjen për divorc studiuesi e sheh si një trazim të vazhdueshëm në ndërgjegjien e grave shqiptare. Ndër çështjet familjare të trajtuara në gjykatë divorci zë vendin e parë, por është e vështirë të përcaktohet nga të dhënat se cili ndër bashkëshortë nis procesin ligjor të zgjidhjes së

martësës. Përhapja e dukurisë së divorcit në shoqërinë shqiptare, përgjithësisht ofrohet si shqetësim i vajzave dhe grave, të cilat janë edukuar me normat kulturore të rëndësishme të martësës dhe familjes. Shpesh këto gra vihen në shërbim të familjes dhe fëmijëve edhe atëherë kur konfliktet me bashkëshortët e tyre janë mjaft të ashpra.

Sociologu Dervishi në gjetjet e studimeve të tij e profilizon zgjedhjen për divorc nga gratë shqiptare përgjithësisht si zgjidhje për t'u larguar nga një mjedis familjar e bashkëshortor problematik. Faktorët e qëndrueshëm të sjellë në vëmendje nga studiuesi, të cilët mund të orientojnë debatin sociologjik mbi treguesit e divorceve janë:

Mungesa e stabilitetit në zhvillimet ekonomike, që rrit prirjen e mjaft burrave për t'u angazhuar në verpimtaritë jashtligjshme, të cilat nxisin në rast zbulimi arratisjen e tyre ose burgosjen për kohë të gjatë. Ky faktor krijon problemin e divorcit të faktit si dhe jo rrallë herë nxit bigaminë, martesë të njëkohshme në shtete të ndryshme (Dervishi, Z.;2001:148).

Shpërpjestimet në nivelet e formimit arsimor të vajzave dhe djemve që lidhen në martesë (Po aty, 149).

Diferencat e konsiderueshme në moshën e martësës ndërmjet bashkëshortit dhe bashkëshortes (Po aty, 155,161).

Realizimi i martësës nëpërmjet njohjeve të pamjaftueshme nga të tretë (Po aty, 158).

Fejesa dhe martesë e vajzave me moshë të re, nën 19 vjeçe (Po aty, 164).

Së dyti, në studimet sociologjike, por edhe në studime ndërdisiplinore me interes për format e zhvillimit të

marrëdhëniet familjare aspekte të dhunës në familje marrin vëmendje të veçantë. Dhuna në familje është një nga zhvillimet problematike në shoqërinë shqiptare jo vetëm për rrjedhojat ndaj viktimave të dhunës në familje, por edhe për interesin publik në lidhje me trajtimin e faktorëve shoqërorë, të cilët nxisin prirjet e dhunshme.

Studiuesi Z. Dervishi dhunën brenda familjes në shoqërinë shqiptare të zhvillimeve demokratike pastotalitare e analizon në konfliktin e profileve kryesore të zhvillimit të shoqërisë shqiptare: modelet e familjes tradicionale kryesisht banuese në zonat rurale; treguesit e ulët të integritit të popullsisë së zhvendosur nga vendbanimet rurale drejt vendbanimeve urbane, duke krijuar modelin e “fshatit urban” (Shih: Dervishi, Z.; 2001:53-54). Në gjetjet e autorit përshkruen disa tipare të dhunës në familje që përkohjnë me: a- dhunën me përkatësi gjinore; b- treguesit e lartë të dhunës ndaj gruas nga bashkëshorti; c- dhunën ndaj fëmijëve, ku vihet re dhe prirja e nënave për të qënë më kritike dhe dhunuese ndaj vajzave dhe prirja e baballarëve për të qënë më të dhunshëm ndaj djemve; d-qëndrimet autoritare dhe të dhunshme të vëllait/vëllezërve më të rritur ndaj motrave (Po aty, 55).

Profilet dhe faktorët e dhunës brenda familjes janë njëra anë e diskutimit, por trajtimi i dukurisë së dhunës në familje nuk mund të jetë i plotë pa marrë në konsideratë pasojat që ajo shkakton për të dhunuarit. Në diskutimin e rrjedhojave të sjelljeve të dhunshme në familjen shqiptare të dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit të XX sociologu Dervishi ndërton një tablo, e cila mbi të gjitha është shprehje e çekuilibrit shoqëror në ato vite, e kulturës tradicionale të prindërimit, e rëndësisë së kontrollit social pa drejtpeshim objektiv ndaj sjelljeve të moralshme dhe të pamoralshme (ndryshe për vajzat dhe ndryshe për djemtë), e rritjes së proceseve

socialkulturore me natyrë atomizuese si pasojë e rritjes së elementëve pluralistë dhe shumëkulturore në shoqërinë shqiptare.

Në analizën e te dhënave empirike studiuesi në mënyrë narrative dhe të shtjelluar argumenton se *“e vetmja formë e dhunës që justifikojnë përgjithësisht shqiptarët është ajo që ushtrohet nga prindërit ndaj fëmijëve”* (Derivishi, Z.;2001:65). Kjo prirje e justifikimit të dhunës së prindërve ndaj fëmijëve shpreh qartë kulturën tradicionale të prindërimit dhe përdorimin e mjeteve tradicionale të edukimit. Nga ana tjetër, mendoj se një prirje e tillë shpreh rëndësinë e rolit të prindërve dhe tagrin e tyre për të orientuar në *“korsinë e duhur të jetës”* fëmijët e tyre. Kjo është një nga tezat e diskutueshme në lidhje me format e edukimit prindëror, duke mos harruar se në kuptimin sociologjik dhuna ka disa përmasa, dhe në kuptimin përmbajtësor nuk është e shprehur vetëm në agresion, por është një formë e shtrëngimeve dhe kufizimeve emocionale, ekonomike, në lirinë e të vepruarit, e shprehur edhe nëpërmjet formave të shpërblimeve dhe ndëshkimeve në familje, për të edukuar fëmijët në bazë të rregullave të mirëpranuara shoqërisht.

Së treti, ndër sfidat e zhvillimit të jetës familjare, veçanërisht në shoqëritë në tranzicion si shoqëria shqiptare, është ballafaqimi ndërmjet brezave dhe bashkëjetesa jokonfliktuale ndërmjet tyre. Në një nga studimet e tij monografike *“Bashkëjetesë me demonët e konflikteve”*, sociologu Devishi ka bërë subjekt studimi grup-moshën e adoleshentëve, që për nga dinamikat e sjelljes, është më e brishta dhe më e stuhishmja njëkohësisht. Gjetjet e orientojne diskutimin në dendurinë e konflikteve dhe intensitetin e tyre ndërmjet prindërve dhe djemve ndryshe nga konfliktet me vajzat.

“...përgjithësisht djemtë konsiderohen më trazovaçë, më kokëfortë, më kryeneçë, më të pabindur ndaj prindërve, më të prirur për sherr vend e pa vend edhe me prindërit... Ndërkohë vajzat adoleshente përgjithësisht konsiderohen më të shtruar, më të bindura ndaj prindërve, më të prirura t’u shmangen mosmarrëveshjeve me të tjerët dhe sidomos me prindëri.” (Dervishi, Z.; 2005:56).

Në analizën e të dhënave të anketimit ka rezultuar se motivet bazë të mosmarrëveshjeve të adoleshentëve djem me prindërit e tyre janë kryesisht për arsye ekonomike dhe çështje të tjera që lidhen me pavarësinë e të vepruarit. Motivët e mosmarrëveshjeve të vajzave adoleshente me prindërit e tyre kanë rezultuar të një natyre tjetër, me përmbajtje të përthyerjeve të mendësive psikokulturore tradicionale, që i nxisin prindërit të mbajnë vajzat nën kontroll të vazhdueshëm.

Djemtë adoleshentë të dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit të XX, nga njëra anë, kanë përjetuar shokun kulturor të ndryshimit të shpejtë dhe të çoroditur ekonomik në shoqërinë shqiptare dhe, nga ana tjetër, përfytyrimet për nevojat dhe dëshirat e tyre i kanë bazuar në modele të largëta perëndimore për realitetin e tyre familjar, e gati të paarritshme për ta. Studiuesi Dervishi arsyeton: *“...konfliktimet e të rinjve me prindërit, ngaqë prindërit nuk u plotësojnë si duhet kërkesat e tekat ekonomike, do të vazhdojnë të tensionojnë marrëdhëniet në familjet shqiptare edhe për një kohë relativisht të gjatë”*(2005:60). Motivët ekonomike nuk janë vetëm burim i konfliktit në familje mes prindërve dhe djemve të tyre, por jo rrallë herë janë edhe faktorë të shfaqjes së tre sjelljeve problematike kryesore për adoleshentët si: a- puna e adoleshentëve në ekonominë familjare ose jo familjare (Po aty, 61), b- emigrimi i tyre drejt

vendeve më të zhvilluara (Po aty, 64-66), c- anagzhimi në forma të veprimtarive deviante (Po aty, 69), si përpjekje për të siguruar standartin e jetesës që adoleshentët pretendojnë.

Mosmarrëveshjet e vajzave adoleshente me prindërit e tyre përshkallëzohen në konflikt për motive të ndryshme nga ato të djemve adoleshentë. Nën fluksin e ndryshimeve të menjëhershme dhe nën difuzimin e sjelljeve kulturore alternative dhe të panjohura ose të ndaluara më herët, vajzat adoleshente përjetojnë tjetërsim edhe nën trysinë e kërkesave të prindërve të tyre dhe modeleve të reja shoqërore. Ndër motivet më të shpeshta të konfliktimit me prindërit dhe vajzat e tyre adoleshente janë modat e reja të jetesës dhe të veshurit, sidomos qëndrimet kundërshtuese të prindërve ndaj marrëdhënieve seksuale paramartesore dhe veshjeve ekstravagante, formave të bashkëjetesës paramartesore, që në sytë e prindërve janë ekspozime të rrezikshme për vajzat e tyre dhe kjo nxit rritjen e tutelës së tyre psikologjike ndaj vajzave (Dervishi, Z.; 2005:75-76).

Studiuesi reflekton rreth aspekteve origjinale të reagimit të vajzave adoleshente shqiptare ndaj varfërisë në familjet e tyre. “...vajzat me personalitet të zhvilluar përgjithësisht janë më të prirura të mbyllën në vetvete, e konsiderojnë cënim të dinjitetit të tyre nëse një person i tretë ndërhyr, qoftë edhe me pikësynime humane, në intimitetin e marrëdhënieve të tyre me prindërit”(Dervishi, Z.;2005:78). Vajzat adoleshente priren që të zgjedhin si rrugë të çlirimit të tyre nga tutela e prindërve, pa cënuar dinjitetin e tyre shkëputjen për vazhdimin e arsimit të mesëm në shkolla të qëndrave urbane të zhvilluara, të vazhdojnë arsimin e lartë në qytete universitare, të stabilizohen në qytete përmes martesës, ose të largohen nga zonat e tyre të vendbanimit për arsye punësimi. Një rrugëtim i tillë i vetëmenaxhimit të

burimeve të mosmarrëveshjeve nga ana e vajzave shpreh dëshirën e tyre për të përmbushur pritshmëritë e prindërve ndaj rëndësisë së moralit të tyre, por edhe për të qënë fleksibël ndaj kushteve të reja shoqërore.

Ndihmesa në studimet sociologjike dhe për studiuesit e rinj të proceseve familjare

Studimet monografike të sociologut Dervishi dhe veçanërisht në çështjet dhe temat sociologjike mbi procese empirike të familjes janë një pasuri e shtuar në fondin e teksteve studimore mbi familjen shqiptare të pas vitit 1990. Profesor Dervishi priret të ndërtojë një panoramë hulumtuese tërësore, si të thuash, 360 gradë të fakteve sociale në fokus të studimeve të tij, duke u qëndruar besnik shtyllave të kërkimit sociologjik si:

Refleksioni sociologjik shumëpërmasor rreth shkaqeve historike dhe zhvillimit në proces të dukurive dhe fakteve sociale mbi familjen.

Prezantimi i gjetjeve sociologjike studimore të sociologëve e studiuesve të disiplinave të tjera shoqërore e humane shqiptare dhe joshqiptare për çështjet me interes studimor mbi familjen.

Zhvillimi i diskutimeve të gjetjeve empirike nëpërmjet analizave sintetizuese dhe krahasuese të marrëdhënieve shkak-pasojë të evidentuara gjatë studimit.

Promovimi i studimeve sociologjike mbi familjen dhe nëpërmjet rekomandimeve praktike tërheqja e vëmendjes së aktorëve social dhe strukturave shtetërore për trajtim të dukurive shoqërore përmes lenteve sociologjike.

Çfarë deri më tani është përshkruar, përkon me ndihmesat e vetë Profesor Zyhdi Dervishit, si një studiues profesionist

skrupuloz dhe me kërkesa të larta ndaj punës së tij studimore e pedagogjike, reflekton parimet e një njeriu që kohën më të madhe të ditës së tij e kalon mes librave, arkivave, kërkimeve të vazhdueshme në terrenin e shoqërisë shqiptare, dhe prezanton ndihmesat e një sociologu të sprovuar në shkrimin e teksteve të shumta monografike origjinale. Profili i sociologut Dervishi është një ndër më të spikaturit e pas vitit 1990, i cili në punën e tij nuk ka reflektuar asnjëherë pengesat dhe sfidat, që jo rrallë herë i ka ndeshur, por ka zhvilluar një punë profesionale model nëpër rrugetimin e mundimshëm të studiuesit profesionist pak të vlerësuar dhe pothuajse aspak të shpërblyer në shoqërinë shqiptare të 30 viteve të fundit.

Lexuesit të tërhequr nga studimet sociologjike dhe për më tepër studiuesit e rinj të apasionuar pas kërkimeve empirike sociologjike, ndër ta edhe të interesuarit mbi studime sociologjike mbi familjen në tekstet e Profesor Dervishit do të mund të gjejnë:

Orientim drejt metodave origjinale të studimit sociologjik në reflektim të tipareve të veçanta psikokulturore të anëtarëve të shoqërisë shqiptare.

Interpretim origjinal të literaturës vendase dhe të autorëve joshqiptarë mbi familjen dhe çështje që lidhen me të.

Të dhëna empirike, fakte sociale dhe argumente sociologjike mbi çështje të ndryshme të familjes shqiptare, të cilat do ndihmojnë në parashtrimin e dukurive dhe analizën krahasimore në diskutimin e gjetjeve.

Ndihmesa e Profesor Dervishit për studiuesit e rinj të sociologjisë, por jo vetëm, është reale dhe shumëpërmasore.

Së pari, është një udhërefyës i profilit idealist për çdo student të Degës së Sociologjisë në Universitetin e Tiranës, me kujdesin e Profesorit me përvojë, vit pas viti, motivon dhe mbështet përparimin profesional dhe human të studentëve nëpër auditoret ku zhvillon mësim.

Së dyti, Profesor Dervishi është udhëheqës shkencor i më së paku 12 disertacioneve të përmbyllura me sukses nga ish-studentë të profilit sociologji, publikuar edhe në rregjistrimet e Bibliotekës Kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Së treti, tekstet e punimet monografike të sociologut Dervishi janë ndër më të cituarit në botimet vendase dhe të huaja prej studiuesve të sociologjisë dhe disiplinave të përfaqësuara me të, çka shpreh qëndrueshmërinë e gjetjeve të tij studimore si dhe rivlerëson faktin e të qenit ndër pionerët e studimeve sociologjike në Republikën e Shqipërisë të pas vitit 1990.

Së katërti, studiuesi Dervishi ka dhënë ndihmesa ende të pavlerësuara si duhet në shoqërinë shqiptare dhe strukturat e saj, në njohjen e profileve të shoqërisë dhe kulturës shqiptare në kontekstin ndërkombëtar të studiuesve dhe lexuesve kuriozë me artikuj studimorë të botuar në revista shkencore jashtë vendit si dhe punime monografike të përkthyer në gjuhë të huaja si anglisht dhe turqisht (në proces) dhe të botuara nga shtëpi botuese prestigjioze në Berlin dhe Stamboll.

Së pesti, në studimet e sociologut Dervishi, hulumtuesit e disiplinave të ndryshme shkencore mbi familjen mund të gjejnë nxitje për trajtime analitike më të thelluara të mjaft çështjeve të rëndësishme:

Faktorët dhe rrjedhojat komplekse të dobësimit të rolit të familjes në kontrollin seksual të të rinjve.

Ndikimi i normave kulturore tradicionale në përforcimin e rolit të martesës dhe familjes në shoqërinë shqiptare të shekullit të XXI.

Sfida dhe perspektiva të familjes në përmbushjen e funksionit të krijimit të kapitalit social.

Funksione dhe disfunksione të familjes si njësi ekonomike në shoqërinë shqiptare të ditëve tona dhe për të ardhmen.

Profile të konflikteve bashkëkohore ndërmjet prindërve dhe fëmijëve: analizë krahasimore ndërmjet brazave që zëvendësojnë njëri-tjetrin.

Analizë sociologjike e modeleve të shoqërizimit gjinor në familjet e çifteve të reja.

Rrjedhoja të strukturave të autoritetit prindëror në familje në zgjedhjet romantike të të rinjve dhe të rejave.

Faktorët shoqërorë të mosmarrëveshjeve në familje dhe pasojat e tyre në marrëdhëniet familjare.

Qëndrime dhe perceptime rreth risive të jetës familjare në shoqërinë shqiptare: analizë krahasuese me dukuritë analoge të shoqërive të tjera etj.

Në përfundim të këtij artikulli është e thjeshtë të kuptohet se sociologët, si ata të sprovuarit edhe studiuesit e rinj, janë përballur dhe vazhdimisht do të përballen me sfida të panumërta, por ata vetë do të jenë të vetmit që do të promovojnë veten e tyre nëpërmjet punës së palodhur dhe profesionale. Familja është një nga institucionet që parashtron në proceset e ndryshimit të saj nevojën për studime serioze sociologjike. Studiuesit e familjes mund të reflektojnë mbi rrugëtimin e përvojës studimore profesionale të sociologut Dervishi. Do të ishte ndihmesë për

ta të “lakmojnë” kriterin e kërkesave të vazhdueshme të studiuesit për të dhëna empirike nga burime parësore. Vetëm nëpërmjet kërkimeve empirike dhe studimeve në terren sociologët e rinj do të promovojnë veten si komunitet shkencor, do të sigurojnë të dhëna të larmishme për të përshkruar në një spektër shumëplanësh dukuritë dhe proceset familjare bashkëkohore. Rugëtimi i Profesor Dervishit dhe përvoja e tij e kërkimeve empirike është një fond mjaft i pasur për të siguruar jetëgjatësinë dhe vlerën praktike të studimeve sociologjike. Objektiviteti i të dhënave, argumentimi shkencor i bazuar në fakte sociale herët a vonë do të tërheqë vëmendjen për rëndësinë publike të studimeve sociologjike në përgjithësi dhe atyre mbi familjen në veçanti.

Literatura kryesore

Swingewood, Alan: *A short history of sociological thought* (Second edition), Macmillan Education, USA 1991

Calhoun, Craig; Gerteis, Joseph; Moody, James; Pffaf, Steven & Virk, Indermohan (editors): *Classical Sociological Theory* (Third edition), John Wiley & Sons Ltd., USA 2012

Ritzer, George: *Sociological theory*, Alfred A. Knopf, New York 1983

Dervishi, Zyhdi: “Projektskicë e “ngrehinës” së mendimit sociologjik në njëqindvjetorin e mëvetësisimit të shtetit shqiptar”, *Lente Sociologjike*, vëllimi II, Nr.2, 2012, fq.219-233

Dervishi, Zyhdi: *Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva*, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë 2001.

Dervishi, Zyhdi: *Flirte me plagët*, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë 2003

Dervishi, Zyhdi: *Bashkëjetesë me demonët e konflikteve*, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë 2005

Hammond, Ron J.: *Sociology of the family*, Smashwords edition, USA 2012

Charles, Nickie; Davies, Charlotte A. and Harris, Chris: *Families in transition. Social change, family formation and kin relationships*, Policy Press, Uk 2008

(KUMTESA)**PABARAZITË GJINORE NË KËNDVËSHTRIMIN
SOCIOLOGJIK TË ZYHDI DERVISHIT****Dr. Merita Poni**

Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Pabarazia Departamenti i Sociologjisë

gjinore përshfaqet në të gjitha sferat e jetës, publike dhe private, duke ndikuar identitetin, veprimet, qëndrimet dhe statusin shoqëror të burrave dhe grave. Pabarazia gjinore është rrjedhojë e dallimeve gjinore, të krijuara nëpërmjet procesit të shoqërizimit, që synon përgatitjen për rolet sociale, që ndërmerren përgjatë cikleve të jetës dhe që lipset të jenë të përputhshme me kërkesat kulturore që përcaktojnë shpërblime dhe ndëshkime për modele të ndryshme të sjelljeve. Sociologu Zyhdi Dervishi sjell në vëmendje përshfaqjen e pabarazive gjinore në shoqërinë shqiptare, përmes një analize të shumëfishtë që shqyrton ndikimin e shoqërizimit, ndarjen e roleve shoqërore, aksesin në jetën publike dhe privilegjet shoqërore që krijon gjinizimi në mënyrë asimetrike për burrat dhe gratë. Evidentimi i stutuseve të grave dhe vajzave, nxjerr në pah se ato janë nënrenditur shoqërisht për shkak të aplikimit të skemave gjinore që prodhojnë shtresëzim shoqëror. Ndërsa autoriteti dhe mbizotërimi mashkullor shihen si modeli më i përhapur për funksionimin e institucioneve shoqërore dhe veprimtarive jetësore, që nga vendimmarrja brenda familjes e deri te drejtimi i shtetit. Sociologu Dervishi e vë në dyshim

këtë model, pasi ia ekspozon atë gjykimit objektiv përmes analizës sociologjike dhe evidenton se historikisht edukimi, ekonomia dhe qeverisja kanë qenë mbizotërime mashkullore që kanë privilegjuar burrat si grup shoqëror dhe kanë nënërenditur gratë si shtresë shoqërore e shpërfillur në masë të konsiderueshme. Vepra e Dervishit bën thirrje për balancim të hierarkisë gjinore të krijuar nga sistemi patriarkal dhe fton shoqërinë shqiptare të zhvishet nga paragjykimet dhe stereotipet gjinore që helmojnë jetën e grave, që nënvlerësojnë aftësitë e tyre dhe që i mbajnë ato larg sferës së influencës shoqërore, duke çuar dëm potencialin e tyre për zhvillimin shoqëror. Gjithashtu Dervishi ka argumentuar në mënyrë të detajuar idenë se rritja e peshës specifike të vajzave dhe grave në strukturat vendimmarrëse të çdo veprimtarie ndikon për shërimin e dukurisë problematike të korrupsionit, si një plagë gangrenizuese që po e traumatizon shoqërinë shqiptare të ditëve tona.

Koncepte kryesore: *gjini, pabarazi, shtrezësim gjinor, korrupsion, faktor kundërkorrupsion*

Korrupsioni pengon afrimin e vajzave dhe grave te veprimtaritë politike

Gjatë viteve të tranzicionit pas-socialist, dukuria e korrupsionit u përhap në mënyrë të shpejtë dhe që atëherë vazhdon të jetë një prej shkaqeve kryesore për moszhvillimin ekonomik dhe klimën e mosbesimit ndaj politikës dhe institucioneve shtetërore. Sikundër burrat, edhe gratë janë mosbesuese ndaj moralit të korruptuar të politikës, gjë që i mban ato larg saj. Mosbesimi tek partitë politike dhe institucionet shtetërore të drejtuara prej tyre ka krijuar tek

gratë ndjesi apatie ndaj angazhimit politik, indiferencë të theksuar për politikën dhe largim prej diskursit politik që konsiderohet si një veprimtari mashkullore agresive per ndarje pushteti. Përgjatë gjithë viteve të tranzicionit, publiku është tronditur me pamjet shokuese dhe akuzat e ndërsjellta mes politikanësh, të përcjella gjerësisht në media, aq sa kanë shkaktuar zhgënjime traumatike prej politikëbërjes. Zënkat mes politikanësh janë pritur me trishtim të thellë nga publiku, i cili ka humbur jo vetëm besimin tek politikanët, por ka krijuar edhe bindjen se politika nuk i shërben më interesave të publikut, por interesave vetjake pasurore të personave të angazhuar politikisht. Kjo situatë është analizuar me detaje nga sociologu Zyhdi Dervishi në të gjithë veprën e tij e sidomos në tekstet për përfaqësimin politik të vajzave dhe grave, duke nxjerrë në pah shkaqet e hezitimit të tyre për pjesëmarrje aktive në politikë. Te monografia “Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik”, fryma e mosbesimit shkaktuar nga zhgënjimi prej politikanëve ilustron në rrëfimin e një mësueseje të shkencave shoqërore, e cila gjatë intervistimit (të kryer në vitin 2011) shprehet:

“Në fillim të viteve '90 të shekullit të XX, neve mësime të shkencave shoqërore na kërkoheshin në mënyrë të veçantë, me këmbëngulje të reformoheshim ose të rinovoheshim, por gjatë dhjetëvjeçarit të parë, me përjashtim të të përndjekurve politikë, në vlerat morale të shoqërisë shiptare pothuajse nuk ndodhën ndryshime të dukshme. Njerëzit që përgojoheshin ose që akuzoheshin, shpejt a vonë hiqeshin nga puna. Si anëtare e Partisë Socialiste unë jam shokuar nga punimet e Këshillit të Përgjithshëm Drejtues më 3 dhjetor 2001. Shikoja në televizor se si kacafyteshin me fjalë, se si e shanin njëri-tjetrin si gratë e liga drejtuesit kryesorë të partisë sime. Nuk

u besoja as syve dhe as veshëve. Drejtues që ne i kishim nderuar shumë, ua çorrën maskën në fytyrë njëri-tjetrit. M'u dukën njerëz të rëndomtë, të ngatërruar në pislleqe... Singerisht u ftoha shumë me partinë... Nisa të reflektoj më thellë. Kam kuptuar se përfytyrimet e shoqërisë sonë për të moralshmen dhe pamoralshmen, për të aftin dhe të paaftin kanë ndryshuar krejt” (2011:291).

Fryma e mosbesimit ndaj politikanëve është pasojë e sjelljes së tyre që reflekton një përmbysje të vlerave shoqërore dhe thyrje të besimit të ndjekësve politikë dhe votuesve. Gratë dhe vajzat e shohin të pamundur të bëhen pjesë e politikës agresive ku mbizotëron retorika e sharjeve dhe fyryeve. Edhe ato që kanë qenë pjesë e organizatave politike janë shkurajuar nga sjellja e kolegëve të tyre burra dhe janë tërhequr nga politika, duke mos dashur të “ndoten” me fjalorin vulgar dhe të përfshihen në gjeste rrugaçërie që shfaqen rëndom në komunikimin politik mes burrave. Mosangazhimi politik i vajzave dhe grave në fakt e dëmton seriozisht demokracinë vendimmarrëse dhe përfaqësimin politik si dhe kontribuon në ashpërsimin e konfliktit politik që më së shumti mbahet ndezur prej politikanëve burra.

Episodet e korrupsionit aktiv dhe pasiv, abuzimit me pushtetin dhe shpërdorimin e detyrës filluan të shtoheshin përgjatë viteve të tranzicionit dhe mosndëshkueshmëria jo vetëm që u duk sikur e legalizoi këtë dukuri, por edhe nxiti përhapjen masive të kulturës së pagesës “nën e mbi dorë” për marrjen e shërbimeve publike që duhen ofruar falas si detyrim institucional i administratës shtetërore dhe punonjësve të shërbimeve publike. Pasurimi i shpejtë dhe i pajustificuar filloi të konsiderohej si “meritë” dhe jo si akt i pamoralshëm. Amnistimi moral i korrupsionit nxiti edhe më shumë abuzimin me detyrën, nepotizmin dhe përfitimet

personale nga posti drejtues. Kjo dukuri u përshkallëzua nga nivelet më të ulëta të administratës publike dhe shërbimeve (si roja i institucionit, punonjësja e pastrimit, specialist i rëndomtë) e deri tek nivelet më të larta drejtuese (drejtues sektori, institucioni e deri tek ministrat). Vlerat monetare të përftuara nga korrupsioni transferohen në nivele më të larta dhe përdoren për blerje postesh ose ngjitje në karrierë. Mundësitë për punësim, marrje e mbajtje posti dhe ngjitje në karrierë përcaktohen nga aftësia pagueuse që ofron korrupsioni. I aftë konsiderohet ai që përfiton sa të mundet nga posti dhe i ndan përfitimet me eprorët. Me këtë imazh përshfaqen në sytë e publikut politikanët të cilët kanë shformuar tërësisht perceptimin e publikut që prët prej tyre të jenë njerëz të përgjegjshëm, që kanë marrë mbi vete përgjegjësinë e të punuarit ndershmërisht për mirëqenien e popullit. E vetmja aftësi që iu duket qartazi, siç ka argumentuar me shumë fakte e të dhëna të shumëllojshme sociologu Zyhdi Dervishi është *“dalja për zot interesave të veta dhe të klanit fisnor, krahinor e politik dhe ndarjes së parave të siguruara me korrupsion sipas skemës së hierarkisë politike”* (2011:292).

Sjellje të tilla kanë ndikuar për keq edhe në edukimin e brezit të ri, i cili idealisht beson se të rriturit duhet të sillen me përgjegjësi dhe të vlerësojnë në mënyrë të paanshme aftësitë e tyre për t'i promovuar në arritjet shkollore, karrierën profesionale dhe vendimmarjen publike sipas parimit të meritokracisë. Por nuk ndodh kështu, prandaj edhe të rejat që kanë aftësi dhe besim tek zotësia e vet, nuk kanë dëshirë t'i afrohen politikanëve dhe subjekteve politike të cilët i përdorin për qëllime elektorale dhe përfitime partiake e personale. Sjellja arrogante dhe pandershmëria e shfaqur pa ndrojtje në sytë e votuesve ka shkatuar një reagim kundërshtues ndaj figurave politike në nivel vendor. Mbajtja

anë dhe favorizimi i militantëve partiakë pa meritë ka ngjallur neveri tek të rinjtë dhe të rejtat dhe ua ka thyer besimin se ata mund të kenë një të ardhme të sigurtë falë zotësisë profesionale dhe ndershmërisë morale. Ky fakt evidentohet fare qartë në një intervistë të dhënë nga një vajzë maturante gjatë vitit 2011, e cila dëshmon një ngjarje në ditën e provimit të maturës, kur deputeti i zonës angazhohet aktivisht në mbështetjen e nxënësve të familjeve që mbështesnin atë si politikan.

“Në botën time shpirtërore ka ndikuar më shumë babai që është idealist i kulluar ose i pandreqshëm... Deri në provimet e maturës edhe unë mendoja si babai. Dëshiroja të studioja për shkencë politike ose për drejtësi. Mendoja se si juriste ose politikane do të ndihmoja më shumë për të korigjuar padrejtësitë e kësaj bote. Por, në provimin e matematikës u zhgënjeva shumë. Në shkollën, ku ne bëmë provimin e maturës, ishte i pranishëm një deputet dhe disa mësues matematike që i silleshin rrotull. Kur u afishuan rezultatet, pamë se disa nxënës, që mezi kishin marrë notën 5 gjatë katër viteve, ishin vlerësuar me 9 dhe 10. U përfol shumë se këtë maskarallëk e kishte kurdisur deputeti për fëmijët e disa miqve, me të cilët bënte pazare politike dhe biznese të pista. M’u duk e zhvlerësuar jo vetëm 10 ime e matematikës, por edhe dëshira për t’u bërë politikanë ose juriste” (2011:294).

Perceptimi për korrupsionin e politikanëve është aq i përhapur sa duket e pabesueshme se mund të ketë një rrez të ndershëm të angazhuar politiksht. Madje edhe nëse ndonjëri prej tyre motivohet së brendshmi për të zgjidhur problemet e dikujt, nisur nga empatia ose detyra, mbi të do të rëndojë stereotipi paragjykses se e ka bërë në këmbim të përfitimit. Kjo re e zezë paragjykesë, bashkë me emrin errëson edhe

dëshirën e mirë të atyre politikanëve dhe zyrtarëve që duan të veprojnë me ndershmëri, pa kurrëfarë interesi vetjak. Perceptime të tilla i mbajnë larg politikës vajzat dhe gratë, të cilat me shumë gjasë mendojnë se përfshirja në politikë do t'i ekspozojë ndaj etiketimeve moralizuese me konotacion negativ, duke i përbaltur pa faj dhe duke i futur “në një thes” me politikanët e zyrtarët e korruptuar. Meqë tek publiku prevalon ideja se marrja me politikë bëhet vetëm për përfitime personale, atëherë e njëjta aksiomë vlen edhe për vajzat dhe gratë nëse ato do të merreshin me politikë. Është e vështirë për vajzat dhe gratë të ndryshojnë perceptimin publik me shumbujt e mirë egzistues të politikanëve dhe zyrtarëve të ndershëm, pasi këta mendohet të jenë pakicë, shtu faktin që ndihma që jepet nga zyrtarë të ndershëm pa interes nuk konsiderohet e tillë. Solidariteti shoqëror dhe përgjegjshmëria për nevojat e tjetrit nuk janë më shtysa primare të ndihmës, pavarësisht se përmenden si të tilla kur ajo jepet. Në fakt ajo çka përcakton ofrimin e ndihmës është aftësia paguese e qytetarit nevojtar, që nuk ka mundësi zgjedhje tjetër, ose të paguajë dhe të shërbehet ose të largohet pa marrë shërbim, pra të ushqejë korrupsionin. Duket se shërbimet publike që ofrohen falas janë privatizuar nga punonjës të shtetit, të cilët punën në shtet e shohin si një mundësi të mirë për të përfutur të ardhura shtesë mbi pagën. Stepja e vajzave dhe grave përballë këtyre mendësive është mëse e justifikuar, pasi ato nuk dëshirojnë të jenë pjesë e kësaj skeme korruptive, që deformon edhe boshtin e tyre moral. Në analizën që i bën kësaj dukurie, Dervishi thekson se korrupsioni shkakton edhe prishjen e lidhjeve shoqërore, gjë që ka ndikim në zbehjen e kohezionit social. Ja si shprehet ai për efektin minus të korrupsionit tek solidariteti shoqëror:

“Lidhjet miqësore, shoqërore e fisnore janë dobësuar e deri paralizuar jo vetëm nga fuqia e përforcuar gërryese e procesit të atomizimit. Nën trysinë në rritje të përfoljeve, të akuzave të bazuara e të pabazuara për korrupsion, edhe deputetët, dhe përgjithësisht të angazhuarit në veprimtari politike, më dashamirës e më altruistë ngurojnë të ndihmojnë të tjerët edhe pa kurrfarë interesi. Në shoqërinë shqiptare aktualisht janë mjaft të përhapura mendësitë: “Sa me e madhe të jetë ndihma që i jep dikujt një politikan, aq më i madh është interesi i politikanit që fshihet prapa ndihmës” ... llumi i korrupsionit bën pis edhe politikanin më idealist” (2011:300).

A e minimizon pjesëmarrja politike e vajzave dhe grave korrupsionin?

Megjithë zhgënjimin e thellë nga politika e korruptuar, vajzat dhe gratë janë aktivizuar politikisht edhe pse në nivele të ulëta drejtimi. Gjithësesi, edhe pse të nënpërfaqësuar në politikën aktive, përgjithësisht ato kanë qenë votuese të rregullta dhe kanë ndikuar në mënyrë të tërthortë vendimmarjen publike, duke favorizuar subjektet politike me të cilat janë ndjerë më afër, për shkak të bindjeve politike ose lidhjeve fisnore e shoqërore. Ethet e garës për pushtet dhe militantizmi partiak që kanë pushtuar më së shumti burrat, nuk i kanë prekur gratë dhe vajzat, gjë që e nxjerr në pah edhe studimi sociologut Dervishi, për gratë dhe vajzat, i kryer në vitin 2001, “Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva”, rezultatet e të cilit tregojnë se deri 90% e tyre qëndrojnë në zonën e qendrës. Mbajtja e një qëndrimi të ekuilibruar ndaj politikës i ka karakterizuar gratë edhe përgjatë periudhës së regjimit socialist. Polarizimi i skajshëm politik i trancizionit pas-socialist nuk i ka infektuar

gratë dhe vajzat, sikurse ndodhi përgjithësisht me burrat, të cilët me kapërcimet e tyre politike sa majtas-djathtas shkaktuan një konfuzion të madh në lidhje me pozicionimin e tyre politik. Madje pas vitit 1990 ndodhën çudira me përfaqësimin politik, pasi njerëz që kishin përfaqësuar ideologjinë komuniste kaluan në skajin e kundërt, duke përfaqësuar ideologji të djathta. Për këto transformime radikale të njerëzve “brenda natës” dhe kalimin nga e majta tek e djathta, Zyhdi Dervishi shprehet:

“Diskutime të tilla... përshkohen nga paqartësitë dhe çoroditja, nga gjithfarë paragjykimesh, dhe nga kalimi i mjaft njerëzve nga njëri-skaj në tjetrin: ish-komunistë ose, më saktë, ish-antarë të Partisë Punës brenda një kohe fare të shkurtër u konvertuan në antarë ose lider të partive të djathta; fshatarë fare të varfër bëhen antarë të partive të djathta dhe nënshkruajnë peticione për kthimin e tokave ish-pronarëve... Ndërkohë tregtarë të rinj bëhen antarë të partive të majta të formuara gjatë dhjetë viteve të fundit” (2001:128).

Kalime të tilla të ish-funksionarëve politikë nga njëri ekstrem në tjetrin nuk mund të krijonin besim tek politika për vajzat dhe gratë. Përkundrazi, ato i panë me dyshim kapërcime të tilla prej “180 gradësh” dhe nuk u joshën të shkonin pas politikanëve të konvertuar dhe politikës së tyre të korruptuar. Po përse gratë nuk u prekën nga epidemia e skajshmërive politike? Gratë kanë shërbyer si amortizator i konflikteve mes burrave, duke ruajtur ekuilibrat në sferën private në gjirin e familjes. Duke e konsideruar edhe sferën publike si një vazhdimësi të sferës familjare, ato kanë ruajtur të njëjtin qëndrim zbutës në arenën e politikës, duke ulur tonet e ngritura dhe kërcënuese të kolegëve të tyre burra.

Sociologu Dervishi e shpjegon këtë aftësi paqëtuese të grave me faktorët shoqërorë dhe psikokulturorë, duke u shprehur:

“Me mirësinë dhe shpirtgjerësinë e tyre, vajzat dhe gratë, veçanërisht nënat shqiptare, tradicionalisht kanë ndikuar për “të ftohur gjakrat” në sherret e ndezura ndërmjet burrave, për të kapërcyer mosmarrveshjet e zakonshme deri tek konfliktet më të mprehta. Gjithashtu kanë qenë dhe janë shumë të përkushtuara për të ndihmuar antarët e tjerë të familjes, për të humanizuar marrëdhëniet në familje, imponojnë më shumë korrektësi në marrëdhëniet shoqërore. Ndaj jam i mendimit se rritja e shkallës së pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në jetën politike do të ushtrojë një ndikim të ndjeshëm për ç’tensionimin e “klimës politike mjaft të acaruar” në vendin tonë, do të gjallërojë një frymë mirëkuptimi dhe një kulturë tjetër komunikimi ndër politikanët e orientimeve të ndryshme, do të shërbente si një faktor i rëndësishëm për kufizimin dhe shërimin e “plagës-gangrenë” të korrupsionit që po “paralizon arteriet” kryesore të zhvillimit të shoqërisë shqiptare” (2001:133).

Në të gjitha studimet për gratë dhe vajzat, sociologu Zyhdi Dervishi evidenton rolin pozitiv që do të kishte rritja e pjesëmarrjes së tyre në zbutjen e politikës shqiptare dhe sidomos në *“injektimin e frymes antikorruptive në të gjithë sektorët e veprimtarive në shoqëri, veçanërisht në politikë”* (2001:135).

Literatura kryesore

Dervishi, Zyhdi: *“Gratë në syrin e ciklonit dhe perspektiva”*, (botimi i dytë), Shtëpia botuese “Jeruzalem”, Tiranë 2001.

Dervishi, Zyhdi: *“Gratë në turbulencat e mendësive politike dhe realiteti politik”*, Botimet “Emal”, Tiranë 2011.

MJESHTËRIA E ANALIZËS SOCIOLOGJIKE NË
TEKSTIN MONOGRAFI “VËSHTRIME TË
KRYQËZUARA NË DET” OSE “SOCIOLOGJI
KULTURE 1”

Dr. Brunilda ZENELAGA

Departamenti i Sociologjisë

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

Hyrje

Ky artikull synon të evidentojë veçanti të analizës sociologjike të realizuar nga studiuesi bashkëkohor Zyhdi Dervishi në tekstin monografi “Vështrime të kryqëzuara në det” ose “Sociologji kulture 1”. Në këtë punim shqyrtohen tre linja kryesore të kësaj analize.

Linja e parë ka në fokus mjeshtërinë metodologjike të përdorur në studimin e sipërpërmendur; linja e dytë përqëndrohet tek objektiviteti i gjetjeve të këtij studimi, ndërsa e treta fokusohet në rëndësinë e qëndrueshmërisë së gjetjeve të studimit të profesor Dervishit, i cili megjithëse në pamje të parë duket se pasqyron një realitet të rreth 20 viteve më parë, nxjerr në pah dilema që vazhdojnë akoma sot të shqetësojnë shoqërinë shqiptare.

Krahas shqyrtimit të burimeve bibliografike, ky artikull është pasuruar edhe me copëza nga intervista të drejtpërdrejta dhe biseda të lira të realizuara me emigrantë shqiptarë që jetojnë në Itali, e konkretisht në provincën e Sienës, studentë dhe studiues që e kanë njohur profesor Zyhdi Dervishin në kohën që ai kryente studimin në terren në Itali, e që unë i kam rikontaktuar, në rolin e studiuseses.

**Mjeshtëria metodologjike në tekstin monografi
“Vështrime të kryqëzuara në det” ose “Sociologji kulture
1”**

Metodologjia e hulumtimit, si disiplinë logjike, ka qenë pak e zhvilluar gjatë viteve '90 të shekullit XX, madje kjo jo vetëm në Shqipëri, por dhe në nivel ndërkombëtar, pavarësisht se përdorimi i metodave shkencore edhe në shkencat shoqërore është shumë i hershëm. Nëse bëhet një kërkim i shpejtë nëpërmjet mekanizmit të kërkimit “google scholar” për literaturën në lidhje me metodat e kërkimit shkencor, vihet re se pjesa më e madhe e librave për metodologjinë e kërkimit shkencor janë publikuar pas vitit 2000. Gjatë viteve '90 të shekullit XX në Shqipëri madje dhe vetë shkencat shoqërore ende nuk kishin krijuar karakterin e tyre të mëvetësuar nga njera-tjetra, sidomos në programet universitare. Departamenti i Filozofisë dhe Sociologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës u themelua në shtator 1993, ndërsa Departamenti i Sociologjisë u mëvetësua nga ai i Filozofisë, në zbatim të standardeve të Marrëveshjes së Bolonjës, në vitin 2005 (Dervishi, Z., 2012: 230).

Në këtë atmosferë tranzicioni, vështirësish dhe sfidash, realizimi i kërkimeve të mirëfillta sociologjike, të mbështetura në një aparat të qartë metodologjik, mbledhja me kujdes e fakteve dhe qëmtimi me objektivitet i opinioneve, mendimeve dhe perceptimeve të njerëzve, kërkonte aftësi të jashtëzakonshme, intuitë shkencore dhe vullnet të çeliktë.

Tekti monografi “Vështrime të kryqëzuara në det ose sociologji kulture I”, u publikua nga studiuesi bashkëkohor Zyhdi Dervishi, pikërisht në këtë periudhë. Ai i referohet analizave teoriko-sociologjike, të gërshetuara me fakte empirike dhe synon të ndriçojë profile të kulturës shqiptare përmes metodës krahasimore me modele të kulturës së urbanizuar perëndimore, fqinje me kulturën shqiptare, siç është kultura italiane. Një platformë e tillë hulumtuese, e avancuar dhe komplekse, sidomos për atë kohë, ishte ideuar nga studiuesi Dervishi në një mënyrë tërësisht origjinale nëpërmjet kombinimit të dijeve dhe metodave sociologjike

të përvetësuar, në procesin e kërkimit, në ato vite të tranzicionit të shkencave shoqërore në Shqipëri.

Metoda krahasuese në studimet me fokus kulturën ka nisur të përdoret në fund të shekullit XIX, madje publikimi i parë me karakter krahasues në studimet sociokulturore konsiderohet një punim i Edward B. Taylor i realizuar në vitin 1889 (Shih: Ember, C.R; Ember, E., 2009: 14). Studimet ndërkulturore në të cilat përdorej metoda krahasuese filluan të kishin shtrirje më të gjerë në vitet 1930-1940. Antropologu i mirënjohur botëror, Murdock mbrojti gradën Doktor i Shkencave në vitin 1925 në Universitetin e Yalës, me një punim të tijin me karakter, sa antropologjik, aq dhe sociologjik, të bazuar në metodën krahasuese, sipas modelit të themeluar më parë nga William Graham Sumner. Në këtë periudhë në SHBA një grup i tërë studiuesish u fokusuan tek të kuptuarit e perceptimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve të njerëzve, sipas sistemit kulturor të cilit ata i përmbaheshin (po aty, 15).

Në Shqipëri, rreth 50-60 vite më vonë, atëherë kur disiplina e sociologjisë filloi të marrë frymë lirisht, një qasje të tillë metodologjike në fushën e sociologjisë, veçanërisht në nëndisiplinën e sociologjisë së kulturës, e shohim të zbatohet pikërisht në studimin e Zyhdi Dervishit “Vështrime të kryqëzuara në det” ose “Sociologji kulture 1”. Pra, si të thuash, ky tekst monografi, përbën një kontribut të veçantë jo vetëm nga pikëpamja teorike, por edhe nga ajo metodologjike, në historinë e zhvillimit të sociologjisë në Shqipëri pas shpërbërjes së regjimit socialist totalitar.

Metodologjia krahasuese në këtë punim, analiza e dallimeve dhe përafrimeve ndërmjet modeleve analoge të dy kulturave, përbën një mekanizëm të rëndësishëm që ka nxjerrë në pah gjetje shumë interesante në fushën e sociologjisë së kulturës, por edhe në atë të sociologjisë së migrimit. Sikurse studiuesi Dervishi shprehet “nëpërmjet analizave krahasuese të modeleve të të menduarit, të sjelljes e të jetës të shqiptarëve dhe italianëve, të përthyerë në vetëdijen e emigrantëve, në

këtë libër shtjellohen në proces disa nga tiparet psikokulturore të shqiptarëve...Këto studime ndihmojnë jo vetëm për të “gjetur” dhe ekspozuar origjinalitetin e kulturës shqiptare në “ansamblin” e kulturave europiane e më gjerë, por edhe për të njohur më mirë kulturën kombëtare, për t’u vetëdijësuar për përparësitë dhe elementet e saj që lipsen “modifikuar” sipas disa standardeve kulturore gati të ndërkombëtarizuara, etj.” (Dervishi, Z., 2003: 5-6).

Një tjetër karakteristikë metodologjiko-stilistike shumë interesante dhe origjinale në këtë punim është ndërthurja e analizës mikrosociologjike me atë makrosociologjike, ose më mirë mënyra se si e para përdoret si instrument për të shpjeguar proceset makrosociologjike. Duke analizuar ndërveprimin kulturor ndërmjet emigrantëve dhe vendasve, studiuesi Dervishi hedh dritë mbi sistemet kulturore dhe elementet e tyre, mbi mënyrën se si këto sisteme, në ndikimin e dinamikave emigratore, ndërveprojnë me njeri-tjetrin, mbi mënyrën se si shtetet pritëse dhe ato të origjinës hartojnë politika për të gjetur zgjidhje për problemet që krijohen nga ndërveprimi, në kushtet e emigrimit, të individëve që i përkasin kulturave të ndryshme etj.

Objektiviteti, mision shkencor në punën e studiuesit Zyhdi Dervishi

Në tekstin monografi “Vështrime të kryqëzuara në det” ose “Sociologji kulture 1”, studiuesi Dervishi ka përdorur disa metoda komplekse të hulumtimit shkencor që mësojnë të hedhin dritë me objektivitet mbi shumëdimensionalitetin e një dukurie mjaft komplekse, siç është emigracioni dhe dinamikat e ndërveprimit kulturor që ai formëson.

Lipset të theksohet se studiuesi Zyhdi Dervishi përqafon metoda bashkëkohore perëndimore të hulumtimit. Ai gërsheton me kujdes shqyrtimet teorike me analizat empirike përkatëse.

Nga njera anë studiuesi Dervishi mbështetet në mënyrë të kujdesshme në një aparat konceptual të qartë të paraqitur nga

të mirënjohur kryesisht të fushës së sociologjisë së kulturës si Ëilliams, Herbert, Horton, Hunt etj., bazohet në të dhëna nga burime dytësore si: të dhëna të publikuara nga struktura statistikore të besueshme, të dhëna me karakter historik të paraqitura në punimet e autorëve të huaj, të dhëna nga burime etnografike dhe letrare shqiptare me vlerë të veçantë sidomos në fushën e sociologjisë së kulturës, etj.

Nga ana tjetër, aparati empirik i përdorur në hulumtimin e Zyhdi Dervishit, gjithashtu është shumë kompleks. Gërshetimi i metodave cilësore të tilla si: vëzhgimi jo i drejtpërdrejtë dhe ai i drejtpërdrejtë, studimi i historive të jetës, intervistat dhe bisedat e lira me emigrantë që jetojnë në provincën e Sienës në Itali, me metodën sasiore të anketimit, të realizuar sipas kritereve të kampionit të shtresëzuar, i bëjnë të dhënat e këtij hulumtimi shumë solide dhe i japin karakter objektiv dhe shkencor rezultateve të tij. Studiuesit Bob Matthews dhe Liz Ross në librin e tyre “Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane” e quajnë *trekëndëzim* këtë matje të cilësisë së hulumtimit, që do të thotë se, në qoftë se për t’iu përgjigjur një pyetjeje hulumtuese, janë mbledhur lloje të ndryshme të dhënash, secili grup të dhënash mund të përdoret për të verifikuar gjetjet nga grupet e tjera (Matthews, B., Liz, R, 2010: 53). Duke u mbështetur pra në të dhëna të përfuara nga shumë burime hulumtuese, që, nga njëra anë, plotësojnë njera-tjetrën dhe, nga ana tjetër, sigurojnë vërtetësinë e njera-tjetrës, studiuesi Dervishi e ngre hulumtimin e tij mbi themele të sigurta metodologjike shkencore, duke synuar studimin e fakteve sociale si sende, pra objektivitetin e padiskutueshëm shkencor.

Kryerja e një hulumtimi në një realitet empirik të ndryshëm dhe larg realitetit ku studiuesi jeton, e përball atë me sfida të shumta.

Së pari, kërkohet energji, vëmendje dhe kujdes i shumëfishtë për të njohur këtë realitet të ri social.

Së dyti, nevojitet njohje e gjuhës dhe kulturës së shoqërisë dhe mjedisit ku hulumtimi do të kryhet.

Së treti, kërkohet një orientim i kujdesshëm kah institucioneve dhe burimeve të sigurta të informimit.

Së katërti lipset të krijohen kontakte me persona kyç që të mundësojnë zgjerimin e rrezes së komunikimit të studiuesit me njerëz të tjerë, përvoja e të cilëve konsiderohet me vlerë për përmbushjen e qëllimit të hulumtimit.

Së pesti kërkohen aftësi për të përdorur me frytshmëri kohën që studiuesi ka në dispozicion.

Së gjashti nevojiten burime finaciare mbështetëse, etj.

Studiuesi bashkëkohor Zyhdi Dervishi, i apasionuar ndaj punës së drejtpërdrejtë me njerëzit, me qëllim nxjerrjen në pah të fakteve sociologjike të paeksploruara më parë, sidomos në fushën e sociologjisë së kulturës, me modesti e konsideron veten fatlum që iu dha një mundësi për të studiuar bashkëkomunikimet ndërmjet kulturës së emigrantëve shqiptarë dhe kulturës së vendasve italianë (Devishi, Z., 2003:11) (megjithëse në shkencë ka pak hapësirë për determinizëm dhe besohet se “fatin e bën vetë njeriu”). Sfidat e sipërpërmendura, të cilat për hir të së vërtetës, nuk gjenden të shprehura në asnjë rresht të tekstit monografi “Vështrime të kryqëzuara në det” ose “Sociologji kulture 1”, eklipsohen nga entuziazmi i profesor Zyhdiut, i gjeneruar nga misoni i tij fisnik për t’u shërbyer njerëzve me anë të nxjerrjes në pah të vërtetave nëpërmjet hulumtimeve shkencore. “Një mjedis i tillë, gjithsesi impresionues, më nxiti, ose më saktë më obligoi të ndërmeroja këtë studim, në përmasat e një libri. Pohimi i të vërtetës për emigrantët shqiptarë aq të përfolur ka jo vetëm rëndësi teorike në fushën e studimeve sociologjike, por edhe na ndihmon praktikisht për të mbrojtur dhe afirmuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre,” – pohon vetë Dervishi në librin e tij (Po aty: 12). Ky mison e bën profesor Zyhdiun shumë të afërt me njerëzit. Ai, gjatë përvojës studimore në Siena, siç e përshkruan edhe vetë, ka frekuentuar mjedise nga më të ndryshmet ku

punonin dhe banonin emigrantët, ku bënin mbledhjet e sindikatës dhe ku organizonin festime të ndryshme, ku luanin futboll dhe ku zinin peshk në liqenet artificiale, ku diskutonin për problemet politike të Shqipërisë në sheshin pranë stacionit të trenit në Poxhibonsi dhe në kampingun me rulotë në Kiusdino ku 38 shqiptarë i nënshtroheshin regjimit të refugjatit nën kontrollin e postave të karabinierisë (Po aty, 12-13).

Emigrantët që e kanë njohur nga afër sociologun Dervishi, megjithëse kanë kaluar afro 20 vjet, ende mbajnë gjallë kujtime për të. Duke iu referuar bisedave me profesor Zyhdion, gjatë periudhës që ky i fundit kishte qendruar në Siena, ata nxjerrin në pah ndjesinë e hapjes dhe të afërsisë që kishin përjetuar në komunikimet me të, ndjesi që vetëm një studiues profesionit mund t'ua evokojë subjekteve që po hulumton. Emigrantët e përshkruajnë atë si një studiues të komunikueshëm e plot humor, shumë të ditur, jashtëzakonisht bujar, serioz e me dinjitet, të përpiktë dhe vëzhgues të kujdesshëm. Një emigrant madje përdori fjalët e poetit Dritëro Agolli *“i urtë gjer në dhembje, i thjeshtë gjer në madhësi”*, teksa fliste për profesor Dervishin.

Përvoja dhe literatura sociologjike sugjeron se kur hulumtuesi krijon një marrëdhënie besimi dhe perceptohet si i ndershëm, njerëzor, dhe i ngjashëm me subjektet që hulumton, atëherë mundësia që këta të fundit të jenë “të vërtetë” në dhënien e informacionit, është shumë e madhe. Kjo mjeshteri, sa njerëzore aq dhe profesionale, që zotëron krejt natyrshëm profesor Dervishi, e ka ndihmuar atë të depërtojë, si të thuash, në “bërthamën qelizore” të ndërveprimeve kulturore të emigrantëve shqiptarë me vendasit italianë.

Një perceptim të ngjashëm për profesor Dervishin kishin krijuar madje edhe vetë italianët. Gjatë një bisede të lirë me profesor Fabio Bertin, pedagog në Departamentin e Shkencave Historike, Juridike, Politike e Sociale në Universitetin e Sienës (Univerisità degli Studi di Siena), ai

pohon: “ *E mbaj mend profesor Zyhdiun, si një njeri që nuk fliste shumë, por që dëgjonte me vëmendje e kujdes, me thellësinë e një studiuesi të mirëfilltë*”.

Ndonjëherë hulumtimi i një realiteti disi të huaj për studiuesin ka dhe një përparësi të madhe: e ndihmon studiuesin të jetë objektiv, pikërisht sepse nuk është pjesë e këtij realiteti. Sipas sociologut Werner Sombart, i huaji ka mundësinë të vëzhgojë shoqërinë pritëse së jashtmi dhe kjo i lejon atij të identifikojë dinamika të brendshme që vendasit nuk i shohin dot, për sa kohë janë brenda kontekstit. Falë kësaj, i huaji përbën për shoqërinë pritëse një lloj lenteje zmadhimi për të kuptuar probleme strukturore që ajo përmban (Shih: Costesa V., 2002:12). Duke e përshtatur këtë ide të Sombart-it edhe për studiuesin e huaj, lipset të theksohet se ky i fundit ka mundësi të vëzhgojë së jashtmi (si sende) dukuri dhe fakte sociale për të cilat vendasit ose edhe vetë emigrantët që jetojnë për një periudhë kohore të konsiderueshme në atë vend, nuk kanë më ndjeshmëri dhe intuitë, pikërisht se janë bërë pjesë e atij realiteti. Ndoshta kjo mund të paralelizohet me “efektin e parfumit”, të cilin personi që e ka hedhur nuk e ndjen më, por dikush që i afrohet mund ta ndiejë. Duke mbajtur parasysh këtë, lipset theksuar se profesor Dervishi, nga njëra anë, falë intuitës, kujdesit dhe skrupulozitetit të tij prej studiuesi të mirëfilltë dhe, nga ana tjetër, falë mjeshtërisë për të shfrytëzuar “distancën” mes tij dhe realitetit që kishte marrë përsipër të shqyrtonte, arriti të evidentojë elementë të komunikimit ndërkulturor mes emigrantëve shqiptarë dhe vendasve italianë, për të cilat as vetë emigrantët shqiptarë që jetonin në Siena nuk ishin të vetëdijshëm.

“Kur kam lexuar librin e profesor Zyhdiut, jam habitur se sa thellë dhe me sa kujdes profesori kishte hulumtuar elementë, fakte dhe informacione, që unë, megjithëse kisha vite që jetoja në Siena, nuk i kisha vënë re”,- pohon një i ri, ish student në Siena.

Rëndësia e qëndrueshmërisë së gjetjeve të hulumtimit në tekstin monografi “Vështrime të kryqëzuara në det” ose “Sociologji kulture 1”

Pavarësisht se fokusi kryesor i hulumtimit në librin monografi “Vështrime të kryqëzuara në det” ose “Sociologji kulture 1”, është eksplorimi i elementëve kulturorë të kulturës shqiptare, duke i vënë ato përballë një kulture fqinje të urbanizuar, siç është kultura italiane, ky hulumtim përbën një ndihmesë shumë të rëndësishme edhe në fushën e sociologjisë së migrimit.

Natyrshëm lind pyetja: A i kanë qendruar kohës gjetjet në këtë studim të professor Dervishit? A munden këto gjetje të shpjegojnë dukuri shoqërore që lidhen me aktualitetin shqiptar, megjithëse kanë kaluar rreth 20 vite që nga koha kur ky studim është kryer?

Për t’i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, janë shqyrtuar tre argumente.

Studiuesi Zyhdi Dervishi, *fokusohet në problematika shqetësuese të zgjatura në kohë të shoqërisë shqiptare dhe jo në probleme të përkohshme, kalimtare*. Një nga këto dukuri është dhe emigrimi, që ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë fuqishëm, duke formësuar e shformësuar përbërjen demografike, shoqërore e kulturore si të vendeve pritëse, ashtu edhe të atyre të origjinës së emigrantëve, duke ndikuar fuqishëm në qasjet politike të këtyre vendeve, duke ridimensionuar potencialet e tyre ekonomike etj. Sociologu Dervishi e konsideron emigrimin një dukuri mjaft komplekse, që në përpjesëtime të caktuara, veçanërisht gjatë shekullit XX, ka “prekur” pothuajse të gjitha “hapësirat” sociokulturore të planetit tonë (Dervishi, Z., 2003: 1). Dy dhjetvjeçarët e parë të shekullit XXI gjithashtu dëshmuar se emigrimi përbën një nga çështjet më të nxehta në nivel ndërkombëtar. Është përlllogaritur se në vitin 2015 rreth 244 milionë emigrantë ndërkombëtarë në nivel global (3.3% të popullsisë së botës) janë larguar nga vendet e tyre të origjinës, një rritje kjo krahasuar me rreth 155 milionë njerëz

në vitin 2000 (2.8% e popullsisë së botës) (IOM, 2018: 13). Në nivel kombëtar emigrimi gjithashtu vazhdon të përbëjë një dukuri mjaft komplekse. Numri i shtetsave shqiptarë që kanë kërkuar azil në vendet e BE-së, sidomos gjatë viteve 2015-2016 është i konsiderueshëm. Në vitin 2015 kërkuan azil në vendet e BE-së 68 945 qytetarë shqiptarë, ndërsa në vitin 2016, rreth 32 335 të tillë (Profili i migracionit, 2017: 25). Nga ana tjetër Shqipëria ka përjetuar edhe rikthimin e emigrantëve nga vendet ku kishin emigruar. Të dhëna të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit tregojnë se në vitin 2015 janë kthyer nga vendet e Bashkimit Europian në Shqipëri 25 134 emigrantë shqiptarë, ndërsa për vitin 2016 kjo shifër ka qenë 21 681 (Po aty, 2017: 23).

Këtë situatë studiuesi Dervishi e ka evidentuar edhe në tekstin monografi “*Lente të ndërveprimit simbolik*”, të publikuar në vitin 2016. Ai pohon se, që nga fillimi i viteve ’90 të shekullit XX e deri në ditët tona, shqiptarët mund të karakterizohen si komb emigrantësh. Sipas tij treguesit e emigrimit të shqiptarëve bëhen problematikë, së paku për tre arsye kryesore: 1) Një numër i konsiderueshëm shqiptarësh kanë punuar dhe jetuar për disa vite si emigrantë në vende të tjera dhe më pas janë rikthyer në atdhe; 2) nuk është i vogël numri i shqiptarëve që punojnë dhe jetojnë si emigrantë ilegalë në vende të tjera; 3) është edhe më i madh numri i të rejave dhe të rinjve që e projektojnë të ardhmen e tyre në rrugët plot sfida dhe vështirësi të emigrimit në vende të tjera (Dervishi, Z., 2016: 25).

Për të shpjeguar dukuri të ndryshme që lidhen me dinamikat emigruese, sociologu Dervishi depërton, sit ë thuash, në rrënjët e mendësive të grupeve shoqërore dhe në indin kulturor të popujve. Duke qenë një njohës i shkëlqyer i psikologjisë popullore, sidomos i asaj të shqiptarëve, një studiues skrupuloz i fakteve historiko-sociale si dhe një metodist mjaft i mirë, sociologu Zyhdi Dervishi *eksploron shkaqet e mirëfillta të problemeve*, si të thuash pjesën e padukshme të ajsbergut. Kjo thellësi në eksplorimin e

dukurive shoqërore përbën një arsye të fortë pse gjetjet e studimeve të ndërmarra nga studiuesi Dervishi i qëndojnë kohës.

Sondazhi i Gallup International për potencialin migrues evidentoi se në periudhën 2013-2016 ky potencial, që shpreh dëshirën e qytetarëve shqiptarë për të emigruar ishte 56 për qind, krahasuar me mesataren botërore prej 14 për qind, duke e renditur Shqipërinë në vendin e dytë në botë pas Sierra Leones (61 për qind) dhe në të njëjtin nivel me Haitin (56 për qind). Sipas këtij burimi, ky koeficient ka pësuar një rritje prej 20 për qind krahasuar me periudhën 2010-2012, (Gallup, 2017: <https://news.gallup.com/poll/211883/number-potential-migrants-worldwide-tops-700-million.aspx>, marrë më 21.05.2019). Studiuesit Russell King dhe Ilir Gedeshi kanë evidentuar se ka një rritje të potencialit migrues tek të rinjtë e grup-moshës 18-40 vjeç (Gedeshi, I., King, R., 2018: 40). Sociologu Zyhdi Dervishi që para 20 viteve shkruante “Shumica e të rinjve shqiptarë, sidomos ata që emigrojnë nuk janë pesimistë. Megjithëse aktualisht kanë mirëqenie ekonomike më të ulët dhe më pak mundësi për t’u afirmuar se bashkëmoshatarët e tyre në vendet europiane të Lindjes e të Perëndimit, shumica e të rinjve shqiptarë janë optimistë...Nëse të rinjtë dhe përgjithsisht shqiptarët do të ishin pesimistë ata nuk do të ndërmerrnin rrugëtimin e “ferrit” për të arritur në “brigjet e shpresës”, por do të vetvriteshin në Shqipëri” (Dervishi, Z., 2003: 21). Pra, sipas studiuesit Dervishi, edhe në rastet kur historia përsëritet, optimizmi bën që presioni i pakënaqësive ndaj realitetit shoqëror në vendin e origjinës, të shkarkohet në formën e emigrimit, si një mundësi për një jetë më të mirë.

Qëndrueshmëria e gjetjeve në studimet e sociologut Zyhdi Dervishit, e sidomos në këtë studim të paraqitur në tekstin monografi “Vështrime të kryqëzuara në det” ose “Sociologji kulture 1”, mundësohet nga *vizioni* që karakterizon të gjithë

qasjen hulumtuese të tij. Duke patur njohuri të thella sociologjike, sidomos në lidhje me marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive shoqërore, studiuesi Dervishi, si të thuash, arrin të nge prognoza për zhvillimin e ngjarjeve të mëvonshme sociale. Si një “mjek” i mirëkualifikuar i shoqërisë, ai shqyron simptomat e sëmundjeve shoqërore, bën diagnostikimin e saktë dhe jep recetën përkatëse të sugjerimeve për shërimin e tyre. Megjithëse në pamje të parë duket se pasqyron një realitet të rreth 20 viteve më parë, në tekstin monografi të sipërpërmendur, sociologu Dervishi, duke ndjekur vizionin e tij, nxjerr në pah dilema që vazhdojnë akoma sot të shqetësojnë shoqërinë shqiptare e që e orientojnë atë ende me vështrime të kryqëzuara në det.

Në faqet e këtij libri të publikuar para 20 vitesh shkruhet: “Në shoqërinë shqiptare, veçanërisht në radhët e të rinjve, ende është ‘e ndezur’ psikoza e ikjes, e braktisjes së Shqipërisë, e emigrimit ‘me çdo kusht e me çdo çmim’. Përgjithësisht ‘burimet’ kryesore që e ushqejnë këtë psikozë me rrjedhoja problematike për të tanishmen dhe sidomos për të ardhmen e Shqipërisë janë papunësia masive, pastabiliteti ekonomik e politik, dëshira për të përmirësuar sa më shumë nivelin e jetesës, për të ‘kapur’ një status sa më të privilegjuar në sistemin e ekonomisë së tregut, prirja për t’u afirmuar shpejt në shoqëri ...Ndoshta zhvillimi i shumanshëm dhe demokratizimi real i shoqërisë shqiptare do të ndikojë që kjo rrymë emigrantësh, ëndrrash e shpresash të rrjedhë më shumë në atë kahje që e kërkon përparimi i Shqipërisë sipas standardeve më të përparuara europiane e më gjerë (Dervishi, Z., 2003: 263, 274-275).

Në vend të mbylljes: rëndësia e mbështetjes në modele serioze shkencore

Në vitin 2008, para se të nisja një hulumtim për familjet emigrante dhe sfidat e integritimit në rajonin e Toskanës në Itali, e konkretisht në provincën e Sienës, në rolin e studiuseses, ndjeva se sa e rëndësishme ishte të kishe një busull hulumtuese. Teksti monografi “Vështrime të

kryqëzuara në det” ose “Sociologji kulture 1”, përveç të tjerash, shërbeu për mua si një hartë udhëzuese shumë e vlefshme dhe burim që gjeneronte ide të reja në funksion të njohjes së dinamikave të mëtejshme në jetesës së shqiptarëve në emigracion. Godina e sociologjisë shqiptare, ngrihet më e sigurt, nëse mbështetet në themele të sigurta të kontributeve serioze, disa prej të cilave janë punimet e shumta të studiuesit bashkëkohor Zyhdi Dervishi.

Literatura kryesore dhe webografia

Cotesta, Vittorio: *Lo straniero. Pluralismo culturale e immagini dell'Altro nella società globale*, Laterza, Roma-Bari 2002.

Dervishi, Zyhdi : *Vështrime të kryqëzuara në det. Sociologji kulture I*, Jerusalem, Tiranë 2003.

Dervishi, Zyhdi: *Lente të ndërveprimit simbolik*. Emal. Tiranë 2016.

Dervishi, Zyhdi: *Projektskicë e “ngrehinës” së mendimit sociologjik në njëqindvjetorin e mëvetësimit të shtetit shqiptar*, Revista Lente sociologjike. Vëllimi II, nr 2(4), 2012.

Ember, Carol R. & Ember, Elvin: *Cross-cultural research method, Second Edition*, Alta Mira Press 2009.

<https://news.gallup.com/poll/211883/number-potential-migrants-worldwide-tops-700-million.aspx>, marrë më 21.05.2019

Ilir Gëdeshi; Russell King: *New trends in potential migration from Albania*, CESS, FES, Tirana, 2018.

IOM: *World migration report 2018*, https://www.iom.int/sites/default/files/country/docs/china/r5_world_migration_report_2018_en.pdf, referuar më 21.05.2019

Matthews, Bob; Ross, Liz: *Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*, CDE, 2010.

MB, Profili i migracionit 2016: 2017

KOMUNIKIMI SIMBOLIK: E PADUKSHMJA
SOCIOLOGJIKE NË STUDIMET E ZYHDI
DERVISHITDr. Eriseld KALEMAJ

Departamenti i Shkencave Sociale

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane

Universiteti i “Fan S. Noli” Korçë

Abstrakt

Dukja e sjelljes dhe ndërveprimit njerëzor nuk tregon asgjë ose, së paku, nuk tregon thelbin, sepse njeriu zhvillon veprimtarinë e tij edhe nëpërmjet simbolit. Simbolizmi nënkuptohet në atë që vetë simboli fsheh. Studimi i komunikimit simbolik orientohet kah strukturat e padukshme të subjektit njerëzor, prej të cilave burojnë mënyrat e ndërveprimit në një komunitet.

Studiues të shumtë e konsiderojnë simbolizmin si problem thelbësor të njohjes dhe të kuptuarit njerëzor. Në thelb simboli është instrument i mendimit dhe struktura e mendimit, në pjesën më të madhe, përcaktohet nga gjuha dhe kultura. Ne orientohemi përmes simboleve kulturore dhe kuptimeve të veçantave e kontekstuale që u japim gjërave. Simboli është tepër i rëndësishëm për njeriun, sepse është forma kryesore për të kuptuar mënyrën si mendojmë, si veprojmë e ndërveprojmë, me pak fjalë mënyrën tonë të jetesës edhe pse shpesh vlera e tij neglizhohet ose merret si i mirëqenë.

Tek ky artikull, nëpërmjet analizës dhe interpretimit të tekstit studimor ‘*Lente të ndërveprimit simbolik*’, me autor studiuesin Zyhdi Dervishi do të përpiqemi të njohim hapësirën midis formave të mendimit e përjetimit dhe mënyrës se si ato bëhen të dukshme në kulturën shqiptare. Thelbësisht do të njihemi me vlerën dhe rëndësinë e studimit

të ndërveprimit simbolik në shoqërinë shqiptare; do të shohim faktorët që kanë çuar në dendurinë dhe larmishmërinë e simboleve nënkulturore; format e shfaqjes dhe funksionet e këtyre simboleve; mbi bazën e metodologjisë së studiuësit do të trajtojmë mënyrat e shpjegimit dhe të dekodimit të së padukshmes sociologjike tek shqiptarët.

Koncepte kryesore: *simbol, kulturë, komunikim, ndërveprim*

Hyrje

Njeriu është qenie komplekse për dy arsye; e para sepse nuk është i përcaktuar, pra, karakterizohet nga subjektiviteti i ndryshueshëm e dinamik; e dyta ai nuk mund të jetojë i vetëm, në të kundërt, thotë Aristoteli, mund të jetë kafshë ose zot, por jo njeri (Aristoteli, 2003:11). Në këto kushte, të parën gjë që ka kërkuar njeriu është të njoh veten dhe botën. Ndaj, për çdo gjë, ai ka vendosur shenjën. Shënjimi është gjuha nëpërmjet të cilës mendojmë, vëzhgojmë, mjet i procesit njohës. Gjuha është simbol dhe si e tillë duhet trajtuar. Herët, në shkrimet e shenjta thuhet se e para ishte fjala (simboli). Simboli merr kuptim të përbashkët për të ndarë mes të ngjashmëve botëkuptime të njëjta.

Komunikimi nëpërmjet simbolikës së gjuhës krijon gjithë realitetet njerëzore. Në epokat e hershme kur ishte vetëm një gjuhë, njerëzit në një moment u bënë aq egoist sa kërkonin të arrinin Zotin dhe kështu nisi të ndërtohej Kulla e Babelit, mirëpo Zoti nuk lëshoi asnjë zjarr, rrufe apo përmbytje, siç kishte bërë më herët, për të shprehur zemërimin e tij. Zoti thjesht u ndyshoi gjuhën njerëzve, kështu kulla nuk mund të ndërtohej. Në të përditshmen tonë, ne e anashkalojmë, harrojmë se simbolika e gjuhës verable dhe jo verable është mjeti kryesorë për të krijuar çdo univers njerëzor.

Teoricinë e studiues të shumtë e konsiderojnë simbolizmin si problem thelbësor të njohjes dhe të kuptuarit njerëzor. Nëse bota e kafshëve dominohet nga instiktet dhe ndërmjetësohet nga shenja të paracaktuara, bota njerëzore dominohet nga subjektiviteti, i cili ndërmjetësohet nga konceptet, simbolet dhe gjuha. Simbolet, në dallim nga shenjat, operojnë në një mënyrë më komplekse, sepse në thelb simboli është instrument i mendimit. Ne orientohe mi në realitet përmes simboleve dhe kuptimet që u japim gjërave shpesh janë më të rëndësishme se sa objektet aktuale, të cilave u referohemi. Kështu, njeriu është një kafshë simbolkrijuese dhe simbolpërdoruese.

Po pse njeriu e ka krijuar simbolin? Gjuha ndërtohet mbi konceptet, mirëpo vështirë që çdo koncept të shprehë në mënyrë absolute çdo situatë, gjendje, mendim apo emocion njerëzor. Mendimi (gjuha) dhe bota nuk mund të jenë në një përputhje ideale. Çka do të thotë se realiteti paraqitet si dinamik, në dallim nga objektiviteti i gjuhës. Pra, shënjimi në mënyrë të pashmangshme e objektivizon referencën e saj; qoftë kjo objekt konkret, ide, apo përjetim. Precizioni i gjuhës konceptuale, në fakt do të ishte një reduktim i pavërtetë, i panatyrshëm, tjetërsues i gjithë potencialit dinamik të subjektivitetit njerëzor. Si e tillë, gjuha konceptuale është jo kompetente për të shprehur gjithë gjendjen njerëzore. Vitgenshtajni thotë se tek njeriu “*Ekziston edhe e pashprehshmja*” (Stumpf, 2000 : 427). Kështu, midis natyrës komplekse e dinamike të njeriut dhe objektivitetit të gjuhës konceptuale ka një lloj pamjaftueshmërie. Siç shkruan Dervishi “... në jetën e përditshme shpesh ka një hendek të madh ndërmjet asaj që njerëzit thonë, nga njëra anë dhe ndjenjave e mendimeve të tyre, nga ana tjetër” (Dervishi, 2016 : 466). Për shkak të këtij hendeku njeriu ka modeluar gjuhën dhe ka krijuar gjuhën simbolike si atë verbale edhe atë joverbale, duke e çuar deri në nivelin e artit.

Gjuha dhe komunikimi nuk mund të ketë një metodë të vetme. Modelet e gjuhës, sipas Vitgenshtajnit duhet të jenë

po aq të larmishme sa edhe kontekstet ku vendoset ajo. Në këtë mënyrë gjuha përshtatet si duhet me gjithë ritmin dhe dinamikën, ndryshimet, format e të jetuarit. Thelbi qëndron tek gjuha simbolike, siç shkruan Xh. Berkli: “*Ne duhet vetëm të ngrem perden e fjalëve, për të soditur pemën më të bukur të diturisë, fryti i së cilës është i shkëlqyer dhe mjafton të zgjatim dorën që ta arrijmë*” (Berkli, 2002 : 48). Të qenit simbol, vetiu nuk duhet kuptuar në shfaqjen e saj, përkundrazi duhet kuptuar mes fjalëve që simboli fsheh. Në rastin më të thjeshtë të mos merremi me dukjen e gjuhës, me simbolin e saj të parë, por me atë që përfaqëson. Kjo është arsyeja, se pse duhet t’i mëshojmë mënyrës se si shprehemi. Mënyra të çon tek përdorimi i një gjuhe kontesktuale dhe simbolike.

Si rrjedhojë e kësaj, mund të themi se kuptimet qëndrojnë tek njerëzit, konteksti dhe jo tek fjalët. Simboli është ura lidhëse midis krijimit të unit dhe shoqërizimit të tij në një komunitet më të madh. Marrëdhëniet shoqërore në thelb ndërmjetësohen nga simbolika, atëherë kuptimi nuk gjendet tek koncepti, dukja e një veprimi apo objekti, por tek dekodimi i simbolikës kontekstuale dhe mënyrës së përdorimit të gjuhës verbale dhe joverbale. Tek ky argument Dervishi, duke cituar Umberto Ekon, shprehet se simboli nuk ka lidhje natyrore me objektin që simbolizon (Dervishi, 2016 : 46). Komunikimi simbolik është një strukturë e papranishme, si një sistem i padukshëm i ndërveprimit njerëzor. Shfaqja, dukja, mënyra e shfaqes fsheh thelbin kuptimor të diçkaje, sepse vetë shenja, dukja e diçkaje nuk ka kuptim në vetvete. Madje vetë njeriu është shprehje e tillë, ku qenia e tij, thotë Hajdegeri, fshihet nëpërmjet mënyrës së të qenit. Këtu një rol thelbësor ka kultura në përcaktimin e përdorimit të elementeve të gjuhës jo verbale dhe mënyrës së përdorimit të fjalës (ritmi, intonacioni, theksi). Atëherë, më shumë se sa kuptohet, marrëdhënia shoqërore nënkuptohet tek mënyra se si gjuha fsheh të vërtetën. Ne

duhet të kuptojmë atë që nuk thuhet nëpërmjet mënyrës se si shprehet.

Prej këtej, Gofmani hedh tezën se; bota është një skenë teatrale, ku njerëzit janë aktorë, të cilët, nëpërmjet performancës dhe kërkesave kontekstuale marrin rolin përkatës. Kjo tezë para Gofmanit është thënë nga Shekspiri, Dervishi citon katër vargjet e tij:

E tëra bota është një teatër

Dhe gjithë gratë e burrat janë aktorë

Ata kanë hyrje e daljen që të gjithë

Dhe cilido nuk loz vetëm një rol (Shih: Dervishi, Z., 2016 : 40)

Simbolizmi në kulturën shqiptare një fushë e pa studiuar

Ne e organizojmë jetën nëpërmjet simbolit, ku të gjitha dukuritë, përvojat e përditshme merren si të mirëqëna. Mprehtësia e studiuesit të simbolizmit qëndron në faktin se duhet të shohë, siç shprehet F. Veismen (Friedrich Waismann 1896 –1959): “... plasaritjet e fshehura tek kompozicioni i koncepteve, atje ku të tjerët shohin para vetes vetëm shtegun e rrahur të monotonisë” (Shih: Popper, P., 2009 : 6). Ky ka qenë angazhimi i Dervishit në tekstin e tij studimor “*Lente të ndërveprimit simbolik*”. Ai shkruan: “Njerëzit përgjithësisht janë pak të vetëdijshme për rolin e mesazheve joverbale në orientimin e modeleve të sjelljes së tyre dhe përpiqen pak për të artikuluar ose përgjithësuar rregullsitë e komunikimit joverbal” (Dervishi, Z., 2016 : 21). Kultura dhe ndërveprimi simbolik shpesh merren si të zakonshme, por tepër thelbësore dhe të rëndësishme për jetën tonë. Vetëm kur keqkuptohemi ose pësojmë shok kulturor ndërgjegjësohemi për fuqinë e kulturës në lidhje me ndërveprimin dhe sjelljen tonë me të tjerët (Dervishi, Z., 2016, : 108).

Në këtë mënyrë, studiuesi argumenton vlerën, rolin dhe rëndësinë e studimit të simbolikës në vendin tonë, duke e shoqëruar këtë me shqetësimin se kjo fushë studimi neglizhohet. Madje, vetë gjuha shqipe, në gramatikë, strukturë dhe në thelbin e vetë është një gjuhë simbolike, por siç konstaton Dervishi: “*Studimi i gjuhës simbolike të kulturës shqiptare është në hapat e para*” (Dervishi, Z., 2016 : 27).

Domosdoshmëria për studimin e simbolikës argumentohet edhe nga fakti se për shkak të ndryshimeve politike, sociale e kulturore shoqëria shqiptare përshkohet nga konfuzioni ndërveprues. Dervishi këtu paraqet katër faktorë:

Denduria dhe larmishmëria e kulturës tradicionale me elementë të komunikimit simbolik kërkon kohë për ta mësuar dhe kultivuar më tej.

Elementët e komunikimit simbolik me përdorim nënkulturore zënë një peshë të rëndësishme në kulturën shqiptare.

Emigracioni shton larminë e modeleve të komunikimit simbolik (verbal dhe sidomos jo verbal), çka e komplikon më tepër ndërveprimin në tërësi.

Shqiptarët historikisht përballen me sfida të rënda, në kufijtë e mbijtesës, nën trysinë e ideologjive politiko – ekonomike totalitare dhe të ideologjive propagandistike, duke instaluar tek ata mekanizmin psikokulturor të trajtimit të çështjeve shoqërore bardhë e zi, ku gjallëria e simbolikave kulturore në një farë mënyre është injoruar (Dervishi, Z., 2016 : 25 - 27).

Arsyet e dendurisë simbolike në kulturën shqiptare

Në studimin e Dervishit argumentohet se shoqëria shqiptare ka një përdorim të dendur të komunikimit simbolik, të evoluar dhe të përpunuar në kohë e hapësirë. Kjo ka pasur faktorët e vetë, ku një nga më kryesorët është mos zhvillimi institucional i gjuhës shqipe për një kohë të gjatë. Si

rrjedhojë e kësaj, tek individi shqiptar u kultivua e trashëguua me fanatizëm komunikimi oral, folklori, arti popullor, aspekte të etnografisë, ku zhvillim mori komunikimi dhe ndërveprimi simbolik. Studiuesi bën një analizë të komunikimit simbolik, duke na njohur me dinamikat e këtij fenomeni. Gjithashtu, për arsye historike, politike, ekonomike e gjeografike, Dervishi thekson se kultura shqiptare karakterizohet nga një densitet i lartë i nënkulturave (Dervishi, Z., 2016 : 388).

Kultura shqiptare karakterizohet nga stilet e komunikimit me kontekst të lartë dhe format e komunikimit indirekt. Ky stil thekson të kuptuarit e mesazheve pa deklarur drejtëpërdrejt kuptimin. Stil indirekt është ai në të cilin mesazhet verbale mund të fshehin ose minimizojnë qëllimet, nevojat, dëshirat e vërteta të folësit (Martin&Nakayama, 2010: 158). Në kulturën shqiptare theksohet përforcimi, sfumimi, tjetërsimi, mohimi apo kuptimi i kundërt i asaj që thuhet nga mënyra si thuhet, nga simbolika e kulturës materiale, ritualet, sjelljet, gjuha joverbale etj.

Nisur nga ky karakterizim i kulturës shqiptare, në studimin e Dervishit mbrohet teza se shqiptarët janë aktorë të natyrshëm dhe për këtë ai i referohet konstatimeve të udhëpërshkruesve të huaj. Aktrimi tek shqiptarët zhvillohet së tepërmi kur situatat janë të rëndësishme dhe kur e vërteta nuk është në favorin e tyre (Dervishi, Z., 2016 : 42).

Përdorimi i dendur i simbolikës në proceset ndërveprues vjen edhe për shkak se në kulturën tonë është e rëndësishme ruajtja e parametrave etikë në marrëdhëniet shoqërore, mbrojtja e fytyrës së tjetrit apo mos fyerjen e tij (Dervishi, Z., 2016 : 70). Rëndësia që ka fjalë për vendin, kohën dhe mënyrën e përdorimit të saj tek shqiptarët peshon jashtë mase shumë. (Dervishi, Z 2016 : 76). *“Ndoshta shqiptarët kanë mbetur i vetmi popull në Evropë, i cili ende vuan plagën e rëndë psiko – sociale të vrasjes për fyerje”* – shkruan Dervishi (f. 91). Gjithashtu, duke qënë thellësisht një shoqëri tradicionale, natyrshëm ka denduri të tabuve dhe për

tejkalimin e tyre është zhvilluar e sofistikuar komunikmi simbolik.

Metodologjia në kuptimin e simboleve të kulturës shqiptare

Për ta kuptuar gjithë ndërveprimin simbolik duhet që procesi i komunikimit të analizohet në prizmin e mikrosociologjisë, ndaj në studimin e Dervishit, *“Lente të ndërveprimit simbolik”*, përdoren një larmi metodash e instrumentash, duke i’u përgjigjur një shtrirje gjithëpërfshirëse të konteksteve nënkulturore, si në aspektin social e demografik edhe në aspektin e shtrirjes gjeografike të shoqërisë shqiptare. Në këtë mënyrë, të gjitha format e komunikimit simbolik pasqyrohen si një ‘mozaik shumëngjyrësh’ i kulturës dhe këtë autori e përmbledh me togfjalshin *“atlas i simboleve në kulturën shqiptare”* (Dervishi, Z., 2016 : 29). Pra, që në hyrje studiuesi na fton *“... për një eskursion në botën e simboleve të kulturës shqiptare, por edhe më tej”* (Po aty: f. 31).

Edhe pse autori i referohet studiuesve dhe teoricienëve më të njohur të komunikimit simbolik (si: Uberto Eko, Mark Knap, Irving Gofman etj.), përveç kapitullit VIII në tekstin e tij studimor, ai nuk bën një trajtesë teorike, por tezat, koncepte e teoritë sillen si çelsa për të dekoduar, kuptuar dhe shpejguar dukuritë autentike të komunikimit simbolik në kulturën shqiptare.

Në trajtimin e fenomeneve të ndërveprimit simbolike, autori i referohet folklorit, të dhënave etnografike, kodeve zakonore e kanunore, moralit shoqëror, rrëfimeve nga përvojat e të tjerëve, rrëfimi i përvojave e ngjarjeve personale, referenca tek arti dhe letërsia, tek mitologjia e gojdhënat. Gjithashtu, studiuesi nuk harron të ndalet edhe tek simbolikat unike, të izoluar që burojnë nga përvojat sociale e jetësore. Mjafton për këtë t’i referohemi përdormit

të çarçafëve si mjete komunikmi që përdoren nga banorët e fshatit Kodër me qytetin e Tepelenës, për shkak të afërsisë dhe mundësisë vizuale në distancë (Dervishi, Z., 2016 : 408). Dervishi përdor analizën krahasuese në shumë dimensione. Krahasimi në kohë dhe hapësirë i simbolikave bënë të mundur njohjen dhe kuptimin e dinamikës së vetë simbolit. Jo vetëm kaq, por shpesh krahasimi e çon edhe në analiza normative - kritike, ku ai nxjerr në pah dukuritë problematike të shoqërisë shqiptare. Pra, ai shpesh nuk mjaftohet me thjesht përshkrimin e dukurisë.

Dervishi humlumton tek sjellet zakonore të shqiptarëve, të ndërveprimit të tyre të përditshëm, siç është për shembull kuptimi i ndërrimit të duhanit. Ky gjest nënkupton pa e shprehur verbalisht nevojën për diskutimin e një çështje serioze. Po ashtu dekodimin e kuptimit të shërbimit të kafes, ku nëpërmjet nivelit të ëmbëlësisë së saj nënkuptohen situata, qoftë për rastet mortore, për bisedën e rëndësishme midis mikut dhe të zotit të shtëpisë etj. (Dervishi, Z., 2016 : 95 – 103).

Simbolikat e kulturës, mënyrës së jetesës, formave nënkuptuese të komunikimit shihen si themel i mirëfunksionimit shoqëror. Përdorimi i simbolit në kulturën shqiptare kryen funksione të rëndësishme të ndërveprimit dhe organizimit shoqëror. Këtu autori i referohet një morie formash të komunikimit simbolik, të cilat u korespondojnë funksioneve të caktuara, për shembull kultura materiale shpreh statusin socioekonomik të individit. Shumë forma të komunikimit jo verbal dhe të mënyrës së shprehjeve verbale tregojnë përforcim të mesazhit, sfumim, tjetërsim, mohim ose kuptim të kundërt (Dervishi, Z., 2016 : 128). Ajo që duhet theksuar këtu është fakti që tek shqiptarët kjo mënyrë komunikmi është e dendur, duke konfirmuar kështu format jo të drejtëpërdrejta të ndërveprimit.

Gjithashtu, Dervishi vë re se shumë simbolika të nënkulturave të ndryshme në gjithë kulturën e shoqërisë shqiptare vihen re kuptime jo të njëjta dhe shpesh të

kundërta. Për tu përmëndur është simbolika e veshjes së gunës mbrapsht tek burrat, ku në krahinën e Mirëditës nënkupton se personi ka përjetuar një vdekje të hidhur në rrethin e tij familjar, kurse në Kelmend tregon një mik që po shkon të bëj shkuesi, si shënjë fati (Dervishi, Z., 2016 : 197).

Për shkak të dinamikës së shoqërisë shqiptare, studiuesi ndalet të shohë se si shumë simbole të kulturës janë zhdukur, sfumuar, tjetërsuar dhe simbole të reja janë krijuar. Kjo për shkak të difuzionit kulturor, shtimit të profesioneve të reja, të nënkulturave autentike, globalizmit, teknikës dhe komunikimit elektornik etj.

Në kapitullin e fundit, autori ndalet të bëjë dekodimin e trupit të njeriut, duke filluar nga shprehja e fytyrës, qëndrimi i trupit, mënyra e mbajtjes së flokëve, të mjekrës, të veshjes etj., të cilat shprehin një mori karakteristikash të personalitetit, të gjendjes së tij emocionale, të statusit të personit etj, (Dervishi, Z., 2016 : 552). Në këtë mënyrë, Dervishi provon tezën te kultura shqiptare se, trupi shpreh edhe personalitetin e individit (Dervishi, Z., 2016 : 559).

Literatura kryesore:

Aristoteli: “*Politika*”, Plejad, Tiranë 2003

Berkli. Xhorxh: “*Traktat mbi parimet e njohjes njerëzore*”, Phoenix, Tiranë 2002

Dervishi. Zyhdi: “*Lente të ndërveprimit simbolik*”, Emal, Tiranë 2016

Dervishi. Zyhdi: “*Sociologji shkence I*”, Emal, Tiranë 2019

Dervishi. Zyhdi: “*Sociologji kulture I*”, Jerusalem, Tiranë 2001

Goffman. Erving: “*The presentation of self in everyday life*”, University of Edinburgh Social Sciences Research Centre, 1956

Haidegger. Martin: “*Being and Time*”, State University New York Press 1996

Martin. J, Nakayama.Th: “*Hyrje në komunikimin ndërkulturor*”, UET Press, Tiranë 2010

Popper. Karl: “*Për filozofinë dhe shkencën*”, Fan Noli, Tiranë 2009

Stumpf. Samuel: “*Filozofia, historia dhe problemet*”, Toena, Tiranë 2000

ZYHDI DERVISHI DHE STUDIMI SOCIOLOGJIK I KONFLIKTEVE NË SHOQËRINË SHQIPTARE

Dr. Darina Çoni (Kacollja)

Fakulteti i Edukimit

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan

Abstrakt

Në fushën e sociologjisë idetë e zhvilluara nga një sociolog zhvillohen më tej , e pasurohen nga sociologë te tjerë. Por në rastin e Shqipërisë kjo ka qenë e vështirë sepse sociologjia është një degë e re., dhe si e tillë dhe sociologët nuk kanë pasur një bazë historike të pasur për ta zhvilluar më tej por duhej ta nisnin nga fillimi. Një nga sociologët e parë është edhe Zyhdi Dervishi, i cili me studimet e veta tregoi se si sociologjia nuk është një degë e thatë dhe abstrakte, por një domosdoshmëri praktike njerëzore në përpjekjen e vazhdueshme për të kuptuar dhe përballuar fenomenet që hasen në jetën e përditshme. Një rast i tillë është edhe studimi i kryer për konfliktet që hasen nga nxënësit, në shkolla. Janë fenomene që nga pjesa më e madhe e mësuesve ndeshen në punën e tyre, por ideja për t’i studiuar në hollësi bën dallimin e teorisë dhe praktikës. Rezultatet e këtij punimi janë paraqitur në monografinë “Adoleshentët, bashkëjetesë me demonët e konflikteve” (Tiranë 2005).

Koncepte kryesore: *sociologji, teori, praktikë, nxënës, konflikte*

Roli i sociologut në studimin e fenomeneve të shoqërisë

Libri “Bashkëjetesë me demonët e konflikteve” i shkruar nga Zyhdi Dervishi, është një ndër studimet komplekse ,reale dhe konkrete të shoqërisë shqiptare. Ky libër ka qenë

pikënisja kryesore, e cila më ka udhëhequr në studimet e mia shkencore sociologjike , një ndër të cilat ishte edhe studimi “Konfliktet në universitete”. Libri me shtjellimin e problematikave komplekse të nxënësve adoleshentë shërbeu si një udhërrëfyes për studimin tim, ku në qendër ishin problematikat e studentëve, konfliktet që ata kishin qofshin këto me prindërit, pedagogët, bashkëmoshatarët e tyre etj.

Ky libër shërbeu njëkohësisht për vite me rradhë si literaturë bazë për studentët e Fakultetit të Edukimit, dega:Filozofi-Sociologji dhe Punë Sociale në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. Nëpërmjet tij ata arritën të përvetësojnë konceptet bazë të konflikteve, por njëkohësisht edhe zbatimin e praktikave perëndimore bashkëkohore të ndërmjetësismit për zgjidhjen e konflikteve te ndryshme në shoqërinë shqiptare. Studentët e ketyre degeve nuk janë njohur vetëm me konceptet e këtij libri por ato e njohin dhe punojnë si literaturë bazë pothuajse me të gjitha librat e sociologut Zyhdi Dervishi, të cilat janë shumë edukative pasi prekin problemet sociale të shoqërisë shqiptare ndër vite .

Mirënjohje e veçantë dhe falenderim pa fund shkon për profesorin Zyhdi Dervishi dhe njeriun e pa kursyer,i cili me këshillat, angazhimin dhe profesionalizmin e tij, gjithmonë na ka udhëhequr drejt koncepteve të argumentuara sociologjike.

Ç’është konflikti?

Konfliktet janë pjesë e natyrshme dhe e pandalshme e jetës. Ato janë pjesë përbërëse e marrëdhënieve njerëzore . Njerëzit janë të përfshirë në konflikte të vazhdueshme. Siç thekson sociologu Zyhdi Dervishi, “ Përvoja jetësore dhe studimet ndërdisiplinore kanë provuar se përveç ose krahas konflikteve që shkaktojnë rrjedhoja të dëmshme, funksionojnë edhe konflikte, të cilat nxisin zhvillimet e përshpejtuara të veprimeve të ndryshme shoqërore, ekonomike, politike e kulturore, procesin e humanizmit të shoqërisë moderne”(2005:16) .

Studimi i konflikteve

Sociologu Zyhdi Dervishi në studimin e tij “Bashkëjetesë me demonët e konflikteve”, flet për konfliktet që ndodhin tek nxënësit në shkollat e mesme. Janë këto konflikte, që mësuesit dhe prindërit i ndeshin shpesh, dhe rrallë i studiojmë shkaqet e tyre thellësisht, por në përgjithësi ja veshim ato moshës së adoleshencës, që është edhe mosha më problematike tek të rinjtë. Ky studim i hollësishtëm bën të mundur një pasqyrë të detajuar të këtyre konflikteve. “Sipas këtij parimi metodologjik është ndërtuar ky libër, i cili jo i fragmentizuar, por si tërësi unike përmban një tërësi çelësash me rreze veprimi teorik e praktik, të cilët ndihmojnë për të hyrë në botën e mistershme të zgjidhjes me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve të nxënësve adoleshentë të shkollave të mesme”(Dervishi. Z., 2005:12).

Nën tryshinë e mosmarrëveshjeve të shumëfishta brenda familjes

Në këtë kapitull sociologu merr në studim konfliktet e adoleshentëve me prindërit, për shkak të mendësive dhe përplasjes së tyre me realitetin që i rrethon, sidomos në familje. Një risi që sjell në këtë studim është shpeshësia e këtyre konflikteve sipas gjinive: vajzë djalë. “Shqyrtimi analitik i të dhënave të këtij grafiku provon se realiteti i konfliktive të adoleshentëve me prindërit e tyre hedh poshtë disa opinione të përhapura gjerësisht në shoqërinë shqiptare të ditëve tona: përgjithësisht djemtë konsiderohen më trazovacë, më kokëfortë, më kryeneçë, më të pabindur ndaj prindërve, më të prirur për sherre vend e pa vend edhe me prindërit. ...Ndërkohë vajzat adoleshente përgjithësisht konsiderohen më të shtruara, më të bindura ndaj prindërve, më të prirura t’u shmangen mosmarrëveshjeve me të tjerët dhe sidomos me prindërit’(fq. 56). Ato nga vetë natyra shmangen me qetësi dhe urtësi nga arena e konflikteve ose mundohen t’i sheshojnë ato.

Gjatë këtij studimi del në pah se djemtë në moshën e adoleshencës qëndrojnë më larg prindërve, janë më pak të matur, më këmbëngulës se sa vajzat në kërkesat e tyre për

një mënyrë jetese si të bashkëmoshatarëve të tyre ne vendet perëndimore më të urbanizuara. Vetëkuptohet që kostoja e një mënyre jetese të tillë është e lartë, e papërballueshme për shumicën dërrmuese të familjeve shqiptare. Madje vështirë se do të përballohen edhe për të ardhmen, së paku të afërt” (fq. 59).

Të dhënat tregojnë se konfliktet me vajzat janë shumë më ndryshe se sa nga djemtë. “ shumica e prindërve po përpiqen të mbajnë nën vëzhgim të rreptë gjithë veprimtarinë e vajzave të tyre, sidomos në moshën e adoleshencës. Ndaj edhe për këto probleme vajzat konfliktohen më shumë me prindërit e tyre. Kështu, pesha specifike e vajzave të konfliktuara me prindërit e tyre për arsye se këta i pengojnë të ndjekin sjelljet e reja në mënyrën e jetesës apo në veshje etj.”(fq. 75).

Konfliktet e adoleshentëve me njëri – tjetrin

Duke qenë në një moshë që përjetojnë ëndërrime, iluzione e zhgënjime të forta, të rinjtë adoleshentë, përgjithësisht, janë të prirur të konfliktohen edhe me njëri- tjetrin, më shumë ndoshta se çdo grup- moshë tjetër e të rinjve(fq. 82). Ndoshta kjo vjen nga mosha e cila karakterizohet nga një luftë normale dhe pothuajse e përhershme për të krijuar identitetin individual .

Nga studimi ka rezultuar se ndryshe nga konfliktet në familje, djemtë janë personat më të konfliktuar me njëri - tjetrin. “ Ata përgjithësisht janë më pak të vëmendshëm në mësim. Veçanërisht në orët e mësimi që i tërheqin më pak, mjaft prej tyre përpiqen ta kapërcejnë mërzinë, duke ngacmuar njëri – tjetrin. Përvoja tregon se për ngacmime të tilla, reagimet kundërshtuese janë të ndryshme. Një pjesë e djemve përpiqen të mos pranojnë për asnjë minutë statusin e viktimës, duke kundërshtuar flakë për flakë.”(fq. 86).

Kurse vajzat shqiptare janë më pak të konfliktuara se djemtë. Për këtë çështje në monografinë “Adoleshentët, bashkëjetesë me konfliktet e demoneve” theksohet: “ Tradicionalisht vajzat shqiptare janë më pak konfliktuese se djemtë,

veçanërisht në mjedise të gjera publike, siç është shkolla. Madje shpesh, edhe kur u bëhet padrejtësi, shumica e vajzave adoleshente nuk reagojnë në mënyrë konfliktuese. Përgjithësisht ndaj personit që i cënon me mendime e qëndrime jokorrekte, mjaft vajza hakmerren me heshtje dinjitoze, me buzëqeshje shpërfillëse” (fq. 84).

Motivi kryesor i këtyre konflikte siç rezulton nga studimi janë thashethemet. Sidomos në Shqipëri ky fenomen është shumë i përhapur. Njerëzit duke ndenjur pjesën më të madhe të kohës në lokale, krijon premisën e një përhapje në shkallë të gjerë të thashethemeve. “ Mjaft shqiptarë, veçanërisht të moshës së mesme ose të moshuar, e kanë në majë të gjuhës të akuzojnë të tjerët, madje edhe njerëz fare të afërm, si thashethemexhinj ose intrigantë. Flitet shpesh për njëfarë “ agjencie” thashethemesh që qarkullon më parë se çdo media tjetër informacionet më të rëndësishme që dirigjojnë “opinionin” dhe dinamikën e ndryshimit të stutuseve të grupimeve të caktuara sociale, që vlerëson në mënyrë të pamerituar e përdhos, gradon e çgradon personalitete e njerëz të thjeshtë... Edhe nxënësit adoleshentë të shkollave të mesme nuk janë jashtë rrezes së ndikimit të në “agjencie” të tillë” (fq. 88). Ky pohim vlen edhe për ditët tona.

Konfliktet e adoleshentëve me mësuesit

Në këtë libër sociologu Dervishi argumenton idenë: “Përvoja jetësore dhe studimet socialpedagogjike kanë provuar se, nën trysinë e “shpirtit antikonformist më të ndezur”, nxënësit adoleshentë të shkollave të mesme janë më të prirur se nxënësit e shkollave tetëvjeçare dhe studentët e shkollave të larta të konfliktohen me njëri – tjetrin dhe veçanërisht me mësuesit, të cilët përgjithësisht i konsiderojnë si përfaqësues të tradizionalizmit, të së vjetrës” (fq. 115). Një ide e tillë shtjellohet në vijim e kësaj monografie në mënyrë më të detajuar

“ Qëndrimi ndaj vërshimit të kulturave perëndimore nuk mund të mos vihej në qendër të diskutimeve e deri të polemikave ndërmjet mësuesve dhe nxënësve adoleshentë. Madje, jo rrallë diskutime e polemika të tilla janë shndërruar dhe shndërrohen në mosmarrëveshje e konflikte të mprehta. Shumica e mësuesve mbi 40 vjeç, e shihnin me syze etnocentrike, domethënë me dyshim deri dhe me frikë përhapjen e ndikimeve perëndimore në mënyrën e veshjes, të sjelljes dhe të menduarit të nxënësve adoleshentë” (fq. 121).

‘Në krahasim me të konfliktuarit për motive të tjera, nxënësit e përfshirë në mosmarrëveshje me mësuesit nga keqkuptimet e rastit zënë peshën specifike më të lartë. Rreth një ndër tre vajza dhe më shumë se dy ndër pesë djem të anketuar shprehen se kanë përjetuar konflikte të ndryshme me mësuesit, të shkaktuara nga “shkëndija” të ndonjë keqkuptimi të rastit” (fq. 144). Studime të mëvonshme për konfliktet provojnë se përfundime të tilla të përpunuara nga sociologu Dervishi ruajnë vlerat aktuale.

Ndërmjetësimi – proces i përthyer në kristalet e formimit psikokulturor

Një shqyrtim i hollësishëm sociologu Dervishi i ka bërë procesit të ndërmjetësimit, për të zgjidhur këto konflikte. Është e rëndësishme në një studim të përcaktojmë llojet e konflikteve shkaktarët, por më e rëndësishme është zgjidhja e këtyre konflikteve.

“Nocioni “ndërmjetësimit” arsyeton Dervishi në një kuptim të gjerë mund të përfshijë çdo lloj veprimtarie të një pale të tretë(ndërmjetëse ose pajtuese). E cila ndihmon për zbutjen ose tejkalimin e konfliktit ndërmjet dy palëve që mund të jenë individë, familje, fise, grupime shoqërore ose etnike, kombeshtete ose blloqe shtetesh. Ndërmjetësimi ndryshon shumë prej gjykimit nga organet e drejtësisë, i cili në zgjidhjen e konflikteve bazohet në autoritetin e ligjit dhe të shtetit” ... Ndërmjetësit lipset të bëjnë punë gjithnjë më të kujdesshme për të parandaluar, zbutur dhe kapërcyer

konfliktet e çfarëdollojë, në të cilat, dashur pa dashur, përfshihen nxënësit adoleshenë”(fq. 26, 192).

Nga të dhë nat e studimit rezulton se personat që parapëlqehen si ndërmjetës janë më suedit. Pavarsisht se autoriteti i figurës së mësuesit mbas vitit 1990 u godit rëndë, dhe nuk kishte më atë vlerësim si më përpara, dhe një pjesë e mësuesve filluan mos ta vlerësonin më punën e tyre. Për këtë sociologu Dervishi thekson: “ Në rrethana të tilla autoriteti i mësuesit ndoshta u godit më rëndë nga furia shkatërruese e kësaj histerie shpërfillëse. Shumica e mësuesve, sidomos e atyre me përvojë më afatgjatë vazhduan e vazhdojnë ta zhvillojnë mësimin me profesionalizëm e përkushtim si më parë ” (fq. 237). Detyrë themelore i takon të gjitha agjensive shoqërizuese të ndihmojnë e të shikojnë me përparësi sjelljet e adoleshentëve e t’i drejtojnë ata drejt rrugës së suksesit.

Në këtë monografi argumentohet me përparësi pathemelësia e shumë mendësive dhe paragjykimeve. Ndër të tjera theksohet: “Faktet që ofron ky anketim hedhin poshtë mendësitë se gjoja në ditët tona është zbehur shumë ose nuk funksionon më roli edukues i mësuesve, se gjoja nxënësit distancimin nga mësuesit e konsiderojnë hapësirë lirie për afirmimin e shpejtë të personalitetit të tyre etj.” (fq. 238).

Literatura kryesore:

Dervishi, Zyhdi: Adoloshentët, bashkëjetesë me demonët e konflikteve, Shtëpia Botuese “Emal” Tiranë 2013.

DIVERSITETI NËNKULTUROR: KËNDVËSHTRIME KONCEPTUALE MBI KULTURËN SHQIPTARE NË STUDIMET SOCIOLOGJIKE TË ZYHDI DERVISHIT

Dr. Denisa Titili

Dr. Maria Dojçe

Departamenti i Shkencave Sociale

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Abstrakt

Artikulli prezanton një vështrim konceptual rreth analizave dhe trajtesave të sociologut Zyhdi Dervishit mbi kulturën shqiptare dhe larminë nënkulturore që e karakterizon atë, bazuar në studimin sociologjik “Nëpër degëzime të kulturës shqiptare”.

Kultura shqiptare shfaqet si një mozaik nënkulturash të larmishme, të cilat dallohen shumë nga njëra-tjetra. Këtë diversitet nënkulturor të kulturës shqiptare e kanë vënë në dukje shumë studiues shqiptarë e të huaj, udhëpërshkues, kulturologë, albanologë, etnografë, sociologë e njerëz të letrave.

Punimi monografik i shkruar nga Zyhdi Dervishi ofron një analizë të thelluar të dukurive dhe prirjeve kryesore të zhvillimit nënkulturor në mjedisin shoqëror shqiptar, larmia nënkulturore, karakteristika të formimit psiko-kulturor të shqiptarëve bazuar në vëzhgimin dhe interpretimin e fakteve, modeleve të sjelljes, mënyrave të komunikimit, qëmtimi i mendësive të tyre etj.

Krijimi i tablosë së plotë të larmisë nënkulturore të kulturës shqiptare mund të bëhet vetëm përmes një studimi dhe

pasqyrimi të diversitetit nënkulturor në kontekstin lokal. Në këtë mënyrë, çdo studim i këtij lloji do të shërbejë si një “copëz që plotëson mozaikun e kulturës shqiptare”.

Koncepte kryesore: *konceptual, analizë, dukuri, model, nënkulturore*

Kultura shqiptare- mozaik nënkulturash

Referuar literaturës së përdorur në funksion të studimit konstatohet se kultura shqiptare shfaqet si një mozaik nënkulturash të larmishme, të cilat dallohen shumë nga njëra-tjetra. Sociologu Zyhdi Dervishi argumenton se kultura shqiptare trajtohet si një mozaik elektronik në dinamikë

ndryshimesh të vazhdueshme në të cilin, çdo pllakëz ka dritën dhe ngjyrën e vet të diferencuar në dhjetra e qindra nuanca origjinaliteti të papërsëritshëm (2013:18).

Kjo larmi nuancash në kulturën shqiptare evidentohet në të gjithë përbërësit e sistemit kulturor: në doke, zakone, mënyrën e të folurit, në sjellje, në stilin e jetesës, në veshje, banesa, ceremonialë e ritualë pagane dhe fetare, në art, muzikë, poezi, krijimtari gojore, në norma, vlera, simbole, përbërës të kulturës materiale etj. Ndryshimet në nivel nënkulturor janë tepër të dukshme, megjithatë ato përbëjnë varietete të së njëjtës kulturë.

Në planin konceptual, termi “nënkulturë” ose “subkulture” (kështu gjendet në literaturën e huaj bashkëkohore) ka kuptimin e një bote brenda botës së madhe të kulturës mbizotëruese; pra që ka një mënyrë të vetën, të dallueshme nga kultura sunduese. Nënkulturat përbëjnë varietete të së njëjtës kulturë, të cilat shfaqen në segmente të caktuara të popullsisë. Çdo shoqëri përbëhet nga një sërë nëngrupesh, secili me karakteristika të veçanta, por që kanë të

përbashkëta me të gjithë shoqërinë vlera, norma, simbole, elemente të kulturës materiale etj.

Në shoqëritë bashkëkohore nënkulturat kryesore përcaktohen nga përkatësia klasore, fetare dhe etnike, nga përkatësia gjinore dhe orientimet politike, nga mënyra dhe stili i jetesës, nga orientimet artistike dhe seksuale, nga profesionet dhe grup-moshat etj. (Po aty). Studimet sociologjike e vënë theksin veçanërisht tek karakteristikat dhe veçoritë e nënkulturave të cilat formohen nga stilet e veçanta të jetesës së grupeve të ndryshme shoqërore.

Pasuria nënkulturore dhe veçanërisht dallimet ndërmjet grupeve të ndryshme sociokulturore në mjedisin shqiptar kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të ndryshëm, të cilët jo vetëm kanë vënë në dukje dhe e kanë vlerësuar këtë diversitet nënkulturash, por kanë studiuar edhe faktorët përcaktues të këtij diversiteti të madh nëkulturore.

Diversiteti nëkulturore: faktorët ndikues

Studimi i nënkulturave shfaq një interes të veçantë, pasi përbën një përpjekje për të hartëzuar botën tonë sociale (Jenks, Ch, 2004: 149).

Ka disa faktorë të cilët kanë ndikuar në mënyrë të dukshme në formësimin e tipareve dhe fizionomisë së kulturës shqiptare dhe diversitetit të saj nëkulturore. Trajtesat gjithëpërfshirëse të kulturës shqiptare në studimin e Z. Dervishit, bazuar në analiza krahasuese në dimension kohor dhe hapësinor, vënë në dukje një sërë faktorësh, ndër të cilët përmenden:

Para së gjithash pozita gjeografike e Shqipërisë ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, e cila ka bërë që në hapësirën shqiptare të ndërthurren ndikime të elementeve kulturore të botës perëndimore dhe asaj lindore

Një fakt i tillë është konstatuar nga një sërë studiuesish. Eqrem Çabej argumenton se Shqipëria është trualli në të cilin grindja e gjatë ndërmjet botës romano-perëndimore dhe

ballkanike-bizantine është shprehur në mënyrën më të spikatur. Ky qëndrim i ndërmjetëm midis Lindjes dhe Perëndimit i bashkuar me ruajtjen e ngulur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë përgjithmonë fytyrën e saj të veçantë (2006: 21). Pozita gjeografike dhe rrethanat historike, bënë që shqiptarët t'u ekspozohen në mënyrë mjaft intensive kontakteve shoqërore e kulturore; dhe të përthyhen mbi ta rryma kulturash të ndryshme, që sollën si rrjedhojë ruajtjen dhe konservimin, humbjen dhe zëvendësimin, rikrijimin e vazhdueshëm të tipareve konstitutive të kulturës shqiptare (Bobi, G, 1997: 21).

Së dyti, pushtimet e shumta që populli shqiptar ka përjetuar përgjatë historisë së tij përbëjnë një tjetër faktor përcaktues të diversitetit nënkulturor shqiptar.

Historia e popullit shqiptar është karakterizuar nga përpjekje të vazhdueshme të pushtuesve për të shtrirë ndikimin e tyre përmes imponimit dhe ndërfitjes së përbërësve të sistemit të vet kulturor. Këto ndikime kanë qenë veçanërisht të dukshme në qytete dhe në hapësirën fushore dhe kodrinore të vendit. Nga njëra anë, prurjet e reja kulturore të imponuara prej pushtuesve ndikuan në ndryshimin e mënyrës së jetesë dhe të menduarit të një pjese të popullsisë, duke sjellë si pasojë shtim të diversitetit nënkulturor. Nga ana tjetër, përpjekjet e pushtuesve për rrafshimin e larmisë nënkulturore të kulturës shqiptare dështuan për shkak se shumë zona mbetën të papushtuara (kryesisht zonat malore). Kësisoj, siç shprehet edhe studiuesi Dervishi, nënsistemet e vlerave kulturore të shqiptarëve të zonave të pushtuara dhe të shqiptarëve të zonave të papushtuara, në linjat e tyre kryesore zhvilloheshin në kahe të kundërta, duke përforcuar veçoritë origjinale të nënkulturave të kulturës shqiptare (2013:85).

Prirjet difuzuese ndërmjet banorëve të Gadishullit Ballkanik.

Studimet tregojnë se popujt e Ballkanit kanë përjetuar intensivisht difuzionin ndërkulturor. Fati i përbashkët historik i këtyre popujve, afërsia gjeografike, kontaktet ndërmjet banorëve, migrimet, kanë sjellë si pasojë shpërfaqjen e një vargu tiparësh dhe elementësh ndërmjet kulturave të popujve ballkanikë. Alkimia shumëshekullore midis popujve ballkanas është shprehur në kulturat që i dallonin edhe udhëtarët më pak të njohur me to (Castellan, G, 1991: 147).

Mungesa për një kohë të gjatë e rrjetit të komunikacionit në hapësirën shqiptare, që ndihmon në përafrimin dhe lidhjen ndërmjet krahinave dhe nënkulturave të ndryshme, është një tjetër faktor që ka ndikuar në theksimin dhe përforcimin e dallimeve nënkulturore në kulturën shqiptare (Dervishi, Z., 2013:116-121).

Këtë fakt e ka konstatuar edhe udhëpërshkruesja Edit Durham, sipas së cilës theksimi i ndryshimeve lokale vjen prej sistemit fisnor dhe mungesës së komunikimit (2000: 208). Këta faktorë kanë luajtur një rol të madh në theksimin dhe ruajtjen e dallimeve, tipareve me karakter nënkulturor në shoqërinë shqiptare.

Pasuria gjuhësore (dallimet dialektore, nëndialektore dhe të folmet krahinore).

Gjuha shqipe është e ndarë në dialekte, nëndialekte, grupe të folmesh të formuara nga të folmet krahinore, të grupeve shoqërore, profesionale etj., të cilat dallohen dukshëm nga njëra-tjetra. Krahas dallimeve dialektore e nëndialektore, gjuha shqipe është ndikuar edhe nga gjuhë të popujve fqinjë dhe gjuhë të tjera të huaja, veçanërisht në kushtet e lëvizjeve në shkallë të gjerë të popullsisë, zhvillimeve dinamike dhe prirjeve globalizuese të shoqërisë. Kjo pasuri gjuhësore

reflekton drejtpërsëdrejti dallimet dhe veçoritë nënkulturore të kulturës shqiptare. Siç thekson edhe Gani Bobi, një hartë e kulturës shqiptare e ndarë në subkultura, do të mund të bëhej mbi baza të diferencimeve gjuhësore, si rrjedhojë e veprimit të shumë faktorëve. Harta e kulturës shqiptare, përgjithësisht, do t'i përngjante hartës dialektologjike të gjuhës shqipe (1997: 77).

Diversiteti fetar

Besimi fetar është një ndër përbërësit e sistemit kulturor të një grupi shoqëror. Përkatësia fetare dikton në një shkallë të konsiderueshme mënyrën e jetesës, komunikimit, ndërveprimit të anëtarëve të të njëjtit besim fetar. Anëtarët e një komuniteti fetar karakterizohen nga praktika, qëndrime, zakone, rituale, cerenoriale, forma komunikimi, mënyra jetese të përbashkëta, të cilat dallohen nga ato të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera fetare. Diversiteti fetar përbën një faktor të rëndësishëm të diversitetit kulturor e nënkulturor në një shoqëri të caktuar. Shqiptarët janë një popull me përbërje fetare heterogjene, gjë e cila reflektohet edhe në larminë nënkulturore që karakterizon mënyrën e jetesës së pjesëtarëve që u përkasin besimeve të ndryshme fetare. Aktualisht, besimtarët shqiptarë janë anëtarë të pesë dinominejshëve fetare kryesore: Katolicizmi, Ortodoksia, Myslimanizmi Syni, Bektashizmi dhe Vëllazëria Ungjillore Shqiptare (Protestanizmi). Një spektër i tillë fetar është pasuruar edhe me përhapjen në trajtën e kultit të shumë besimeve të tjera fetare. Ndër shqiptarët, diversiteti fetar është një faktor me veprim të fuqishëm shumëshekullor, i cili “formaton” nënkultura, ose përforcon veçoritë origjinale të nënkulturave ekzistuese (Dervishi, Z. 2013:95).

Bashkëveprimi i të gjithë faktorëve të lartpërmendur i ka dhënë kultures shqiptare fizionominë e saj të veçantë, duke

e cilësuar si një mozaik të vërtetë nënkulturash të dallueshme.

Analiza konceptuale

Studimi i diversitetit nënkulturor të kulturës shqiptare prezanton trajtim shkencor të dukurive dhe prirjeve kryesore të zhvillimit nënkulturor shqiptar dhe paraqitjen e tyre brenda strukturave konceptuale më të përparuara të sociologjisë së kulturës. Bazuar në kuadrin konceptual të integruar në studim, kultura trajtohet si një tipologji katërpjesëshe:

1-Kultura si një kategori njohëse; gjendje e përgjithshme e mendjes dhe përfshin idenë e arritjeve individuale dhe emancipimit njerëzor.

2-Kultura si kategori e mishëruar dhe kolektive; kultura përmbledh shkallën e zhvillimit intelektual dhe moral në shoqëri, kuptim që e lidh kulturën me qytetërimin.

3-Kultura si kategori deskriptive dhe konkrete; është fjala për kuptimin mbi kulturën si art dhe produktin intelektual të një shoqërie.

4-Kultura si kategori sociale që përfshin të gjithë mënyrën e të jetuarit të anëtarëve të një shoqërie.

Duke qenë se kultura ndikon në mënyrën sesi njerëzit e organizojnë jetën e tyre dhe si krijojnë kuptimin për jetën, qëmtimi i modeleve të sjelljes, praktikave dhe mendësive të banorëve në studimin e Z. Dervishit çon në një qasje holistike të kuptimit për kulturën. Bazuar në këtë këndvështrim çdo marrdhënie sociale ka dy anë:

Mënyra se si njerëzit ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si shfaqen, si sillen.

Kultura përdoret për të treguar modelet e jetës brenda një komuniteti, aktivitetet që ndodhin rregullisht dhe rregullimet materiale dhe sociale. Kultura i referohet sferës së fenomeneve të vëzhgueshme; ajo që ekziston objektivisht dhe që ne e kemi prodhuar si kulturë.

Produkte abstrakte që lidhen me idetë që njerëzit kanë për njëri-tjetrin, për kuptimet e tyre, pritshmëritë e tyre
Kultura përdoret për të kuptuar sistemet e organizuara të dijës dhe besimeve, nga ku njerëzit strukturojnë përvojën, perceptimet e tyre dhe zgjedhin mes alternativave. Ky kuptim i referohet sferës së ideve, vlerave, mendësive, botëkuptimit të anëtarëve të një shoqërie. Kultura në këtë kuptim përfshin sistemin e ideve të përbashkëta, rregullave dhe kuptimeve që qëndrojnë dhe shprehen në mënyrat që njerëzit jetojnë.

E parë në këtë këndvështrim konceptual kultura i referohet asaj që njerëzit mësojnë, pra dija që jep standartet për të vendosur se ‘çfarë është.....për të vendosur çfarë mund të jetë.....dhe për të vendosur si duhet të veprohet me të’. Kjo dije e organizuar i jep kuptim veprimeve dhe modeleve sjellore të antëtarëve të një shoqërie dhe njëkohësisht lejon të kuptohet raportet ndërmjet ndryshueshmërive dhe ngjashmërive bazike.

Literature kryesore

Bobi, Gani: *Paradoksi kulturor*, vepra 2, Botime “Dukagjini”, Pejë 1997

Castellan G.,(2001), *Histori e Ballkanit (shekulli XIV- XX)*, përkthim, Botime Çabej

Çabej Egerem: *Shqiptarë midis Perëndimit dhe Lindjes* (botimi i tretë) Botime “Çabej”, Tiranë 2006

Dervishi Zyhdi.,(2011), *Fakte të shumtë në rrjedhën e prirjes konservative të kultures shqiptare*,

tek *Lente Sociologjike, Vol.1 Nr. 1, faqe.232-260*, 2011, Botim i Departamentit të

Sociologjisë, UT,

Dervishi Zyhdi: *Nëpër degëzime të kulturës shqiptare* (Trajtesë sociologjike e disa profileve

të mendimit psikokulturor të shqiptarëve), Shtëpia botuese “Emal”, Tiranë 2013

Durham Edit: *Brenga e ballkanasve*, Botimet “Argeta-LMG”, Tiranë 2000

Jenks, Ch: *Culture* (second edition), Routledge (Taylor & Fransis Group), 2004

RILEVIMI I PROFILEVE THELBËSORE TË HARMONISË NDËRFETARE TË SHQIPËTARËVE NË STUDIMET E SOCIOLOGUT ZYHDI DERVISHI

Doktorante BLERINA MUSTAFALLARI (KËRÇUKU)

Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Ky artikull synon të analizojë ndihmesën e veçantë të sociologut Zyhdi Dervishi për zbulimin dhe argumentimin e aspekteve thelbësore, më të qenësishme të tolerancës, të harmonisë ndërfetare të shqiptarëve. Frekuentimi i vendeve të shenjta të feve të tjera me shpresën për tu shëruar vetë ose të afërmit, pagëzimi i fëmijëve me emra të feve të tjera (përgjithësisht emra me përmbajtje fetare më të spikatur) me shpresën që fëmija të jetojë dhe të jetë sa më i shëndetshëm, sfumimi i konflikteve ngaqë palet e konfliktuara janë me përkatësi fetare të ndryshme etj., janë dukuri që provojnë se harmonia ndërfetare e shqiptarëve ka të bëjë me çështje themelore të jetës. Në studimet e Prof. Dr. Dervishit ofrohen shpjegime të argumentuara për këtë problematikë. Ndryshe nga studiuesit e tjerë, të cilët kanë vënë në dukje kryesisht aspektet ceremoniale të harmonisë ndërfetare të shqiptarëve, sociologu Zyhdi Dervishi ka vlerësuar profilet thelbësore të një dukure të tillë, që e ka bërë të njohur popullin shqiptar në shkallë botërore.

Koncepte kryesore: *pluralizëm fetar, shoqëri shqiptare shumëfetare, tolerancë ndërfetare, harmoni ndërfetare, profile thelbësore të harmonisë ndërfetare etj*

1. Toleranca ndërfetare e shqiptarëve dhe dinominejshi bektashian

Në Republikën e Shqipërisë me statusin e dinominejsheve aktualisht janë të zyrtarizuara 5 organizata fetare, myslimanët suni, bektashinjtë, katolikët, ortodoksët dhe protestanët. Rasti i shoqërisë shqiptare meriton të studiohet si një model ku shumëllojshmëria fetare ka prodhuar paqe, stabilitet, bashkëjetesë e harmoni.

Modeli ndërfitar paqësor shqiptar përbën një sfidë ndaj shumë teorive mbi konfliktualitetin e feve të ndryshme në një shoqëri shumëfetare.

Ndër shqiptarët ka argumentuar sociologu Zyhdi Dervishi diversiteti fetar është një faktor me veprim të fuqishëm shumëshekullor që “formaton” nënkultuara ose përforcon veçoritë origjinale të nënkultuarve ekzistuese (2000:105).

Përvoja historike tregon se feja e njëjtë për shumicën e anëtarëve të kulturave të ndryshme përgjithësisht ka shërbyer dhe shërben si faktor që sfumon dallimet nënkulturore të grupimeve të ndryshme sociale. Në studimet sociologjike, ka shkruar Zyhdi Dervishi, është argumentuar se fetë, veçanërisht fetë e mëdha botërore më të organizuara, historikisht dhe aktualisht kanë funksionuar dhe funksionojnë si mekanizma mjaft kompleks me veprim unifikues të fuqishëm, gati tërësor në kulturën e jetesës, në elemente të kulturës materiale, sidomos në mendësitë, në botën shpirtërore të besimtarëve (2013:94).

Organizatave fetare në shoqërinë shqiptare kanë dhënë ndihmesë të veçantë në procesin e kombformimit. Mirëkuptimi fetar nuk u izolua brenda mjediseve, të organizatave, të institucioneve fetare. Ai ishte pjesë e jetës së shqiptarëve që shfaqej në mënyra nga më të ndryshmet, duke nisur nga festimet e përbashkëta të ceremonive fetare të pashkëve e bajrameve, martesat e bashkëshortëve me fe të ndryshme, për të vazhduar me prezencën e tij në çdo zhvillim social e historik. Mbështetur në këto tregues, mirëkuptimi fetar nga tipar religjioz mori përmasa shoqërore gjithëpërfshirëse. Për këtë arsye, në shoqërinë shqiptare flitet për bashkëjetesë dhe harmoni. Kontributi i besimeve

fetare dhe i klerikëve përballë sfidave të përbashkëta kombëtare e fetare, sidomos gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe më pas, përbën një traditë historike të rrallë jo vetëm për Ballkanin, por edhe më gjerë. Besimet fetare u karakterizuan nga një frymë harmonie e bashkëjetese, e cila ka pasur ndikim të rëndësishëm në ruajtjen e formimin e unitetit kombëtar. Ato patën një rol domethënës përgjatë udhës së mundimshme drejt pavarësisë së vendit. Toleranca fetare ose, më saktësisht, toleranca ndërfitare, siç e ka karakterizuar sociologu Zyhdi Dervishi, “... në sistemin e vlerave të kulturës tradicionale shqiptare më të spikatura, thekson ai, që e dallojnë atë më dukshëm nga kulturuat e vendeve të tjerë europiane e më gjerë: janë besa, mikpritja dhe toleranca ndërfitare” (2003:31). Kjo tolerancë vazhdon të mbetet një ndër vlerat kulturore, historike që i dallon shqiptarët nga mjaft popujt të tjerë, është një model shëmbulldhënës edhe për popujt të tjerë të përfshirë në luftëra të motivuara fetarisht.

Në studimet e sociologut Zyhdi Dervishit është argumentuar në mënyrë të detajuar idenë se besimi bektashian karakterizohet nga toleranca, mirëkuptimi dhe harmonia altruiste. Në librin, “Nëpër degëzime të kulturës shqiptare”, Dervishi thekson se bektashinjtë bëhen më të pranueshëm jo vetëm sepse janë më fleksibël, më liberalë e tolerantë në predikimin dhe realizimin e rregullave, të ritualeve fetare, por edhe sepse manifestojnë frymë altruizmi më të spikatur (2013:111-112).

Toleranca dhe mirëkuptimi janë vlera të bektashinjeve, duke luajtur një rol të rëndësishëm në harmoninë ndërfitare, të shqiptarëve. Elementët e një tolerance të tillë janë të përcaktuar qartë në Statutin e Komunitetit Bektashian, të miratuar në Kuvendin e tij, në korrik të vitit 1924, në teqenë “Hajdarije” të Gjirokastrës. Në artikullin 71 të këtij statuti thuhet: *“Rrojta vëllazërorë e bektashinjeve shqiptarë, me elementet e ndryshëm të racës së përbashkët, është detyra më e shenjtë, detyrë e cila plotësohet me qëndrimin patriotik*

të këshillit atnuer (atnor – B.M.)”. Me anë të këtij mesazhi bektashinjtë synojnë që ta shohin të gjithë popullin të bashkuar si vëllezër, si krijesa të të njëjtit Zot, në një udhë të përbashkët, të përparimit të Shqipërisë. Përmes kësaj porosie bektashizmi ka ecur në rrugën e historisë, pa paragjykimë dhe me përrulësi e devotshmëri drejt arsyes dhe veprimit. Kjo tolerancë në mendime, ide dhe veprime konkrete ka ndikuar që uniteti i bektashinjve me katër dinominejshet e tjerë fetare në shoqërinë shqiptare të jetë shembull jo vetëm për rajonin, por edhe më gjerë.

Sociologu Zyhdi Dervishi pohon se shumica e bektashinjve banojnë në Krujë, përgjithësisht në qytete dhe krahina më në jug të saj, kryesisht në ato territore shqiptare, në të cilat përgjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit të XX popullsia u angazhua në luftë të shumanshme më të ashpër kundër regjimit të pushtimit osman. Ndoshta, edhe në emër të interesave kombëtarë, bektashinjtë ndryshuan dhe përgjithësisht thjeshtuan mjaft elemente të fesë myslimane (2013:110).

Duke filluar aty nga dhjetëvjeçari i fundit i shekullit XIX bektashinjtë filluan të tregohen shumë aktivë në zhvillimin e lëvizjes kulturore dhe kombëtare, veçanërisht në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, duke sjellë rritjen e shpejtë të popullaritetit të tyre në hapësirat shqiptare dhe në Ballkan dhe në vijim përfshirjen e elementeve të ideologjisë nacionaliste në doktrinën e tyre fetare. Kleri bektashian luajti rol organizues, mbështetës e frymëzues në Lëvizjen Kombëtare. Bektashizmi në Shqipëri, sidomos në shekullin XIX, mori tipare të qarta kombëtare dhe rreth teqeve u grumbulluan shqiptarë atdhetarë të përkushtuar ndaj çështjes kombëtare. Baballarët bektashianë shpeshherë u vunë vetë në krye të qëndresës kombëtare. Historia e Rilindjes Kombëtare dëshmon se bektashinjtë mbështetën luftën për liri, për gjuhën dhe shkollën shqipe (Hysi, Sh., 2006:152-163).

Shqiptarët bektashianë kanë shërbyer si urë miqësie dhe njohjeje të ndërsjellët midis komunitetit mysliman dhe atij të krishterë. Faktori fetar është i pranishëm dhe mjaft i ndjeshëm pothuaj në çdo ngjarje të historisë. Mjaft fakte provojnë se atdhetarizmi i shqiptarëve buronte nga mohimi prej të huajve të identitetit kombëtar. Kërcënimet nga të huajt zhvilluan sensin e krenarisë dhe ndjenjës kombëtare. Gjithashtu lipset të mbajmë parasysh edhe ndihmesën e veçantë të Dinominejshit Bektashian në harmonizimin e fesë dhe patriotizmit në Shqipëri. Roberto Morozzo della Rocca vë në dukje që toleranca e tyre ndaj feve të tjera, sipas parimit të ekzistencës të vetëm një Zoti, konfirmon përpjekjet e ndryshme të tyre për të bashkuar besimtarët e të gjithë feve.

Studiues të ndryshëm, në studimet e tyre, kanë argumentuar se harmonia ndërfitare dhe toleranca për besimet e tjera përbëjnë një nga vlerat kulturore më të spikatura të shqiptarëve. Ndoshta Shqipëria është i vetmi vend në Europë që nuk ka patur luftëra fetare, ka shkruar Faik Konica (2001:241). Jo vetëm studiues shqiptarë, por dhe të huaj kanë nxjerrë në pah përmes shkrimeve dhe studimeve mungesën e luftërave fetare në Shqipëri.

Madje sociologu Zyhdi Dervishi, ka argumentuar se dallimet fetare kanë ndihmuar që shqiptarët të jenë më të matur në marrëdhëniet me njeri-tjetrin, të jenë më të prirur të harmonizojnë marrëdhëniet me njeri-tjetrin, të tejkalojnë kontradiktat e natyrave të ndryshme (Dervishi, Z., 2010: 144). Kjo vlerë kulturore që shqiptarët mbartin, i ndihmon ata të krijojnë marrëdhënie harmonike jo vetëm mes njëri-tjetrit, por edhe me anëtarë të komuniteteve me përkatësi tjera etnike, racore etj.

Në studimin e tij, “Nëpër degëzime të kulturës shqiptare”, sociologu Zyhdi Dervishi thekson rëndësinë e vlerës kulturore të tolerancës, në bashkëjetesën sociokulturore të popullsisë shqiptare me grupet e tjera në pakicë. Në këtë

kontekst, Dervishi thekson: *“Mendojmë se zemreku i funksionimit me kapacitet të plotë të vlerës kulturore të tolerancës, të mirëkuptimit ndërjetar ka të bëjë me një profil të qenësishëm të modelimit psikokulturor të popullit shqiptar, i cili është rilevuar ndonëse fare zbehtë, nga studiuesit më të kualifikuar të konstruksionit shpirtëror të shqiptarëve. Të çliruar nga instiktet e turmave, shqiptarët asnjëherë nuk kanë keqtrajtuar grupet shoqërore në pakicë, të formuar mbi baza racore, etnike, nacionale, fetare etj. Historikisht dhe aktualisht, grupet shoqërore në pakicë, si të thuash, kanë qenë dhe janë të mbrojtur nga toleranca, prirja për mirëkuptim dhe fryma humane e grupeve shoqërore në shumicë”* (2013: 404).

Gjithashtu sociologu Dervishi ka argumentuar se shumë aspekte në shoqërinë shqiptare grupet shoqërore në pakicë janë më të mirëkuptuar se shqiptarët në shumicë. Sociologu Zyhdi Dervishi ka përshkuar një situatë të tillë: “Në një konferencë shkencore, që organizohej në Tiranë për problemin e marrëdhënieve ndërmjet grupeve shqiptare dhe atyre minoritare, referuesi kryesor e nis diskutimin me pohimin: Jam krenar që jam shqiptar, por do të isha më i nderuar dhe më i privilegjuar po të isha minoritar”. Dhe me fakte të shumta ai argumentoi në mënyrë bindëse këtë ide” (Dervishi, Z.,2018:115).

2. Frekuentimi i institucioneve fetare

Pas shpërbërjes së sistemit socialist totalitar institucionet fetare rifilluan funksionimin edhe në Republikën e Shqipërisë. Me krijimin e mjediseve të përshtatshme besimtarët filluan të ushtronin ritualet fetare edhe në institucionet fetare. Numri i kishave, xhamive, teqeve, të tyrbeve dhe vendeve të tjera të shenjta në Shqipëri ka ardhur duke u rritur, sidomos gjatë 4 shekujve të fundit. Theodor Ippen ka shkruar se vetëm në qytetin e Krujës në fillim të shekullit të XX ka pasur 366 xhami, teqe, tyrbe dhe vende të shenjta (Shih: Dervishi, Z., 2013:401).

Frekuentimi i mjediseve fetare ndikon edhe në forcimin e unitetit të individëve me përkatësi fetare të ndryshme. Jo të pakta janë rastet kur besimtarë myslimanë frekuentojnë kishat, të krishterë që shkojnë në xhami dhe teqe. Vlen të theksohet se kjo larmishmëri e frekuentimit të kulteve fetare nuk ka dallime moshe dhe përkatësie gjinie.

Në punimin monografik “Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global”, të shkruar nga sociologët Artan Fuga dhe Zyhdi Dervishi theksohet:

“Në xhami ndjekin rituale edhe nxënës të krishterë ose kishën e frekuentojnë edhe të rinj me përkatësi fetare myslimane, veçanërisht në raste festash fetare. Gjithashtu, në ditë festash fetare si pashkët, Bajrami, Kurban Bajrami, nxënësit përgjithësisht bëjnë vizita urimi në shtëpitë e njëri-tjetrit, pavarësisht nga ndryshimet në besimet e tyre fetaretë gjitha këto ndikojnë në kultivimin e tolerancës fetare, në njëjtësinë e mënyrës së tyre të menduarit“ (2002:213-214).

Frekuentimi i institucioneve apo dhe vizitat në familje ku ritualet fetare janë të ndryshme forcojnë dhe riformojnë besimin qoftë dhe në aspektin njohës. Myslimanë suni, bektashinj, katolikë, ortodoksë dhe protestantë kryejnë vizita në shtëpitë e njëri-tjetrit në raste festash fetare. Aktualisht të pakta janë ato familje të cilat ruajnë me fanatizëm ritualet e besimit të tyre. Sot dallimet fetare në mënyrën se si i zhvillojnë ceremonitë e gëzueshme dhe hidhërimet janë më të zbehta se kohë më parë. Rrethana të tilla favorizojnë dashurinë dhe martesën e të rinjve e të rejave me përkatësi fetare të ndryshme. Në shoqërinë shqiptare ekzistojnë paragjykime dhe janë shumë të rralla rastet e pengimit të martesave të të rinjve dhe të rejave që nuk kanë të njëjtën përkatësi fetare.

Për komunitetin bektashian teqetë kanë shërbyer dhe shërbejnë jo vetëm si mjedise ku adhurohet zoti, por edhe si mjedise ku besimtarë të krahinave të ndryshme mbledhen në barazi dhe vëllazëri të admirueshme. Aty s’ka të parë dhe të

fundit. Në qoftë se i afroheni ndonjë dervishi, ai do t'ju presë me përzemërsi dhe thjeshtësi, dhe do t'ju shërbejë e do t'ju shpjerë te babai, që është kryetari i tij..." (Xhelaj, S., 2015:72).

Teqeja bektashiane ka qenë dhe është një qendër pritjeje dhe strehimi, e hapur 24 orë, ditën dhe natën, për të gjithë njerëzit pa dallim përkatësie fetare, gjuhe, përkatësie kombëtare e gjinore etj. Shprehja: "E ke bërë shtëpinë si teqe", tregon vlerat humane të kësaj porte të hapur për të gjithë njerëzit.

3. Kremtimet e festave fetare të besimeve të tjera

Festimi i festave fetare me besimtarë të besimeve fetare të ndryshme tradicionalisht ka forcuar marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve. Festimi i Bajramit, Pashkëve, Sulltan Nevruzit etj, ka bërë që myslimanë dhe të krishterë të shkojnë për vizitë tek njëri-tjetri, qerasin me gatimet tradicionale të festës dhe festojnë për ditët e shënuara.

Festa bektashiane e Sulltan Nevruzi kremtohet si një nga festat kombëtare që simbolizon ripërtëritjen e natyrës, të mirësive, gëzimeve, ngazëllimit, mesazhet dhe emocionet që përcjell kjo festë, nëpërmjet ritualeve të bektashinjtë, i përjetojnë pothuajse njëloj edhe të krishterët e myslimanët suni.

4. Objektet fetare vend mbarësie

Frekuentimi i vendeve të shenjta me pikësynime të ndryshme, si përmirësimi i shëndetit, sigurimi i më shumë mbarësive në jetë etj, është traditë e konsoliduar e të gjithë popujve të botës. Por, shqiptarët ndryshe nga popujt e tjerë, shpesh frekuentojnë edhe vendet e shenjta jo vetëm të fesë që besojnë, por edhe të feve të tjera. Bindja, ose, të paktën shpresa se edhe vende të shenjta edhe të feve të tjera të sjellin mbarësi, të shërojnë sëmundje të ndryshme, deri edhe të pashërueshme nga mjekësia, të heqin magjitë, të sjellin harmoni dhe dashuri midis njerëzve dhe sidomos në familje

janë forma të vlerësimit real të feve të tjera. Studiuesi Zyhdi Dervishi për këtë çështje, në një intervistë për DW ndër të tjera, thekson: “Është një traditë e konsoliduar ndër shekuj që besimtarët myslimanë shkojnë tek vendet e shenjta të krishtera, ose e kundërta, me shpresën për të gjetur shërim për veten e tyre, mbarësi për fëmijët a të afërmit. Natyrshëm lind pyetja, se a mund ta urresh një institucion fetar të një feje tjetër kur mendon se tek ky institucion, tek ky vend i shenjtë do të gjes mbarësi? Kjo do të thotë se ke respekt, ke adhurim të veçantë për një vend të shenjtë të një feje tjetër”. Vende të shenjta të cilat frekuentohen nga shqiptarët me përkatësi fetare të ndryshme ka shumë në hapësirën shqiptare dhe në Ballkan. Teqeja e Sarisalltikut adhurohet nga të gjithë besimtarët. Edhe Kisha Katolike e Laçit, gjatë gjithë vitit, dhe sidomos në ditë të caktuara me rëndësi fetare të veçantë, frekuentohet nga mijëra e mijëra besimtarë jo vetë të besimit të krishterë, por edhe myslimanë. Teqeja e Abaz Aliut në malin Tomor është një vend shenjtërie dhe mikpritës për besimtarët e të gjithë feve. Shtegtarë aty gjejnë mikpritje, përkujdesje dhe qetësim shpirtëror. Sot më shumë se kurrë, të gjithë besimtarët dhe dashamirësit bektashi dhe të feve të tjera nga e gjithë bota, vijnë në këtë vend të shenjtë, përulen në shenjë respekti, dhe largohen duke marrë me vete qetësinë shpirtërore.

Në librin “Vullnetarizmi ind shumëfunksional i shoqërisë”, studiuesi Zyhdi Dervishi shkruan: “...klerikët e kualifikuar e të përkushtuar japin një ndihmese të pazëvendësueshme për trajtimin psikologjik të fatkeqëve me sëmundje të pashërueshme, për t’i përgatitura ato shpirtërisht të përballojnë sfidën më të rëndë në jetën e tyre” (2005:204). Kryesisht përzgjidhen klerikët fetarë për të rrëfyer shqetësimet vetjake, sidomos ato më problematike në rastet kur ndjehen në vështirësi shumë të mëdha dhe kërkojnë tejkalimin e tyre.

Megjithëse shumë të përhapura në të gjitha urdhërat fetarë, praktikat terapeutike janë përmendur relativisht rrallë në

dokumentacion përkatës të feve të ndryshme dhe në studimet përkatëse. Sociologu Zyhdë Dervishi e ka analizuar me përparësi një funksion të tillë të rëndësishëm të besimeve fetare, të vendeve të shenjta në rrafsh sociologjike, dhe sidomos në aspektin e përforcimit të harmonisë ndërfitare të shqiptarëve, që është një nga vlerat kulturore më të arrira tipike shqiptare në rrjedhën e shumë shekujve deri në ditët tona.

5. Pagëzimi i fëmijëve me emra të një besimi tjetër fetar

Pagëzimi me emra të caktuar i fëmijëve është një çështje komplekse që ka të bëjë me kulturën e nënkulturën dhe deri në traditat fisnore të familjeve të veçanta. Sociologu Zyhdë Dervishi ka analizuar traditat e shoqërisë shqiptare edhe për këtë problematikë. Ai ka rilevuar një risi tipike shqiptare, e cila nuk konstatohet në shoqëri të tjera: *“Në ato shoqëri tradicionale ose moderne, të Perëndimit ose të Lindjes, që karakterizohen nga intoleranca fetare nuk përfytyrohet që të krishterët t'i pagëzojnë fëmijët e tyre me emra myslimanë ose anasjelltas. Përkundrazi, në shoqërinë tradicionale shqiptare huazimi i emrave nga të besimeve fetare të tjera konsiderohej si ogur që sillte mbarsi për çështjet jetike. Deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri shkalla e mortalitetit foshnjor ka qenë e lartë. Si rregull, kur një çift myslimanësh i vdiste fëmija i pare, dhe aq më tepër ku i vdiste edhe fëmija i dytë, fëmijës që lëndëte më pas i vinin një emër të krishterë që i korrespondonte emrit të ndonjë shenjtorit të kësaj feje. Ndërkohë, çiftet e bashkëshortëve të krishterë që përjetonin fatkeqësinë e largimit të një ose dy fëmijëve të vegjël nga kjo jetë, fëmijës që lindte më pas i vinin emër mysliman. Sipas besëtytnive emrat me përkatësi fetar tjetër i mbronin fëmijët e vegjël nga shpirtrat e ligj, u sillnin atyre shëndet dhe mbarësi në jetë”* (2016:205).

Një traditë e tillë e pagëzimit të fëmijëve është një dëshmi e përsëritur dendur në shoqërinë shqiptare dhe provon

harmoninë ndërfitare të shqiptarëve. Këtë realitet e ka rilevuar sociologu Zyhdi Dervishi.

Literatura kryesore

Fuga, Artan dhe Dervishi, Zyhdi: *Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global: Integrimi i të rinjve të zonave fshatare në dritëhijet e arsimit të mesëm*, Trajtesë sociologjike, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë, 2002

Konica, F.: *Shqipëria-kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, Vepra 2: Duda, 2001

Dervishi, Zyhdi: *Nëpër degëzime të kulturës shqiptare*, Shtëpia Botuese “Emal”, Tiranë 2013

Dervishi, Zyhdi, a: *Sociologjia: për shkollën e mesme të profilizuar*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 2000

Dervishi, Zyhdi: *Flirte me plagët*, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë, 2003

Dervishi, Zyhdi: *Adoleshentët: bashkëjetesë me demonët e konflikteve*, (Botimi i tretë). Tiranë, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, 2005

Dervishi, Zyhdi: *Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik*, Shtëpia Botuese “Emal”, Tiranë, 2011

Dervishi, Zyhdi: *Sociologjia 12 (Tekst për shkollat e mesme të Republikës së Shqipërisë)*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor e Re, Tiranë 2018

Hysi, Shyqyri: *Historia e komuniteteve fetare shqiptare*, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, Tiranë, 2006

Statuti i Komunitetit Bektashian Shqiptar, Gjirokastër, Korrik 1924.

Xhelaj, Syrja: *Fati ynë prej drite*, Shtypshkronja “Urtësia Bektashiane”, Tiranë 2015.

PERCEPTIMI DHE PRIRJA NDAJ VULLNETARIZMIT TE QYTETARËT E KOSOVËS DHE VIZIONE TEORIKE TË SOCIOLOGUT ZYHDI DERVISHI

Doktorante ARBENITA SYLEJMANI- NIMANI

Abstrakt

Vullnetarizmi në Kosovë nuk është një fenomen i ri. Gjatë viteve të 90-ta të shekullit të XX. Kosova në mungesë të institucioneve publike dhe institucioneve arsimore, të cilat ishin të pushtuara nga regjimi serb, mbante veten përmes vullnetarizmit. Gjatë kësaj kohe vullnetarizmi ekzistonte në shumë fusha, si në atë të arsimit, ekonomisë, politikës dhe mjekësisë. Mirëpo, në periudhën e pasluftës, në vitin 1999, Kosova doli shumë e shkatërruar nga lufta dhe vullnetarizmi pësoi rënie. Ndonëse në Kosovë është në fuqi ligji i tanishëm mbi vullnetarizmin në Kosovë, ky ligj është diskriminues ngase që përfshin vetëm të rinjtë dhe nuk përfshin kategori të tjera në bazë të moshës .

Qëllimi i këtij punimi është që të shihet perceptimi i qytetarëve karshi vullnetarizmit, në mënyrë që të identifikohet nëse në Kosovë mund ketë një kulturë ndaj perceptimit të vullnetarizmit dhe nëse ky aktivitet mund të ketë pësuar rënie apo ngritje. Ky punim u realizua përmes metodës sasiore, me anë të 200 anketave të realizuara me qytetarë të Kosovës, si dhe përmes metodës cilësore ku u analizuan ligje dhe raporte përkatëse si të rrafshit kombëtar, ashtu edhe atij ndërkombëtar.

Rezultatet treguan se mungon një kulturë e vullnetarizmit ndër qytetarë, ku shumica e qytetarëve, ndonëse theksuan se kishin marrë pjesë në punë vullnetare, megjithatë vullnetarizmin e konsideronin si aktivitet që shërben më shumë për pastrimin e lagjes. Më tutje, shihet se ekziston dallim i madh midis femrave dhe meshkujve në aktivitetet

vullnetare, ku meshkujt deklaruan se 82% kishin marrë pjesë në punë vullnetare, ndërsa femrat 68%. Madje, shumica theksuan se nuk ishin në dijeni për ligjin mbi vullnetarizmin. Gjithashtu, rezultatet treguan një prirje të zbehjes së vullnetarizmit, ngase shumë deklaruan se në të ardhmen nuk do të merrnin pjesë në ndonjë aktivitet vullnetar, ngase konsideronin si aktivitet që nuk ja vlen.

Koncepte kryesore: *Kosovë, vullnetarizmi, qytetarë, kulturë, aktivitet, ligj*

Hyrje

Gjatë viteve të 90-ta, regjimi serb në Kosovë tentoi që t'i obligonte shqiptarët e Kosovës që të punojnë sipas programit të Serbisë, në të gjitha fushat dhe veprimtaritë, duke përfshirë këtu edhe institucionet e arsimit, sigurisë dhe politikës. Shqiptarët nuk pranuan të punonin me program të Serbisë dhe si rezultat mbetën pa punë. Për më tepër regjimi serb, gjatë viteve 1991/92 tentoi që t'i obligonte mësimdhënësit shqiptarë në Kosovë që mësimin t'a organizonin sipas ligjeve dhe programeve mësimore të Republikës së Serbisë por, mësimdhënësit nuk lejuan një gjë të tillë. Për këtë shkak, të gjithë shqiptarët u dëbuan nga të gjitha insitucionet publike, përfshirë këtu edhe dëbimin nga shkollat dhe universitetet. Andaj, shumë shtëpi private u lëshuan falas për një qëllim, për t'u shndërruar në shkolla dhe universitete, pa asnjë kompensim financiar. Mësimdhënësit shqiptarë në Kosovë, në rrethana okupuese organizuan procesin mësimor dhe ndërtuan sistemin e pavarur arsimor shqiptar në Kosovë. Mësimdhënësit dhe pronarët e këtyre shtëpive, përveç se punuan pa asnjë kompensim financiar, ata rrezikuan edhe jetët e familjarëve të tyre.

Pas luftës së fundit në Kosovë (1998-1999), Kosova doli e shkatërruar nga lufta, duke filluar nga vrasjet e më të afërmeve, dhunimet dhe shkatërrimi i çdo pasurie. Normalisht, këto pasoja të luftës së bashku me zhgënjimet

dhe mungesën e perspektivës së të rinjëve dhe qytetarëve të Kosovës që u ndikuan nga shkalla e papunësisë, korrupsionit dhe mungesës së përgjegjësisë dhe transparencës në vend, ndikuan që vullnetarizmi të pësoi rënie. Edhe hulumtimi i vitit 2011 i realizuar nga Qendra Kulturore në Prishtinë dëshmon se vullnetarizmi në Kosovë ka pësuar rënie kohëve të fundit (2011). Por, kjo prirje nuk është vetëm në Kosovë, por vërehet edhe në vitin 2018 tek të rinjtë në Amerikë. Për shembull, analiza e perceptimeve të banorëve të Kosovës për vullnetarizmin parashikohen duke i krahasuar me trajtimet teorike dhe empirike të shtjelluara nga sociologu Zyhdi Dervishi në monografinë “Vullnetarizmi, ind shumëfuknsional i shoqërisë”. në një hulumtim të realizuar në Amerikë vihej re se sot nxënësit e shkollave të mesme janë më pak të gatshëm të marrin pjesë në aktivitete vullnetare krahasuar me gatishmërinë që kishin 15 vite më parë (Institute, 2018).

Pavarsisht rënies së punës vullnetare në Kosovë, viteve të fundit shihet se në Kosovë kanë qenë dhe janë të pranishme disa aktivitete vullnetare. Është me rëndësi të përmendim si shembull të suksesshëm të vullnetarizmit festivalin e filmit ‘Doku Fest që mbahet çdo vit në Prizren dhe që kontribuoi dhe vazhdon t’i kontribuon artit dhe kulturës në Kosovë. Në këtë festival, i cili ka filluar të realizohet që na viti 2002, marrin pjesë një numër i konsiderueshëm i vullnetarëve të cilët punojnë në realizimin dhe organizimin e këtij festivali (Vullnetarizmi dhe trashëgimia kulturore, 2009). Gjithashtu, kohëve të fundit vërehen edhe disa aktivitete vullnetare, të disa qytetarë të Kosovës, që punojnë për të mirën e përgjithshme duke kontribuar në rregullimin e parqeve të lagjes dhe ndërtesave kolektive ku jetojnë.

Por, ende mungon definimi i qartë ligjor dhe qasje e drejtë rreth vullnetarizmit në Kosovë. Për shembull në Kosovë ekziston baza ligjore mbi vullnetarizmin, por ky ligji parasheh vetëm vullnetarizmin tek të rinjtë dhe quhet ‘Ligji

për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë’, numër 03/L-145, dhe ky ligj i diskriminon kategoritë e tjera në bazë të moshës. Një nga katër objektivat e Strategjisë së Qeversisë së Kosovës 2013-2017, në lidhje me bashkëpunimin me shoqërinë civile, është edhe nxitja e vullnetarizmit të shoqëria civile. Nga kjo strategji dalin disa aktivite qytetare të disa organizatave civile që kishin angazhuar vullnetarë. Por, kjo strategji nuk është se bëri jehonë të madhe. Për shembull, me ligj parashihet që vullnetarët e rinjë të regjistrohen, por ky sistem nuk funksionon (Civile, 2016).

Metodologjia e studimit

Ky punim u realizua përmes metodës sasiore dhe cilësore. Në kuadër të pjesës sasiore përfshihen 200 anketa të plotësuara me 100 qytetarë të Prishtinës dhe 100 qytetarë të Pejës. Në Prishtinë 50 anketa u plotësuan nga të anketuarat femra dhe 50 nga meshkujt. Edhe në qytetin e Pejës anektat u plotësuan nga 50 të anketuara femra dhe 50 meshkujt. Janë përzgjedhur këto dy qytete me qëllim që të merren mendime të ndryshme nga qytetaret e Prishtinës si qyteti më i madh i Kosovës dhe një qyteti më të vogël krahasuar me Prishtinën, siç është Peja. Pjesa cilësore përfshin analizimin e raporteve të vullnetarizmit si të rrafshit komëtar ashtu edhe atë ndërkomëtar. Anketat e plotësuara janë analizuar në programin statistikor Excel.

Rezultatet e anketimit

Rezultatet e këtij punimi janë shpjeguar dhe interpretuar gjithnjë bazuar në argumentet e librit të sociologut shqiptar Zyhdi Dervishi, “Vullnetarizmi-ind shumëfunksional i shoqërisë”. Në gjetjet e profesor Dervishit, përshkurhen me argumente dhe burime të shumta, në kohë dhe periudha të ndryshme, tendencat dhe perceptimet që kishin dhe kanë shqiptarët karshi vullnetarizmit si dhe, përfitimet që marrën vajzat dhe gratë si rezultat i punës vullnetare gjatë regjimit socialist në Republikën e Shqipërisë.

Përpunimi statistikor i të dhënave nxjerr në pah perceptime dhe qëndrime të ndryshme karshi vullnetarizmit e në veçanti të perceptimit se çka kuptohet me vullnetarizmin, si aktivitet qytetar te qytetarët e Kosovës.

Të anketuarve u është drejtuar pyetja: *Çka kuptoni me punë vullnetare?*

Shumica e të anketuarve vullnetarizmin e konceptojnë si aktivitet që më shumë shërben për të pastruar lagje, ku 36 % të anketuar meshkuj deklaruan një gjë të tillë dhe 44% të femrave. Nga të anketuarit, femra 18 % dhe, meshkuj 23% , theksohej se aktiviteti vullnetar shërben për të ndihmuar rrethin dhe shoqërinë. Më tutje, sipas 21% të anketuarve femra vullnetarizmi konsiderohej si aktivitet që i shërben vetëm bamirësisë, ndërsa po këtë gjë e pohonin edhe 20% të meshkujve të anketuar. Më tutje, tek 17 % të të anketuarve femra dhe 21% meshkuj mendohej se puna vullnetare kërkohet aty ku shteti është i paafte të ofrojë shërbime dhe shfrytëzon qytetarët (grafiku 1).

Kjo përqindje flet qartë se mungon një definim i qartë dhe qasje rreth vullnetarizmit. Qytetarët duke e perceptuar vullnetarizmin si aktivitet për të pastruar lagjen dhe si punë bamirësie dëshmon se ka mungesë të kulturës në raport me perceptimin rreth rolit dhe rëndësisë së vullnetarizmit dhe vërehet mungesa e vetëdijësimit që kanë një pjesë e qytetarëve të Kosovës. Në këtë linjë argumentimi sociologu Zyhdi Dervishi pohon se ndonëse në përqindje jo shumë të madhe (23,71%) shumë nga të anketuarit e identifikonin veprimtarinë vullnetare me bamirësinë. Sociologu Dervishi në këtë kontekst ka parasysh edhe nivelin arsimor të të anketuarve në raport me perceptimin e vullnetarizmit, i cili argumenton se pesha specifike me arsim tetëvjeçarë që vullnetarizmin e perceptojnë si punë bamirësie ishte 10 herë më e lartë se ajo e atyre me grada e tituj shkencorë (Dervishi, Z., 2011: 56-57).


Rol kyç në perceptimin e vullnetarizmit si aktivitet për pastrimin e lagjes dhe si punë bamirësie ka mungesa e qasjes

në institucionet publike që kishin shqitparët gjatë viteve të 90-ta. Kështu, shqiptarët duke jetuar në mungesë të institucioneve publike, vetëm një instiucion arritën të mos e humbnin, e ajo ishte familja dhe shtëpia. Duke qenë familja si i vetmi instiucion për shqitparët në Kosovë, gjithçka që ishte jashtë dyerve të shtëpisë konsiderohej e huaj. Për këtë shkak, sot shumë pak në Kosovë është zhvilluar vetëdija ndaj pastërtisë publike dhe si dëshmi kemi papastërtinë që e shohim në ndërtesat kolektive, rrugët, sheshet, parqet e qytetit, madje akoma nga ballkonet e shtëpisë hidhen troshat (thërmijat) e bukës, sepse akoma nuk konsiderohet e jona ajo çka është jashtë dyerve të shtëpisë. Në këto rrethana edhe puna vullnetare shikohet me dyshim, si diçka që gjindet jashtë dyerve të shtëpisë. Ndonëse kanë kaluar dy dhjetëvjeçarë nga paslufta, kjo vetëdije kërkon më shumë kohe për t'u ndryshuar.


Faktor tjetër që mund të ketë ndikuar që vullnetarizmi të perceptohet si aktivitet për pastrimin e lagjës mund të konsiderohen edhe mediat në përgjithësi. Për shembull, organizata *Let's Do It Kosova* në shtator të vitit të kaluar (2018) filloi fushatën e quajtur “ta pastrojmë Kosovën” dhe se aktivitetet e kësaj fushate ishin shumë të pranishme në të gjitha mediat, ku u bënë shumë programe dhe reklama kushtuar këtij aktiviteti, që pastroi disa deponi ilegale të mbeturinave, me anë të vullnetarëve të shumtë të angazhuar. Dhe, normalisht, një reklamim aq të madh karshi punës vullnetare nuk ka pasur asnjëherë më shumë ne media, sesa që kishte fushata ‘ta pastrojmë Kosovën’ dhe, kjo do të ketë ndikuar te qytetarët që aktiviteti vullnetarë të perceptohet dhe identifikohet vetëm me pastrimin e lagjes. Kjo është një tregues dhe shembull shumë pozitiv që do të duhej të ndjeknin institucionet e Kosovës për të promovuar në media rolin dhe rëndësinë e punës vullnetare në përgjithësi, dhe vullnetarimi të promovohet përtej aktivitetit për pastrim të lagjes. Në këtë kontekst, fushatat vetëdijësuese në media ndaj punës vullnetare do të ndikonin në vetëdijësimin e

qytetarëve që vullnetarizmi të perceptohet si një aktivitet qyterar, ku problemet e komunitetit duhet të zgjidhen në formë të përbashkët dhe kështu do të rritej pjesëmarrja e njerëzve në qytetari aktive.

Grafiku 1. Çka kuptoni me punë vullnetare?




Grafiku 2 A keni marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë aktivitet vullnetar?



Sipas grafikut 2 vihet re se 82% të anketuarve meshkuj kishin marrë pjesë në aktivitet vullnetarë dhe 68% të të anketuarave femra pohonin gjithashtu një gjë të tillë. Pavarësisht që të anketuarit tregonin se kishin marrë pjesë në aktivitete vullnetare, në pyetjen tjetër, nëse do të pranonin

prapë të merrnin pjesë në ndonjë aktivitet vullnetar, shumica e të anketuarve (42% meshkuj dhe 36% femra) pohuan se nuk do të pranonin të merrnin pjesë në ndonjë aktivitet vullnetarë. Ndërsa, më pak pohuan se do të merrnin pjesë në ndonjë aktivitet vullnetarë (25% meshkuj dhe 23% femra). Si aktivitet që nuk ja vlenë mendonin një pjesë e vogël e të anketuarve (20% meshkuj dhe 19% femra), (grafiku 3). Sociologu shqiptar Zyhdi Dervishi thekson se në Shqipëri ka zbehje të vullnetarizmit, ndonëse si rezultat i rrethanave të tjera krahasuar me Kosovën, siç është abuzimi me vullnetarizmin gjatë periudhës së regjimit socialist në Shqipëri, ku nënvizohet se gjatë dhjetëvjeçarit të fundit në shoqërinë shqiptare vullnetarizmi është atrofizuar në një masë të konsiderueshme (Dervishi, Z., 2011: 16-17). Të anketuarit duke mohuar se do të merrnin pjesë në ndonjë aktivitet vullnetar në të ardhmen, tregojnë një panoramë konkrete të tendencës së zbehjes së vullnetarizmit, që vjen si rezultat i mungesës së aktiviteteve vetëdijësuese në media. Sociologu Dervishi vë në pah se duhet të punohet në zbehjen e kësaj mendësie karshi vullnetarizmit, sepse pa kapërcimin e tyre nuk mund të gjallërohet shpirti i vullnetarizmit (Dervishi, Z., 2011: 67).

3 A do të pranonit që prapë të merrni pjesë në ndonjë aktivitetet vullnetar?




Në përgjithësi shumica e të anketuarve femra dhe meshkuj konsideronin se vullnetarizmi nuk sjell të mira për zhvillimin e shoqërisë. Krahasuar me meshkujt, ishte më i lartë numri i femrave që theksonin se vullnetarizmi nuk sjell të mira dhe nuk është i dobishëm për shoqëri (grafiku 4). Edhe sociologu Zyhdi Dervishi, në këtë kontekst argumenton se është rreth 3% më e lartë pesha specifike e meshkujve të anketuar të cilët çmojnë më shumë ndikimin e veprimtarisë vullnetare për funksionim normal të shoqërisë (Dervishi, Z., 2011:69). Natyrshëm shtrohet pyetja, si mund të çmojnë meshkujt më shumë se femrat aktivitetet vullnetare? Dhe, sigurisht që përgjigja gjindet te ndarja e punëve të shtëpisë, sepse duke qenë femrat ato që merren shumë më shumë me punët e shtëpisë krahasuar me meshkujt, kjo gjë ndikon që femrat në përgjithësi të mos kenë kohë të lirë që të mendojnë dhe të merren me punë vullnetare, ngase që shumica e punëve që femrat bëjnë janë pothuajse vullnetare dhe se janë pa asnjë kompensim financiar.

Sot, problemet sociale kanë ngjyrimë të shumta, sepse ato shfaqen në forma dhe shkallë të ndryshme. Dhe, si pjesë e shërimit të këtyre problemeve të shumta sociale, vullnetarizmi do të kontribuonte në zbutjen e këtyre problemeve. Apo siç thekson edhe sociologu Zyhdi Dervishi


shoqëria shqiptare ndodhet para një situatë paradoksale: ka shumë të moshuar të vetmuar, të cilët kanë nevojë për shërbime të ndryshme që mund t'i kreyjnë vullnetarët (Dervishi, Z., 2011).

4. A mendoni se vullnetarizmi sjell të mira për zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi?



Në pyetjen drejtuar të anketuarve në raport me dijeninë për ekzistimin e ligjit mbi vullnetarizmin në Kosovë, shumica dërmuese e të anketuarve deklaruan se nuk ishin në dijeni për ligjin që është në fuqi (72% të femrave dhe 67% e meshkujve), (grafiku 5). Ligji mbi vullnetarizmin nuk përmendet asnjë herë në media, dhe normalisht që qytetarët nuk janë të informuar drejtë. Në këtë pikëpamje, përmes informimit të drejtë që do t'a kenin qytetarët, do të kishte edhe një mendësi tjetër karshi vullnetarizmit.

5. A jeni në dijeni për ligjin mbi vullnetarizmin në Kosovë?



Përfundime

Rezultatet tregojnë se mungon një kulturë në kuptimin e perceptimit të drejtë karshi aktivitetit vullnetar të një pjesë e qytetarëve të Kosovës. Ky perceptim vjen si pasojë e mungesës së fushatave vetëdijësuese në media nga ana e institucioneve të Kosovës. Sa më shumë të kishte fushata vetëdijësuese, puna vullnetare nuk do të shihej si punë për pastrimin e lagjes dhe për çështje bamirësie, por do të shihej si aktivitet qytetarë që i shërben të mirës së përgjithshme si ind i domosdoshëm për funksionimin e shoqërisë, për përparimin e shumëanshëm të saj siç ka argumentuar sociologu Zyhdi Dervishi.

Mungesa e një ligji më gjithëpërfshirës në Kosovë mund të ketë ndikuar që të qytetarët të ketë rënie të tenencës së vullnetarizmit në të ardhmen. Kjo paraqet pengesë të madhe në zhvillimin e vullnetarizmit. Do të duhej që Kosova të ketë ligjin që do t'i përfshinte të gjithë qytetarët në moshë për veprimtari të ndryshme.

Nga të dhënat shihet se meshkujt më shumë kishin marrë pjesë në aktivitete vullnetare. Do të duhej që insitucionet dhe shoqëria civile të inkurajonë më shumë vajzat dhe gratë që të angazhohen në aktivitete vullnetare. Se aktivitetet vullnetare kontribuojnë në përparimin e gruas dhe integrimin e saj në jetën shoqërore, dëshmojnë edhe argumentet e

sociologut Zyhdi Dervishi, i cili nënvizon se aktivitetet vullentare gjatë regjimit socialist ndikuan në emancipimin dhe integrimin e vajzave dhe grave në jetën shoqërore (Dervishi, 2011).

Literatura kryesore

Centre, E. I. (2011). *Vullnetarizmi në Kosovë*. Prishtinë: EU Information and Cultural Centre. Gjetur në https://www.kcsfoundation.org/wpcontent/uploads/2017/12/111110_Vullnetarizmi_ne_Kosove_EUICC_Buletini.pdf

Civile, I. K. (2016). *Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)*. Prishtinë: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Dervishi, Zyhdi: *Vullnetarizmi ind shumëfunksional i shoqërisë*, Shtëpia Botuese "Emal", Tiranë 2011.

Institute, D. G. (2018). *The Challenge of Translating Youth's High Interest in Doing Good into Civic Engagement*. University of Maryland. Gjetur në http://publicpolicy.umd.edu/sites/default/files/Good%20Intentions%2C%20Gap%20in%20Action_Do%20Good%20Institute%20Research%20Brief.pdf

ndryshe, O. j.-q.–E. (2009). *Vullnetarizmi dhe trashëgimnia kulturore*. Prizren: Ec ma ndryshe.

TRADITA E MIRËBËRËSISË KORÇARE DHE REFLEKSIONE MBI VULLNETARIZMIN NË STUDIMET E SOCIOLOGUT ZYHDI DERVISHI

Msc Jorida TOLLKUÇI

Drejtoreshë e Bibliotekës Publike “Thimi Mitko” Korçë

Në punimin monografik “Vullnetarizmi ind shumëfunksional i shoqërisë” i botuar për herë të parë në gjuhën shqipe në vitin 2014, sociologu Zyhdi Dervishi e ka përcaktuar vullnetarizmin: “Vullnetare mund të konsiderohet çdo veprimtari ose pjesë e veprimtarisë së kryer nga një individ ose grupim social, e cila i shërben zgjidhjes së problemeve të ndryshme , veçanërisht atyre jetike, shumë të rëndësishme të shoqërisë, por që nuk është shpërblyer financiarisht për vlerën përkatëse.” (Dervishi, Z., 2004:25)

Fenomeni i njohur i mirëbërësisë, posaçërisht në fushë të arsimit është dukuri edhe në Shqipëri qysh në kohë të hershme. Nga sa dëshmojnë të dhënat e ndryshme historike, Korça me mërgimtarët e saj dhe banorët e tjerë të cilët nuk u shpërngulën nga trojet e të parëve zë vendin kryesor e të dukshëm në Shqipëri për mirëbërësi. Sipas dokumenteve të zbuluar deri më tani, mirëbërësia nis me Iljaz Bej Mirahorin, i cili në vitin 1496 ndërtoi një xhami të madhe komplekse, një imaret (institucion mirëbërësie), me të gjitha lokalet dhe ambientet e nevojshme për të ndihmuar në raste të caktuara skamësit e ndryshëm, të cilët banonin aty përreth. Pastaj me rradhë Joasaf Korçari , Llaso e Korçës (arkë popullore ku depozitoheshin të holla dhe regjistroheshin pasuri të patundshme e duke vijuar me mërgimtarët korçarë: si milioneri Anastas Lakçe, Grigor Sotir Mborja, Jovan Banka, Thimi Prandi Kapedani, Tërpollarët Kristaq Duro, Gaqo Avramidhi, Dhimitër Cilka që i përkasin shek të XIX . Gjatë shek XX ka një rradhë tjetër të madhe mirëbërësish e shoqata

mirëbërëse në mërgim dhe në atdhe që kanë kontribuar sidomos për arsimim dhe shkollën shqipe. Një ndër figurat më të rëndësishme të mirëbërësisë korçare është:

Anastas Avramidh Lakçe (1821-1894)

Anastas Lakçe u lind në qytetin e Korçës dhe herët u vendos në Rumani, ku me aftësitë e tij të veçanta arriti të pasurohet me anën e punës në tregëti.

E para vepër mirëbërësie e tij në fushë të arsimit është ngritja e një shkolle fillore në Korçë 1867. Kurse në testamentin e tij të parë të 18 majit 1881, ai linte një pjesë të pasurisë së vet për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës në Shqipëri.¹ Në mbledhjen e parë për krijimin e “Degës së Stambollit për vivlla shqipe”, në Bukuresht, u grumbulluan edhe 1700 franga për botimin e librave në gjuhën shqipe, si dhe në aktivitete të tjera të degës ku kontributi më i madh financiar ishte i vetë Lakçes.² Në dhjetor 1884, u themelua shopëria e shkronjave shqip “Drita”, ku Lakçe dhuroi 100 franga për të blerë një shtypshkronjë për të shtypur libra shqip. Kështu filluan të botohen librat shqipe bukureshtiane të Sami e Naim Frashërit, Jani Vretos e të tjerëve, botimi i të cilave hyn në fondin e artë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.³ Prandaj nuk është e rastit që Naim Frashëri ia kushtoi Anastas Lakçes veprën e tij Bagëti e bujqësia. Hovi që mori levizja kulturore shqiptare pas krijimit të “Dritës” në Bukuresht në botimin e disa librave shkollore shqipe çuan në përpjekjet e suksesshme për çeljen e Mësonjëtores Shqipe të Korçës. Në vitet e fundit të jetës Lakçe viziton Korçën për t’u çmallur dhe për t’u ndërgjegjësuar edhe më mirë për çështjen e mëmëdheut nën pushtimin disa shekullor. Pasi u kthye në Bukuresht një vit para se të mbyllte sytë më 16.10.1893 bën testamentin e fundit .Nder të tjera të një pjesë e të ardhurave do të shkonin për krijimin e Institutit të

¹ Testamenti I fundit I Anastas Lakshe, vep Dhori Kotti, Korçë1928.

² Historia e letërsisë shqipe, II Tiranë 1960

³ Cit Nikollaq Zoi, vepra.

Femrave dhe hapjen e farmacisë duke dhuruar barna për të sëmurët e vobegjë pa dallime fetare.⁴ Pasi vdiq trupi i ballsamosur i Lakçes, u soll në Korçë, ku populli i bëri një pritje madhështore nderimi. Trupi i tij u vendos në një varr monumental, pranë kishës së Shën Gjergjit të cilën e kishte ndërtuar vetë.

Jovan Mihal Banka (1875-1905)

I pari mirëbërës i cili vjen nga diaspora shqiptare e Egjiptit është Jovan Banka. Mërgimtarët shqiptarë jetonin të afruar e të lidhur me njëri-tjetrin, duke ruajtur zakonet dhe traditat e dheut mëmë. Në këtë shtrat të ngrohtë emocional, u aktivizuan dhe bene pune të rëndësishme për zgjimin kombëtar disa nga emrat e shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare si: Thimi Mitko, Spiro Dine, Jani Vruho, Filip Shiroka, Milo Duçi, Loni Logori, Andon Zako Çajupi etj. Në vitin 1878 Banka dërgoi në Korçë shpenzimet e nevojshme për ndërtimin e ujësjellësit. Në rrezë të bregores së Shën Thanasit u ndërtuan ato që më vonë morrën emrin “Çezmat e Bankës”. Rreth vitit 1886, Jovan Banka u vendos përfundimisht në Greqi ku ndertoi dy hotele të mëdhenj. Në të njëjtën kohë në vitin 1888 Banka ngriti një Korçë një gjimnaz, i cili u quajt ‘Liceu i Bankës’ dhe mbajtjen e gjimnazit ‘Bangjion’ të Korçës.⁵ Sipas testamentit, gjithë pasuria e tij e patundur dhe në monedhë lihej për shkolla dhe mirëbërësi të tjera në Korçë, si (mbajtja e pesë shtertërve në spitalin Vangjelizmos, në Athinë, me porosi që të preferoheshin të sëmurë korçarë, si edhe marrjen e dy vajzave jetime çdo vit në jetimoren ‘Amalion’, ato do të martoheshin secila me prikë prej 2000 franga ari).⁶ Por sot nuk dihet ku është varri i tij dhe se kush e trashëgoi kapitalin e tij të depozituar me testament së bashku me interesin bankar.

⁴ Testamenti I fundit , vep. Një faqe historie, nikollaq Zoi. Cit.

⁵ Gazeta e Korçës 17.04.1936. Nr 2495.

⁶ Korça dhe katundet e qarkut 1901

Një figurë tjetër e njohur e mirëbërësisë korçare është edhe Diamanti Terpo 1844-1894

Emri i Mandi Tërpos u bë i njohur bujshëm në Korçë në vitin 1887, atëherë kur ishte në prag të çeljes Mësonjëtorja e Korçës dhe kur ‘eforët’ e shkollës shqipe u ndodhën ngushtë, sepse nuk po gjendej një shtëpi me qira për ta përdorur për institucionin e rëndësishëm, i cili pritej të hapej “nga shkaku se grama shqipe nëmërohëj si gjuhë e mallkuar”.⁷ Mandi Tërpo nuk mënoi të telegrafonte nga Bukureshti në Korçë me fjalët, të cilat mbetën historike në analet e shkollës shqipe ‘Zbrazni shtëpinë time, e cila do të mbetet e hapur për gjithë jetën Ky akt nuk ishte dhe nuk mund të ishte një veprim i zakonshëm i dhurimit të një shtëpie. Më shumë sesa vlera materiale, ai kishte vlerën e madhe morale, një akt i madhërishëm në shërbim të kulturës, të kultivimit të diturisë në gjuhën amtare. Mbas rreth pesë shekujsh robërie, Mësonjëtorja e Korçës ishte e para shkollë kombëtare laike shqiptare, që do të përhapte dritën e diturisë në gjuhën amtare.

Dy vjet para se të ndahej nga jeta, në moshën 48- vjeçare, më 16 shkurt 1892, Mandi bëri testamentin, me anën e të cilit linte pjesën më të madhe të pasurisë së tij, duke proklamuar: “për gjuhën time shqipe, që në këtë mënyrë të ruhenë interesat për të mirën e gjuhës që kam dëshëruar.

Një figure tjetër e rëndësishme e mirëbërësisë korçare që i përket shek XX është dhe Thoma Kostandin Turtulli (1865-1937)

Thoma Turtulli u lind në qytetin e Korçës në vitin 1865. Qysh në vitin 1885 firma tregtare ‘Vllazëria Turtulli’, u bë magazinë e madhe universale me shumë dyqane.

Thoma Turtulli ka meritë të veçantë për ngritjen e kinemave të para në qytetin e Korçës, pra për një kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin kulturor të qytetarëve korçarë. Në vitin 1921 Thoma Turtulli së bashku me sipërmarrës të

⁷ AQSH,F.25-Vjetori i pavarësisw

tjerë themeloi “Shoqërinë Anonime Shqiptare Cinematro”. Me 25 dhjetor 1927, Cinematro çeli në Korçë kinemanë e njohur Majestik. Sipas traditës kulturore Korça me interlandin e saj ka trashëguar pasuri me libra, të përqëndruara në institucione fetare, arsimore dhe familje të caktuara. Sipas të dhënave të tërthorta Korça ka pasur bibliotekë publike para vitit 1921⁸ Për një institucion të mirëfilltë bibliotekar për Korçën kishte menduar intelektual i njohur atdhetar Nikolla Lako. Ai që dëgjoi zërin e popullit të Korçës ishte Thoma Turtulli i cili vuri në dispozicion të ndërtesës 200 napolona. Ende pa u mbaruar ndërtesa Nikolla Lako dhuroi gjithë koleksionin e bibliotekës personale në kujtim të prindërve të tij. Në gusht të vitit 1930 u nënshkrua akti publik i dhurimit të bibliotekës. Një vit pas përrurimit të bibliotekës, Turtujt hodhën një hap tjetër mirëbërësie, në fushë të ndihmës shoqërore për fëmijët e paprind. Kësaj kërkese iu përgjigj Erasti Turtulli, e veja e Grigor Turtullit.⁹ Ndërtesa u ngrit Brenda një viti dhe me kohë u grumbulluan jetimë nga Korça, Berati, Shkodra, Kosova, Vlora etj . Në vitin 1932 Thoma Turtulli bëri një hap të rëndësishëm përpara duke e ngritur në një shkallë më të lartë humanizmin e tij, për të ngritur një spital në Korçë. Gazeta Besa e dha menjëherë lajmin e mire për Korçën dhe për mbarë vendin. Më 11 korik 1934 u bë përrurimi i spitalit.¹⁰ Por, spitalit i mungonte diçka. Korça me klimen e ftohtë kishte nevojë për ngrohje në stinën e dimrit. Këtë e plotësoi e shoqja e mirëbërësit Athina, e cila i dhuroi Kryqit të kuq një kalorifer.¹¹ Ai kalorifer ishte i pari në Korçë që punonte me qymyrguri.

Në vitet 1934-1935 Turtulli do ta ngrinte në një shkallë më të lartë veprën e mirëbërësisë në udhën e evolucionare të

⁸ Gazeta e Korçës 1926.23.3.1926. Nr. 269.

⁹ Gazeta Demokratia, Gjirokastër 5.7.1930, Nr.257.

¹⁰ Gazeta Besa 14.07.1934 Tiranë, Nr. 900.

¹¹ Gazeta e Korçës 20.7.1934, Nr 2008

zhvillimit të Korçës dhe mbarë vendit. Është fjala për ndërtesën e madhe të bukur e solide të Liceut Kobëtar të Korçës, të Shkollës Industriale dhe të përfundimit të Katedrales. Punët për ndërtesën e Liceut po ecnin me rritim të përshpejtuar në verën e vitit 1937, por për fat të keq, Thoma Turtulli, në gusht ra në shtrat nga bronkopneumonia për të mos u ngritur më. Pas katër muaj lëngatë të rëndë, mirëbërësi i madh mbylli sytë përjetë, më 28 gusht 1937. Përveç Liceut të cilin nuk arriti ta gëzojë, i mbeti edhe një peng tjetër. Ai donte të ngrinte në Korçë nje shtëpi për pleq.¹² Ndikimin e traditës së mirëbërësisë Korçare e shohim si vazhdimësi të vullnetarizmit i cili është thelbësor në procesin e zhvillimit dhe në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit në shoqërinë shqiptare. Vullnetarizmi është një dukuri sociale ndërvepruese që përfshin të gjitha grupet e shoqërisë dhe të gjitha aspektet e veprimtarive njerëzore, veçanërisht në fushat e promovimit të barazisë gjinore, fuqizimin e rolit të gruas, zbutjen e varfërisë, luftën kundër virusit HIV/aids dhe në grumbullimin e armëve. Publikimi i trajtesës sociologjike ‘Vullnetarizmi ind shumëfunktional i shoqërisë’ i Prof.Dr Zyhdi Dervishi, protagonist i dhe modeli i një studiuesi të suksesshëm dëshmon vlerat e vullnetarizmit në luftën kundër varfërisë në Shqipëri. Profili sociologjik i këtij punimi monografik i pari në literaturën shoqërore shqiptare, është bazuar në të dhënat e shumta të një anketimi të gjerë, kompleks të realizuar në të gjitha zonat e Shqipërisë që synon të nxjerrë në pah gjithë problematikën sociale, ekonomike e psikokulturore të vullnetarizmit në shoqërinë shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore dhe të përvijojë prirjet kryesore të zhvillimit të veprimtarisë vullnetare në të ardhmen e afërt. Duke iu referuar trajtesës sociologjike në fjalë vemë re se si rrjedhojë e abuzimit me vullnetarizmin gjatë periudhës së regjimit totalitar socialist dhe e infektimit të mjaft shqiptarëve nga epidemia e pasurimit të shpejtë,

¹² Gazeta e Korçës 18.11.1937, Nr.2870.

duke dhunuar normat elementare morale e ligjore, gjarë dhjetëvjeçarit të fundit, shpirti i vullnetarizmit në shoqërinë shqiptare është atrofizuar në një masë të konsiderueshme.

Vullnetarizmi 'ind' i rëndësishëm në të gjithë strukturat funksionuese të shoqërisë, si një gjenerator i zhvillimit të shumanshëm e të përshpejtuar të shoqërisë njerëzore. NËNA figura më e qëndrore në panteonin e vullnetarëve, konsideruar nga çdo pikpamje si krijesa që përgjithësisht investojnë më shumë punë vullnetare për funksionimin normal e zhvillimin e shoqërisë. Pa investimet e nënave vështirë se do të formatoheshin personalitetet e gjenive, të cilët kanë përparuar me ritme të shpejta mendimin krijues në fushën e shkencave, të kulturës e filozofisë. Nga të dhënat e anketimit që identifikojnë veprimtarinë vullnetare me bamirësinë është në përpjestim të zhdrejtë me nivelin arsimor, (përgjithësisht sa më të arsimuar të ndjehen shqiptarët, aq më të pavarur ndihen për të zgjidhur me forcat e tyre problemet vetjake). Sipas të dhënave të studimit në shoqërinë shqiptare rilevohet qartë edhe një grupim tjetër social me mendësi e qëndrime e prirje kundërvullnetariste, përgjithësisht janë njerëz me formim arsimor e profesional josolid, me shpirt nisme fare të vakët. Më shumë se gjysma e të anketuarve e konsiderojnë vullnetarizmin si shprehje dhe faktor të humanizmit të shoqërisë, duke qenë kështu më pranë vullnetarizmit në mendësi se në praktikë.

Në mbarim të Luftës së Dytë Botërore Republika e Shqipërisë ishte një nga vendet më të prapambetur e më të shkatërruar të Europës. Në këtë kohë para popullit shqiptar shtrohej si domosdoshmëri jetike jo vetëm rindertimi sa më i shpejtë i vendit, por edhe fillimi i veprimeve të vrullshme në të gjitha fushat e veprimtarisë ekonomike e shoqërore, arsimore e kulturore. Në rrethana të tilla përparimet në shumë sektorë mund të zhvilloheshin duke nxitur shpirtin vullnetar në masat e gjera popullore, duke rritur ndjeshëm llojshmërinë e veprimtarisë vullnetare edhe si rrjedhojë e aktivizimit të atij profili në modelin psikokulturor që

karakterizohet me shumëfishimin e humanizmit dhe altruizmit përtej të zakonshmes në përpjekje për të ndihmuar të tjerët në situata të jashtëzakonshme. Aksionet për rindërtimin e vendit dhe për ndërtimin e veprave të mëdha industriale e të komunitetit konsideroheshin si realizim në jetë i idealeve të luftëtarëve të lirisë, si agjenci e shumanshme komunikimi, kapërcim i barrierave ndërmjet nëkulturve, si mekanizëm integrimi e emancipues i vajzave, por edhe si fashitje e konflikteve ndërnacionale, përcaktuan ndryshime të dukshme, të shpejta e rrënjësore të mënyrës së jetesës e të të menduarit të mijëra e mijëra aksionistëve, një zhvendosje nga mënyra fshatare drejt mënyrës urbane të jetesës.

Përvoja na tregon se rastet e fatkeqësive natyrore rigjallërojnë shpirtin e vullnetarizmit deri në sakrifikim për të përballuar emergjencat. Pasi kalon kjo fazë, përgjithësisht e shkurtër, shpirti i vullnetarizmit tek shumica e shqiptarëve fashitet në prozaizmin e rindërtimeve.

Sipas të dhënave të trajtesës që na parashtron Prof. Zyhdriu, proceset demokratizuese të shoqërisë shqiptare janë përshkuar nga elementë anarkikë duke shtuar numrin dhe peshën specifike të fëmijëve e të rinjve të infektuar nga sëmundjet sociale të rrugës me problematikë braktisjen e shkollës dhe ‘punësimi’ si lipsarë apo si shitës ambulantë. Kryerja e veprimtarive vullnetare që synojnë zhvillimin e aftësive intelektuale, artistike, sportive, kryejnë edhe funksione profilaktike e shëruese për epidemitë sociale që i kërcënojnë ata. Përgjithësisht femrat janë më të prirura të angazhohen në veprimtari vullnetare dhe profesionale që ofrojnë shërbime me profile humane më të spikatura.

Kalimet në Republikën e Shqipërisë nga sistemi totalitar një partiak në demokracië shumëpartiake, nga ekonomi e centralizuar në ekonominë e tregut të lirë, emigrimi në trajtë eksodi dhe migrimet masive u shoqëruan me vështirësi dhe sfida të shumëllojshme. Kësisoj të moshuarit formojnë një grupim social të marginalizuar ekonomikisht, shoqërisht e

psikologjikisht, por sipas të dhënave të anketës në shoqërinë shqiptare është ende mjaft ndikuese prirja tradicionale për të respektuar dhe ndihmuar të moshuarit. Shoqëria shqiptare po sensibilizohet gjithnjë e më shumë për t'u angazhuar si vullnetarë që të ndihmojnë njerëzit nevojtarë me forma të ndryshme propagande e me projekte konkrete duke u përpjekur t'u gjenden pranë njerëzve në nevojë. Përsa i përket vullnetarizmit në linjat e komunikimit ndërmjet shqiptareve nga shqyrtimi analitik i të dhënave të anketimit përvijohet përfundimi se edhe për problematikën e vullnetarizmit, shumica e shqiptarëve parapëlqejnë format tradicionale të komunikimit, bisedat me të afermit dhe miqtë, kurse drejtuesit e stukturave ekonomike dhe politike janë me pak të besueshem. Ndërkohë që televizioni është sfidues i të gjitha njetëve të komunikimit masiv, sepse për punë vullnetare është më mirë të flasim me shembuj konkretë që t'i sjell ekrani i televizorit dhe fjala e pacensuruar e njerëzve në sheshin e punës për të kultivuar shpirtin e vullnetarizmit. E ardhmja e vullnetarizmit në trajtesën sociologjike të profesor Zyhdi Dervishit shikohet si profil i qëndrueshëm në modelimin psikokulturor të shqiptarëve, sepse shumë fakte të qëmtuara përmes vëzhgimeve, si dhe të dhënat e anketimit ofrojnë përfundime që kundërshtojnë mendësitë se është tharë nervi i humanizmit dhe vullnetarizmit. Përvoja tregon se aktualisht në vendin tonë njerëzit e varfër janë më të prirur të ofrojnë punë vullnetare të thjeshta, ndërkohë më të pasurit po prirën t'i shlyejnë detyrimet ndaj komunitetit për punë vullnetare duke ofruar para. Studimet komplekse ndërdisiplinore kanë provuar se shqiptarët janë të ashper në luftën e konkurrencës, por kur konkurrentët ndodhen në vështirësi shfaqin profilin altruist të vetëdijes së tyre. Këtë formim psikokulturor të shqiptarëve e ka shprehur poeti anglez Xhorxh Bajroni me vargun “Ç’kundërshtarë për vdekje, por sa miq besnikë”

Si përfundim sipas monografisë së punuar nga sociologu Zyhdi Dervishi me titull “Vullnetarizmi, ind shumëfunktional i shoqërisë”, në lidhje me shpirtin altruist në modelimin psikokulturor të shqiptareve na tregon se në të ardhmen, sa më shumë do të rritet vëllimi dhe llojshmëria e veprimtarisë vullnetare, aq më shpejt do të zhvillohet dhe aq më shumë do të humanizohet shoqëria shqiptare duke investuar në fushën e vullnetarizmit.

Literatura kryesore

Dervishi, Zyhdi: Vullnetarizmi, ind shumëfunktional i shoqërisë, Shtëpia Botuese “albPAPER”, Tiranë 2004.

Gogaj, Iljaz: Mirëbërësit Shqiptarë të arsimit, Shtëpia Botuese “albin”, Tiranë 2003

INTEGRIMI SHOQËROR I EMIGRANTËVE SHQIPTAR
NË TERRITORE TË NDRYSHME SHOQËRORE
(KRAHASIM, RASTI I ITALISË DHE I TURQISË EDHE
NËPËRMJET STUDIMEVE TË SOCIOLOGUT ZYHDI
DERVISHI)

Msc. Eneida Binaj

Universiteti “Aleksandër Moisiu”,

Departamenti i Edukimit, Durrës

Agjencia Kombëtare e Diasporës

Abstrakt

Ky artikull trajton faktorët që çuan shqiptarët të emigronin në periudha të ndryshme historike si dhe sfidat që ata hasin për gjatë përpjekjeve për t’u integruar në shoqërinë pritëse. Të identifikojë përmasat e integrimit në shoqërinë Italiane dhe Turke, të bëjë një lloj krahasimi midis dy vendeve të ndryshme pritëse. Artikulli do të marrë në shqyrtim rastin e emigraenteve në territore të ndryshme sociale, emigrantët në Itali dhe Turqi. Artikulli ka si qëllim të eksplorojë faktorët që kanë çuar këtë pjesë të shoqërisë shqiptare të emigrojnë në shtetin turk dhe italian, çfarë ndikimi kanë karakteristikat e lokalitetit në integrimin social të emigrantëve. Metodot e përdorura në këtë studim janë analiza e të dhënave dytësore. Një nga gjetjet më të rëndësishme të studimit është integrimi social, i cili është i ndryshëm në territore të ndryshme sociale, si dhe faktorët dhe shkaqet pse kanë emigruar janë të ndryshme. Emigracioni është një fenomen që karakterizohet nga faktorët nxitës dhe shtytës, duke ndikuar kështu në dinamikën e popullsisë, zhvillimit rajonal, ekonomik, social dhe kulturor të saj. Një ndër elementët

ndikues është integrimi social, përshtatshëmëria e emigrantëve në elementet e kulturës të vendeve pritëse, të tilla si: norma, vlera, tradita, mënyra e jetës për të qenë pjesë e shoqërisë, ku ata kanë emigruar (rasti i emigrantëve shqiptarë në Itali dhe Turqi).

Në këtë kuadër vlerësohet si aspekt i rëndësishëm dhe kapitali social, përmes së cilit mundësohet matja e përshtatjes dhe asimilimit të emigrantëve në vendin pritës. Ai përfshin tiparet sociokulturore, historike, rrjetet emigratore për vazhdimësinë e kulturës shqiptare si dhe lidhjen e emigrantëve me kulturën e vendit pritës.

Si përfundim, rëndësia e këtij artikulli qëndron tek disa aspekte sociologjike të emigracionit. Procesi i integritit social dhe kapitali social, përshtatur kjo me rastin e shqiptarëve në territore të ndryshme sociale, atij të shtetit italian dhe turk.

Koncepte kryesore: *Emigrim, integrimi social, kapital social, territor social, vlera kulturore*

Hyrje

Lëvizja është një pjesë e pandarë e natyrës njerëzore. Por nga ana tjetër emigracioni nuk është një dukuri e re e shoqërisë njerëzore. Emigracioni është një fenomen shumëdimensional. Lëvizja e njerëzve kanë ndikim të rëndësishëm si në zhvillimin ekonomik dhe në ndryshimet sociale në nivel lokal apo në nivel global. Njeriu largohet nga streha e tij përshkak të një gjendje lufte, skamje, fatkeqësie natyrore etj. Ky artikull ka në fokus integrimin social të shqiptarëve në territore të ndryshme sociale. Në studimet sociologjike është e rëndësishme analizimi i perjudhës së zhvillimit dhe vazhdimësisë së këtij fenomeni.

Prezantim

Emigrimi është një dukuri me rrjedhoja të shumanshme, zhvilluese, frenuese e shpesh kontradiktore në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, ekonomike, politike e psikokulturore në rrafsh botëror, veçanërisht në vendet që janë më të ekspozuara ndaj “flukseve” më intensive të “eksportimit” dhe të pritjes së emigrantëve (Dervishi, Z., 2003:1-2). Motoda e përdorur në këtë artikull është analiza e të dhënave dytësore. Artikulli nxjerr në pah qasjen e krahasimit nëpërmjet feomenit të emigrimit në territore të ndryshme sociale, atë italian dhe turk. Gjithashtu procesi i integritit përbën një dukuri komplekse dhe shumëpërmasore që kërkon vëmendje studimore të veçantë edhe për një arsye tjetër. Mjaft studiues mbrojnë idenë se integrimi është gjithmonë një proces lokal, sepse njerëzit integrohen në territorin, shoqërinë dhe qytetin ku jetojnë dhe jo në një vend abstrakt (Berti, F.; Valzania, A., 2010:35). Duke iu referuar kontekstit italian studime dhe raporte të ndryshme kanë treguar se në këtë kontekst rajone dhe provinca të ndryshme paraqesin nivele të ndryshme të treguesve të integritit (CNEL, 2012:29-33, 98).

Gjatë studimit të fenomenit emigracionin në shtetin turk e ndajmë në dy perjudha të ndryshme historike: perjudha e parë është analizimi i fenomeni të emigracionit në perandorin Otomane dhe perjudha e dytë fenomeni i emigracionit pas vitit 1990. Ndërsa fenomenin e emigracionit në Itali do e analizojë pas viteve 1990. Kjo për të analizuar faktorët që çuan shqiptarët të emigronin në perjudha të ndryshme historike dhe pikërisht në territore të ndryshme sociale.

Çdo shoqëri që pranon emigrante dhe mundëson formimin e fenomenit të emigracionit, fillon të formuloj strategji politike për të ruajtur qëndrueshmërin e emigrantëve në vendin pritës. Për këtë arsye është formuar një kapital social i përbashkët që ka mundësuar përshtatjen e emigrantëve me mënyrën e jetesës së vendasëve. Kjo praktike mundëson

integrimin social të emigratëve shqiptarë, më lehtë në shoqërin turke. Turqia moderne formoi një politikë që në Turqi pranohen të gjithë emigrantët që kanë lidhje me kulturën turke. Emigrantët që regjistroheshin në bazë të indentitetit fetare (feja muslimane), u jepej pjestar i “kombit”. Për këtë arsye emigranet nga Ballkani, sidomos shqiptarët e disporës, njihen si grupe shoqerore të ardhur nga vende të tjera në shoqërin turke. Ky konceptim minimizon paragjykimet, ndihmon shqiptarët për tu përshtatur me normat, zakonet, vlerat e shoqërisë turke.

Procesi i integritimit nuk është proces statik, i qëndrueshem dhe përfundimtar. Është një proces me sfida dhe dinamika zhvillimi. Në kushtet e jetës së tyre emigrantet në Itali mbartin me vete problematikën e të dënuarit të “huaj”. I huaj nga pikpamja etnike, kulturore, shoqërore në krahasim me banorët e vendit pritës. Integrimi në provinca të ndryshme është i ndryshëm dhe paraqet nivele të ndryshme të integritimit social. Madje shumë emigrantë janë të pakënaqur nga jeta e tyre, të ardhurat janë të pamjaftueshme, kriza ekonomike ka prekur familjet e tyre. I’u referova një ideje mjaft interesante të sociologut Zyhdi Dervishi, në librin e tij “Vështrime të kryqëzuara në det” (Sociologji Kulture 1), në të cilin janë pasqyruar, përveç të tjerash, gjetjet e një studimi të realizuar pikërisht në provincën e Sienës në vitin 1996-1997. Ky studiuës argumenton se, në Siena, bashkëkomunikimet ndërmjet kulturës së emigrantëve shqiptarë dhe kulturës së vendasve janë më të drejtpërdrejta dhe më pak të përthyerë nëpër ndikimet kulturore të të tretëve, siç mund të ndodhë në rajone të tjera të Italisë, ku janë përqëndruar emigrantë të vendeve të tjera europiane, aziatike e afrikane (Devishi, Z., 2003:8).

Aganaglu është një ndër studiuesit kryesor të përcaktimit të termave të emigracionit si dhe studiues i situatës së emigrimit prej vendeve të ndryshme të Ballkanit, sidomos të Shqipërisë. Rënia e perandorisë Otomane dhe themellimi i

regjimit socialist në Shqipëri ka ndikuar në minimizimin e fenomenit të emigracionit të shqiptarëve. Me rënien e regjimit socialist pas vitit 1990 shqiptarët emigruan në vende të ndryshme, ku midis tyre ishte Turqia dhe Italia. Emigrimi i shqiptarëve drejt këtyre dy vendeve ka ndodhur për faktorët nxitës siç janë largimi prej kushteve politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të Shqipërisë.

Studimet empirike të sociologjisë analizojnë shkaqet e emigracionit ku disa prej më të zakonshmet janë “punësimi”, “arsye familjare”, “kushtet politike” etj. Pikërisht këto janë arsye sa individuale, aq edhe sociale. Hipoteza kryesore pse njerzit emigrojnë, janë caktuar “faktor nxitës dhe shtytës”.

Qasja “nxitëse – tërheqëse” e emigrimit, përfshin disa shkaqe, të cilat formojnë mendimin e vendimit për të emigruar, si dhe formojnë një balancë mekanike midis faktorëve të jashtëm dhe të atyre personale. (Taylor; 1969;99). Në literaturën e shkencave sociale rreth emigrimit, gjenden një sërë faktorësh pse emigrantët kanë emigruar në territore të ndryshme sociale. Sipas një **modeli të përvojës së Emigrimit (studim nga Oxford University)**. Faktorët e emigrimit janë faktorët ekonomik, politikë, social dhe kulturor. Në faktorët nxitës të emigrimit analizojmë : kushtet e vendit të orgjinës – ekonomik, politik, social; Statusi në vendin e origjinës; Eksperienacat në vendin e origjinës.

Kjo analizë mbetet e paplotësuar nëse nuk konsiderohet sfondi social i vendit të origjinës (Kuzents;1965:12) së emigratëve. Për të dy vendet (pritis dhe origjinës) është shumë e rëndësishme të analizohen faktorët e tjerë përveç atyre ekonomike si ato sociale dhe kulturore, të cilët nxisin dhe tërheqin emigratët (Beijer; 1969:49). Disa prej këtyre faktorëve janë mënyra e funksionit social, lidhjet shoqërore midis aktorëve socialë, vlerat dhe zakonet e shoqërisë, liria e besimit dhe riteve fetare etj.

Nëse i referohemi librit të përbashkët “Fshatari polak ne Europë dhe Amerikë” të Thomas (William I. Thomas) dhe Znaniecki (Florian Znaniecki) që ofron një kuadër metodologjik të plotë për studimet sociologjike për emigrimin. Ky moment ndryshimesh karakterizohet nga një rrethanë e vecantë, që lidhet me kalimin nga vendi i origjinës në vendim pritës. Në vendin e origjinës pavarësisht problemeve që i detyrojnë ta lenë, emigrantët kishin më shumë siguri dhe stabilitet. Në vendim pritës, pavarësisht mundësive më të mëdha për të realizuar projektin e tyre të jetës ndihen më shumë të vetmuar. Kjo rrethanë bëhet më e mprehtë dhe më ndikuese kur emigrantët lëvizin nga zonat rurale drejt qendrave urbane të vendeve të zhvilluara. Ky fenomen ngjan shumë dhe me emigrimin e shqiptarëve në Itali ose Turqi në fund të shekullit të kaluar dhe në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XXI.

Sjellja dhe proceset shoqërore janë produkt i ndërveprimit aktiv midis individëve dhe vlerave kulturore dhe sociale. Si e tillë në rastin e emigrantëve në Itali dhe Turqi ka tipare të ndryshme sociokulturore dhe të figurave të emigrantëve. Vlen të theksoi se në këto dy komunitete të emigrantëve shqiptarë zhvillohen edhe disa tipa të tjerë socialë. Si: idealistët politikë, mendjehëtët, intelektualët, etj. Secili prej tipave të mësipërm të emigrantëve pasqyron potencial integruës ndaj shoqërisë pritëse, por dhe reagim ndaj kësaj të fundit.

Përfundime

Përfundimet e këtij artikulli mbeten tek elementet e analizës teorike dhe opininet e marra nga emigrantët shqiptarë në Turqi dhe Itali. Si konkluzion të këtij artikulli mund të thuhet se shqiptarët që kanë emigruar pas vitit 1990 dhe në vazhdim, se janë integruar mjaftueshëm në strukturat sociokulturore të shoqërisë së vendit pritës. Emigrantët shqiptarë e kanë realizuar integrimin e tyre social jo duke u

asimiluar por duke krijuar një kombinim midis vlerave dhe kulturës së vendit pritës.

Analizimi i fenomenit të emigracionit duhet të realizohet me anën e “lentes sociologjike” (term i përdorur nga sociologu Zyhdi Dervishi). Me anën e kësaj lente ne mundësojmë analizimin e elementeve sociokulturor të fenomenit të emigracionit në prespektivën mikro. Njohjen e elementeve sociokulturor të shoqërisë së origjinës, mënyrën e jetës, të menduarit, vlerat e shoqërisë pritëse. Të gjitha këto elemente mendojmë se ndikojnë në shoqërizimin e emigrantëve në shoqërinë e vendit pritës.

Karakteristikat e lokalitetit ndikojnë në përshtatjen me vendin pritës të emigrantëve. Nëse i referohemi studimeve të realizuar deri tani emigrantët që shkoin në një vend pritës me lokalitet të vogël e kanë më të lehtë për tu përshtatur dhe të përfshihen në jetë sociale por kjo gjë ka dhe anën negative. Një vend i vogël nuk të ofron hapsirën për tu zhvilluar dhe për të ecur para.

Vihet re nga qasjet teorike se emigrantët pavarësisht vendit pritës, Turqi apo Itali, kanë ndryshime strukturore dhe funksionale të jetës së tyre sociale dhe familjare. Nga njëra anë vihen re ndikime të elementeve kulturore të vendit pritës që ndikon në ndryshimin funksional të individit apo familjes në nivel mexo. Por, nga ana tjetër, vihet re dhe një lloj konservatorizmi dhe ruajtjen me fanatizëm të kulturës, vlerave, besimeve fetare, traditave familjare të vendit të origjinës dhe në vendin pritës.

Përmasat e integritimit social të emigrantëve të vendet pritëse janë të lidhura ngusht dhe me faktorë të tjerë individual dhe social. Emigrantët kanë qëndrime të ndryshme në lidhje me integritimin social dhe institucional në vendin pritës. Disa prej tyre mendoj të jenë pjesë, duke marrë nënshpirtësinë e vendit pritës, disa të tjerë mendojnë për një periudhë të shkurtër kohore, për përfundimin e studimeve apo për të lëvizur drejtë

një vendit tjetër për të kërkuar një punë më të mirë etj. Një tregues tjetër i integritimit janë dhe të ardhurat në krahasimin me ato të banorëve të vendit pritës.

Një element tjetër i integritimit social janë dhe përmasat sociale të integritimit, sa të prirur janë emigrantët shqiptarë të kenë marrdhënie miqësore me shtetasit e vendeve pritëse. Përfshirja e tyre në organizata sociale me karakter shoqëror dhe ruajtja e kontakteve me vendin e origjinës.

Literatura kryesore

Aganoglu, H. Yldirim; *Osmali'dan Cumhuriyet'e Balkanlorin Makus Tahili: Göç*; Istanbul: Izyayincilik, 2012.

Berti, Fabio; Andrea Valzania: *Le nuove frontiere dell'integrazione. Gli immigrati stranieri in Toscana*, Franco Agneli, 2010.

CNEL: *Indici di integrazione degli immigrati in Italia. Attrattività e potenziale di integrazione dei territori italiani*, VIII Rapporto, 2012.

Dervishi, Zyhdi : *Vështrime të kryqëzuara në det. Sociologji kulturel*, Jerusalem, Tiranë 2003.

Taylor, Richard C.; *Migration and Motivation : Study of determinants and types* :in *Migration*; Edited by J.A Jackson , UK, Cambridge University Press, 1969.

Thomas, W.I.; Znaniecki, F. *The Polish Peasant in Europe and America*;Dover, 1958.

Umma. A. Segal; Elliot, Doreen; Nazneen, S. Mayadas: *Immigration worldwide, Policies, Practice and Trend* , Oxford University Press, 2010.

PARAGJYKIMET KRYESORE QË PENGOJNË PËRPARIMIN E VAJZAVE DHE GRAVE NË KARRIEREN POLITIKE E PROFESIONALE, NË SKANERIN E STUDIMEVE TË SOCIOLOGUT ZYHDI DERVISHI

Amarda Likaj

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Sociologjisë

Abstrakt

Ky punim u realizua me qëllim që të evidentojë paragjykimet kryesore që pengojnë përparimin e vajzave dhe grave, në karrieren politike e profesionale në shoqërinë shqipëtare. Ky punim ndjek një qasje hulumtuese kryesisht cilësor, që bazohet në shfrytëzimin e të dhënave që gjenden të gatshme në burime si literaturë shkencore, artikuj të ndryshëm.

Duke iu referuar librave "*Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe prespektivave*" si dhe "*Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik*", nga Prof. Dr. Zyhdi Dervishi do të identifikojmë disa nga paragjykimet që pengojnë ecurinë e përparimit të vajzave dhe grave në veprimtari të shkruara profesionale e shoqërore. Cilat janë ato menësi apo paragjykime që shoqërojnë vajzat e gratë për t'u përfshirë në të gjithë nivelet e veprimtarisë politike? Në të gjithë veprimtarinë e shumanshme rëndësi të veçantë që kanë përpjekjet sistematike për të sfumuar e kapërcyer, jo vetëm paragjykimet e shumëllojshme të burrave për to por dhe paragjykimet e ndersjëlta të vajzave dhe grave për njëra tjetrën.

Koncepte kryesore: *mendësi paragjykuese, stereotipe gjinore, politikë, pune, karriere profesionale.*

Hyrje

Paragjykimet për vajzat dhe gratë kanë ekzistuar në të gjitha shoqëritë dhe kanë shfaqur intesitet të ndryshëm në kohë dhe vende të ndryshme, pavarësisht nga stadi i zhvillimeve të shoqërive. Paragjykimet për vajzat dhe gratë kanë qënë lidhur me rolet sociale dhe pritshmeritë shoqërore për përmbushjen e tyre. Roli social i gruas është konsideruar ngushtësisht i lidhur me familjen, ekonominë shtëpiake dhe përkujdesin për fëmijët. Rolet sociale dhe stereotipet që i bashkojnë ato janë konstrukte shoqërore të ndërtuara shoqërisht përgjatë zhvillimit të kulturës. Ajo mësohet përmes procesit të shoqërizimit brenda institucioneve shoqërore si familja, shkolla, puna, feja dhe pushteti që ushtrohen përgjatë gjithë ciklit të jetës (Giddens, A, 1997:84-94). Pavarësisht se nuk ju janë dhënë role sociale në shumicën dërmuese të jetës publike, gratë në të gjitha shoqëritë janë përparësit të afirmuar përtej sferës private dhe të përmbushin dhe role të tjera të dobishme shoqërore me gjithë pengesat e vendosura kundrejt tyre prej paragjyqimeve. Pengesat për përparimin e vajzave dhe grave në karrierën politike dhe profesionale janë si pasojë e paragjyqimeve të shumta që rezultojnë në pabarazi të thella mes grave dhe burrave në shumë aspekte të jetës, dhe kryesisht në pasuri, status dhe ndikim shoqëror. Në shoqërinë shqiptare ndikimin e paragjyqimeve që pengojnë përparimin e vajzave dhe grave në karrierën politike dhe profesionale e ka studiuar me përparësi sociologu Zyhdi Dervishi ku shprehet se: “paragjykimet për gratë kanë tejngopur gjithë atmosferën e shoqërisë shqiptare si një masë xhelatinoze e padukshme, pengon angazhimin e vajzave dhe grave në jetën politike” (Dervishi, Z, 2011: 18). Këto studime pasqyrojnë realitetin Shqiptar të vajzave dhe grave ku prania dhe pasojat e paragjyqimeve në jetën e tyre kanë një frenim të angazhimeve në veprimtaritë shoqërore, ekonomike dhe politike. Në këtë punim do të evidentojmë se cilat janë këto mendësi apo paragjyqime që shoqërojnë vajzat e grate në karrierën politike dhe profesionale.

Mendësitë apo paragjykimet që shoqërojnë vajzat dhe gratë

Në librin “Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik”, do të shohim se cilat mendësi dhe paragjykime e shoqëruan votimin e vajzave dhe grave si hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm për tu përfshirë në të gjitha nivelet e veprimtarisë politike.

Në shoqërinë shqiptare përpjekja feministe nuk ka pasur shumë rezultate, kur vajzat dhe gratë fituan të drejtën e votimit ndodheshin në tryshninë e paragjykimeve të shumta ku mund të citojme: “Vota e një gruaje ka qëndruar brënda katër mureve të shtëpisë e nuk ka ç’i duhet askujt”, “grauja e shpërfillur në familjen e vet nuk ka perse të japë mend me votë për punët e të tjerëve” (Dervishi, Z, 2011: 152). Si një shoqëri patriarkale roli i vajzave dhe gruas ishte vetëm brenda shtëpise ku nuk ju dëgjoej fjala dhe shpërfilleshin nga familja, grauja nuk mund te preceptoet nga burrat që te kishte te drejten e votes sepse ishte e nënshtruar dhe nuk kishte status duke e izoluar gati plotësisht nga jeta politike.

Rritja e rolit të vajzave dhe grave në jetën shoqërore, ekonomike dhe kulturore, arsimore por ndikimi në strukturat politike vendimarse është shumë i zbehtë. Sociologu Zyhdi Dervishi shprehet se :“përgjithsisht edhe shumica e vajzave dhe grave që nuk dalin nga rrjedha e jetës së zakonshme ndjehen të frustruara, pasi ato përgjithsisht e konsiderojne veten plotësisht të afta të përparojnë në karriere, por rrethanat ekonomike, politike e shoqërore dhe mendësitë e shoqërisë jo vetën nuk i favorizojnë, por dhe i pengojnë” (Dervishi. Z, 2001: 95). Vajzat dhe gratë shqiptare e përjetojnë më me dramaticitet këtë ndjenjë frustrimi sepse përgjithsisht janë më të prirura drejt afrimit të personalitetit të tyre për të vepruar në shoqërinë politike. Por mendësitë që shoqërojnë vajzat e gratë nuk i kuptojnë dhe herë-herë e keqkuptojnë përkushtimin e tyre në veprimtaritë profesionale dhe politike. Duke ju përkushtuar veprimtarive në karrierën politike dhe profesionale, privojnë veten nga

kënaqesitë e jetës të përditshme, dhe disa modele të sjelljes te te menduarit e të vepruarit si antarët e tjerë të familjes. Duke u krijuar mendesi dhe paragjykime për këto vajza dhe gra të cilat për hir të karrierës lypsen të përshtatin dhe modele sjelljesh të ngjashme më ato të burrave profesioniste të suksesshëm. Në zhvillimet e shoqërisë shqiptare u rrit numri dhe pesha specifike e vajzave dhe grave në organet drejtuese politike dhe shoqërore, ku gjatë regjimit socialist kjo interpretohet si një përparsi e arritur nga rendi socialist, duke e bërë krahasimin me rendin kapitalist. Vajzat dhe gratë kishin të drejtën e përfaqësimit në organet drejtuese të sektorve të ndryshëm të veprimtarive shoqërore, ekonomike dhe kulturore. Duke mos pasur përvojën e përgatitjen profesionale te nevojshme, mosarritjet e gabimet në punë përfoconin paragjykimet përçmuese për aftësinë drejtuese dhe pergjithsisht intelektuale të femrave shqiptare. Në këtë mënyrë mendësitë përçmuese dhe paragjyquese dëmtonin rëndë imazhin e vajzave dhe grave nga opinjoni i shumicës në mjediset shoqërore te Shqipërisë.

Transformimit të shoqërisë shqiptare pas shpërbërjes së regjimit socialist, iu shtua një valë paragjykimesh kundrejt vajzave dhe grave. Sociologu Zyhdë Dervishi shprehet se: "në periudhën e regjimit paskomunist, paragjykimet u përhapën si një mjegull e dendur avuj acidesh dhe helmuan ndjenjat, mendimet dhe përjetimet e individeve, grupeve sociale, vecanërisht të vajzave dhe grave". (Dervishi, Z, 2001:48). Për të folur për paragjykime në hapsirat ne të cilat veprojnë ose ndikojne në të gjitha fushat e jetës, paragjykimet e vajzave dhe grave nga burrat janë të dukshme sepse dominon pjesmarrja me aktive e burrave duke paragjykuar se vajzat e gratë nuk janë shumë të afta për të qënë lidere. Sepse nuk janë shume të besueshme dhe jo fotë bindëse sidomos kur behet fjale për karrjerën e saj politike, por dhe profesionale. Vajzat dhe gratë janë parë gjithnjë si krijesë e dobët dhe inferiore, edhe ne kanunin shqiptar të Lek Dukagjinit roli i gruas ne shoqërinë shqiptare përcaktoet si

inferior. Politika është parë si arena ku duhet të dominojë burrat sepse në studimet e kryera, personaliteti i burrave është agresiv, dominues, i pavarur, kompetent, inteligjent dhe këmbëngulës. Sa i përket personalitetit të gruas shfaqet si jo dominante, e varur, pa kompetenca, jo inteligjente, pasive dhe e pavendosur. Duke parë këtë qasje shpesh vajzat dhe gratë priren të paragjykojnë në lidhje me përparimin e tyre në karrierën politike.(Gazeta” WordPress.com”,07,02,2013)

2. Pengesat kryesore për t’u përfshirë vajzat dhe gratë në jetën politike

Mendësitë përçmuese në marrdhëniet shoqërore të vajzave dhe grave me të tjerët do të evidentohen si disa nga pengesat kryesore për t’u përfshirë në jetën politike. Sociologu Zyhdi Dervishi në studimin e tij analizon paragjykimet më vepruese dhe më të përhapura në shumë mjedise ku punojnë vajzat e gratë. Rreth 33.69 për qind e vajzave dhe grave janë shprehur se i konsiderojnë paragjykimet si pengesë kryesore për t’u përfshirë në jetën politike. Paragjykimet përçmuese që iu drejtohen vajzave dhe grave nga burrat, nga njera-tjetra si dhe vetëparagjykimet për aftësinë e tyre në politikë. Kështu mjedisi për rreth vajzave dhe grave karakterizohet nga një mjegull e dendur paragjykimesh. Paragjykimet më të shumta lidhen me karakterin e të qenit grua ku cilesohen se vajzat dhe gratë nuk janë në gjëndje të drejtojnë dhe se nuk mundën që t’u dalin zot të tjerëve, ndërkohë që nuk i dalin zot vetes, si dhe vajzat nuk kanë menduri për të zgjidhur çështje politike. Vajzat e gratë i cilësojnë si të dobta emocionalisht dhe nuk mund të përballojnë peshën e rëndë të çështjeve politike, gjithashtu nga paaftësia e vajzave dhe grave për të zgjedhur në kohë problemet e rënda të politikës shqiptare vajzat e gratë bëhen arrogante, cinike madje dhe skizofrene. Gratë në vorbullën e politikës bëhen më të vrazhda se burrat. Etiketimi i vajzave dhe grave për angazhimin e tyre në politikë çon dhe në një pjesmarje më të pakët në politikë.

Vajzat shpesh herë gjenden nën trysinë e familjarëve që nuk dëshirojnë që të përfshihen në politikë për arsye të prioriteteve të tyre kryesore konsiderohet shkollimi por dhe mendësitë ose paragjykimet që do shpërfitojnë gjatë karrierës politike. Ndikimin e paragjykimëve përcëmuese për aftësinë e grave në vëndin tonë, sociologu Zyhdi Dervishi shprehet: "përvoja tregon se gratë, të mënjauara nga jeta shoqërore dhe politike në moshën e pjekurisë e kanë të vështirë, ose më saktë, të pa mundur të aktivizohen në jetën politike, sepse veç të tjerash, angazhimi në punët rraskapitëse në ekonominë shtëpijake i dekalifikon pothuajse të gjitha gratë në atë shkallë, sa që ato nuk mund të përditësohen në zhvillimet bashkëkohore edhe në fushën politike"(Dervishi, Z, 2001:107). Familja shqiptare si një familje që bazohet në rregulla e norma të përcaktuara të trashëguara e përcaktojnë rolin e gruas në familje. Paragjykimet përcëmuese më të përhapura : "nuk i lejojnë angazhimet familjare të meren me politikë, sidomos kur kanë fëmijë për të rritur", "femra është për burrin dhe fëmijët", "gratë mbyten në një pikë ujë, nuk janë në gjëndje të menazhojnë punët e familjes e jo më të menazhojnë punët e shtetit", "fisi jonë nuk e ka traditë punën politike të grave". Të gjitha këto paragjyime mbi zhvillimin e vajzave e grave në karrierën politike janë frenuese dhe ato ndihen të frustruara nga trysnia e paragjykimëve të shumëllojshme. Rrymat kryesore të paragjykimëve nga grupet shoqërore krijojnë dhe rrjedhojat kryesore problematike të tyre. Në këtë studim argumentohet se intesiteti i paragjykimëve nuk është i njëjtë në të gjitha mjediset e segmentet e shoqërisë shqiptare. Është më e lartë pesha specifike e vajzave dhe grave me banim në qytet që ndihen të paragjykuara nga burrat. Edhe pse dihet tradicionalisht dhe aktualisht banorët e fshatërave jetojnë në trysinë e një mjegulle më të dendur të paragjykimëve.

3. A vazhdojnë të paragjykoen vajzat për angazhimin e tyre në politikë

Vajzat dhe gratë janë në përpjekje të vazhdueshme për të sfumuar e kapërcyer jo vetëm paragjykimet e shumëllojshme të burrave për to, por dhe paragjykimet e ndërsjellta të njëra-tjetrës. Shoqëria shqiptare nuk ka një tregues të lartë të angazhimit të rinjve në politike, dhe sidomos të vajzave. Kur zhvillohen zgjedhjet lokale vihen re dukshëm angazhimi i tyre në forume politike, në rrethin shoqëror has vajza të cilat angazhohen në këto forume politike në parti të ndryshme. Për të parë një qasje indukrive për të kuptuar realitetin në aspektet e përvojës të vajzave të cilat janë të angazhuara në forume politike tre vajza shprehin mendësitë dhe paragjykimet që i kanë shoqëruar. Angazhimi në forumet politike për vajzat ka qenë problem për prindërit e tyre, sepse vajzat duke u angazhuar në politikë nuk do t'i përkushtoheshin shkollës dhe do të ndikonte në rezultatet e tyre. Paragjykimet me të shumta vajzat i kishin nga shoqet e tyre, duke i cilësuar se janë egoiste dhe shikojnë interesat e veta dhe duke u angazhuar me politikë do të kenë sukses dhe do të bejnë karrierë. Gjithashtu duke i parë këto vajza si objekte të ngacmimeve dhe përçmimeve që mund t'iu behen vajzave. Mendësi të tjera se vajzat nuk janë të afta të mëren me politikë, se terreni i politikës shqiptare është shumë i vështirë dhe vajzat kanë pengesa dhe nuk do ia dalin të merren me politikë. Se mosha e vajzave është që të martohen dhe ja të merren me politikë. Ka paragjykimet që lidhen me moralin e vajzave, se servilosen për të fituar një vend në parti duke mos patur moral për veten. Duke u marrë me politikë ato do të ndryshojnë dhe personalitetin e tyre. Se në një realitet ku dominojnë burrat, vajzat do perdoren dhe nuk do të arrijnë të sukses në politikë. Paragjykimet janë shprehje e preceptimit shoqëror që ndikon tek vajzat e gratë për aftësinë e tyre. Pasojat e paragjykimet janë të shumta angazhimi i vajzave dhe grave në politike frenon, shoqërisë shqiptare i duhet një ndryshim kulturor në mendësitëparagjykuese dhe qëndrimeve që mbajnë ndaj vajzave dhe grave. Monografite për këtë problematikë të shkruara nga sociologu Zyhd

Dervishi ruajnë vlerat aktuale dhe ndihmojnë për të tejkaluar paragjykimet përcmuese për vajzat dhe gratë, jo vetëm në jetën politike, por për shumëçka.

Literatura kryesore

Dervishi, Zyhdi: *Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe prespektiva*, (Botimi i tretë), Shtëpia Botuese “Emal”, Tiranë, 2001

Dervishi, Zyhdi: *Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik*, Shtëpia Botuese “Emal” Tiranë, 2011

Gazeta “Shqiptarja. com”, (26,09,2017)

Gazeta” WordPress. com”(07,02,2013)

Poni, Merita: *“Ndryshimet bashkëkohore në mendësitë e shqiptarve për vajzat e gratë”*, (Universiteti i Tiranës), 2016

MOTIVE SHOQËRORE NË POEZINË E ZYHDI DERVISHIT

Sadik Bejko

Doktor i shkencave letrare

Profesor Zyhdi Dervishi, ligjërues në disa universitete i lëndëve me profil sociologjik dhe kulturor, autor librash që i kanë dhënë një vend nderi në këto fusha të dijes, ka edhe përmasën e një poeti të talentuar. Ky talent tashmë është dëshmuar në serinë e botimeve të disa librave poetikë ⁽¹⁾ dhe në vëmendjen që kanë zgjuar ato në rrethet letrare. Dora e poetit ndihet dhe në gjithë prozën shkencore të profesor Zyhdi Dervishit, ndihet në stofin e hollë e të përzgjedhur të gjuhës, në zgjedhjen e qëmtuar të detajeve, në metaforat që vetëitjnë edhe brenda stilit rreptësisht shkencor të korpusit të librave të tij sociologjikë.

Librat me poezi të Zyhdi Dervishit sjellin atë dije që mund të shprehet posaçërisht me mjetet e poezisë, shpalosin atë qasje, atë ndjeshmëri subjektive që vështrimi i specializuar dhe i ftohtë i një shkencëtari në sociologji i ndruhet ta thotë. Personaliteti i tij kështu pasurohet. Poezia është poezi, sociologjia - sociologji, ato janë dy lëmi më vete, por qoftë dhe kjo mprehje e penës së poetit në një mori motivesh sociale, këmbëngulja në veçanti te motivet sociale i japin atij koherencën e një talenti unik.

Motivet sociale shtrihen në gjithë librat poetikë të autorit. Më dukshëm dhe më me prurje në temën sociale janë motivet e vëllimit "Jehonëlebetia", ku kryesisht do të ndalemi.

Ajo që përbën karakteristikën më thelbësore në trajtimin e kësaj teme është vizioni gati kozmik i rënies, i lodhjes, i zaptimit nga e keqja të një shoqërie. Një rënie totale e plazmuar në pamje të ashpra, të përçudshme, pothuaj apokaliptike. Një rënie që mbetet ende në proces të pandërprerë, pa besim a shpresë përmirësimi.

Kjo të kujton poezinë "Biseda e një njeriu të lodhur nga jeta e nga shpirti i vet", poezi e gjetur në një papirus 2000 vjeçar para erës së re, e cila sjell krizën, bjerren dhe lëshimin e fuqive të shoqërisë egjiptiane në epokën e quajtur Mbretëria e Mesme. Njihen nga historia epoka të tilla kur shoqëri të caktuara hyjnë në qorrsoak, rrëzohen me kokëposhtë dhe rëniet e tilla pasohen nga shpërthimi i ligësive dhe i veseve. Njeriu nuk e njuh më tjetrin, as vëllain, as fqinjin, as veten në tjetërsimin, transformimin e përcudshëm që kanë pësuar.

Po japim një fragment nga kjo poezi e Egjiptit të lashtë:

KUJT T'I FLASËSH SOT

*Kujt t'i flasësh sot? Vëllezërit janë të ligj;
e pamundur, sot, t'i duash miqtë, lakmia sundon
gjithkush pasurinë e fqinjit grabit.*

*Kujt t'i flasësh sot? Fisnikëria s'gjendet më,
Gjithkujt i ka plasur cipa.*

*Kujt t'i flasësh sot? Kush ka fytyrë të kënaqur
është i lig, kudo nëpërkëmbet mirësia.*

*Kujt t'i flasësh sot? Nuk shihen më fytyrat
secili e fsheh fytyrën përpara vëllait.*

*Kujt t'i flasësh sot? Lakmitare janë zemrat,
njeriu nuk ka zemër ku mund të mbështetet.*

*"Kujt t'i flasësh sot? Nuk ka më njerëz të drejtë,
pre e keqbërësve është toka.*

*Kujt t'i flasësh sot? Jam mbushur me mjerim/ e nuk di as kujt
t'i besoj"/ Kujt t'i flasësh sot? S'ka kufij/ mëkati që vendin po
sfilit⁽²⁾.*

Situata të tilla ndodhin kur shturen marrëdhënie ekonomiko-sociale deri atëherë të qëndrueshme, kur thyhen struktura sociale mbizotëruese në kohë dhe shoqëria endet në mjegull derisa të gjenden vlerat dhe rregullat e një rendi të ri social.

Shqipëria sapo kaloi nëpër kësi provash. Rënia e një sistemi strukturash, vlerash pa krijuar të rejtat ngjan si fundi i botës.

E keqja bëhet mbizotëruese, demonët dhe instinktët marrin komandën dhe ngjan se ky proces kokëposhtë vetëm në një llum edhe më të zi mund të përfundojë.

Më poshtë po japim fragmente poezish nga libri “Jehonëlebetia”:

*Thahen lisat. Kreshtat/ e maleve sharrohen/ ...hije-zezonë...
(Shkrete)/ Ëndrrat fëminore të mesnatës/ Në gjendje kome/
(Kirurgjia e hënës).*

Batica e trazuar e lotëve/ na e përmbyt hapësirën/ e pamatë të syve.

Nga stuhi e dhimbjes/ qerpikët thinjen/ e kërlëshen/ si leshterikë (Det dhe dhimbje).

...Tërmeti me gurët e themelit,/ kalldrëme shtron/ mbi çati.

.../ Qaramanë e dështakë të përçarë.../ kutërbojnë/ si uturakë të palarë (Duhumë kënete).

Nga barku i shpuar i anijes

shatërvani i llumit

mësyn majat e direkëve. (Kursi i thyer)

*Vektori i busullës së kursit të kohës/ rrëzohet në pikiadë/
kërkon tabanin/ e baltovinës.*

Morgu është mbushur me të gjallë,/ ndërtesat e tjera me kufoma. (Në kryqin e udhëkryqit).

Nga shembujt e cituar më lart vjen tabloja e një qytetërimi të sëmure rëndë, ku të arratisurit prej morgut marrin rrugët e llumit dhe zhyten thellë, poshtë e më poshtë.

Ky verb poetik kataliptik shenjon një situatë me mbizotërim të shëmtisë shoqërore. Poeti nuk e barazon veten, nuk është pjesë e një situatë të tillë. As nuk e lëshon veten ndaj presionit të një realiteti në rënie. Poezia e Zyhdë Dervishit, nuk është poezi pesimiste. Paradoksi dhe sarkazma si mjete estetike, por dhe si çelësa vlerësimi të situatës, të distancojnë prej frymës së shëmtisë, përshkallëzimit në rritje të rrënimit.

Të tjerë poetë shqiptarë këto vite kanë shkruar një poezi të dëshpërimit. Dhe disa prej këtyre poetëve kanë ardhur nga

një kohë kur i këndohej, siç dhe i kënduan, vetëm optimizmit.

Poezia e Zyhdi Dervishit ka tonalitetin e vizionit biblik. Sipas këtij vizioni toka, shoqëria në të cilën jetojmë, janë mbretëri e së keqes së pandreqshme, njerëzimi mbetet peng i mëkateve mortale, i veseve. Dhe ... i tillë do të mbetet për gjithmonë e jetës. Vetëm bota qiellore, Qyteti i diellit (Shën Agustini), është shpëtimi prej tokësore.

Pa qenë fetar, konceptimet, paradigmat biblike, vizionet kozmike, të ngjashme me ato biblike, janë mjete për të përforcuar shprehjen poetike, për t'i gdhendur tablotë me relief, për të sjellë imazhe e mendime me forcë përgjithësuese, mesazhe me thellësi universale.

Poetët e pas 1990 - të shkruan një poezi të zhgënjimit, të pesimizmit. Ndonjëherë këta janë ish-poetë të traditës së realizmit socialist. Ky vizion me kokëposhtë Shqipërisë së tranzicionit në poezinë e këtyre poetëve buron nga vetë pamjet që ofronte realiteti. Poezia u çlirua nga kufizimet tematike, tani mund t'u jepeshe dhe ndjenjave 'negative' si trishtimi, humbja, zhgënjimi. Ndonjëherë në këtë poezi të pas '90-tës denoncohet një situatë kataliptike që të çon te ai përjetim i disa shtresave dikur të privileguara në shoqërinë tonë, shtresa të cilat rënien e komunizmit e përjetuan si fundin e botës. Shqipëria e lëvdur nga realizmi socialist, Shqipëria si frymëzim i së mirës, i së të bukurës, fisnikja, madhështoria Shqipëri, në poezinë disa poetëve të pas 1990-tës u shndërrua në një tjetër kahe, tashmë ajo është Shqipëri e shëmtimit, e së keqes, e mjerimit.

Te shumë poetë (Fatos Arapi, M. Kraja, P. Taçi, etj) pra, në Kosovë e në Shqipëri edhe liria është atakuar. Kthimi nga liria nuk është kusht se gjërat do të ndryshojnë si me shkopin e magjistarit. Lëre pastaj që dhe lirinë, popujt e pamësuar me të e përfytyrojnë si liri pa kushte, pa rregulla.

Mësimet e hidhura nga historia nuk mbahen parasysh. Shqiptarët janë popull që shpreson e beson se gjërat mund të ndryshojnë me atë lehtësi që ndërrojnë stinët. Kush beson

lehtë të fjalët e thata, të premtimet e aktorëve politikë, zhgënjehet.

Shqiptarët në të dy shtetet kanë hasur në probleme jo të vogla me të sotmen dhe me perspektivën e tyre. Poezia po i sjell jehonat e kësaj lebetie (po të perifrazojmë titullin e njërit prej librave të autorit Zydi Dervishi) "Jehonëlebetia".

Zhgënjimi, humbja e besimit, lodhja, shkuarja dëm e djersës dhe e mundit 50 -vjeçar, depresioni se gjithmonë kemi ecur më rrugë të gabuar, dhe fatalisht kështu do të vazhdojmë, kaosi demokratik, varfëria...mbeten shkaqet... pra, edhe idetë që përcjellin poetët e pas 1990-tës në poezinë me motive sociale.

Dhe, përfundimisht, Shqipëria nuk bëhet...Ne jemi humbësit e përjetshëm:

Artin e shkëlqyer të humbjes/ Ne e kemi ngritur në fat./ Ne njohim vetëm lavdinë e popullit/ Të humbjeve të mëdha ⁽³⁾.

2.

Poezia sociale në letërsinë shqipe lindi në periudhën e Pavarësisë, si pjesë e ndërgjegjes kritike në opozicion me atë romantike që ishte himnizuese e çdo gjëje shqiptare. Në ato vite dhe si vlagë e mbajtur nga Rilindja besohej se do të bëhej Shqipëria. Fishta në fjalimin e pikëlluar mortor për Avni Rustemin në Vlorë më 1924, prapë thotë se "ka Shqipëri, do të bëhet Shqipëria. Djemtë e saj me shkop e strajcë nuk do të kërkojnë bukë në dyert e hueja". ⁽⁴⁾ Nga fjala e Atë Gjergj Fishtës "Në dekë të Avni Rustemit".

Noli në poezinë e tij sociale e shihte të keqen te një qeverisje e keqe, e cila duhej zëvendësuar më metodat "ngrehuni e bjeruni". Ai shkoi deri te klithmat:

.. skllëvër, bij skllëvëri, s'e meritoni,/ se liri s'doni.../ (Moisiu në mal) ⁽⁵⁾

Migjeni solli tablotë më të ashpra të mjerimit dhe kritikën se "flamujt e melankolisë" ⁱⁱ e të dështimit valonin gjithandej. Ai sillte si rrugëdalje të vagullta grushtat e bijve të shekullit të ri, ose mbinjeriun. Një revoltë e karakterit me shumë

estetik, e një shpërthimi ekzistencial, sesa e ndonjë drejtimi politico-shoqëror.

Në poezinë e pas 90-tës tema sociale më shumë sesa ndërgjegjes kritike, i jep vend një lloj mënyrë të menduari plot helm, mohimit, negacionit, nihilizmit. Nuk është më ajo "Shqipëria do të bëhet" e rilindasve, as optimizmi utopik i monizmit, as ndërgjegjia kritike e shëndetshme e Nolit, Fishtës, Migjenit ⁽⁶⁾.

Poezia e Zyhdi Dervishit në këtë pejsazh të trishtuar të poezisë së sotme, sjellë vërtet tablo rrënqethëse të një shoqërie të mbërthyer nga instinktët e vetëshkatërrimit:

*Vendi im.../ Vetëngujuar brenda mureve të vetëmarrisë/
gjysmën e pasurive e shpenzon për të blerë eksplozivë./
gjysmën tjetër e shpërthen me dinamit./ (Kuja e gjysmave)*

Por, siç shkruam më lart, ai e stigmatizon bjerrjen, rrënimin e shoqërisë apo të individit qoftë, asnjëherë nuk njëjtësohet me të tilla situata.

Nga ana tjetër ka një tendencë për ta shpallur rrënimin total si ndërgjegjia e kohës sonë, madje si tipari që i vë vulën asaj. Jo se vendi nuk ka kaluar periudha më të këqija se këto që po jetojmë, por pikërisht zgjedhja për ta shpallur rrënimin si ndërgjegje e kohës, sjell agresivitetin ekstrem, braktisjen e idealeve formuese, zvetënimin e elitave, deri te dalliditë ciklike të arratisë nga vendi.

Ka shumë libra, poezi dhe prozë të autorëve të kohës sonë me tituj të tillë, si: Gloria Victis (Lavdi të humburve) Fatos Arapi, "Rrugëhumbur" nga Anton Papeka, "I humburi", roman nga Fatos Kongoli, "Ferrparajsa", nga Xhevahir Spahiu. etj...

Në këtë skicim të shpejtë të motivit social në poezinë shqipe donim të jepnim se poezia e Zyhdi Dervishit është larg nga ato "vjershëza të stolisura me pupla të trishtuara", të trishturit sa për modë, nga poetët që flirtojnë me problematikat e thella të kohës, dhe, po ashtu, është larg edhe nga ujërat me mellanin e zi të pikëllimit, ujëra ku pesimistët

përmblyten edhe vetë. Në tërësi do të theksonim se këto dy prirjet më lart janë tipare të poezisë së poetëve që në të gjitha kohët janë marrë me lirikën sociale.

Po ka dhe një rrugë të tretë.

Është dhe një poezi që u qaset me shqetësim të thellë qytetar probleme dhe plagëve të kohës. Më këtë vazhdë është poezia e Zyhdi Dervishit. Si poezi e një sociologu me emër, pra e filtruar dhe nga ftohtësia e shkencëtarit, ajo është larg dhe nga ekskamacionet, mbingarkesat emotive dhe stërhollimet sentimentale. E gdhendur, e dendur në fjalë e në strukture, ajo rrit forcën e mesazheve që përcjell. Figuracioni, kryesisht metamorfozat, imazhet e hiperbolizuata, ironia e sarkazma, paradoksi janë tipare të mbrujtura në funksion të mesazhit dhe të rritjes së ekspresionit.

Autori është i prekur rëndë nga shpërthimi i shëmtisë te shoqëria dhe individi:

*Në amforën e krisur të kohës/ emrin e përjarge/ me copëza/
nëpërkash,/ të zhbëra nga helmësi/ e helmët tënd.*

Nuk të njoha/ ndaj tiku i hidhërimit/ po më çmend. (Pezmi)

Por ai proteston me dhimbje ndaj së keqes, e neverit fakti që një mik i tij mbështillet e futet brenda stomakut të vet, bjerret nga idealet.

*Për një çast ai doli nga vetja/ ndonëse ishte goxha burrë./
M'u duk i gjithi i mbështjellë/ me stomakun e vet të kthyer./
Një duf i rëndë m'i dogji/ mushkëritë si afshi në furrë (I
kthyeri).*

Poezia e Zyhdi Dervishit nuk ndruhet të japë mesazhe, madje bën thirrje të drejtpërdrejta për shëndoshjen morale dhe rritjen e burrërisë dhe krenarisë.

*Kobhataja e kokuljes së burrave/ si murtajë e kohës së
droguar/ kudo po bën kërdrinë.*

Nën dhë bashkëluftëtarëve të Gjergj Kastriotit/ të thinjur/ betejave/ iu rihapën plagët/ dhe flokët/ iu rinxinë (Ethet e varreve).

E tronditin në dinjitetin dhe në nderin e tij fenomenet e mbrapshta që të ngjan se po marrin të drejtën e qytetarisë.
... dhe mali që s'u thye nga gjylet/ më të rënda të luftërave/ në ditë paqëtimi/ po zhburrërohet.

Ai rreh t'u vërë një ledh fenomeneve të tilla dhe të thotë se shëmtia është dhe do të mbetet e shëmtuar, asnjëherë nuk mund të shndërrohet me të kundërtën e saj, me të bukurën.

Kjo frymë e shëndetshme i bën këto poezi më vlera qytetare të shënuara. Por edhe me vlera atdhetare njëherësh. Pa u deklaruar askund në rreshtat e saj, kjo poezi me nëntekstin dhe ndjeshmërinë pozitive që përcjell, ndër të tjera, ngjan se na thotë që "Shqipëria do të bëhet". Një mesazh për të gjetur guxim e shpresë dhe në kohë të vështira.

Përfundime:

Sociologu Zyhdi Dervishi, njëherësh dhe poet i dëgjuar me disa libra, për poezinë e tij me kohë ka merituar vëmendjen e kritikëve dhe të poetëve.

Poezia e Zydi Dervishit prej mbi 20 vjetësh rreh problematikën e kohëve dhe të mjediseve që jetojmë. Duke qenë poezi e shprehësisë lirike, me gjuhë të shënuar nga poetika e modernes, ajo shquhet për mprehtësinë e këndvështrimeve të një rrethi të gjerë, të një larmie temash. Si poezi e një kulturologu dhe sociologu që heton plagë dhe dukuri të aktualitetit, ajo shquhet, në vaçanti, për theksin e saj social.

Detajet, tabllotë, idetë, ndjeshmëria pikëzohen si realitete të poezisë, të tekstit poetik.

Veçori të kësaj poezie janë denoncimi i dukurive të shëmtuara sociale dhe vështrimi i tyre nga lart, pa rënë në pozitat e pikëllimit të pashpresë. Qasja ndaj një tematike

tillë ka veçanti dhe prurje që duhen marrë në shqyrtim edhe më tej, për dinamikën e trajtimeve nga libri në libër. Poezia jo vetëm i heton, por dhe u jep theks universal dukurive sociale. Ekologjia e shpirtërores është një shqetësim që i tejkalon kufinjte e ngushtë mjedisorë.

¹⁾ Zyhdi Dervishi:

Qiej të përthyer, poezi, botoi Jerusalem, 1999

Jehonëlebetia, poezi, botoi Jerusalem, Tiranë, 2005

Vetëklonimi i maskave, poezi, Botime E M A L, Tiranë, 2009

Mokra e hijeve, poezi, Botime E M A L, Tiranë, 2014

³⁾ Fatos Arapi, “Gloria Victis”, (Lavdi humbësve), Tiranë 1997. Cituar nga Fatos Arapi, Urna e vogël, F.36, botoi Nereida, Tiranë 2014.

⁴⁾ Atë Gjergj Fishtës, “Në dekë të Avni Rustemit”, revista Afrimi, vjeti II, Maj 1942, Vlonë. Cituar nga internet, <http://alb-spirit.com/2019/05/09/fishta-tek-vorri-avni-rustemit/>

⁵⁾ Fan Noli, Moisiu në mal, Cituar nga Antologjia “Zemra e qiellit”, f.44, botoi Kosova PEN center, Prishtinë, 2015

⁶⁾ Migjeni, Vargjet e lira, Novelat e qytetit të Veriut, f. 57, botoi Migjeni, Tiranë, 2006

SHQETËSIME PËR PROBLEME SHQIPTARE DHE TË PËRBOTSHME NË POEZINË E ZYHDI DERVISHIT

Sazan Goliku

Në historinë e kulturës botërore, po dhe atë shqiptare, kemi shembuj të shumtë se personalitete shkencore kanë pasur edhe krijimtari të shquar artistike. Po përmend vetëm disa prej tyre si: Kahjami, Da Vinçi, Lomonosovi, Lajbnici, Niçja deri te figurat tona Sami Frashëri e Fan Noli. Në këtë udhë, ku bashkohet studiuesi me shkrimtarin, po ecën edhe profesor doktor Zyhdi Dervishi.

Poezia e Dervishit në katër librat e tij: “Qiej të përthyer” (1999), “Jehonëlebetia” (2005), “Vetëklanimi i maskave” (2009), “Mokra e hijeve” (2014) karakterizohet nga fryma e theksuar sa qytetar aq dhe human në çdo qelizë të saj. Temat e motivet e poezive kapin një gamë të gjerë të problemeve të mprehta të realitetit të sotëm shqiptar dhe të përbotshëm, nëpërmjet perceptimit e konceptimit poetik, me figuracion të pasur dhe emocionalitet të lartë. Shpirti kritik i Dervishit prek me dhembje plagë të hapura të botës shqiptare, që e pengojnë të eci përpara krahas shteteve e popujve të qytetëruar të botës.

Korrupsioni në të gjithat hallkat e shtetit, mosndëshkueshmëria e shkelësve të ligjeve, lufta e paskrupullt për pushtet, varfërimi dhe polarizimi i shoqërisë etj. pasqyrohen me vërtetësi në vargjet e Dervishit. Gjithashtu, dukuritë negative që po përjeton njerëzimi i sotëm janë në fokusin e poezive të tij.

Duke e parë nga një këndvështrim sociologjikë, vepra poetike e Dervishit mund të quhet reagim i pastër figurativ ndaj realitetit aktual dhe ai poet “diagnostikues” i

sëmundjeve të epokës. Profesor Zyhdi sa analizon e argumenton me akribi shkencore, me qetësi, ftohtësi e maturi në veprat e tij sociologjike, aq impulsiv e goditës shprehhet në poezi. Pra, kuptimi i drejtë mes dallimit thelbësor të shkencës dhe artit ka kushtëzuar jo vetëm metodën e stilit, po dhe temperamentin e ndezur, si cilësi karakteristike e poetit Dervishi.

Vargjet e poetit kanë ngarkesa të shumta semantike dhe me rrezatime polivalente ndjeshmërisht, ku e bukura dhe mesazhet janë shkrirë organikisht. Çelësi i kësaj poezie duhet parë në thurjen e sistemit figurativ origjinal që përbën strukturën solide të poetikës.

Lakonizmi dhe denduria stilistike janë tipare të dukshme të kësaj poezie, siç janë edhe imazhet ekspresioniste dhe herë-herë edhe surreale. Pikëpyetjet në fund të disa poezive janë shprehje dyshimi ose mosbesimi, ose dëshirë e tërthortë për kapërcimin e një gjendjeje ose situatë të padëshiruar. Po në thelb janë sfidë ndaj një realiteti dramatik.

Të interpretosh dukuritë e proceset politike, ekonomike, kulturore dhe etiko-morale të konceptuara poetikisht, duke shmangur cerebralitetin libresk, duhet të jesh i vetëdijshëm dhe i aftë, pra i talentuar, për të qëndruar me të dy këmbët brenda gjuhës së poezisë.

Si një kredo të poezisë së Dervishit do të pranoja thënien e Sartrit: "...letërsia krejtësisht e lirë paraqet negativitetin si moment i nevojshëm i ndërtimit" (Zh. P. Sartri, "Ç'është letërsia", 1998, f. 63). Në këtë kuptim vargjet e Dervishit janë thika të mprehta për të operuar nga trupi i sëmurë i shoqërisë pjesët e kalbura ose të infektuara. Ai godet sëmundjen në emër të humanizmit të vërtetë, jo me deklarata subjektive ose të retorikës hipokrite që mbushin faqet e shtypit dhe mediat e shumta online. Ndjenja e

dashurisë dhe e dhimbjes për gjendjen e vendit dhe situatat që po kalojmë në këtë tranzicion absurd përshkojnë gjithë poezitë e Dervishit, pavarsisht se satira e mprehtë mbizotëron ndaj dukurive negative. Një koncept të tillë për satirën e paraqet edhe Benedeto Kroçe: “Për satirë kuptohet një shqetësim moral që, ndonëse e sheh me sy vesin për të luftuar dhe për ta paraqitur shëmtimin e tij, nuk e humbet nga syri shkakun e indinjatës që qëndron në një dashuri të zhgënjyer për fisnikërinë, pastërtinë, ndershmërinë.” (Benedeto Croce, Poezia antike dhe moderne, f. 98).

Që në librin e tij të parë “Qiej të përthyer” Dervishi nuk e kursen sarkazmën te poezia “Politikë” ndaj politikës zyrtare e partiake pa skrupuj, duke e quajtur atë “shtrigë e shtrigave”, që me “Alkiminë tinëzare të natës/ dhe gurëvarret lëvizin”, që me hipokrizi klasike: “gjirizin e kthen në tempuj/ tempullin në gjiriz.”

Te “Mokra e helmetës” poeti vëren paradoksin qeveritar:

“Vendi im përherë i përmbysur: një vrasës profesionist/ një laro ministër/ një gjeneral krimesh/ një kolonel të zvetënimeve/ një palo prijës/ një këngëtare çengije/ e ngre mbi piedestalin e dinjitetit të ngjizur/ me mundim të fisëm/ nga mijëra/ artistë/ shkencëtarë/ e profesorë.” (Vetëklanimi i maskave, f. 26 – 27).

Këto vargje na kujtojnë me turp vargjet e njohura të Fan Nolit, ku satirizon qeverinë anakronike të mbretërisë së viteve ’30. Servilizmi i të paaftëve dhe të pacipëve, mungesa e dinjitetit minimal, për të fituar diçka ose një çfarëdo lloj posti, ka shkatërruar hierarkinë e vlerave:

“Acarit të dimrave të zhgënjimit/ me ujëra të turbullta që ngrinë/ si stalagmite në boshtin e kohës/ rriten politikanucët/ hije – manekinë” (“Qiej të përthyer”, f. 64)

Ky karikaturizim poetik i goditur është shprehje e asaj praktike të politikanëve mashtrues, të cilët i përdorin militantët naivë si karrem për të kapur e mbajtur pushtetin me çdo mjet e mënyrë. Të mbështetur te politika të interesave klanore dhe të lidhur në mënyrë të ndërsjellë me biznesin e madh, pushtetarët e radhës shndërrohen natyrshëm në sundimtarë, shkatërrues të parimeve, ligjeve dhe të institucioneve demokratike:

“Të infektuarit me lebrën/ e korrupsionit kanë para/
më shumë se gjithë/ vlerëtarët e vërtetë:/ dijetarët, gjeneralët/
e prijësit popullorë./ Një ditë me dunat e parave/ harkun më
të lartë/ të triumfit do të rreken/ të ngrenë për vete./ Do të
përqeshen dhe nga barelievët/ e gurëzuar të virtyteve të
kthyer në skelete.” (Jehonëlebetia, f. 132).

Poeti e njih mekanizmin e shfrytëzimit të burokracisë nga pushtetarët për interesat vetjak që të çon në degjenerimin dhe bjerrjen e shtetit:

“Si prostitutë historike/ shtrydhi nga pushteti/
spermën e gjithë e përfitimeve./ Nga babëzia/ sperma iu
thartua/ me urinë./ Shteti dhe nëpunësi si cerga/ me fijen e
merimangës/ akuzojnë njeri – tjetrin/ e kërkojnë alibi.”
(Idem, f.65)

Pra, ligjet, të shndërruara në rrjetë merimangash, u shërbejnë politikanëve dhe nëpunësve të të gjithë shkallëve, për të mbuluar me mjete të stërholluara fitimet e majme, çka çon në varfërimin e mjerimin e masave të gjera, po dhe në humbjen e dinjitetit të vetë shtetit.

Kjo neveri kuptimplote, që rrjedh në të gjitha poezitë me motive politike të librave të Dervishit, nuk buron vetëm nga ndjenjat vetjake të poetit, po nga gjendja emocionale e akumuluar mbarëpopullore. Dhe në kaosin e sotëm shqiptarë, të sistemit të vetëquajtur demokratik, pasiguria

për jetën e njeriut, i cili zbaton rregullat morale dhe ligjet, është një dukuri e rrezikshme, prandaj poeti shikon:

“Kudo trekëndësja të padukshëm/ ku luhaten litarë
gjarpërinjë/ me leqe – kurthe/ interesa mafiozë./ Njeriu i
ndershëm të tepërt/ e ndien veten në këtë botë/ si të
mbështjellë me lëkurë/ të kalbur lebroze.” (Idem, f.63)

Prandaj ndërgjegjja qytetare e ndjeshmëria vetjake e Dervishit reagon me zemërim të përligjur se

“Kovat e krimit – kamxhik/ mbi kokat e të gjithëve/
me kuisje kobndjedhëse/ fshikullon.” (Idem, f. 69)

Krahas parrullave e retorizmit hipokrit, pushtetarët, me forcën e ligjit në dorë demostrojnë prepotencë dhe brutalitet:

“Me grushtin e rrufesë sferike/ goditi tryezën e rëndë/
të vendimarrjes” (Mokra e hijeve, f. 49)

Përplasja e grushtit është një veprim që simbolizon mendësinë se “unë kam pushtetin, kam dhe mundësinë të hartoj dhe të zbatoj ligjin siç duan interesat e mia dhe të klanit që unë përfaqësoj.”

Natyrisht, duhet kuptuar se përgjithësimi poetik nuk përfshin ato segmente të politikës realiste e konstruktive dhe ata individ me parime e prirje pozitive e progresive, por që me heshtjen e tyre ose pamundësinë për të ndikuar në sistem, ekzistencën e tyre mund ta quajmë virtuale.

Motivet e poezive të Dervishit kanë përmasë jo vetëm kombëtare. Problemet, konfliktet dhe luftërat e sotme në botë, po dhe në rajonin e Ballkanit, nuk mund të mos ndikojnë në një shkallë ose tjetrën edhe në vendin tonë. Me hiperbolë konvencionale, ja si e shpreh poeti realitetin aktual, kur në çdo cep të globit kemi gjakëderdhje:

“Duhma e krimeve të luftës/ dhe kaltërsinë e qiejve
përdhosi./ Shiu gjak i mpiksuar/ e llavë katrani rrjedh nga
gjinjtë e përdhosur të hënës./ Nën grinë e shiut – llum/ u

baltosën dritë – hijet/ e skemave diplomatike të politikanëve/ përshpirtjet e klerikëve/ simfonitë e këngët/keqardhja e retorikave, psherëtimave/ në çdo tribunë...” (Qiej të përthyer, f. 22). Me përjasje me dukurinë e ngrohjes globale, poeti paralelisht vëren rritjen e tensioneve botërore politike e luftarake:

“Nga dhembjet/ dhe azoteminë e lotit/ po ngrihet zjarrmia/ në fytyrën e globit” (Idem, f. 13)

Ballkani, historikisht si fatalitet tragjik, si një burim luftrash, vazhdon ende me pangopësinë shoviniste të ndezë shkëndijat e konflikteve. Në Ballkan

“Nepërkat gërshetohen kurorë/ në kokat tona./ Në ashtin e kafkave/ me agiet e dhëmbëve helmues/ na gdhendin epitafet/ e trishta të jetëve/ që s’u jetuan kurrë.” (Vetëklonimi i maskave, f.25)

Emigracioni masiv, sidomos ai pa kontrolluari, si dukuri e pandalshme e ditëve tona, nga dramë shqetësuese shumëpalëshe është kthyerën tragjedi për mijra e mijëra njerëz që shkojnë nga vendet skajshmërisht të varfra dhe me luftëra shkatërruese drejt Europës e Amerikës së veriut.

Ja si e fokuson poeti një imazh tronditës: “Me këmbë të gërryera deri në asht, \ të mpira nga hipotermia, \ çapitet drejt kufirit, \ luginë më luginë, \ mal më mal, \ e kodër më kodër.\ Në terrin e acartë të natës, \ fati i refugjatit, \ gjethe e helmuar, \ kafshuar nga kufiri – kobër.” (Mokra e hijeve “Natë”, f. 35). Nëse njëqind e ca vjet më parë për shqiptarët kurbeti ishte një dramë për ato familje që mbeteshin pas, po dhe për ato që endeshin rrugëve të botës, emigracioni i sotëm i ngjan një lumi që të çon drejt humbjes së identitetit dhe lë pas shkretëtirë në vendin tonë. Me empati drithëruese poeti rrëfen: «Në zgrip të fatit mes mjegullës së dyzimit jam nisur shtigjeve dritë – hije të mërgimit. ...Vendi im nga ligjet e optikës rrëgjohet shndërrohet në një pikë. pikëllimi që

helmon gjithë qenien time». (Qiej të përthyer, Pikëllimi, f. 58)

Problemi jetik i ndotjes së mjedisit kombëtar aq dhe botëror për të sotmen dhe për perspektivën e njerëzimit, që po shkatërron në mënyrë të pathyeshme globin me ngrohjen globale, me zhdukjen e vlerave të natyrës, me armët e zhdukjes masive:

“Fati i njeriut – krah fluturë/ Përpëlitet në furinë e shpërthimeve”. (Jehonëlebetia, triptik, f. 41).

Qytetari dhe poeti Dervishi ngre fuqishëm zërin e protestës në vargjet e tij shigjetuese si paralajmërim, së bashku me korin ende të pafuqishëm të miliona njerëzve. Ai kërkon «të çlirojë kapilarët e mushkërive nga ushtria e tartabiqeve të molekulave gaz – helmuese. (vetëklonimi i maskave, i arratisur, f. 80), sepse “Lumenjtë u përqaftuan me të vjellat e gjirizeve të industrisë». (Idem, f. 78), sepse «...detet dhe oqeanet mbushen me qelb atomik të helmuar». (Mokra e hijeve, Kristal loti, f. 37), sepse «Egzema e ndotjeve industriale \ rrallon mjekrën e gjelbëruar të pyjeve». (Jehonëlebetia, Ekzema, f. 78).

Fati i fëmijëve, i të ardhmes së njerëzimit, janë motive tronditëse në shumë poezi të Dervishit: «Loti i vogëlushit – kristal pastërtie në të turbullohet imazhi gjithë botës (Qiej të përthyer, Lot apo sy, f. 24) Dhembja therëse e poetit shpërthen sidomos në motivet e vrasjeve të përbindshme të fëmijëve në Kosovë gjatë gjenocidit serb:

“Sytë e fëmijëve të masakruar-/ dije të përgjakur/ harkylbere/ të përgjysmuar./ Njëra gjysmë/ mbi plagët e Kosovës/ flukse vegimesh/ për lirinë.” (Idem, Diej të përgjysmuar, f. 31)

Po bota ku është? Po institucionet e paqes, mirësisë, mirëkuptimit, e lutjeve pse heshtin?

“Ditëve të përzhitura kosovare.../ Gjithë tempujt e shenjtoreve eklipsohen/ nga dy sy të masakruar fëmije. (Idem, Eklips, f. 36)

Qëndrimi i prerë kritik ndaj hipokrizisë, pangopësisë, prirjes për fitim të shpejt dhe pa punuar ndershmërisht, që të çon në skëterrën e krimit, vezullon në shumë poezi të dervishit. Ai këmbëngul me dhembje e zemërim për një virtyt qytetar, përball degradimit e manipulimit të moralit njerëzor nga autoritarizmat, nga religjione agresive dhe ekstremiste të ndryshme, nga industrializmi i vlerave shpirtërore. Degjenerimin moral poeti shpreh me neveri:

“Njeriu i zvetënuar/ fundoset me rropamë/ në gropat skeptike/ të pështjellimeve morale” (Vetëklonimi i maskave, Rrëzime paralele, f. 119)

Kriza e individualitetit dhe i identitetit të njeriu i turmës e bën poetin të pohoj me trishtim:

“Kam humbur veten mes bashkëkohësve/ dritëhumbur idealçartur/ shpirtgjymtuar” (Qiej të përthyer, Epitaf, f. 67)

Prandaj poeti shpërthen sarkazmën e pamëshirshme:

«Në tymnajën e turmës pa indetet/ njeriun e zakonshëm nuk e njih askush./ Përpiqet të ngrihet mbi nivelin e mjegullës/ duke kërcyer një tango- tekashboshësie./ Mjerani – një zorrë e zbrazët/ që përpëlitet mbi prush.» (Vetëklonimi i maskave, e zbrazët, f. 141).

Kujtimi dhe nderimi për figurat që janë përpjekur, po dhe kanë dhënë jetën për lirë, përparimin e begatinë e atdheut është nderim e krenari për vetë brezat e sotëm e të ardhshëm. Injorimi dhe harresa e dëshmorëve dhe e luftëtarëve të vërtetë të lirisë nga politikanë e pushtetarë të pacipë sfidohen me përbuzje me poezitë “Veterani i llogoreve” dhe “Krikëllimet e përvajshe”:

«Sa herë kaloj nga varreza e vjetër/ gremisur mes ferrave të harresës/ dëgjoj një krikëllimë të përvajshme kockash/ që më ngjeth në shpirt me lemeri./ Janë kockat e një luftëtari të thinjur në hershmëri/ kthehen e rikthehen nga njeri krah në tjetrin/ kur një kalimtar i rastit pështyn/ mbi jehonën e përgjakshme/ të luftërave për liri». (Idem, Krikëllimë e përvajshme, f. 98)

Pritshmëria, që ka në vete optimizmin e natyrshëm, është formuluar poetikisht nga Dervishi si një pyetje shpresëdhënëse:

«Kur do të fillojë ndritja/ e kolonave të mermerta/ mbi krahët e dallëndysheve/ që këngët mbi këngë i nisin/ drejt shkëmbinjve të arnuar/ me shtufin – kripë të djersës/ e fije nervash të pandryshkura/ të arkitekturës/ me rrënjët e ëndërrimtarit tonë? (Qiej të përthyer, '90, 10)

Po e mbyllë këtë analizë me dy pyetje të poetit që e kanë të pamundur përgjigjen, që kanë brenda skepticizëm, po dhe dëshirën për të mirën, me idealen: «A është bërë i njerëzishëm njerzimi?»

dhe «me ç'kod do të komunikojmë \ në agimin e turbullt të së ardhmes?»

PERCEPTIMI DHE FORMA ‘KENNING’ NË KRIJIMTARINË E ZYHDI DERVISHIT

Prof. dr. Fatmir Terziu

Abstrakt

Ka shumë mënyra për të imagjinuar se çfarë poezie na jep poeti Zyhdi Dervishi. Si lexues, si njerëz të thjeshtë, si profesionistë për të pasuruar përvojën tonë natyrisht shkojmë më tej në diskursin e saj. Nga ana ime, gjithmonë e kam vlerësuar mënyrën delikate dhe të shkëlqyeshme të poezisë së poetit Dervishi, pasi ajo është e denjë për të na frymëzuar e bërë për të kërkuar që të shohim përsëri gjërat (gjëra të përditshme, gjëra të mëdha dhe sublime) për të rishikuar botën, për të rishikuar gjuhën që përdorim për të përshkruar botën për veten tonë, të mos i marrim këto gjëra thjesht si një renditje por si një angazhim për të mirë. Është pikërisht ky funksion i poezisë së Dervishit, që nganjëherë e bën leximin dhe shkrimin e tij të ndihet “perceptues” dhe “transformues”.

Në fund të fundit, është e domosdoshme të ballafaqohet me transformimin e poezisë në lajmëtare iluzionesh, diçka që ne jetojmë brenda dhe e ndjejmë se e dimë. Kjo poezi është si të shikosh veten në pasqyrë dhe të gjesh arsyen që nuk e pranon fare veten. Ndoshta ndjehesh pak i çuditur, dhe pyet veten për këtë çuditje. Por kjo është një mrekulli që na bën të shikojmë më afër, dhe duke shikuar më afër, shohim gjërat që gjithmonë kanë qenë atje, sikur shihen për herë të parë. Kjo përvojë e të qenit “zgjuar” në botë, të cilën poezia e Dervishit e jep, është vërtet shumë emocionuese.

Koncepte kryesore: *perceptim, transformim, kenning, iluzion, logopedia*

1. Transformimi i poezisë në lajmëtare iluzionesh

Transformimi i poezisë në lajmëtare iluzionesh kërkon mjeshtëri. Prej kohësh e ka patur dhe e ka kryer poezia një funksion të tillë. Që në lindje të saj fuqia e saj u vu nga mjeshtër të poezisë në një funksion të dyfishtë. Duke lartësuar fjalën dhe duke fokusuar iluzionet e njerëzve. Në një kohë kur poezia ka pësuar një transformim rënjësor tensioni midis tradicionales dhe avant-gardes, lufta midis modernizmit dhe postmodernizmit, edhe në poezi, si në çdo artkrijimtari tjetër ka marë disa forma. Poetë të mirëfilltë kanë përshkuar këtë rrugë me vlera të reja dhe kanë krijuar një linjë të re poetike, që vjen përpos arsyes dhe njohurisë që ata përfaqësojnë. Edhe në krijimtarinë shqiptare emra të tillë ka plot. Emra të tillë krijojnë në heshtje, zgjedhin rrugën akademike të pasqyrimin dhe paraqitjes së gjërave dhe mënyrën ‘intelektuale’ të modestisë.

Por, shpesh ‘tradhëtohen’ nga krijimtaria e tyre. Librat e tyre në fusha të shumta shpesh i bëjnë të ‘skuqen’ në sytë e lexuesit, që i mirëpret për mirë dhe i kërkon për t’i lexuar, kështu modestia e tyre mbetet thjesht një ‘tradhëti’ personale. Një personale, që në këtë cak e “humbet” edhe përfaqësimin e saj në sfondin publik, por që e fiton vlerën e veprës së autorit ‘modest’ në një masë të gjerë shoqërore. “Modestia nuk është vetëm një ornament, por edhe një roje e vrytitit”, thotë Jozef Adisoni, një eseist i njohur dhe një poet britanik (1672-1719). Kështu më duket se është edhe me krijimtarinë e Zyhdi Dervishit, mbajtës i titujve akademikë, Profesor dhe Doktor. Krahas studimeve të tij, që vulosen me librin e tij studimor dhe tepër voluminoz, “*Lente të ndërveprimit simbolik*”, ai është edhe një poet me një pasuri të rëndësishme poetike. Një pasuri e rëndësishme

poetike që vjen si një shtrat i garantuar në dualitetin teorik të modernes dhe postmodernes.

2. Modernizmi dhe postmodernizmi

Modernizmi është një koncept i zhdërvjellët në duart e teoristëve të sotëm. Ata përdorin dy rrugë në këtë kapje teorike të tyre, për të shpjeguar kulturat dhe ecjen kulturore në fusha të ndryshme. Nëpërmjet teorive të tyre ata synojnë edhe për të përshkruar arritjet e derisotme, por gjithashtu edhe për të arritur përsëri në një mendim që është vendosur në kulturën perëndimore që nga koha dhe teoria e filozofit francez, Descartes (31 Mars 1596 – 11 Shkurt 1650). Modernizmi në këtë përshkrim zëvendësohet nga postmodernizmi, duke tentuar thjesht që ta paraqesin këtë rrugëtim si një ecje historike ose drejt çrrënjosjes me mobilizimin teorik të asaj që vjen nga baza e modernizmit. Postmodernizmi kësaj kryen një përfundim logjik të modernitetit mbi bazën e së cilës kuptojmë ‘insistimin e vet epistemologjikal të lidhjes historike pauzë dhe risi, ose edhe nga ana tjetër, zbulon praktikalisht të jetë vetë një zhvillim projekti në nevojën e përfundimit’, pra në kërkim e në kërkim të një të ardhme tjetër (Anthony J. Cascardy, *The subject of Modernity* (Kembrixh: Kembrixh University Press: 1992:243). Megjithatë, parë në këtë teori, poezia e Dervishit e ofron këtë nëpërmjet një pleqërimi filozofik të ndërjegjes, e cila shpreh veten në imazhet e konfuzionit kulturor të shoqërisë shqiptare në tërë zhvillimet e saj, “nëpër labirinthe e rrugëve/ me mistere dritë-hije të Sienës/njerëzit gazmendin superioritet kuajve dhe këngëve / në supe / flamujt e kontratave dhe pëllumbat.”

Në këtë pikë shohim këtë lidhje të modernizmit dhe postmodernizmit, si një detaj që buron nga leximi i krijimtarisë poetike të Zyhdi Dervishit. Poezia e lartpërmendur e tij, si shembull, konvergon mbi një vulgare

të nxitur nga koha, si një arsye e pashkëmbyer e antisemitizmit për të përdorur figurën e nivelimit midis dy hapësirave dhe vendeve nga vlera e kapitalit. Kjo figurë në gjuhën e poetit është një fluskim shpirtëror imazhez. Kështu ajo plotëson transformimin e poezisë së Dervishit në lajmëtare iluzionesh nëpërmjet aspektit të konfigurimit filozofik të mesazhit. Tek poezia “*Muzg*” autori gjen një konfigurim tek ‘retinat e gjithësisë’ dhe kështu ai plotëson aspektin e plotësuesit të asaj që ndërlidhet me tërë strukturën poetike. Ai e lidh këtë me aspektet njerëzore, socialen, psikosocialen e këtyre njerëzve, anën informale dhe metainformale të tyre, duke metaforizuar në mënyrë perfekte një simbolikë paralele.

Lexojmë vargjet “*sytë e yjeve/fiken një e nga një / shpirtrat e njerëzve errësohen / në akullnajë kome*” dhe gjejmë imazhin e plotë në poezinë e tij. Kështu imazhi në poezinë e këtij autori është një arsye më shumë për të kuptuar rolin e imazhit në poezi.

3. Imazhi në poezinë e Dervishit

Le të nisim me poezinë “*Prag*”. Poeti shkruan: “*ortekë shtrëngatash shqyejnë/ gojëkrateret e vullkaneve/n’errupsion/ Vena-variçet e errësirës shfryjnë/ në shatërvanet e llumit e/ stërpikin pafundësinë/ e dritshme të syve*”. Në tërë këtë mori fjalësh, vijnë në mendjen tonë një grumbull imazhesh që renditen dhe zënë vend përpos një rregulli, që kërkon së pari sqarimin teorik të imazhit. Se çfarë është një imazh, kjo ka qenë dhe është një çështje e hershme preokupimi.

Një çështje që ka preokupuar mjaft filozofë dhe poetë. Ata, pra filozofët dhe poetët kanë kërkuar mes krijimtarisë së tyre dhe vetes për mijëra vjet dhe ende nuk kanë përgjigje definitive, për imazhin në poezi. Më gjerësisht përdoret përkufizimi i një imazhi siaps teorisë së

Ezra Pound: “... në këto ditë, kuptimi i imazhit është një kompleks intelektual dhe emocional që zbulohet në një çast të kohës” (Ezra Pound: *Imazhi dhe realja*; 1969: 95).

Por ka një histori për këtë përkufizim të Pound. Para se të përkufizojmë, Pound përkufizimin e tij, imazhi në poezi është parë shumë ndryshe nga shumica e njerëzve. Prandaj, me pyetjen “çfarë është një imazh?” menjëherë prishet ndjesia themelore për të në tri pjesë. Ne gjetëm një pikëlidhje me këto tre pyetje që ndihmojnë për të sqaruar më tej ndryshimin teorik që rrethon këtë koncept në poezi. Këto tre pyetje ndihmëse janë:

- 1) Si mund të vijë kuptimi poetik nga imazhet?
- 2) Sapo është krijuar një imazh në mendje pas leximit të një poezie, çfarë është ajo që kuptojmë?
- 3) Si mund të funksionojë një figurë në një poezi?

Para se ne tu japim përgjigje këtyre pyetjeve, ne dëshirojmë të diskutojmë në lidhje me disa terma që e parapërgatitin imazhin në mënyrë të atillë që ai të mund të kuptohet nga të gjithë lexuesit e poezisë, pa u ndikuar tek ato, pra nocionet teorike që gjenden në përgjigjet tona. Janë disa terma, siç e theksuam edhe më lart, të cilat shihen në lidhje me kuptimin e tyre, pra të imazheve në poezi.

Janë shëmbëlltyrat, imagjinatat, ndijimet etj. Së pari është shëmbëlltyra. Shëmbëlltyrën e hasim në kuptimin logjik të përkufizuar nga John Ciardi, në definicionin e tij të ‘imazheve’ tek Libri i *Fjalorit Botëror*. Kjo shpjegohet më së miri sipas teorisë së tij tek të gjitha figurat, duke i dhënë ato në forma të ndryshme dhe në forma të tilla, që të duken sikur ato pra imazhet e poetuara të jenë të gjallë. “Skulptura është më së miri e definuar si total ndijor, sipas sugjerimit që vjen në mendjen e lexuesit me poezi” (John Ciardi, *World Book Dictionary* def. E “imazhet.”) Kështu shëmbëlltyrat që

formohen në poezi nga ngjasimet skulpturore, apo edhe të ngjashme me to, formojnë imagjinatën.

Duke nënkuptuar fjalën “Imagjinatë” të lidhur me funksionin e saj në poezi, natyrshëm ne kuptojmë atë që mjaft teoricienë e quajnë një laborator mendor për krijimin e imazheve dhe ideve të reja. Në këtë kuptim teorik e shohim thujtë njësoj siç Ambrose Bierce e thotë: “një magazinë e fakteve, që vijnë nga pronësia e përbashkët ‘poet e gënjeshhtar’. Por për John Ciardi, fjala imagjinatë, “nuk është thjesht imagjinatë, apo thjesht një fjalë si etimologji e saj që bën me dije, aspektin e formimit të imazheve dhe realitetit; ajo është mjaft e njohur si një formë fakultative e interpretimit të imazheve, të cilat shkojnë përtej realitetit, duke i thurur këngë realitetit.” (John Ciardi, World Book Dictionary def. E “imazhet.”)

Nëpërmjet këtij zinxhiri teorik ne krijojmë arsyen e ndijimit, si një hollësi që vjen si një tërheqje nga prania e pesë senseve. Kjo shpesh ndjehet edhe si një hollësi konkrete. Por një hollësi konkrete vjen në poezi nga imazhet, që sipas Gaston Bachelard, besohet se e ka origjinën e imazhit në të vërtetën që buron nga thellësia e ndërjegjes njerëzore, nga shumë arsye që lidhen me aspektin e të qenit.

Ku shihet kjo lidhje teorike në poezinë e Dervishit? I tërë nënkapitulli “Sozi dhe pikëllime” i vëllimit poetik të autorit “*Qiej të përthyer*” vjen në ndihmë. Janë dhe një sërë poezish të tjera si “Amfiteatrot e Ballkanit”, “Qiej të përthyer”, “Rrënjët”, “Diell i përgjysmuar”, “Ndërrim stinësh”, “Boshi i çkohëzimit” etj që plotësojnë tërë arsyen praktike për të kuptuar rolin e imazhit në poezi.

4. Roli i figurave në krijimin e imazhit në poezi

Duke marrë si shembull poezinë e Dervishit në këtë pikë natyrshëm del parësore të sqarohet edhe një fakt që lidhet me figurat artistike në poezi. Në poezitë e Dervishit më së

shumti shihet një kursim figurativ, por një arsye e qartë që e bën poezinë e tij të padëmtuar nga përdorimi i dendur i fugurave, që në disa krijimtari poetike duken hapur si dëmtuese të poezisë. Sipas kësaj duket qartë se figura e ka vendin e saj në poezi vetëm nëse përfshihet brenda tërësisë stilistikore, kuptimore dhe estetike të saj. Krahasimi është i radhëpërdorur nga autori, por tek disa poezi ai si një figurë elementare, ose si forma e parë njohëse, na e jep materialen e piketuar nga vargu i poetit duke e krahasuar me diçka tjetër ose më saktë me një dukuri tjetër: *“Ti ike rrëmbimthi si valët/rebele të Drinit. Nga të ftohtit/paretet qelq kristali/të qenies sime u thyen...”* (Poezia: Boshi i çkohëzimit).

Në poezinë e Dervishit figurat kanë qëllim të qartë: për të ‘vizatuar’ aspekte të rëndësishme. Këto aspekte duken në shumë poezi. Tek poezia *“Murانات e padukshme”* metafora, kjo mbretëreshë e figurave, nuk del vetëm si një përçuese e qartë të qëllimit, por edhe si një figurë që nëpërmjet fjalës që humbet kuptimin e saj të parë realizon kuptimin filozofik: *“Motorët e raskapitur të makinave/gulçojnë udhëkryqeve./Molekulat e gazit helmues degëzohen/në kapilarët e mushkërive/të kalimtarëve me sy të kuqëluar/nga semaforët-diej të mekur/në mërzinë e pezullt/të perëndimit”*.

Tre nga këto gjëra ne lehtësisht i lidhim me botën që na rrethon, ndërsa ndryshku (edhe pse një proces i përkryer natyror) shpesh ngjall imazhet e industrisë. Pra, mund të mblidhemi se ky tekst i vogël ka të bëjë më shumë sesa helmimin esencial. Gazi helmues është, në këtë rast, jo një, por shumë. Mblidhet për të sugjeruar diçka më të madhe se sa shuma e këtyre pjesëve ndoshta dhe detyrim-mos-harresë.

Si njerëz, ndjenja jonë e shikimit është sigurisht pothuajse më dominuesja e pesë instancave në dispozicionin tonë fizik, dhe ndoshta për këtë arsye imagjinata (e parë dhe

shkruar me mend) është një nga pajisjet më të imagjinueshme dhe më të këndshme të poetikës së Dervishit. Por imazhet e mira nuk janë thjesht vetëm të mira, sepse është saktësisht ana kirurgjikale që operon në saktësinë e përshkrimit të tyre, pasi themi se kjo është një e mirë sepse në të njëjtën kohë është ajo që na tërheq si në një fotografi, është ajo, pikërisht ajo që zgjon një humor, një ndjenjë apo një ide. Kjo sjell një perceptim imazhesh të cilat na afrojnë mjaft mirë me formën ‘kenning’ në poezinë shqiptare e më gjerë.

5. Forma ‘kenning’ në poezinë e Dervishit

Një perceptim që realizohet nga forma e ngjeshur e metaforës në poezi krijon një strukturë tipike dhe i jep poezisë një formë të veçantë. Kjo formë e veçantë e quajtur kenning, që i jep një liri të ndjeshme poezisë, edhe pse me një mbifuqi shprehëse të metaforës, është një strukturë poetike e përdorur fillimisht në krijimtarinë anglosaksone dhe me një ndryshim të vogël edhe në mesin e krijimtarisë skandinave. Poezia kenning në krijimtarinë poetike shqiptare, nuk ka qenë një ‘shkollë’ më vete, edhe pse tek-tuk ajo është lëvruar nga mjaft poetë në heshtje. Poetë si Agim Gjakova, Nehas Sopaj, Sazan Goliku, Fatime Kulli, Nuhi Vinca, Izet Shehu, Bardhyl Londo, Visar Zhiti, Halil Hoxhosaj, Kolec Traboini, Puntori Ziba, Iliriana Sulkuqi, Ahmet Selmani, Vullnet Mato, Apostol Duka, Mimoza Ahmeti, Lujeta Lleshanaku, Fatos Arapi, Rrahman Dedaj, Flutura Aça, Agron Tufa, Rudjan Zekthi, Milianov Kallupi, Dritëro Agolli, Moikom Zeqo, Petraq Risto, Rozi Theohari, Arian Leka, Grigor Jovani, Roland Gjoza e disa të tjerë, në mjaft poezi të tyre ngjeshin kuptimin e metaforës, dhe i afrohen ndjeshëm formës ‘kenning’. Janë për mjaft arsye që lidhen me strukturën emblematisht të saj.

Forma strukturore e poezisë kenning e bën që vetë disa poezi të kësaj forme të jenë më të ‘turbullta’ se të tjerat, por që shërbejnë për të mbajtur lart forcën e imazhit dhe mesazhit që përcillet. Për shembull poezia e kësaj forme e një prej poetëve Britanike, më me emër në përdorimin e formave kenning në poezi, Judith Nichols (1941) përdor kennings si pjesët e një poeme të madhe, që në vetevete është një kuptim në tërësinë e saj, dy poetë të tjerë Andrew Peters Fusek dhe Polly Peters shkojnë më tej, duke na dhuruar ndërtimin e një poezie të përbërë tërësisht nga kennings. Por duhet kuptuar qartë se një poezi e tipit kenning nuk është thjesht në disa raste, një formë shumë e ngjeshur në metaforë. Një kenning, është kur një objekt është përshkruar në një frazë me dy fjalë, të tilla si në poezinë “Dimër bërthamor” (fq. 13) të poetit akademik Zyhdi Dervishi, ku vargu i parë i strofës së dytë: “Në pole luspa-luspa” sjell kuptimin e dyfishtë të Rruzullit, që ashtu si në poezinë “Shishebluja”, poezi kenning e një prej poetëve Britanike, më me emër në përdorimin e formave kenning në poezi, Judith Nichols (1941) ku kuptimi i detit vjen nga dy fjalët e ngjeshura në metaforë: “rugë-balena”, përcakton këtë përshkrim, dyfish edhe si metaforë, edhe si mesazh, që natyrshëm shkon në qasjen e duhur, jo thjesht perceptuese. Dervishi dhe poezia e tij kanë këtë ‘kostum’ tipologjik, mjaft të ndjeshëm e të dallueshëm nga të tjerët, me të cilin konkurojnë.

Edhe herë të tjera jam ndalur në poezinë e poetit shqiptar Zyhdi Dervishi. Këtë radhë është diçka më e qëlluar, diçka më e lidhur me një aspekt që shënon veçorinë tipike të perceptimit në poezinë e tij. Një perceptim që në fakt krijohet jo vetëm nga metafora, por edhe nga kjo veçori strukturore dhe semantike të poezisë kenning.

Dihet se një metaforë e përdorur nga poeti, merr dy gjëra përsipër në poezi dhe pretendon se ata janë të njëjta. Një mënyrë për ta bërë këtë është duke thënë se X është Y, si në poezinë e Dervishit, “Pezëm” ku ngjeshen dy metafora në të njëjtën strofë, ku del kuptimi dytësor i “*sy përherë të veshur/me perde thellimi*” dhe nga “*nga krahu i thyer i korbit/në kubenë e natës pikon/limfë trishtimi*” dhe në fund retushohet nën penelatat e mërziqjes dhe trishtimit njerëzor. Kjo nuk është fjalë për fjalë një e thjeshtë e vërtetë, por në leximin, perceptimin dhe mishërimin e imazhit, në dëgjimin leximtar mes linjave, është e lehtë të imagjinohet së pari duke marrë karakteristikat e një krijese të trishtuar, një gjë e vetme e vogël lëviz nëpër qiell, pastaj karakteristikat e një korbi, na sjellin nëpërmjet perceptimit të këtij zogu vetminë, të zezën, të trishtuarën, përhumbjen deri në largim nga ky ‘pezëm’.

Mjaft poezi të tilla të Dervishit, si “Fosile”; “Vetëmalkim”; “Polifoto në mermer” etj, japin një kenning me një dispozitë normative ku dominon një lloj tipiciteti i figurshëm letrar, veçanërisht në perifraksim. Ato vijnë në formën e një kompleksi që konfiguron gjuhë figurative në vend të një gjuhe më konkrete. Shkurt kjo formë kërkon një njohje të gjerë të traditës, gjuhës shqipe, semiotikës, dhe tërë proceseve që lidhen me strukturën dhe stilistikën...

Dervishi i plotëson të gjitha këto. Si studiues i mirëfilltë ai e njeh tërë këtë rrugë të ndjeshme e të vështirë të performimit të strukturës kenning në poezi. Ndërsa disa kennings janë relativisht transparente, shumë varen nga njohjet e miteve të veçanta ose nga legjendat. Kështu qielli mund të quhet natyralisht siç Dervishi e cilëson ‘kreshta dallgësh’ që ‘shndërrohen në një pikë’, por duhet kuptuar edhe mitikja që vjen nga togfjalëshi ‘në zgrip të fatit/mes mjegullës së dyzimit...’ (“Pikëllim”).

Të tjerë subjekte marrin e rimarin emrin e sajuar në bazë të konventave të caktuara, pa referencë në një histori të veçantë. Dhe natyrshëm krijojnë strukturën kenning, për të qenë pjesë e kulturës shqiptare edhe në poezi, ashtu siç bënë edhe gjermanët kur krijuan strukturën e tyre kenning në poezi.

Kohë më herët ishin edhe vetë Grekët që shijuan këtë formë poetike në hutim. Në një poezi të periudhës parakristiane linja e dytë e poemës në të cilën Archilochus lidh legjendën e tij të dhelprës dhe majmunit ishte jo thjesht një burim i hutuar i dijetarëve helenistike. Ata e kishin të qartë kapjen e variacionit grek të kennings. Sipas Athenaeus Apollonius Rhodius kjo kapje shpjegohet në vetë këtë poemë. Ajo qartësohet pikësëpari, se duke iu referuar praktikës spartane kuptimi i fjalëve përsëritëse ‘dredhadredha’ ishin metafora të njoftimeve zyrtare që kryheshin me tellal ose me shkop dhe kështu jo më kot ndeshja e tipit kenning u bë objekt studimi.

Për kennings të tillë, me sa duket paradoksal që sjellin fakte të hershme të poezisë së këtij tipi në Ballkan, ngjitur me Shqipërinë (shih më tej Waern I., OETEA FHE: Poezi të parakrishtëritit kenning në greqisht (Uppsala, 1951), faqet: 55-8, Johansen dhe Whittle në Aesch. Suppl. 180). Duke vazhduar me strukturën kenning në poezinë e Dervishit le të ndalemi më konkretisht tek poezia “Politikë”. Në strofën e fundit autori përdor ‘njeriu i vogël’ dhe ndarë me vizë ngjeshur këtij togfjalëshi ai i shton togfjalëshin tjetër ‘sommambul në terrin’. Të dyja këto togfjalësha mbartin plotësin e njëri-tjetrit, por edhe ngushtojnë dhe zmadhojnë funksionin e njëri-tjetrit. Një shembull i tillë ngjan me poezinë e Chris Jones, “Sirenë dhe tundër” ku ne e shohim qartë variacionin kenning: ku ai përdor tofjalëshat e duhur ‘rrugë-balenë’ dhe ‘rrugë e ngjalës’ për të na dhënë kuptimin

e ngjeshur metaforik të Detit (Chris Jones: Përdorimi i vjetër në anglisht “Poezi e shekullit XX”; Oxford University Press, 2006). Kjo ngjeshje metaforike kryen dy procese njëherësh. I pari kryen ndryshimin e signifikesit, dhe i dyti është kuptimi që bën ndryshimin edhe me vetë konceptin akademik ‘signifikues’, duke i bërë jehohë në rastin e Dervishit hipnozës së dilemave dhe në rastin e dytë duke trikuar me kompetencën e fjalës ‘det’ në tërë zhurmimin e tij dhe gjerësinë metafizike. Në të gjitha rastet poezia e Dervishit përmes kësaj forme të avancuar poetike të shpie tek vetë simbolika e avancuar e këtij poeti. Kjo shihet në përgjithësi, por domosdoshmërisht është e dukshme tek ‘Mokra e hijeve’.

6. Mokra e hijeve, simbolika e avancuar e Dervishit

Simbolizmi është një nga mënyrat më të avancuara poetike që bën të mundur jo vetëm reprezentimin e një diçkaje, por edhe rritjen e mënyrës së të shkruarit sidomos në poezi, kur dihet që në disa raste mund të paraqesë mendime të tjera. Kështu është libri më i ri i poetit tashmë të mirënjohur shqiptar, Zyhdi Dervishi, “Mokra e hijeve”. Që në titull “mokra” është një simbolikë më vete, por kur ajo qaset në shoqërinë e ‘hijeve’ bëhet akoma më e fuqishme në metaforën e saj. Mokra nuk është thjesht një *mekanizëm* ku arsyeja dhe materia bluhet, por edhe një vend ku qasen strukturat hijore të hijeve dhe filozofia kumton mesoren simbolike të tyre. Në këto mesore hyjnë mjaft simbolika të tjera të ndërlidhura me dhe-dhimbjen dhe me arsyen e një nate në shpirtin e njeriut. Nata në këtë arsye të tensionuar shpirtërore paraqet lodhjen, vetminë, punën e padobishme dhe dashurinë e pashpërblyer në ‘terrën e acartë’ ku *‘fati i refugjatit/gjethë e helmuar/kafshuar nga/kufiri-kobër’*

bëhen vetë simbolika e natës, asaj hapësire ku e padukshmja struket ‘me këmbë të gërryera deri në asht’.

Një simbol i tillë në vëllimin e Dervishit, punon në dy mënyra: Është vetë diçka, dhe ajo diçka gjithashtu sugjeron diçka më të thellë. Është shumë e rëndësishme për të dalluar një simbol nga një metaforë tek “Mokra e hijeve”, pasi Dervishi është një njohës akademik i denjë, dhe kështoj ai vendos poetikisht arsyen e tyre. Metaforat janë krahasimet midis dy gjërave në dukje të ndryshme. Simbolet i lidhin dy gjëra, por kuptimi i tyre është edhe më i saktë dhe figurativ. Një metaforë mund të lexohet tek ky vëllim si, “po shkoj drejt banesës së fundme pa dyer e dritare”. Një simbol mund të jetë vetë kjo banesë, e cila do të ndjell ciklin e vdekjes dhe ikjes nëpërmjet humbjes dhe zhdukjes fizike që lë. Disa simbole kanë të përhapura, vlerat e pranuar gjerësisht se shumica e lexuesve duhet të njohin: qenien, arsyen, materialen që i sugjeron faktori i pafajësisë ose i dredhur me dorë mes pranisë së vlerave. “Edhe nën dhe” ndjenja është e lidhur me ndjeshmëri. Megjithatë, asnjë prej këtyre direktivave nuk është absolute, dhe të gjithë ata janë të vendosura në të vërtetë nga kultura individuale dhe kohëshkrimi (do të di një lexues jashtë Shqipërisë që një Hije e mokrës sugjeron trisht?). Jo. Simbolet kanë kuptime absolute, dhe, nga natyra e tyre, ne nuk mund ti lexojmë ato në vlerë nominale. Por, Dervishi di ti transferojë ato poetikisht në gjuhën e artë të fjalës poetike.

Dervishi mes këtij vëllimi, ndryshe nga poezitë e tij të mëparshme, beson se ka dy lloje psikologjike, subjektive dhe objektive, dhe që të gjithë njerëzit janë të predispozuar të karakterizohen nga shkallë të subjektivitetit dhe objektivitetit të ndryshme, që një mund të zgjedhë në mes të dyve deri në një masë që ka rezultuar në teorinë e tij të maskës simbolike, që nënshkruhet nga hija e mokrave.

Hija e mokrave, në antitezë me Mokrën e hijeve, tek vëllimi poetik i Dervishit është ajo që supozohet si qëndrim me ato të cilat ne përballemi me botën, si dhe imazhi për veten tek të cilat dashuria na ndihmon për të parë veten dhe arsyen tonë të dashur. Ky është dallimi në mesin tonë. Opinionet rreth vetes dhe opinionet e mbajtura nga të tjerët. Dhe kjo është mbrojtja jonë psikologjike kundër të lënduarve që ngarkohen simbolikisht tek poezitë e këtij vëllimi. . . . Dervishi e koncepton si maskë, mokrën e hijeve, si një disiplinë e cila, në qoftë se ne do të ndjehemi vërtetë të vërtetë, të lumtur dhe me të vërtetë të virtytshëm, ne imponojmë mbi veten.

Mokra e hijeve ne supozojmë, është morali ynë dhe psikologjika e asaj ku qaset e kundërta, plotësuese për secilin prej psikologjikes tonë ose prej mangësisë morale, por është gjithashtu, imazhi i idealizuar për të lexuar veten. Duke veshur një maskë, një Mokër hijesh, Dervishi, vazhdon të tregojë simbolikisht, ne bëhemi ata që ne kemi dëshirë që të jemi, pa e kuptuar mesazhin e mokrës në vetvetet dhe më së shumti edhe atë të mokrës së hijeve që bluajmë dhe na bluajnë.

Maska simbolike është emëruar nga disa dijetarë si simboli më i rëndësishëm i kësaj periudhe. Dervishi në këtë vëllim ka përdorur simbole të tjera të shumta dhe në këtë herë, disa prej të cilave janë marrë nga jeta që na rrethon dhe shoqëron në përditësi. Një nga ata që janë në kategorinë e fundit, edhe pse Dervishi e mban larg nuk e përmend atë shumë, është vegimi ndryshe që në disa prej poezive simbolizon ose sugjeron maskë. Kjo është arsyeja që ndjek njeriun mes një simbolike transparente poetike.

7. Logopedia e imazhit dhe vallëzimi i intelektit mes fjalëve

Imazhi në poezinë e Dervishit krijon mes perceptimit pamje të ngjashme në mendjen e lexuesit. Poeti përdor perceptime dhe imazhe për t'i vendosur lexuesit në një përvojë shqisore. Imazhet e poezive të tij shpesh na japin pamje të menjëhershme mendore që u pëlqejnë shqisave tona të shikimit, tingëllimit, shijes, prekjes dhe erërave. Vëllimi i tij poetik, “Vetëklonimi i maskës” është një gërshetim i tillë psikoanalitik mes perceptimit dhe imazhit, duke rikrijuar diskurs adekuat në këtë pikë. Qëllimi i imazheve në poezinë e Dervishit dhe shkrimeve të tjera të tij, si sociale, sociologjike, analitike, kulturologjike dhe shkencore, është krijimi i fotove të qëndrueshme dhe mesazhdjedhëse në mendjen e lexuesit, fotografi të qarta që ngjallin ndjenja të caktuara të cilat shkrimtari dëshiron që lexuesi t'i ndjejë. Ky lloj imazhi apelon tek ndjesia e lexuesit për perceptimin vizual.

Jo më kot ndoshta poeti vëllimin e tij poetik “Vetëklonimi i maskës” e hap me një kuotim dedikues: *“Tim eti, një mësuesi idealist të kësaj bote”*, duke na krijuar hapur dhe qartë se mesazhi i imazhit tashmë vjen i trashëguar dhe i ridimensionuar në tërësinë e tij diskursive. Kështu imazhet poetike, gjuha shqisore dhe figurative e përdorur në poezinë e këtij vëllimi merr një dimension tjetër në kuptimin e qartë të asaj që poeti siguron me stilin dhe metodën e tij, mund të mendohet edhe përsa i përket ‘korrespondencave’ të trashëguara nga komunikimi prindëror, ku në fakt babai tashmë është një arsye dhe një person, një ngjarje, një objekt, ose pse jo dhe një arsye që ka krijuar një mit tek i cili perceptohet poeti për të mishëruar një numër kuptimesh, për të cilat vëmendja e lexuesit është e drejtuar. Sikurse e cituam dhe më lart Ezra Pound duhet theksuar se gjithashtu foli për logopedinë, atë që ai e quajti “vallëzimi i intelektit midis fjalëve” (ibid). Pikërisht në këtë logopedi, ku ndjehet

komunikimi lirik i lirikave shohim dhe ndjenjën e shpirtit për të cilën flet realiteti i kohës në të cilën autori zgjedh vetë kohën dhe aspektualitetin e saj të krijojë imazhe dhe perceptime të qarta.

Poezitë e këtij vëllimi me forcën dhe liricizmin e tyre na sjellin jo thjesht lirika për t'i lexuar, por për t'i mbajtur mend gjatë. “Ylberi i zgjimit” hap mrekullinë lirike të shtatë kapitujve dhe na bën të qartë imazhet që flasin me një gjuhë tipologjike: “Në dy male të lartë u mbështeta/Si në dy këmbë./Trupi m`u lartësua si llavë e zjarrtë/E shpërthimit vullkanik/Të gjakut e palcës/Të dy këmbëve-male...” Pikërisht kjo është përpjekja e autorit për të na thënë qartësisht se kush jemi. Përpjekja për të kuptuar se kush jemi është, në një farë mënyre jo thjesht një perceptim, as thjesht një drejtësi, por një detyrë shumë e papërfillshme, duke perceptuar tërë amalgamën e problemeve të përditësisë në të cilat qëndron vetja jonë dhe trupi ynë. Por një gjë të tillë më të lehtë që mundohet të na e bëjë poezia e Dervishit është vetë arsyeja që të lëmë idenë e një vetësie fikse dhe të mendojmë për vetësi të ndryshueshme (ose të rregullueshme), ta dorëzojmë negativitetin vetiak të vetësisë sonë të shpërfillur me atë nocion në veprimtarinë e perceptimit dhe t'ia përkushtojmë mes leximit veprimtarisë së ndjeshmërisë. Poezia e Dervishit ka shumë përdorime dhe ngushëllime, por unë mendoj se mbi të gjitha, dhembshuria (për botën dhe krijesat që banojnë në të) është ndërmarrja më e mirë e krijimtarisë së poetit. Nëse lexuesit gjejnë tema dhe ndryshime të shkëlqyera, perceptuese, poetike, ata natyrshëm ndodhen në një fushë mbresëlënëse imagjorative. Poezia e shkëputur nga kapitulli “Përballë cunameve” dhe që ka një titull mjaft domethënës “Autodafe” flet qartë për angazhimin dhe betimin e poetit në lidhje me imazhet dhe realitetin e tyre: “Më digjni në furrat e gëlqerës/Ose më

bluani të gjallë/Në mokrat që s`bluajtën kurrë/Miell gëzimi.
...../...se në tokën time/Deri në mpiksjen e mbarme të
gjakut/Përjetësisht jam dashuruar.”

“Metastaza ballkanike” nga ana tjetër plotëson diksursin e përlotjes që vjen nga realiteti i stuhive: “Në Ballkan/Para barelievit të varreve/Qiparisat nuk përulen/Nga përlotjet e stuhive/Tropikale./Në Ballkan/Stuhitë e tajfunet e tornadot e cunamet/Rebelohen në tela me gjemba/Të nervave të tendosura e të skuqura/Prej mënisë e zmerimit./Mbi kafkat e ballkanasve/Zgjaten e kërleshën/Metastazat kanceroze/Të vetëshkatërrimit.” Këtu është vëmendja dhe perceptimi, këtu është imazhi dhe krahasimi, këtu është lista dhe akumulimi dhe ri-prezantimi, këtu është përshkrimi dhe evokimi. Pra poeti e ndjen dhe e shtjellon imazhin mes një realiteti që përforcohet tek poezia “31 Dhjetor”: “U zvarrit si gaforrja dhe një vit i mbrapshtë/Me mundime, dhimbje e strese./Politika-shtrigë më shtrigane/Turbulloi edhe çdo pikël vese.” E gjitha vazhdon akoma më e fuqishme në kapitullin pasues. “Retina të plagosura” merr përsipër të forcojë mesazhin dhe bukurinë e tij. “Pentagrami i rrënimit” ka më shumë forcë. Është kjo poemë e jashtëzakonshme që shpërblen sa më shumë lexime të kujdesshme, siç mund të kursehen vetëm për të, dhe përdor shenja të shumta të subjektit të saj të pakapshëm nëpërmjet një gjurme të gjesteve poetike të matura që ia vlen të rilexohen: “*Nuk më tremb hungërima e ujkut/Në xhunglën e ferrëshme të ferrave./As ulërima e luanit kur më shtërngon/Me morsën e kthetrave/Të uritura të bëbëzisë./Më gërryen themelet e shpirtit/Mjaullima e maces kompozuar/Me notat më të ndotura të ligësisë.*”

Sepse poezia e Dervishit, natyrisht shumë bashkëkohore është e mbushur me ankth rreth pritjes së gjatë, ndoshta edhe vetë rëndësisë së pritjes për ndryshim.

Poezia që i drejtohet një auditori skeptik do të bëjë për vete një auditor ndryshues, do të bëjë natyrisht (me qëndrimin e vet) ta ftojë auditorin e saj në atë lloj marrëdhënieje. Këto ndryshime janë mekanizma që gjithnjë janë përballë, janë efikase, funksionale por jo artizanale. Këtu ideja e “hijes” nuk është përcaktuar në një mënyrë që e ngushton dhe e përmban atë, përkundrazi, me anë të rritjes së shembujve, ilustronet, hapet, ekspozohet një ide e “hijshme”. E hijshmja duket se lind në vendin ku njeriu dhe ambienti vijnë në bashkim me njëri-tjetrin, dhe, në përputhje me nocionin, duket se përfshin (ndoshta edhe kërkohet) një shkallë e gjatë lufte mes ndryshueshmërisë dhe pandryshueshmërisë. Ky është një nga ngushëllimet e shkrimit, jo kapjes apo fiksimit, por duke vënë në dukje dhe vlerësuar gjithnjë kënaqësitë, shqetësimet, dëshirat dhe kuriozitetet e botës gjithnjë një botë e përherëshme. Poezia “Nën hijen e qiellit” ka një mesazh të qartë: *“Një re e murrme/Më rri mbi kokë/Si pelerinë./Herë ngjeshet si shapkë/Herë mblidhet si kamë/Herë godet si vetëtimë.”*

Dhimbjët, ndjenjat, vuajtjet e hidhura të ardhura nga kohërat për kohërat nuk janë strehëra të qëndrueshme, përpos dhimbjes ato mbijetojnë dhe flakën. Poezia “Streha ime” është një format i qartë i transformimit të poezisë: *“Goditur nga breshëri/Rrebesht trishtimi./Rrekem të gjejë strehë/Në kasollën mbuluar/Me kashtë të thinjur/Mundimi e stërmundimi.”* Dhe pastaj ta përfytyrojmë gjuhën si sensin e gjashtë, që na jep një mënyrë tjetër më të thellë të qasjes në ato gjëra, duke kuptuar ato dhe duke i përshkruar ato, duke i lidhur ato, dhe duke i ri-imagjinuar ato dhe duke lejuar veten të jemi të butë (ndonjëherë thellësisht) ndryshe nga ata. Ndryshe nga ata, se jeta jonë lexohet ndryshe mes poezisë së Dervishit, ku “Kotësi” jep mesazh të qartë: *“Në guvat e qeta të varreve hedhin lule/Petale të rëna nga cikma zie./Më kot*

rreken të mbuhsin me lule varret/Humnera pafund padrejtësie". Kështu funksionn edhe kapitulli i tretë "Guaska drite dhe gurëzime" dhe tjetri vijues "Vargmale ngujimi" deri sa mesazhi përfundon me kapitullin që i ngjizi emrin këtij vëllimi poetik. "Vetëngujim gjenetik" është një arsye më shumë për të ridimensionuar forcën e mesazhit dhe diskursit logjik: "Si barinj në kopshtet e mirazheve/Me alkiminë e tjetërsimit/Njerëzit e kohës sonë/Vetëklonohen 1001 herë./Të klonuarit e njetë si narcisë/Dashurohen mes veti./Në retinat e syve/Nuk u gjallojnë më/Silueta njerëzish/Të tjerë."

Tek "Kumtet e tokës" Zyhdi Dervishi sjell në vizion eksperiencën më të përparuar poetike të imazherisë dhe perceptimit ku objekti ose përvoja e tij që sjell ndërmend në një marrëdhënie përkohë me arsyetimin që qas një ngjarje e dytë, ose ndonjë gjë e rastësishme, si tek poezitë e tjera "Përmbytja e Kalasë së Rozafës"; "Alpine" dhe "Shqyt". Në këto poezi, ashtu sikurse dhe tek "Kristale fëminie" është e sigurt, megjithatë, se imazhi poetik është një eliminim i së tepërtës në një kuptim të caktuar dhe themelor. Kjo ndodh thuajse edhe në krijimtarinë e tij të gjithanshme, po aq dhe në studimet e tij ku perceptimi zë vendin kryesor, sikurse ndodh tek "*Lente të ndërveprimit simbolik*".

8. Riforcimi i komunikimit verbal

Riforcohen bindjet se komunikimi verbal, mbetet i detajuar larg apo më pranë zonës qendrore të vëmendjes, me prurjen e plotë e të përpunuar të "*Lente të ndërveprimit simbolik*" të studiuesit shqiptar, Zyhdi Dervishi, në të mësuarit e simboleve kulturore. Studiuesi dhe vepra madhore provojnë bashkërisht se ekzistojnë dëshmi të qëndrueshme për përgjithësimin se nuk ka përfitime të të mësuarit të simboleve që do të fitohen nga përdorimi i ndonjë mjeti

specifik për të dhënë udhëzime, pa kuptuar se simbolet kulturore paraprijnë në dritëpërcaktime sociologjike. Hulumtimet e bëra nga Dervishi, janë thellime që tregojnë performancën ose fitimet e kursimit të kohës nga një ose një simbolikë tjetër dhe që tregohen të jenë të prekshme ndaj hipotezave rivale, rivaliteteve në lidhje me efektet e pakontrolluara të metodës së komunikimit simbolik dhe risive që vijnë si specifika të mekanizmave të selitjes metodologjike. Mes studimit janë përshkruar problemet me atributin e tanishëm të simboleve dhe sistemit të simboleve dhe sugjerimet e bëra për drejtime hulumtuese më premtuese për përcaktimet psikologjike.

Në këtë analizë, unë do të përshkruaj një kornizë për studimin sociologjik “*Lente të ndërveprimit simbolik*” që lidh dhe i përket dhe disa elementëve të kulturës sociale që lidh tri elemente të ndërthurura të kulturës njerëzore (motivet kulturore, burimet dhe kuptimet) dhe që tregon kontekstet konkrete në të cilat secili ndikon në mënyrë më kritike veprimet dhe rezultatet e atyre që quhen pasuese mes vetë lenteve të ndërveprimit simbolik. Në kontrast me modelet që hedhin motivet, burimet dhe kuptimet si shpjegime konkurruese se si kultura ndikon në veprimin, mes studimit të Dervishit, argumentoj se këto janë elemente themelore përbërëse të kulturës që janë të pandashme, të ndërvarura dhe në të njëjtën kohë operative.

Cili element siguron lidhjen më të fortë me veprim, dhe se si funksionon kjo lidhje, duhet kuptuar si një funksion i pozicionit të aktorit brenda kontekstit më të gjerë shoqëror. Unë argumentoj duke marrë apriori tërë dimensionin studiues dhe të përkushtuar të Dervishit, se motivet mesatare kanë lidhjen më të dallueshme ndaj veprimeve brenda një shtrese shoqërore, burimet kulturore sigurojnë lidhjen më të fortë në të gjithë shtresat dhe kuptimet kanë ndikimin më të madh të

drejtpërdrejtë kur kodohen dhe sanksionohen. Një rikuadratim dhe një sintezë që ri-integron teoritë e asaj dukurie përcaktuese sociologjike mes tipologjisë “konkurruese” të kulturës së mëparëshme në një model kulturologjik të varur nga konteksti i kulturës në veprim shihet tek studimi i Dervishit. Së fundi, duke u bazuar tek studimi “*Lente të ndërveprimit simbolik*” përdor prova nga hulumtimi empirik paraprak, si dhe të dhëna të reja nga një studim kulturologjik i vazhdueshëm i sjelljeve krijuese në mesin e letrave shqipe e më gjerë, për të treguar se si elementë të ndryshëm të kulturës janë konkretisht të lidhura me veprimin në tetë kontekste të ndryshme shoqërore.

Duke vepruar kështu, një udhërrëfyes për kalimin nga logjika “ose” ose më shumë e teorisë kulturore dhe ritheksimi për rëndësinë e shqetësimit sociologjik klasik për “kur” dhe “si” ndikojnë aspektet e ndryshme të kulturës dhe rezultatet në kontekste konkrete sociale. Si pasojë “*Lente të ndërveprimit simbolik*” është një pasqyrë ku shihet ajo që ka munguar deri më sot, ku detajohet e projektohet vizioni i një strukture më të përparuar studimore në këtë fushë. Ajo që plotëson është thelbi dhe konteksti i gjërë i kuptimit dhe mbarështrimit të domosdoshëm të vlerave si procese të kulturave simbolike.

9. Vlerat simbolike në sitën e përcaktimeve sociologjike

Kultura simbolike është aftësia për të mësuar dhe transmetuar traditat e sjelljes nga një brez në tjetrin nga shpikja e gjërave që ekzistojnë tërësisht në sferën simbolike. Kultura simbolike është sfera kulturore e ndërtuar dhe e banuar në mënyrë unike nga Homo sapiens dhe është e diferencuar nga kultura e zakonshme, të cilën e kanë shumë kafshë të tjera. Kultura simbolike studiohet nga arkeologët, antropologët social dhe sociologët.

Shembujt janë koncepte të tilla, si të mira dhe të këqija, shpikje mitike si perënditë dhe nëntoka, dhe konstruktet shoqërore si premtime dhe lojëra të futbollit. Kultura simbolike është një fushë me fakte objektive, ekzistenca e së cilës varet paradoksalisht nga besimi kolektiv. Për shembull, një sistem i monedhës ekziston vetëm për sa kohë që njerëzit vazhdojnë të kenë besim në të. Kur besimi në faktet monetare bie, vetë faktet zhduken papritmas. Pak a shumë e njëjta vlen edhe për nënshtetësinë, qeverinë, martesën dhe shumë gjëra të tjera që njerëzit në kulturën tonë e konsiderojnë të ‘vërtetë’. Koncepti i kulturës simbolike nxirret nga semiotika dhe thekson mënyrën në të cilën kultura dalluese e njeriut ndërmjetësohet nëpërmjet shenjave dhe koncepteve. Aspekti simbolik i kulturës dalluese njerëzore është theksuar në sociologji nga Emile Durkheim, Claude Lévi-Strauss, Clifford Geertz dhe shumë të tjerë.

Nga pikëpamja darviniane, kultura simbolike ka provuar shumë për t’u shpjeguar. Një vështirësi është se vetë koncepti shpesh duket i bezdisshëm dhe filozofikisht i papranueshëm për shkencëtarët natyrorë. Shkenca moderne u krijua në kundërshtim me idenë se fiksime kulturore të pranuar mund të barazohen me fakte. Megjithatë, koncepti i kulturës simbolike kërkon që ne të kuptojmë vetëm atë mundësi paradoksale. Shumë kohë përpara shpikjes së internetit në fund të shekullit të njëzetë, evolucioni lejoi që njerëzit të flisnin midis dy sferave, realitetit nga njëra anë, realitetit virtual, nga ana tjetër. Kultura simbolike është një mjedis i entiteteve virtuale që nuk kanë homologë në botën reale.

Një herë u mendua se kultura, arti dhe kultura simbolike u shfaqën së pari në Europë rreth 40.000 vjet më parë, gjatë tranzicionit të Paleolitit të Mesëm e deri në të

Epërm - shpesh quhej 'shpërthimi simbolik' ose 'revolucioni i Paleolitit të Epërm'. Disa arkeologë ende i përmbahen këtij mendimi. Të tjerë tani pranojnë se kultura simbolike ndoshta u shfaq në Afrikën Sub-Sahariane në një datë shumë më të hershme, gjatë periudhës së njohur si Epoka e Mesme e Gurit. Dëshmia përbëhet nga tradita të okërve tokësorë me përzgjedhje të fortë për ngjyrën e kuqe, shembuj të të ashtuquajturit 'ngjyruet' të okër që duket se janë përdorur për qëllime të projektimit, ndoshta në trup, dhe gdhendjet gjeometrike në blloqet okër. E gjithë kjo pjesë e dukshme e industrisë së kozmetikës datonte në mes 100,000 dhe 200,000 vjet më parë. Një teori është se kjo përbën dëshmi për një traditë rituale. Përveç kësaj, rreth 100.000 vjet më parë, ka guacka të shpuara të cilat duket se tregojnë shenja veshjesh, duke sugjeruar se ato ishin të lidhura së bashku për të bërë gjerdane. Nëse tradita okri është interpretuar në mënyrë korrekte, ajo përbën dëshmi për 'artin' e parë të botës - një aspekt i 'kulturës simbolike' - në formën e ornamentit personal dhe pikturës së trupit. Fillimisht u kundërshtua që sistemet dekorative vetëm të pigmentit janë thjesht një shfaqje individualiste, jo domosdoshmërisht indikative për ritualin, ndërsa traditat e beadave dëshmojnë për gjuhën, marrëdhëniet e institucionalizuara dhe kulturën simbolike të ritualit të plotë. Kohët e fundit, megjithatë, ata që e bëjnë këtë kritikë kanë pranuar se provat për përdorimin e pigmentit të okrave, që shtrihen mbrapa në 300,000 vjet më parë, duhet të njihen si mediane më të hershme që dëshmojnë për traditën rituale kolektive.

Në këtë paradhënie teorike vlerat simbolike qasen në sitën e përcaktimeve sociologjike si strukturime të reja e të mirëthelluara nga studiuesi Dervishi. Ai në bazë të të dhënave të shumta, bazuar dhe në studimet e mjaft të tjerëve dhe atyre me emër në këtë fushë, si Emile Durkheim, Claude

Lévi-Strauss, Clifford Geertz, kapërcen në një fushë të hapur e të panjohur më parë, duke i dhënë përkatësisë elementët e domosdoshëm dhe mjaft të duhur. Mbi këtë kontekst “kryesisht për aktrim në skenën e jetës” faktori “shumëllojshmëri: ngjashmëri dhe pangjashmëri të shkallëzuar” na jep funksion të qartë larg ngjashmërive në linja ikonike (Dervishi, 2016: 40-56).

Me këtë rifreskim të vlerave simbolike në sitën e përcaktimeve sociologjike Dervishi, duke u bazuar në përvojën e tij e në mjaft teori të përparuara sjell në lëmin botëror atë që buron në fushën e pasur shqiptare, po aq dhe ballkanike, si aspektualitete të modelve që rezatojnë shumësi mesazhësh të ndryshme deri të kundërta.

10. Fusha e hulumtimit të simbolikës sociologjike

Qëllimi i *“Lente të ndërveprimit simbolik”* në tre kapitujt e parë është të diskutojë hulumtimin e simbolizmit, në tërësinë kulturore, fuqinë goditëse, frikësuese të fjalës dhe orientimin e shqiptarëve kah simboleve kulturore, si dhe funksionet shoqërore të simboleve kulturore nga një kritikë e perspektivës sociologjike. Tek ky studim, sidomos tek këta kapituj diskutohen aspekte të ndryshme të sociologjisë si një koncept metateorik. Sugjerohen nga studiuesi tashmë i mirënjohur shqiptar, Zyhdi Dervishi, gjithashtu kriteret që qeverisin kur mund të jetë e përshtatshme për të kryer një analizë kritike të elementeve sociologjike në tekstet e hulumtimit të kësaj fushe mes vetë simbolikave dhe perceptimeve të ngjashme. Këto gjetje shkencore përfshijnë autonominë sociale të kufizuar të studiuesve, rëndësinë sociopolitike dhe dobinë ideologjike të produkteve kërkimore, modës sociale të zonave kërkimore, stilit pseudo-objektiv, asaj që derivon prej mungesës së vetëreflektimit të

treguar dhe mungesës së vetëdijes së manifestuar të kontekstit social të hulumtimit në botimet kërkimore, të cilat me daljen në dritë të “*Lente të ndërveprimit simbolik*” plotësojnë atë boshllëk të munguar.

Fusha e hulumtimit të simbolikës sociologjike mes studimit të Dervishit diskutohet në lidhje me terminologjinë më të përparuar dhe me disa tekste me ndikim të lartë ku interpretohen në dritën e kritikës sociologjike dhe ku aplikohen kriteret për një lexim të ndjeshëm të teksteve kërkimore në aspektin e elementeve përkatëse të fushës në fjalë jashtë sferës problematike dhe ku ilustron relevanca e tyre. “*Lente të ndërveprimit simbolik*” gjithashtu diskuton fushën e simbolizmit më të avancuar në kuptimin e koncepteve të Hall për interesat njohëse, emancipimin dhe komunikimin e paarritshëm, dimensionet e fshehura dhe shenjizat e gjuhëve simbolike. Nëse e kuptojmë saktë këtë na jep mundësinë e lejimit të konceptit të lëvizjes dhe zhvillimit që bëhen me stile efikase, ku zërat që variojnë mes kuptimeve dhe leximeve simbolike ndjekin dhe korespondojnë tek pyetet enigmatike dhe dyzuese që janë formuar në marrëdhënie me disa sense të paradhëna simbolikisht. Ndoshta këtu dialektika Hegeliane do të merrte një formë tjetër, duke argumentuar se simbolika sociologjike është e vetëndikuar nëpërmjet pyetjeve. Fozofia e Dervishit nuk është zbulimi i koncepteve që ekzistojnë në disa akte të njohjes, filozofia e tij është formacion i koncepteve. Dhe në këtë mënyrë edhe filozofët më të avancuar si Deleuze dhe Guattari do të gjenin mirëkuptim. Pra filozofia e Dervishit është një krijim i koncepteve, ndaj mbetet apriori një vlerë dhe një dimension edhe me vlerë globale sociologjike.

11. Mbyllje

Në tërësinë e saj poezia dhe krijimtaria, studimet e poetit dhe akademikut kontemporan Zyhdi Dervishi janë një ripozues

kompleks të fuqisë së fjalës që vjen nga mjeshtria e transformimit të vargut dhe tekstit në një sinjalizues iluzionesh dhe imazhesh në tërë dialektikën e tyre mesazhdhënëse. Që të shprehet kjo me një kuptim më të thjeshtë, në poezinë e këtij autori shihet plotësia e mjaft llojeve të ligjërit ku fjalët përdoren sipas mjaft rregullive të caktuara nga vetë autori. Po ashtu flet edhe ana studimore e autorit.

Kuptimi sintaksor i shmangur i autorit vjen i përputhur me tërë dinamikën letrare të poezisë që vjen si një parësore nga shkak i kërkesave shprehëse. Në poezinë e tij shihen mjaft fjalë të munguara midis fjalëve të përdorura, të cilat janë të zakonshme për ndërtimin sintaksor normal. Por në krijimtarinë e Dervishit kemi të bëjmë me një varg tipik poezie që endet në shtratin midis modernes dhe postmodernes në tërë fuqinë e tij të shprehjes.

Pikërisht kjo e bën poezinë e tij të jetë rrëqethëse, e plotë, dinamike, plot ritëm dhe kuptim, ndërkohë që ai krijon në arsyen e lexuesit mjaft përfytyrime që vijnë si rezultat i pasazheve derivuese. Tematika e hulumtimit të simbolikës sociologjike mes studimit të Dervishit merr një formë globale.

Bibliografi/Referenca:

- Addison, J. (2010) *Mbulimi i përparmë: Koleksione letrare*. Londwr dhe Nju Jork: Wildside Press LLC.
- Buchanan, I. & Marks J. (2000) *Deleuze dhe Literatura*. Edinburgh: Edinburgh University Press.
- Cascardy, J. A. (1992) *Tema e Modernitetit*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Ciardi, J. (2015) *Libri Botwrwr i Fjalws*. def. E “imazhet”.
- Claude Lévi-Strauss, C. (2008) *Antropologjia strukturale*. London: Hachette.

- Dervishi, Z. (1999) *Qiej të përthyer* (Poezi), Botimet “Emal”.
- Dervishi, Z. (2009) *Vetëklonimi i maskave* (Poezi), Botimet “Emal”.
- Dervishi, Z. (2005), *Jehonëlebetia* (Poezi), Botimet “Emal”.
- Dervishi, Z. (2014) *Mokra e hijeve* (Poezi), Botimet “Emal”.
- Dervishi, Z. (2016) *Lente të ndërveprimet simbolik*, Botimet “Emal”.
- Durkheim, E. (2014) *Rregullat e Metodologjisë Sociologjike: Tekste të Përzgjedhura mbi Sociologjinë dhe Metodën e saj*. London: Free Press.
- Geertz, C. (1973) *Interpretimi i kulturave*. London: Basic Books.
- Jones, C. (2006) *Përdorimi i vjetër në anglisht* “Poezi e shekullit XX”. Oxford: Oxford University Press.
- Nicholls, J. (2004) *Billywise*. Nju Jork: Bloomsbury.
- Kryqi i Brukselit, Hema, Libri i Vercellit, Libri i Exeterit, Codex, Librat, LLC, Librat e Përgjithshme LLC, Librat e Përgjithshëm.
- Schneidau, N. Herbert (1969) *Ezra Pound: Imazhi dhe realja*. Louisiana: Louisiana State University Press.
- Poezia e vjetër angleze (2010): Kenning, Lista e Kennings, Bede, Manuscript Cædmon,
- Terziu, F. (2007) *Kritika ndryshe: Vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare I*. Tiranë: Arbëria.
- Terziu, F. (2012) *Kritika ndryshe: Vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare II*. Nju York: Lulu

Symbolic communication: sociological invisibility in the studies of Zyhdi Dervishi

Abstract

The appearance and behavior of human interaction shows nothing or at least does not show the essence, because man develops his activity through symbol. Symbolism is implied in what the symbol itself hides. The study of symbolic communication is oriented towards the invisible structures of the human subject, from which derive the ways of interacting in a community.

Many scholars consider symbolism as the fundamental problem of knowledge and human understanding. In essence, the symbol is an instrument of thought, and the structure of thought is largely determined by language and culture. We are oriented through the cultural symbols and the special, contextual meanings we give to things. The symbol is very important to man, for it is the main form of understanding how we think, how we act and interact, shortly, our way of life, often its value is neglected or taken for granted.

In this article, through the analysis and interpretation of the study text 'Symbolic interaction lenses', by the author Zyhdi Dervishi we will try to recognize the space between the forms of thought and experience, and how they become apparent in Albanian culture. Essentially, we will know about the value and importance of studying symbolic interaction in Albanian society; we will see the factors that have led to the density and variety of subcultural symbols; display formats and functions of these symbols; on the basis of the methodology of the scholar, we will discuss the ways of explaining and decoding the sociological invisibility to Albanians.

Key notions: *symbolism, culture, communication, interaction*



NATYRA DHE KULTURA

Botim i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

ISSN 2078-7111



9 772078 711003 ▶